

QEVERISJA DHE INSTITUCIONET NË KOSOVË

1999-2012

Doktoranti: Adem Shala

Dorëzuar:
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në:
Shkenca juridike, me profil: E drejtë publike, për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ferit Duka

Numri i fjalëve: 60 000

Tiranë, qershor/2015

Abstrakti

Procesi qeverisës dhe institucional në Kosovë 1999-2012, është i ndikuar nga Bashkësia Ndërkombëtare, nga efektet globale dhe bashkëdyzimi i faktorëve e rrethanave specifike kosovare dhe atyre globale në rajon. Në rastin e qeverisjes dhe institucionalizimit të Kosovës, efektet globale ishin akoma më specifike si rezultat i grumbullimit të madh të problemeve për një kohë të gjatë. Qëllimi i këtij punimi qendron në gjetjet e përgjigjeve në pyetjet: Cilat janë kushtet, shkaqet, pasojat, aktet, sfidat dhe efektet kryesore të qeverisjes 1999-2012? Më cilat sfida ballafaqohen institucionet dhe qeverisja kosovare pas pavarësisë? Si të arriheshin efekte më cilësore të qeverisjes dhe institucioneve në këtë periudhë?

Procesi i qeverisjes ishte ballafaquar më kushte të pavoritshme: a) mungesë të traditës demokratike plurale; b) pengesa të jashtme; c) nivel të ultë të zhvillimit ekonomik dhe ambient biznesor të papërshtatshëm; ç) vonesë në reformat e tranzicionit; d) kulturë politike e biznesore të kaluar; e) përqendrim të pushtetit mbi burimet dhe sektoret egzistencial; ë) dukuri negative në institucione; f) mungesë të opozitës së mirëfilltë; etj. Të gjitha këto rrethana po ndikojnë drejtpërdrejt në karakteristikat dhe efektet institucionale e qeverisese.

Modeli i këtij studimi nis nga këndvështrime të shumta me metodat përkatëse, për kuptimin e shkaqeve, pasojave, korelacionet variabile dhe efektet. Kërkimi i faktëve specifike e konkrete kosovare dhe kuptimi e interpretimi i akteve juridike vendore e ndërkombëtare që ndërlidhen e ndërveprojnë reciprokisht në institucionet dhe proceset qeverisëse kosovare; duke përdor modele e strategji të hulumtimit më krahasime, vlerësime, etnografi vrojtuese, teori të bazuara, argumentim të fakteve e proceseve, që lidhen më temën në kohën e hapsirën e lartëcekur. Përdorimi i modelit eksperimental (që vetë koha i ka vertetuar); përfaqësimor përmes vezhgimit aktiv e pasiv e studimit kohor të përkufizuar të dukurive konkrete. Analiza e Raporteve monitoruese të institucioneve ndërkombëtare mbi qeverisjen dhe institucionet kosovare. Analiza e Raporteve të vetë institucioneve dhe raportet e shoqërisë civile, si dhe agjencioneve të pavarura monitoruese të qeverisjes në Kosovë. Krahasimi me pikëpamjet moderne të teorisë mbi qeverisjen demokratike dhe kushtet e objektivat e qeverisjes demokratike, do jenë qëllime të këtij studimi. Në veçanti, aspekti juridik i organizimit e veprimtarisë institucionale në qeverisje.

Abstract

The governing processes and institutions 1999-2012, are influenced by the International Community and global effects. This Kosovo specific governing process is a compound of two processes, specific kosovo circumstances and global effects in the region. In the case of Kosovo, the global effects were even more specific as a result of the large collection of problems over longer periods of time. The purpose this paper lies in finding the answers to the questions: What are global effects, causes, consequences, challenges, activities and effects of governance in the years 1999-2012? Which are the challenges which Kosovo institutions and government face after independence and in the future? How to achieve qualitative effects of governance? What are the negative trends in governance and institutions, and how to overcome them?

The governance process has faced adverse conditions: a) the absence of a plural democratic tradition; b) low level of economic development hence business environment unfit; c) delay in transition reforms; d) external obstacles such as the political business culture of the past; d) the concentration of power on the existential resource sectors; e) negative phenomenon in institutions; lack of genuine opposition etc. All these circumstances are affecting directly Global effects the characteristics of governance and institutional efficiency.

This study used multiple viewpoints on appropriate methods for understanding the causes, consequences, and variable correlations and effects. This study focused on researching specific facts related to Kosovo and in understanding the interpretation of local and international legal acts that relate to and interact with the processes on the Kosovo governance while employing models and strategies of research on comparisons, evaluations, observation ethnography, grounded theory, and evaluating the facts and processes related to the topic on the above mentioned area. This study used the experimental model represented through active and passive observations which is a time limited study of concrete phenomena. Furthermore, the study conducted analysis of monitoring reports of international institutions on governance and Kosovo institutions, analysis of reports of the institutions themselves and parts of civil society organizations, and independent monitoring agencies of the government of Kosovo. Comparisons were drawn with modern views of theories on the conditions and objectives of democratic governance

Dedikimi:

Ajshës, Adelinës dhe Anes.

Falënderime

Falënderoj udhëheqësin e punimit për sugjerimet e vlefshme metodike dhe veprimet pedagogjike-motivuese, në të gjitha fazat e punimit: në radhitjen e temave, thellimin e hulumtimit, në mënyrën e argumentimit, në përdorimin e metodave, referencave, etj. Kam pasur nderin, fatin dhe privilegjin që jam udhëhequr nga prof. Dr. Ferit Duka.

Falënderoj stafin akademik për sygjerimet gjatë konsultimeve dhe gjatë ditëve doktorale. Falënderoj stafin administrativ të UET-it për punën dhe informacionin mjaftë cilësor. UET-it, i jam mirënjohës për hapin e guximshëm dhe të përgjegjshëm në krijimin e mundësive për studime të doktoraturës dhe krijimin e kushteve konkurruese për zhvillimin shkencor. UET-i e hapi këtë mundësi dhe konkurrencë, për të cilën e falënderoj shumë duke i dëshiruar dhe uruar suksese cilësore.

Ndihma dhe përkrahja e institucioneve kosovare, e aktorëve të shumtë në procesin qeverisës, e qytetarëve dhe e OJQ-ve, nuk më mungoi, të cilët i falënderoj përzemërsisht.

Një falënderim i veçantë për familjen time, për miqtë dhe gjithë të afërmit e mi.

Shkurtesat:

ASK: Agjencioni Statistikor i Kosovës
AKI: Agjencioni Kosovare e Inteligjencës
AKM: Agjensionin Kosovar i Mirëbesimit
BE : Bashkimi Evropian
BRSS: Bashkimi i Republikave Sovjetike Socialiste
DP: Deklarata e Pavarësisë
EULEX: Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
GND: Grupi Ndërkombëtar Drejtues
GjND : Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
IPVK: Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë
ICO: Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në Kosovë
KGJK: Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK: Këshilli Prokurorial i Kosovës
KS: Këshilli i Sigurimit të OKB-së
KPA: Këshilli i Përkohshëm Administrativ
KTK: Këshilli Tranzitor i Kosovës
KPM: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës
KKK: Këshillit Kombëtar kundër Korrupsionit
MAPL: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT: Ministria e arsimit, shkences dhe teknologjisë
MBZHR: Ministria e bujqësisë dhe e zhvillimit rural
MEPSM: Misionin European për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes
MSA: Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit
NATO: Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OKB: Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJQ : Organizata Joqeveritare
OSBE: Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian
OEK: Oda ekonomike e Kosovës
OEGJ: Oda ekonomike gjermane
PSSP: Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i OKB-së për Kosovën
PCN: Përfaqësuesi civil ndërkombëtar në Kosovë
PSBE: Përfaqësuesi special i BE-së
PPP: Partneriteti Publiko-Privat
PUN: Prania Ushtarake Ndërkombëtare
RSFJ : Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
RFJ : Republika Federative e Jugosllavisë(Serbia dhe Mali i Zi)
SHBA: Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SKS : Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene
TMK: Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UNMIK: Misioni Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNDP : Programi i OKB për Zhvillim

Përmbajtja	5
<i>Parathënie</i>	<i>8</i>
Hyrje	17
1. Aspekte metodologjike	17
1.1. Objekti, qëllimet dhe hipotezat.....	17
1.2. Pyetjet kërkimore, Modeli dhe metodat.....	31
Kreu I. Karakteristikat e qeverisjes demokratike	35
1.1. Karakteristikat e përgjithshme	35
1.2. Pikëpamjet moderne	47
1.3. Kushtet dhe standardet	63
Kreu II: Qeverisja dhe institucionet e Kosovës para vitit 1999	73
2.1. Statusi juridik dhe qeverisja	79
2.2. Rrënimi i autonomisë	93
2.3. Qëndresa shqiptare 1989/99	95
Kreu III: Administrimi ndërkombëtar i Kosovës	105
3.1. Konferenca e Rambujesë	105
3.2. Rezoluta 1244 e KS	112
3.3. Korniza kushtetuese 2001	117
3.4. Cilësitë institucionale e qeverisë	121
3.5. Plani i Ahtisarit	139
Kreu IV: Statusi i ri politik e juridik i Kosovës: Pavarësia	150
4.1. Pavarësia dhe Kushtetuta	150
4.2. Institucioni legjislativ dhe ekzekutiv	162
4.3. Sistemi i drejtësisë dhe Gjykata kushtetuese	180
4.4. Administrata publike dhe Sektori i sigurisë	191
4.5. Qeverisja komunale	200
Kreu V: Konsolidimi i institucioneve dhe qeverisja	203
5.1. Sundimi i ligjit	204
5.2. Subjektet politike dhe institucionet	220
5.3. Kushtet për qeverisje demokratike	237
5.4. Të drejtat e njeriut dhe të pakicave	259

5.5. Institucionet dhe rritja ekonomike	267
Kreu VI: Proceset integruese dhe Republika e Kosovës	282
6.1. Fillesat e integrimit në BE: aspekti juridik e politik	282
6.2. Integrimi ndërshqiptar në suazat rajonale	304
6.3. Integrimi i veriut	309
Përfundimi	318
<i>Shenime plotësuese për burimet dhe literaturën</i>	<i>336</i>
Bibliografia.....	347

Parathënie

Nevojat dhe trendet zhvillimore në Kosovë, gjithnjë kërkojnë cilësi të re qeverisëse. Niveli i efektivitetit të institucioneve qeverisëse ishte i pamjaftueshëm për zgjidhjen e problemëve me të cilat përballej vendi. Qytetarët, organizatat e shumta monitoruese, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, raportet e BE-së, etj. i theksonin nevojat e domosdoshme e urgjente për konsolidimin e cilësisë qeverisëse: menjanimin e dukurive negative në institucione, sundimin e ligjit, krijimin e ambientit të sigurt e të përshtatshëm për investime, shërbime publike cilësore dhe politika zhvillimore. Duke besuar se institucionet dhe cilësia qeverisëse janë instrument esencial në krijimin e parakushteve zhvillimore, si dhe dëshira për të njohur, ndryshuar e zhvilluar këtë proces të ndërlikuar, më nxitën ta hulumtoj aspektin juridik të procesit qeverisës dhe veprimtarinë e efektet institucionale. Në fokus të veçantë ishte identifikimi i ndikimit të akteve juridike dhe ndërveprimi i faktorëve tjerë në ngritjen e cilësisë, efektivitetit dhe efikasitetit të qeverisjes. Pra, ndikimi i politikave konstitucionale në qeverisje e institucionalizim dhe efektiviteti i tyre në sferat tjera gjatë periudhës 1999-2012. U përcaktova për këtë periudhë ngase, shkaqet dhe efektet e konsolidimit të institucioneve dhe të se drejtës qeverisëse në Kosovë, dalin nga rrethanat e faktorët e shumë ndikues, pikërisht të kësaj periudhe 14 vjeçare.

Qellim i studimit ishte njohja dhe paraqitja e sfidave të konsolidimit juridik e institucional gjatë kësaj periudhe; ishte matja e vlerësimit i nivelit të respektimit të parimeve kryesore të mirëqeverisjes: konsolidimi juridik i procesit, vëzhgimi i zbatimit të rendit e ligjit, politika publike dhe ekonomike të suksesshme, llogaridhënia e lidërshpit, transparenca në vendimmarrje, hapja për debate e konkurrencë, iniciativa integruese, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje e procese dhe krijim i vlerave kulturore. Qellimi i këtij studimi ishte edhe analiza e efektivitetit qeverisës në ndryshimin e rrethanave gjatë kësaj periudhe, përmes akteve juridike dhe veprimtarisë institucionale.

Administrimi ndërkombëtar 1999-2008 arriti suksese fillestare në krijimin e institucioneve dhe sanimin e gjendjes, por në esencë e pengonte qeverisjen demokratike dhe institucionalizimin e pavarur sipas vullnetit politik të qytetarëve. Mungesa e kompetencave qeverisëse të faktorit vendor, funksionimi i brishtë i të gjitha

institucioneve gjatë kësaj periudhe, mungesat e infrastruktures së mirëfilltë juridike, niveli i ultë i zhvillimit ekonomik, mungesa e reformave, mungesa e përvojës pluraliste, gjendja e pas luftës, karakteristikat kulturore, etj., krijuan dukuri negative në institucione e qeverisje. Andaj, edhe efektet e qeverisjes dhe të institucioneve vedore e ndërkombëtare në Kosovë, gjatë kësaj periudhe nuk ishin të knaqshme. Pra, procesi i qeverisjes 1999-2008, ishte i subordinuar nga faktori ndërkombëtar. Si i tillë sillte gjendje kaotike, anarki dhe papërgjegjëshmëri. Në realitet kjo përkthehej në pengim të vetëqeverisjes dhe institucionalizimit të mirëfilltë demokratik kosovar, për shkak të mohimit të vetëvendosjes.

Pas shpalljes së Pavarësisë më 2008, u arrit konsolidimi juridik dhe organizativ i pavarur për qeverisje. Edhe pse ishte i ndikuar nga Plan i Ahtisarit dhe mbikqyrja ndërkombëtare për zbatimin e tij, ky proces politik dhe konsolidim juridik e institucional ishte një sukses i madh. Por edhe pas pavarësisë,(2008) vazhdoi mungesa e cilësisë në qeverisje dhe në institucione, me pasoja në shumë sfera e procese. Konsolidimi i mirëfilltë demokratik e efektiv i institucioneve dhe i qeverisjes, për shoqërinë kosovare u bë kusht dhe instrument esencial për ecje përpara. Grupe të caktuara brenda institucioneve, bartëse të dukurive negative, u shndërruan në uzurpues të institucioneve dhe pengesë për procese pozitive. Jo efektiviteti e joefikasiteti dhe dukuritë negative në institucione, u bënë shkak të jozhvillimit dhe pengesë e vonësë e procesit integruar. Kjo rrethanë më shtyri të përcaktohem për këtë temë të punimit, i cila kishte për qëllim të hulumtoj aspektin juridik të qeverisjes, formën qeverisëse dhe konsolidimin institucional në Kosovë 1999-2012, përkatësisht, efektet konkrete të tyre, si dhe kushtet, pengesat e dukuritë negative në institucione.

Ky studim ka për qëllim dhëniën e përgjigjeve shkencore pyetjeve: Si e përcaktoj Bashkësia ndërkombëtare procesin qeverisës e institucional në Kosovë dhe cilat ishin karakteristikat dhe efektet e tij? Cilat ishin karakteristikat e akteve juridike ndërkombëtare për qeverisjen kosovare dhe si ndikuan në cilësinë e akteve kushtetuese e ligjore vendore? Cilat rezultate i arriti qeverisja dhe institucionet gjatë administrimit ndërkombëtar 1999-2008? Si shprehej lidhshmëria e drejtpërdrejtë e qeverisjes dhe e institucioneve më vetëvendosjen? A ishte e mundur qeverisja demokratike pa pavarësinë? Çfarë ishin zgjidhjet kushtetuese e ligjore dhe sa ishin të

përshtatshme për qeverisje demokratike dhe efektive? Cilat janë kushtet për konsolidimin sa më cilësor e efektiv të qeverisjes? A është cilësia qeverisëse faktor esencial për zgjidhjen e problemeve të shumta kosovare gjatë kësaj periudhe? A është urgjente dhe e domosdoshme ngritja e cilësisë në qeverisje dhe konsolidimi demokratik institucional, për të krijuar parakushte për avancimin e një mori proceseve vitale? Cilat janë format dhe politikat konstitucionale më të përshtatshme për tejkalimin e gjendjes në Kosovë? etj.

Me mjaftë interes janë veshtruar ndërlidhja e akteve juridike të Forumeve ndërkombëtare për Kosovën dhe qeverisjen e saj, dhe ndikimi i proceseve globale e rajonale në qeverisjen kosovare. Është analizuar ndikimi dhe interpretimi i akteve juridike ndërkombëtare e vendore në qeverisje dhe në proceset shoqërore, politike, ekonomike e kulturore kosovare. Studimi kishte për qëllim hulumtimin e faktorëve që mundësojnë qeverisje sa më demokratike dhe avancimin e instrumenteve të kontrollit juridik, institucional e shoqëror të pushtetit, për të penguar vendimmarrjet autokratike e arbitrare për interesa të ngushta dhe ekstreme. Gjithashtu, në fokusin e interesimeve të mia ishin edhe çështjet se si të shtohet efikasiteti, funksionet dhe efektiviteti i kërkuar sipas zgjidhjeve juridike; si të krijohen politika konstitucionale, ligje e akte nënligjore, politika ekonomike dhe kulturore për tejkalimin e gjendjes; si të shpërqendrohen burimet e pushtetit mbi shoqërinë, ekonominë, pronën dhe informimin; si të konsolidohet vetëdija politike e qytetarëve në favor të kognitivës dhe përcaktimit të tyre për demokraci. Krijimi i subjekteve dhe lidhësive të përgjegjshëm, zgjedhje e konkurrencë parimore demokratike, debat konstruktiv, institucione të hapura e funksionale, rritje e zhvillim ekonomik, shërbime publike cilësore, avancim të pozitës ndërkombëtare, integrim të mirëfilltë, integrim të komuniteteve pakicë dhe respektim të të drejtave të njeriut, vetëqeverisje komunale, etj. janë gjithashtu probleme që kanë marrë jo pak vëmendje në këtë punim.

Rezultatet hulumtuese treguan se përgjegjësia e faktorit vendor në qeverisje dhe cilësia e këtij procesi, ishte dhe është esenciale për jetësimin e proceseve zhvillimore dhe tejkalimin e pengesave të brendshme e të jashtme. Janë analizuar me kujdes shkaqet dhe pasojat e gjendjes, si dhe faktet se çdo dështim në përmirësimin e qeverisjes, paraqet destabilitet me pasoja multidimensionale. Po ashtu është

konstatuar se mu për këtë çështje, qytetarët, elitat politike dhe faktori ndërkombëtar, duhet të jenë shumë të ndërgjegjshëm dhe të marrin përgjegjësinë, të përcaktohen e veprojnë për qeverisje e institucione demokratike sa më efektive. Sfidat më të rëndësishme të qeverisjes demokratike kosovare, sidomos pas shpalljes së Pavarësisë ishin: konsolidimi i mirëfilltë demokratik i institucioneve, përmirësimi i procesit zgjedhor, integrimi i veriut në qeverisje e institucione, menjanimi i dukurive negative në institucione e qeverisje, tejkalimi i varfërisë, papunësisë, krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe integrimi i mirëfilltë rajonal, avancimi në procesin e integrimit në BE dhe antarësimi i mëtejme në organizatat ndërkombëtare e në proceset pozitive globale.

Rezultatet hulumtuese vërtetuan se cilësia qeverisëse e institucionale varej nga një mori faktorësh, kushtesh e pengesash vendore dhe të jashtme, të cilat ky punim kishte për qëllim t'i identifikojë, diagnostikojë dhe të propozojë alternativa e parakushte juridike, konstitucionale, kulturore, politika ekonomike, etj. Në punim është theksuar se grupe për interesa të ngushta dhe bartëse të dukurive negative, të futura në udhëheqje partiake dhe në institucionet themelore të shtetit, po shpërfillnin përcaktimet juridike e qëllimore të qeverisjes, po rrezikonin zhvillimin demokratik e institucional dhe integrimin e afirmimin e Kosovës. Edhe grupe të jashtme të interesit, përmes organizatave ndërkombëtare, politikave të jashtme të vendeve të tyre dhe drejtpërsëdrejti, ndikonin në institucionet dhe qeverisjen kosovare përmes mënyrave, roleve dhe qëllimeve të shumta. Në studim analizohën edhe vështirësitë e integrimit të pakicave, në veçanti asaj serbe-deinstrumentalizimi i saj nga politika e gabuar serbe. Në këtë punim kërkohet që Bashkësia Ndërkombëtare të ruajë parimin e respektimit të multietnicitetit në Kosovë dhe të mos i favorizojë kërkesat destruktive të komunitetit serb të dirigjuara nga politika destruktive e Serbisë, në dëm të komuniteteve të tjera në Kosovë.

Ky punim thellon dhe zgjeron njohuritë mbi shkaqet qeverisëse e institucionale jozhvillimore të kësaj periudhe, si dhe afron parashikime e alternativa të dobishme për tejkalimin e gjendjes dhe avancimin e proceseve në të ardhmen. Theksohen përgjegjësitë në qeverisje, duke filluar nga institucionet, qytetari-votuesi, elitat politike partiake dhe intelektuale, mediet, shoqëria civile, shkenca, etj. Po ashtu

theksohet edhe përgjegjësia e Bashkësisë Ndërkombëtare në këtë proces. Studimi i këtyre dukurive në këtë periudhë, tregoi se pa institucione të pavarura e legjitime që respektojnë kushtetutshmërinë e ligjshmërinë, nuk mund të ketë qeverisje demokratike dhe efektive. Pengesat e Pavarësisë vinin nga jashtë, por ndërlidheshin drejtpërsëdrejti edhe me faktorin politik jociësor vendor. Pa një traditë e kulturë politike demokratike për një kohë bukur të gjatë, politika konstitucionale me proceset e veprimtarinë e institucioneve qeverisëse nuk mund të jenë efektive e të qëndrueshme. U kostatu se pa një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shpërqendrim e largim të pushtetit mbi burimet e shumta, nuk mund të ketë qeverisje demokratike, të cilat gjithashtu nuk mund të vijnë pa rend, sundim të ligjit e siguri, që urgjent duhet t'i sigurojë qeverisja dhe institucionet kosovare. Pra, ndikimi i gjendjes momentale po ndikon në qeverisje, por edhe qeverisja përmes forcave politike dhe efektivitetit të institucioneve duhet t'i tejkalojë këto ndikime negative, përmes krijimit të vullneteve politike, politikave të qarta zhvillimore dhe respektim të kushtetutshmerisë e ligjshmërisë në procesin qeverisës dhe me efikasitetin e sistemit të drejtësisë në denimin e bartësve të dukurive negative në institucione.

Lënda e këtij punimi është strukturuar në një mënyrë dhe formë që të përmbushen kriteret shkencore e metodologjike, që nevojiten për trajtimin e problematikës së marrë në shqyrtim. Punimi qelet më këtë parathënie, e cila ndiqet nga hyrja, gjashtë krerë, përfundimin, shenimet plotësuese dhe bibliografia.

Në parathënie janë paraqitë shkurtimisht disa nga aspektet kryesore që lidhen më përmbajtjen e punimit.

Hyrja, përmbanë të gjithë spektrin e çështjeve që lidhën më aspektin metodologjik: objektin, qellimet, hipotezat, pyetjet kërkimore, modelin dhe metodat e studimit.

Në Kreun I, paraqiten dhe trajtohen disa nga karakteristikat themelore të qeverisjes e institucioneve demokratike, pikëpamjet moderne për qeverisjen demokratike, matja dhe treguesit e karakterit demokratik të qeverisjes dhe rezultateve konkrete të vepritarisë institucionale, kushtet për qeverisje e institucione demokratike, ndikimi i formës qeverisëse e konstitucionale, dhe në veçanti, standardet që duhet synuar qeverisja demokratike. Të gjitha këto paraqitën në kontekst të krahasimit dhe vlerësimit më qeverisjen dhe institucionet në Kosovë.

Në Kreu II, analizohet pozita juridike, qeverisja dhe institucionet në Kosovë para vitit 1999. Kryesisht, analizohet aspekti kushtetues i federalizmit dhe statusi juridik i Kosovës, forma dhe përmbajtja e qeverisjes socialiste, rrënimi i autonomisë dhe qëndresa shqiptare 1989/99, Të gjitha këto, në kontekst të ndikimit të tyre në qeverisjen dhe institucionet e pas vitit 1999.

Në Kreun III, analizohet administrimi ndërkombëtar 1999-2012: Aktet juridike të forumeve ndërkombëtare për çështjen e Kosovës dhe qeverisjen e Kosovës nga faktori ndërkombëtar dhe Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, në veçanti karakteristikat e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, si bazë e qeverisjes. Format dhe cilësitë e akteve juridike dhe efektet institucionale e qeverisëse gjatë këtij administrimi. Korniza Kushtetuese (2001) dhe veprimtaria e institucioneve të Kosovës, përkatësisht roli, efektet dhe rezultatet e tyre. Karakteristikat e subjekteve politike dhe ndikimi i tyre në veprimtarinë institucionale dhe në rezultatet e procesit qeverisës. Në veçanti, analizohen karakteristikat e Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (mars/2007)-Plani i Ahtisarit; ndikimi i tij në formen e rendin qeverisës dhe në efektet institucionale. Kryesisht, analizohen përcaktimet obligative të këtij Plani për formën qeverisëse, kushtetutën, mbikqyerjen e realizimit, dhe përcaktimet për të drejtat e pozitën e komuniteteve pakicë. Ndikimet i tij në politiken konstitucionale, në përgjegjësitë e formën e institucionalizimit dhe ndikimin e tij në karakteristikat e efektet qeverisëse pas shpalljes së pavarësisë.

Në Kreu IV, shqyrtohet forma qeverisëse dhe karakteristikat e sistemit juridik të Kosovës së pavarur dhe formimi e konsolidimi i institucioneve sipas Kushtetutës. Theksohet pajtueshmëria e Deklaratës së Shpalljes së Pavarësisë dhe e Kushtetutës së Republikës së Kosovës me Planin e Ahtisarit, dhe efekti i saj në institucionalizim e qeverisje. Vlerësohet roli dhe ndikimi i njohjeve dhe antarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare, mbikëqyrja ndërkombëtare pas pavarësisë-përfundimi i saj, dhe Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në funksionimin dhe efektin institucional. Analizohet aspekti kushtetues e ligjor i përgjegjësive të institucionit legjislativ, qeverisë, kryetarit të Republikës dhe efektet e përgjithshme qeverisëse. Analizohet aspekti kushtetues e ligjor i konsolidimit të Sistemit të drejtësisë dhe efektet e rezultatet e këtij pushteti pas shpalljes së pavarësisë.

Analizohet roli, organizimi, përgjegjësitë dhe efektet e Gjykatës Kushtetuese, përcaktimet kushtetuese e ligjore dhe gjendja në Administratën publike, formimi dhe konsolidimi i Sektorit të sigurisë sipas përcaktimeve kushtetuese e ligjore. Një analizë e veçantë i kushtohet qeverisjes komunale/vendore, si në aspektin juridik dhe atë zbatues. Pra, në këtë pjesë të studimit analizohen zgjidhjet kushtetuese dhe forma qeverisese, formimi e konsolidimi organizativ i institucioneve sipas përcaktimeve të rendit kushtetuese e ligjor, dhe disa nga efektet e përgjithshme të tyre.

Në Kreun V, analizohet më gjerësishtë niveli e cilësia e konsolidimit dhe rezultatet e efektiviteti i institucioneve dhe qeverisjes në Kosovën e pavarur. Analizohen shkaqet, pasojat kushtet, standartet dhe faktor të shumtë me ndikim në efektet institucionale në sundimin e rendit dhe ligjit. Analizohet konsolidimi i konkurrencës pluraliste dhe cilësia e subjekteve politike, kontrolli parlamentar, efektet dhe rezultatet e sistemit zgjedhor, cilësia e konkurrencës pozitive-opozitive, kontrolli ndaj administratës, kontrolli nga mediet e pavarura dhe shoqëria civile, niveli e ndarjes së pushteteve, respektimi i të drejtave të njeriut, respektimi i të drejtave të pakicave etnike e niveli i integritetit të tyre, decentralizimi, implementimi i Konventave ndërkombëtare. Mandej, debatet, përpunimi i interesave konkrete gjatë vendimmarrjeve dhe shpërndarjes, sigurimi i buxhetit, sigurimi i shërbimeve publike, politikat sociale, politikat ekonomike, integriteti, ngritja e kulturës politike kognitive të votuesit, ruajtja e karakterit të hapur të institucioneve, ndryshimi përceptues dhe real i raportit shtet-shoqëri, respektimi dhe interpretimi i kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, ndryshimet kushtetuese, etj. Analizohet në veçanti niveli i ultë i sundimit të ligjit dhe shkaqet, pasojat e sfidat përkatëse. Analizohet përshtatshmëria e politikës konstitucionale dhe roli e funksioni i sistemit zgjedhor. Niveli i ndarjes në mes të pushteteve dhe kontrolli reciprok, në veçanti ndikimi i subjekteve politike më lidhshëm të tyre në procesin qeverisës. Ndikimi reciprok i zgjidhjeve kushtetuese e ligjore në njerën anë dhe tradita e kultura politike në anën tjetër, në funksionimin e institucioneve dhe në efektet qeverisese. Analizohen dhe vlerësohen kushtet e standardët për mirëqeverisje: aspekti i përshtatshëm kushtetues e ligjor-politika konstitucionale, niveli i zhvillimit ekonomik, tradita dhe kultura politike, shpërqendrimi i pushtetit dhe ndikimi i rrethanave ndërkombëtare e rajonale. Në veçanti, analizojmë rolin e institucioneve në rritjen

ekonomike dhe sfidat e problemet në këtë drejtim. Rregullimi kushtetues e ligjor i të Drejtave të Njeriut dhe niveli i respektimit të këtyre zgjidhjeve juridike. Në veçanti, zgjidhjet juridike dhe zbatimi i tyre në sigurimin e të drejtave të pakicave. U konstatu se për qeverisje demokratike kërkohet shpërqendrim i burimeve shoqërore dhe ekonomike të pushtetit si: prona, kapitali, dija, informimi, largimi i pushtetit partiak nga shërbimet publike, administratë efikase, liria e qarkullimit, kushtet për veprimtari biznesore, etj., të cilat arrihen përmes sundimit të rendit kushtetues e ligjor në të gjitha sferat. Institucionet dhe qeverisja duhej t'i siguronte qytetarët dhe ekonominë nga veprimtaria e presioni i grupeve të presionit, nga grupet e korruptuara në pushtet dhe nga grupet e ndërlidhura me to; ti denonte bartësit e këtyre dukurive.

Në Kreun VI, i analizojmë proceset integruese të Republikës së Kosovës. Kryesisht, aspektin juridik, politik e ekonomik të integrimit të Kosovës në BE. Pasqyrohen sukseset vështirësitë e sfidat juridike e politike të integrimit në BE dhe sfidat ekonomike të këtij integrimi. Paraqitën vlerësimet e Raporteve të BE-së për gjendjen konkrete të qeverisjes dhe institucioneve në Kosovë 2011-2012. Një interesim i veçantë i kushtohet edhe integrimit ndërshqiptar në suaza të bashkëpunimit intenziv rajonal. Në veçanti, analizohen sfidat e institucionalizimit në Komunitet e veriut të Republikës së Kosovës dhe marrëdhëniet me Serbinë.

Përfundimi përmban: konkluzionet, rezultatet, mungesat e defektet e procesit qeverisës e veprimtarisë institucionale 1999-2012. Njëherit, edhe rekomandime që kërkoheshin për avancimin demokratik e efektiv të këtij procesi gjatë kësaj periudhe, e që vlejné edhe për periudhën pas vitit 2012 dhe gjendjen aktuale.

Rezultatet e këtij punimi thellojnë njohuritë e gjertanishme, veçmas për shkaqet, pasojat dhe sfidat institucionale e qeverisese pas pavarësisë, të cilat janë të dobishme për hapjen dhe vazhdimin e debateve për gjendjen aktuale dhe parashikimin e së ardhmes. E rëndësishme është analiza e akteve ndërkombëtare që përcaktuan formen dhe përmbajtjen e zgjidhjeve kushtetuese e ligjore, të cilat ndikuan në efektet e institucioneve dhe qeverisjes. Angazhimet konkrete të Bashkësisë ndërkombëtare me kapacitetet qeverisese të faktorit kosovar, të cilat nuk ishin gjithëher të suksesshme. Rezultatet e këtij studimi konstatuan se institucionalizimi dhe procesi i qeverisjes gjatë

kësaj periudhe, ishte i varur nga aktet juridike ndërkombëtare për Kosovën, nga proceset globale dhe e Drejta Ndërkombëtare, si dhe nga kapacitetet kosovare.

Studimet e këtyre akteve, vendimmarrjeve, veprimtarisë e proceseve, e pasurojnë literaturën mbi zhvillimet kosovare si precedent historik. Zgjidhja e çështjes së Kosovës dhe e vetëqeverisjes, është shembull specifik se si arrihet liria e një vendi kur shoqëria është e vendosur, këmbëngulëse, e guximshme, sakrifikuese e vizionare, dhe kur beson thellë në vlerat njerëzore, shoqërore, juridike e politike vendore dhe në vlerat, proceset e aktet juridike e politike ndërkombëtare. Thekson në veçanti, përgjegjësinë, angazhimin dhe organizimin e qytetarëve më lidhshëm e tyre për të konsoliduar cilësinë qeverisëse në favor të proceseve zhvillimore, konsolidimit demokratik, integritetit dhe afirmimit ndërkombëtar të shtetit demokratik të Kosovës. Punimi thekson se si vendet me ndikim pozitiv ndërkombëtar, korin sukses kur mbrojnë aspiratat demokratike e liridashëse të vendit përkrahës. Po ashtu dëshmon edhe të kundërtën, se si i deformojnë proceset dhe institucionet kur veprimet dhe qëllimet nuk përputhen me interesat e vendit e shoqërisë konkrete. Rezultatet e këtij studimi afirmojnë kërkesën për bashkëveprim të mirëfilltë pozitiv të Bashkësisë ndërkombëtare më faktorin pozitiv kosovar në menjanimin e dukurive negative dhe në konsolidimin e qeverisjes demokratike; për ta përmbyllur sa më suksesshëm procesin antarësimit, integritetit dhe zhvillimit të Kosovës. Në këtë punim analizohen aktet juridike, pasqyrohen rezultatet politike, morale, organizative e vepruese të Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë. Gjithashtu, afirmon përvojat kosovare për krizat dhe proceset e ardhshme kudo në botë. Thekson nevojën për avancimin e cilësisë në qeverisje dhe menjanimin e dukurive negative në të gjitha institucionet qeverisëse dhe fuqizimin e sundimit të rendit e ligjit.

Shpresojmë se, ky studim do të jetë një kontribut modestë në pasurimin e avancimin e kërkimeve juridike të se drejtës publike, të drejtës kushtetuese dhe të drejtës administrative, në sferën e qeverisjes e konsolidimit të sistemit juridik e organizativ të institucioneve, në këtë periudhë. Mbetem gjithashtu më shpresë, se studimi do të jetë i dobishëm për institucionet vendore dhe të jashtme, për shoqërinë e gjerë, botën akademike e intelektuale të interesuar dhe për gjeneratat e ardhshme.

Hyrje

1. Aspekte metodologjike

1.1. Objekti, qëllimet dhe hipotezat

Aspekti juridik i procesit qeverisës dhe i zhvillimit institucional në Kosovë gjatë periudhes 1999- 2012, është i lidhur, i ndikuar dhe i kushtëzuar nga një mori proceseve, faktorëve e rrethanave vendore, rajonale e globale. Kosova kishte specifika të sistemit politik e juridik, të cilat ndikuan në karakteristikat qeverisëse e institucionale: pozitën juridike në RSFJ, okupimin 1989-99, qendresën dhe sakrificat 1989-1999, administrimin ndërkombëtar 1999-2008, pavarësinë 2008 dhe mikqyrjen ndërkombëtare. Nga viti 1999 kishte qeverisjen përmes akteve juridike ndërkombëtare, rregullim kushtetues e ligjor specifik të ndikuar nga Bashkësia ndërkombëtare, formim e konsolidim fillestar të institucioneve, ekonomi të rrënuar, vonesë në reforma, kulturë politike specifike si rezultat i të gjitha rrethanave paraprake, përkatësi etnike, etj. Të gjitha këto rrethana së bashku, kanë përcaktuar forma dhe përmbajtje juridike (kushtetuese e ligjore) dhe dukuri e efekte të procesit qeverisës e institucional më kompetenca e përgjegjësi konkrete. Andaj, objekt studimi janë: Aktet juridike të institucioneve ndërkombëtare për Kosovën-aspekti përcaktues i qeverisjes dhe zhvillimit institucional; aktet juridike kosovare që rregullojnë qeverisjen; raporti i akteve juridike ndërkombëtare për Kosovën ndaj akteve qeverisëse të Kosovës-subordinimi, bashkëveprimi dhe ndërvarësia e tyre; forma dhe rendi juridik i qeverisjes; sfidat e formimit dhe të konsolidimit të institucioneve gjatë administrimit ndërkombëtar dhe pas pavarësisë; përgjegjësitë dhe veprimtaria e institucioneve kryesore: legjislativë, ekzekutive, gjyqësore e administrative; ndarja dhe balancimi i pushtetëve; antarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare-rol i tyre në qeverisje; problemet

zhvillimore; procesi i integritit; etj. Pra, formësimi kushtetues i institucioneve dhe roli, ndikimi, efektet e rezultatët qeverisese gjatë periudhës 1999-2012. Njëherit, do të analizohen edhe ndikimet e rrethanave, proceseve e faktorëve të shumtë, në qeverisjen kosovare dhe në veprimtarinë e institucioneve.

Në veçanti, do të analizohen e interpretohen aktet bazë qeverisese: Rezoluta 1244 e KS të OKB-së (1999), Plani i Ahtisarit (2007), Korniza Kushtetuese (2001) dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008) dhe organizimi e veprimtaria institucionale me efektet konkrete. Do të analizohen dispozitat juridike të këtyre akteve, për të dhënë përgjigje se sa ishin të përshtatshme këto akte juridike qeverisëse për procesin qeverisës dhe proceset tjera në Kosovë. Do të analizohen efektet dhe rezultatët konkrete të veprimtarisë institucionale në: respektimin e kushtetutshmërisë e ligjshmërisë-kontrolli juridik; në sundimin e ligjit; në kontrollin ndërinstitucional dhe autonominë e pushteteve; në procesin zgjedhor dhe konkurrencën pozitive-opozitive; në sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve publike; në sigurimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut; sigurimin e të drejtave të komuniteteve etnike pakicë dhe integritetin e tyre; në menjanimin e dukurive negative në institucione; në zhvillimin e qendrueshmërisë ekonomike; në decentralizim; implementimin e së drejtës ndërkombëtare; në njohje, antarësim dhe afirmim ndërkombëtar; në integritet e bashkëpunim rajonal; në procesin e integritit në BE; në ngritjen e kulturës politike kognitive të votuesit; ruajtje të karakterit të hapur të institucioneve; në ndryshim e raportit shtet-shoqëri; sigurimin e lirisë/pavarësisë së mediave; në politat sociale; në legjitimitetin demokratik, sovranitetin popullor-qytetar e territorial; në forcat politike, shoqërore e ekonomike; ndikimin e grupeve të interesit dhe grupeve të presionit në vendimmarrjet institucionale; etj. Pra, studimi ka për qëllim

përcaktimin e shkaqeve e pasojave sipas faktorëve, intensitetin e influencave dhe korelacionet në mes variablëve.

Objekt studimi janë aspekti juridik, proceset, ngjarjet, veprimet dhe tradita qeverisëse në Kosovë para vitit 1999, ngase, ndikimet e tyre janë evidente. Gjatë viteve 90-ta, filloi procesi i shpërbërjes së RSFJ-së, ndryshimet e sistemit qeverisës në vendet socialiste dhe ndryshimet globale. Serbia më 1989, në menyrë antikushtetuese e rrenoi autonominë e Kosovës dhe e okupoi atë. Nga ana e qytetarëve dhe e subjekteve politike kosovare u shfaqen proceset rezistuese politike, nxjerrja e akteve burimore kushtetuese, organizime institucionale vetëqeverisëse dhe manifestime protestuese. Ndërsa, gjatë vitit 1998-1999 edhe rezistenca ushtarake. Të gjitha aktet kushtetuese dhe rezistenca e shoqërisë e subjekteve kosovare dhe e institucioneve, karakterizoheshin më rezistencë këmbëngulëse për vetëvendosje e vetëqeverisje përmes institucioneve legjitime e të pavarura. Veprimtaria këmbëngulëse dhe sakrificat kosovare gjatë viteve 80-ta dhe 90-ta, veçmas 1998-99, e thelluan përkrahjen dhe ndërhyrjen e drejtëpërdrejtë të Bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Më ndërhyrjen ndërkombëtare u krijuan rrethana, akte juridike dhe forma qeverisëse e institucionale më ndikime të theksuara nga faktori i jashtëm.

Ndërhyrja ndërkombëtare në rajon dhe në çështjen e Kosovës ishte e vazhdueshme gjatë viteve të 90-ta, më një mori vendimeve, rezolutave, opinioneve, veprimëve, sanksioneve e presioneve. Por, ndërhyrja më e drejtëpërdrejtë në Kosovë ndodhi në vitin 1999, përmes akteve dhe veprimeve ndërkombëtare më të drejtëpërdrejta, kryesisht më: Organizimin e Konferencës së Rambujesë (1999); Ndërhyrjen ushtarake të NATO-s (1999) dhe Rezoluten 1244 të KS të OKB-së (1999), të cilat krijuan rrethana dhe akte juridike të reja të cilat përcaktonin qeverisjen dhe institucionalizimin në Kosovë. Gjatë

Administrimit ndërkombëtar 1999-2008, qeverisja dhe institucionalizimi në Kosovë bazohej kryesisht në Rezoluten 1244 të OKB-së. Kjo Rezolutë, (pika 11) përcakton përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare në krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtësore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare të statutit, duke marrë tërësisht parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648) të cilat, përshkruajnë dhe përcaktojnë procesin qeverisës në këtë fazë kalimtare.

Gjatë administrimit ndërkombëtar 1999-2008, autoritet kryesor vendimmarrës në qeverisjen kosovare, me ‘veton’ e vet në sferën legislative e ekzekutive, ishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP), deri në të drejtën e shpërndarjes së institucioneve të zgjedhura kosovare. I gjithë mekanizmi dhe organet e Administratës ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK), nuk jepnin përgjegjësi ndaj organeve të zgjedhura kosovare dhe as para gjyqësorit në Kosovë. Kemi kompetenca tejet të reduktuara të faktorit vendor në qeverisje, të cilat u sanksionuan edhe më Kornizën kushtetuese (2001). Rregullimi juridik kushtetues-Korniza Kushtetuese (2001) ishte e imponuar. U formuan Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë (IPVK) dhe ato komunale. Kuvendi i Kosovës nuk e kishte funksionin e vertetë ligjvënës e kontrollues. Gjyqësori nuk ishte i pavarur. Edhe ekzekutivi dhe institucionet tjera nuk kishin kompetenca përmbajtësore.

Faktorit vendor në qeverisje, nuk i lejohej mundësia e krijimit të vullnetit politik e as të marrë vendime të rëndësishme. Procesi i qeverisjes 1999-2008, ishte i subordinuar nga faktori ndërkombëtar. Si i tillë sillte gjendje kaotike, anarki dhe papërgjegjshmëri. Në realitet kjo përkthehej në pengim të vetëqeverisjes dhe institucionalizimit të mirëfilltë demokratik kosovar, për shkak të mohimit të pavarësisë. Rezoluta 1244 e KS të OKB-së,

sa i përket Statusit ndaj Kosovës ishte e papërcaktuar deri në ndonjë zgjidhje të ardhshme. Periudhë kjo, që zgjati tetë vite mbajtje peng të vullnetit politik të shqiptarëve në Kosovë, si rrjedhojë sillte mungesën e reformave dhe mungesën e krijimit të traditës qeverisëse demokratike të pavarur si faktor tejet i rëndësishëm. Institucionet kosovare ishin pa pushtet real në asnjë sferë. Ndër shkaqet tjera, që drejtpërsedrejti ndikuan në cilësitë e qeverisjes gjatë bashkëqeverisjes me Bashkësinë ndërkombëtare ishte edhe kaosi ligjor. Kishte rregullore të paqarta dhe kishte përpjekje për imponim edhe të legjislacionit jugosllav. (Stavileci,2000:336) Kryeadministrator i UNMK në Rregulloren nr. 1 (1999) pati kërkuar që në Kosovë të vlejnjë ligjet serbe që ishin në fuqi deri më 23 mars të vitit 1999. Më vonë u konsolidu rregullativa juridike e organizative funksionale e UNMK-ut dhe Korniza kushtetuese (2001) me Institucionet e përkohshme të Kosovës. Këto akte, institucione dhe procese ishin pozitive në raport me të kaluarën kosovare, por ato ishin jocilësore dhe joefektive sa duhet, më pasoja edhe për të ardhmen.

Qeverisja ndërkombëtare 1999-2008-UNMIK, ishte joefektive dhe penguese e proceseve, për shkak të statusit të pazgjidhur të Kosovës. Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë (IPVK) gjatë bashkëqeverisjes me faktorin e jashtëm, ishin të penguara, të varura dhe u mungonin kompetencat. Si të tilla, ishin edhe joefektive e joefikase, të papërgjegjshme e jodemokratike në kompetencat e përgjegjësitë e tyre dhe ndaj procesit politik. Këto pengesa dhe dukuri negative në institucione, kanë ndikuar negativisht në shumë sfera e procese, pasojat e të cilave janë afatëgjata. Pakica serbe, veçmas ajo në veri, tolerohej nga Bashkësia ndërkombëtare të luaj rol destruktiv në procesin e institucionalizimit në qeverisjen kosovare, duke mos u integruar dhe duke krijuar institucione paralele të lidhura me Serbinë. Pasojat e kësaj tolerance shihen edhe

sot e kësaj dite. Të gjitha këto, ndikuan drejtpërdrejt në organizimin e funksionimin institucional dhe në cilësinë e efektet qeverisëse gjatë kësaj periudhe.

Pas pavarësisë, (2008) u krijuan parakushte për qeverisje e organizim institucional të pavarur, por prap më mbikëqyerje ndërkombëtare sipas përcaktimeve të Planit të Ahtisarit, (2007) në funksion të mbikëqyerjes së zbatimit të tij. U shpall pavarësia (Deklarata e Pavarësisë, prill/2008) dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës (qershor/2008), si dhe formimi e konsolidimi i institucioneve sipas kësaj Kushtetute. Kushtetuta e Kosovës përcaktoj formen qeverisëse të shtetit: Republikë parlamentare, shtet unik dhe i pandashëm dhe përmbushi parametrat kushtetues të shtetit demokratik të së drejtës. Në (nenin 1) përcaktohet: “Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm.” Pra, sadoqë Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës përcakton modelin e qeverisjes lokale dhe modelin mjaft të avancuar të decentralizimit në funksion të garantimit e realizimit të të drejtave të komuniteteve pakicë, Kosova është shtet unik dhe i pandashëm. Në (nenin 2) të Kushtetutës përkufizohet qartë sovraniteti i Kosovës: “sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshem, i patjetërsueshem dhe i pandashëm dhe mbrohet më të gjitha mjetet e përcaktuara në këtë Kushtetutë dhe me ligj.” Në trajtimin e sovranitetit (neni 20-Dispozitat e përgjithshme) përcaktohet roli i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe normat juridike të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare si marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare në Kuvend, (neni 20.1) të cilat kanë epërsi ndaj normave të brendshme të Republikës, duke i ratifikuar ose duke i disponuar në vetë Kushtetutën e Kosovës, (neni 20) psh. siq ishin Plani i Ahtisarit dhe Rezoluta 1244, të cilat nuk ishin në kundërshtim më sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës, siq e vertetoj edhe Opinioni i Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë, për

ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë. (2010) Kushtetuta, përcakton qartë kontrollin juridik të pushtetit: “Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.” Në nenin (2.1) “Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet në pajtim me Kushtetutën nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.” Duke shprehur epërsinë e këtij akti dhe kushtetutshmërinë e ligjshmërinë në procesin qeverisës, përkufizon se “Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë” (Neni 16.1, K-I)

Forma e qeverisjes, ndarja e pushteteve dhe përgjegjësitë kryesore të institucioneve kryesore, përcaktohen qartë në Dispozitat themelore, në veçanti në nenin 4:

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë. 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë. 4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. 5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. 6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. 7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës. (Kapit. I, neni 4, par. 1-7).

Kushtetuta, në kapituj të veçantë, më nene e paragrafe të qarta, i përcakton: Të drejtat dhe Liritë themelore; Të drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre; Kompetencat, strukturën dhe funksionet-përgjegjësitë e Institucionit legjislativ e ekzekutiv; Sistemin e Drejtësie; Gjykatës Kushtetuese; Marrëdhëniet ekonomike; Qeverisjen lokale dhe organizimin territorial; Sektorin e sigurisë; Institucionet e pavarura; deri të Dispozitat përfundimtare dhe në Kapitullin e XIV: Dispozitat kalimtare. Në pajtim me këto zgjidhje kushtetuese dhe ligjet përkatëse, procedurat e aktet tjera nënligjore, u konstituuan të gjitha institucionet themelore me kompetencat e përgjegjësitë e tyre. Cilësia qeverisëse kosovare

varej nga ky rend juridik, nga kjo politikë konstitucionale dhe nga tradita e qeverisjes. Varej nga përvetësimi praktik i raporteve e parimeve në mes organeve e institucioneve; nga zbatimi i parimeve demokratike; nga zbatimi konkret i ligjit dhe politikave; nga forcat shoqërore, politike, kulturore dhe ekonomike në Kosovë; dhe nga ndikimi i proceseve rajonale e globale. Funksionimi sipas aspektit juridik-kushtetutshmërisë e ligjshmerisë ishte në nivel të konsiderushem, dhe kjo ishte thelbësore për stabilitetin e rendit politik e juridik dhe karakterin demokratik të qeverisjes kosovare, por efektiviteti, efikasiteti dhe rezultatët duhej të ishin më të larta.

Pas shpalljes së Pavarësisë, Kosovën e njohën numer i konsiderushem i vendeve ekonomikisht të zhvilluara, më ndikim rajonal e global dhe anëtare të Organizatave të rëndësishme ndërkombëtare. Kosova u bë anëtare e FMN-së (2009) dhe u antarësu në BB (2009) me të drejta të plota. Antarësimi në këto dy institucione globale ekonomike-finansiare ishte e një rëndësie të veçantë dhe me ndikim në efektet qeverisese e zhvillimore. Pengesa ka në antarësimin e saj në OKB, si rezultat i pengesave nga Rusia. Në Kosovë ende qëndron UNMIK-u me rolin rudimentar, pasi ende nuk ka Rezolutë të re në OKB për Kosovën. Në OSBE, pengesë është edhe Serbia. Anëtarësimi në Këshillin e Europës ishte më i lehtë ngase 2/3 e vendeve antare e kanë njohur Republikën e Kosovës. NATO është e pranishme në Kosovë më një mision force (KFOR-PUN). Edhe BE është mjaftë prezente në Kosovë, sfidë është mosnjohja e pesë vendeve të BE-së, por parlamenti dhe organet tjera të BE-së dhe vendet e saja më ndikim, janë përkrahese të procesit të konsolidimit institucional dhe afirmimit të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto suksese dhe pengesa të pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, po ndikojnë në suksese dhe veshtirësi konkrete qeverisese. Por njëherit, edhe vetë ngritja e cilësisë qeverisëse në

Kosovë ndikon fuqishem në afirmimin dhe anëtarësimin e integrimin e Kosovës, dhe anasjelltas, niveli i ultë i cilësisë është pengesë serioze për anëtarësim e integrim. Kundërshtaret e pavarësisë përpiqen ta pengojnë institucionalizimin e mirëfilltë të pakicës serbe (pjesa veriore), për ta penguar qeverisjen dhe institucionalizimin e plotë, pikërisht, për ta penguar afirmimin ndërkombëtar dhe integrimin e anëtarësimin e mëtejshëm të Kosovës. Pengesë serioze janë edhe dukuritë negative në qeverisje dhe në institucione, përkatësisht, bartësitë e tyre dhe institucionet përkatëse joefektive në eliminimin dhe denimin e bartësve të këtyre dukurive negative.

Pas pavarësimit, qeverisja efektive demokratike ishte proces tejet i vështirë, për shkak të mungesës së kushteve bazë për demokraci: nivelit të ultë të zhvillimit ekonomik privat; mungesa e traditës demokratike; pengesat e jashtme; kultura politike e biznesore; përqendrim i pushtetit mbi burimet dhe sektoret egzistencial; ambienti biznesor i papërshtatshëm; mungesa e opozitës së mirëfilltë; etj. Për të arritur rezultate zhvillimore kërkohej cilësi e re qeverisëse, në fokus të thellimit e krijimit të parakushteve për investime, procese bashkëpunuese rajonale, avancime në procesin integruar në BE dhe në organizatat e proceset rajonale e globale. Këto mund të avancoheshin, përmes angazhimit të qartë e të vendosur të faktorit vendor dhe ati ndërkombëtar njëkohësisht, për të konsoliduar cilësinë institucionale e qeverisëse. Por, këto përpjekje nuk ishin në nivelin e duhur. Sukseset nuk munguan, por nevojat për konsolidimin cilësor demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës ishin urgjente dhe të mëdha. Cilësia qeverisëse dhe institucionale pas shpalljes së Pavarësisë paraqiste thelbin e zhvillimit, ngase, Pavarësia e mirëfilltë nuk mund të përmbajtësohej pa cilësi në qeverisje e institucione në bazë të rendit juridik përkatës. Kjo cilësi e qeverisjes varej nga një mori faktoresh e

rrethanash. Varej nga: cilësia e rendit politik e juridik, i cili edhe pse i imponuar nga Plani i Ahtisarit, konsiderohej i mjaftushëm dhe sipas standarteve demokratike, por implementimi i tij nuk ishte i lehtë ngase mungonte: cilësia e subjekteve politike dhe e lidërshipt; tradita politike e qeverisë; niveli i zhvillimit ekonomik; shtresëzimi plural i shoqërisë; procesi i avancuar integruar; pozita e volitshme gjeopolitike dhe infrastruktura e zhvilluar, mungesa e vullnetit politik për luftimin e dukurive negative në institucione dhe mungonte efektiviteti i gjyqësorit ndaj bartësve të dukurive negative.

Efektiviteti qeverisës pas shpalljes së pavarësisë, ishte i ndikuar edhe nga e kaluara e tejzgjatur e qeverisjes joefektive; nga jozhvillimi ekonomik; papunësia; varfëria; mungesa e investimeve; uzurpimi i subjekteve nga udhëheqja partiake dhe depërtimi i grupeve të korruptuara në institucione, mosluftimi i dukurive negative në institucione për një kohë të gjatë; përqendrimi i pushtetit; etj. Këto kushte e shkaqe, patën pasoja në cilësinë e funksioneve institucionale, në nivelin e ultë të realizimit të përgjegjësisë të vetë parlamentit si institucion bazë i demokracisë parlamentare. Niveli i ultë i zbatimi të ligjit, niveli i ultë i kontrollit ndërinstitucional, veçmas, i parlamentit ndaj ekzekutivit dhe ndaj institucioneve të pavarura, defektet e procesit zgjedhor, karakteristikat e subjekteve politike dhe lidërshipt të tyre, vetëdija politike e qytetarëve, etj, kanë sjell pasoja në rritjen e korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe në mosluftimin e tij. Dukuritë negative në institucione e dëmtonin buxhetin e shtetit, ekonominë dhe shoqërinë: duke i deformuar investimet publike dhe duke krijuar pasiguri për investitorët potencial të brendshëm e të jashtëm dhe në jocilësinë e shërbimeve publike e administrative.

Ndikim në rezultatët qeverisësë kishin edhe qëndrimet e vendeve fqinjë; ndikimet ndërkombëtare në rajon; niveli i shoqërisë civile dhe mediave; mungesa e forcave të reja

opozitare; mungesa e politikave të qarta zhvillimore ekonomike, etj. Në veçanti, niveli i zhvillimit ekonomik ishte i ndërlidhur drejtëpërsedrejti, ngase pa zhvillim të sferës ekonomike private nuk ka qeverisje demokratike dhe nuk ka shpërqendrim të pushtetit, e as shoqëri civile të avancuar. Por, edhe pa qeverisje efektive, sundim të rendit e ligjit, sigurisë, politikave të përshtatshme ekonomike, administratë cilësore e shërbime publike cilësore, të cilat duhej t'i siguronin institucionet-qeverisja, nuk kishte zhvillim ekonomik e as shoqëri civile përkatëse. Pra, egziston një ndëridhje kushtëzuese reciproke për tejkalimin e situatës. Pa përpjekje të shumanshme e gjithëpërfshirëse të faktorëve e aktorëve të shumtë, duke filluar nga qytetaret e lidërsipi dhe deri të përkrhja e jashtme e mirëfilltë, nuk kishte qeverisje cilësore, e as zhvillim e integrim.

Infrastruktura juridike, sundimi i ligjit, politikat ekonomike dhe shërbimet administrative, nuk ishin në nivel. Edhe infrastruktura bankare, rrugore, urbanizmi, furnizimi më rrymë, etj, nuk ishin të konsoliduara. Infrastruktura ligjore ishte në proces të konsolidimit dhe plotësimit, por zbatimi i ligjit dhe i rendit e sigurisë, nuk ishte në nivelin e kënaqshëm. Investimet kapitale publike dhe shpenzimet tjera të qeverisë, përcilleshin me dukuri negative dhe më mbikëqyrje të ulët. Të gjitha këto dukuri shkaqe e pasoja, ishin rezultat edhe i traditës së kaluar dhe vlerave ndaj biznesit, ndaj pronës publike dhe asaj private. Pra, institucionet dhe qeverisja ende nuk kishin dhënë efektet e duhura, ngase nuk influenconin sa duhet dhe si duhet në parakushtet për zhvillimin e qendrueshëm ekonomik.

Ky studim, ka për qëllim thellimin e kuptimit të rëndësisë së shumanshme që po e thekson Bashkësia Ndërkombëtare për sundimin e ligjit, demokracinë, respektimin e të drejtave e lirive të njeriut dhe respektimin e të drejtave të pakicave, jo vetëm për të mirën e vendit por edhe për stabilitet në rajon e në botë si rezultat i qeverisjes demokratike. “Se

shtetet liberale dhe demokratike sjellin paqë dhe stabilitet të sistemit, [sistemit ndërkombëtar-A.Sh.] po fiton gjithnjë peshë, duke u provuar si i saktë, të paktën në Evropë.”(Hasani, 2010:51) Fukuyama thekson se “Qeverisja e dobët e kompromiton parimin e sovranitetit mbi të cilin është ndërtuar rendi ndërkombëtar mbas sistemit Westphalian.” (Fukuyama, 2010:142) Shkaktare e krizave ndërkombëtare në rajone, duke e përfshirë edhe krizën në RSFJ dhe çështjen e Kosovës, ishte dështimi i qeverisjes dhe i institucionalizimit demokratik efektiv. Pra, procesi i qeverisjes dhe veprimtaria e institucioneve, është një problem madhor edhe ndërkombëtar, jo vetëm problem i brendshëm e humanitar dhe i të drejtave të njeriut, por edhe i sigurisë dhe i zhvillimit global. Andaj, qëllimi i përkrahjes ndërkombëtare, sipas Fukuyam-ës është: “si të promovojmë qeverisjen e shteteve të dobëta, të përmirësojmë legjitimitetin e tyre demokratik dhe të forcojmë institucionet e vetë qëndrueshme.”(2010:139) Ky synim pozitiv i Bashkësisë ndërkombëtare po bëhet “projekti kryesor i politikave bashkëkohore ndërkombëtare...si rezultat i shpresës sonë se vendet e varfëra do të kenë një mundësi për t’u zhvilluar ekonomikisht¹ (Fukuyama, 2010:139) Me realizimin e Pavarësisë, Kosova dhe qytetarët e saj u shndërruan në faktor stabiliteti dhe sigurie, por nevojat dhe mundësitë zhvillimore ishin dhe janë akoma më të medha.

Duke u entuziasmuar më formën qeverisëse demokratike e zbatimin e ligjit në vendet e zhvilluara demokratike dhe nga raportet në mes tyre, Fukuyama theksonte se “kemi arritur pikën fundore të evolucionit ideologjik të njerëzimit dhe universalizimit të demokracisë perëndimore, si formë përfundimtare të qeverisjes së njerëzve.”

(1989:325) Por, për vendet e tranzicionit dhe për Kosovën, format demokratike dhe përcaktimet juridike të qeverisjes demokratike, nuk është lehtë të funksionojnë. Ngase, siç thotë Bzhezhinski për format juridike demokratike: “ato janë enë të zbrazëta që duhet mbushur më përmbajtje.”²(1996:83) Kosova e vonuar në reforma të tranzicionit, më pengesa afatëgjata në institucionalizim të pavarur, gjendjen e rëndë ekonomike, etj., nuk e kishte të lehtë që format juridike të sistemit qeverises demokratik, t’i përmbushte me përmbajtje efektive demokratike. Ndikimi i kulturës shoqërore e politike, i vlerave, traditës, qëndrimeve, sjelljeve e shprehive të elitat, të zyrtarët dhe të qytetarët, ishte një faktor esencial për nivelin e respektimit të kushtetutshmërisë në procesin qeverisës dhe në sundimin e ligjit në Kosovë, gjatë periudhës në fjalë.

Sfidë e përmirësimit të qeverisjes ishte menjanimi i korrupsionit dhe i dukurive tjera negative në institucione, avancimi i sundimit të ligjit dhe avancimi i procesit integruar në funksion të zhvillimit. Respektimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në procesin e qeverisjes, është esenca e qeverisjes demokratike. Thëllimi i respektimit të ndarjes së pushtetëve dhe kontrollit reciprok, fuqizimi i gjyqësorit dhe i rolit e funksioneve të parlamentit në raport me qeverinë dhe ndaj të gjitha institucioneve tjera, reformimi i administratës, konsolidimi i parimeve demokratike të procesit zgjedhor, etj., ishin domosdoshmëri për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit në institucionet kosovare pas pavarësisë. Të gjitha këto masa ishin të domosdoshme dhe urgjente për ta përmirësuar cilësinë e procesit qeverises dhe veprimtarinë e institucioneve sipas kushtetutshmerisë. Konsolidimi juridik e institucional, krijoi parakushte për qeverisje e institucione me

rezultate e stabilitet rajonal, më rezultate konkrete në formimin, konsolidimin dhe me efekte e rezultate konkrete, por më cilësi e efekte ende jo të kënaqshme sipas standarteve demokratike dhe sipas nevojave zhvillimore e përcaktimeve kushtetuese e ligjore. Statika juridike kërkohet t'i përshtatet dinamikës shoqërore e politike dhe përmirësimit më efektiv të qeverisjes kosovare. Ngase, praktika dhe normimi shpeshherë devijojnë nga qëllimet e normimeve kushtetuese, nuk funksionojnë ose nuk implementohen për shkaqe e arsye të shumta. Andaj, duhej shikuar dukuritë e tilla me kujdes dhe në frymën e efektivitetit e parashikimeve që të amendamentohen disa nga zgjidhjet kushtetuese dhe ligjet e aktet nënligjore përkatëse, për të arritur qëllimet dhe efektet konkrete qeverisëse. Në Kapitullin e parafundit të Kushtetutës përcaktohet procedura e ndryshimit dhe amendamentimit, ku parashehiet votimi i 2/3 e shumicës së deputetëve dhe 2/3 e deputetëve që përfaqësojnë komunitetet pakicë, dhe interpretimin nga Gjykata kushtetuese për vlerësimin e pajtimit të amendamenteve të propozuara me parimet kushtetuese. Pra, Kushtetuta e Kosovës radhitet ndër Kushtetutat “e ngurta” sa i përket procedurave për amendamentim. Por, duhet të përcaktohet e interpretohet qartë se, kërkesa evotimit të 2/3 e deputetëve që përfaqësojnë komunitetet pakicë, të vlejë vetëm për ndryshimet që mund të prekun pozitat dhe të drejtat e komunitetit pakicë, e jo për ndryshimet tjera që nuk kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve pakicë.

Proceset integruese janë përcaktim i shprehun edhe në Kushtetutën e Kosovës (2008) si “synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike” (preambula) por, për të arritë këtë kërkohet stabilitet i institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve, aftësinë për tu përballur më konkurrencën-forcave të tregut

brenda BE-së, sigurimin e një ekonomie funksionale dhe aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Pra, kërkohet qeverisje dhe institucione më cilësi e standarde implementuese demokratike. Por, edhe vetë hapat parapërgaditor dhe mbështetja në procesin e integritit nga BE-ja dhe organizatat tjera, mundësojnë dhe krijojnë parakushte për qeverisje e menjanim të dukurive negative në qeverisje, siç është p.sh. procesi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asocimit (MSA), procesi i sigurimit të kushteve për liberalizimin e vizave, etj. Qeverisja kosovare duhet t'i përkushtohet përgatitjes së vendit për integrim, që d.m.th. të ngrit nivelin e cilësisë demokratike, efikase e efektive të veprimtarisë institucionale sipas përcaktimeve kushtetuese dhe kërkesave të BE-së dhe të reformoi e përshtatë legjislacionin. Pra, këto janë sfidat institucionale pas pavarësisë dhe sfidat juridike, politike e ekonomike të integritit në BE dhe në organizatat tjera.

Institucionet kosovare pas shpalljes së pavarësisë, sipas Kushtetutës dhe formimit e konsolidimit institucional u përcaktuan për këto standarde të qeverisjes: kontrollit dhe kufizimit kushtetues-shtetit të së drejtës; kontrollit reciprok të pushteteve; funksioneve pozitë-opozitë, decentralizimit përmes pushtetit lokal-komunal; sigurimin e pavarësisë dhe efikasitetin e gjyqësorit; respektimin dhe jetësimin e të drejtave të pakicave; të drejtave dhe lirive të njeriut; sigurimin e shërbimeve cilësore publike; politikën sociale; të drejtat e punës; qarkullimin e lirë të njerëzve dhe kapitalit; parashikimin si zvogëlim i pasigurisë; planifikimet; kushte më të volitshme për aktivitet biznesor, etj., Mandej, zgjidhja e konflikteve pa dhunë; ndërrimi i qetë i pushtetit; respektimin e vendimeve të Gjykatës kushtetuese; siguria e qytetarëve; cilësia e jetës, politikat për ruajtje të ambientit; paqja dhe integrimi; etj. Pra, këto ishin standarde parimore që duhej t'i arrinte qeverisja, institucionet dhe shoqëria kosovare. Sukseset e tilla qeverisëse 2008-2012 nuk munguan,

por mbetej edhe shum për të bërë pas periudhes që po e hulumtojmë. Andaj, ky punim do t'i analizojë këto efekte dhe rezultate qeverisëse, sipas zgjidhjeve kushtetuese e ligjore dhe nivelit implementues të këtyre përcaktimeve juridike, duke i identifikuar shkaqet, pasojat, vështirësitë dhe efektet konkrete institucionale e qeverisëse të kësaj periudhe.

1.2.Pyetjet kërkimore, Modeli dhe metodat

Disa nga pyetjet që punimi do të sjellë përgjigje shkencore janë: Cilat ishin karakteristikat e akteve juridike qeverisëse dhe si e përcaktuan formen, cilësitë, efektet dhe rezultatet qeverisëse e institucionale në Kosovë gjatë periudhës 1999-2012? Cilat ishin veçantitë e karakteristikat e përgjithshme qeverisëse dhe institucionale gjatë bashkëqeverisjes me Bashkësinë ndërkombëtare? Cila ishte forma qeverisëse pas pavarësisë? Me cilat sfida u ballafaquan institucionet dhe qeverisja kosovare pas shpalljes së pavarësisë? Cilat ishin shkaqet, pasojat e sfidat, që kanë ndikuar në cilësinë institucionale e qeverisëse? Si ndikoj cilësia qeverisëse në sferat tjera? Cilat ishin dështimet në reforma, në konsolidim institucional dhe në zgjidhjen e problemeve? Si të arrihej qeverisja me demokratike sipas sistemit juridik-kushtetues dhe krijimi i kulturës përkatëse? Sa implementohej sundimi i ligjit, autonomia dhe kontrolli reciprok i pushteteve, debati, parimet demokratike të procesit zgjedhor dhe konkurrenca, respektimi i kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, efikasiteti, reformimi i administratës, rritja ekonomike dhe zhvillimi, integrimi e mirëqenia? Cilat ishin shkaqet, bartësit, dhe pasojat e dukurive negative në institucione? Cilat ishin strategjitë dhe mënyrat e luftimit të dukurive negative? Si të ruhej karakteri i hapur i institucionëve? Pse nuk integrohej pakica serbe dhe si të integrohej ajo? Cilat ishin zgjidhjet kushtetuese e ligjore për të drejtat e

komuniteteve pakicë dhe sa ishin implementuar ato? Cilat zgjidhje kushtetuese e ligjore duhej ndryshuar? Si të ndikohej në zhvillimin ekonomik dhe në integrim? etj.

Ky studim është kërkimor empirik, analitik, normativ e interpretues juridik dhe teorik. Studim strukturor nga këndvështrime të ndryshme, për analizën, argumentimin dhe vlerësimin e funksioneve të shtetit-istitucioneve dhe të së drejtës në Kosovë gjatë periudhes 1999-2012, i cili do të limitohet në shkaqet, pasojat, efektet dhe rrjedhat e përgjithshme. Studimi do të analizojë në vija të përgjithshme aktet ndërkombëtare juridike qeverisese dhe ato të Kosovës, raportin në mes tyre, si dhe politikat, vendimet, strategjitë dhe efektet e tyre konkrete në institucionalizim e qeverisje dhe në proceset tjera. Ekzistojnë punime shkencore me analiza të konsiderueshme për këto tema, por, theksimi, interpretimi e plotësimi i njohurive dhe përmbledhja në punime të caktuara disiplinore, është njëri ndër qëllimet e këtij punimi.

Kompleksiteti i objektit të studimit, kërkoi modele e strategji të hulumtimit me analiza, krahasime, vlerësime, etnografi vrojtuese e teori të bazuara. Pra, kërkoi këndvështrime të shumta e studim multidimensional me metodat përkatëse. Si referencë krahasuese dhe vlerësuese, ishin standardet e qeverisjes konstitucionale demokratike të vendeve perëndimore dhe teoritë moderne mbi qeverisjen demokratike. Pra, u bënë krahasime e referime sipas teorive moderne mbi qeverisjen efektive demokratike dhe zgjidhjeve kushtetuese e ligjore përkatëse, implementimit të standardeve demokratike të raportuara nga monitorimet dhe analizat e organizatave globale e vendore.

Metodat e përdorura në këtë punim janë cilësore, sasiore e të përziera, me teknikat metodike për mbledhjen e të dhënave parësore e dytësore. Hulumtimi u bë përmes argumentimit, klasifikimit, rishikimit të të dhënave e rezultateve të gjertanishme; përmes

mbledhjes së treguesve dhe analizës e sintezës së tyre përmes induksionit e deduksionit. Veçanërisht, duke ju qasur dallimeve, shkaqeve dhe pasojave sipas faktorëve dhe intensitetin e influencave në qeverisjen kosovare. Argumentimi, paraqitja e rezultateve kërkimore, u bë sipas preferencave metodologjike për hulumtime kërkimore juridike.³

Burimet e të dhënave për këto çështje, janë marr nga: a) Aktet juridike ndërkombëtare dhe aktet juridike kosovare dhe të RSFJ-së, që përcaktonin rendin juridik të qeverisjes; b) Raportet e institucioneve ndërkombëtare qeverisese në Kosovë dhe ato të institucioneve kosovare; c) Raportet mbikëqyrëse e monitoruese të institucioneve e organizatave ndërkombëtare dhe vendore; ç) Politikat, strategjitë, projektet e vendimet e vendeve më ndikim dhe të organizatave rajonale e globale; d) Statutet, Programet, Politikat, Strategjitë dhe Vendimet e subjekteve politike kosovare; e) Literatura e jashtme e vendore që lidhet më temën; ë) Raportimet nga shoqëria civile dhe nga mediet e pavarura e kritike; i) Opinionet e qytetarëve dhe të aktorëve të shumtë të këtij procesi; etj. Të gjitha proceset e kësaj periudhe i kam vëzhguar e hulumtuar aktivisht, gjatë gjithë kësaj periudhe.

Literatura e kohës në RSFJ, kishte karakter vlerësues superlativ për sistemin politik vetjak dhe si e tillë, i mungonte niveli i duhur i aspektit analitik-kritik. Edhe literatura e jashtme, si rezultat i rendit botëror ekzistues të asaj kohe, ka ngjyrat e veta në vlerësime e këndvështrime. Literatura e botuar pas viteve të 90-ta është më e plotë, më analitike, më kritike dhe më objektive.

Kreu I: Karakteristikat e qeverisjes demokratike

1.1. Karakteristikat e përgjithshme

Qeverisja dhe institucionet demokratike, funksionojnë sipas përcaktimeve kushtetuese e ligjore dhe rregullojnë funksionimin e raporteve në mes të individit, shoqërisë, pushtetit dhe shtetit. Institucionet janë organe e veprimtari të shumta, të cilat përmes legjislacionit, vendimmarrjeve, politikave dhe zbatimit të tyre arrijnë efekte e qëllime të caktuara. Politikat qeverisëse bëjnë përpunimin e interesave, shpërndarjen e mundësive dhe krijimin e parakushteve publike, si dhe sigurojnë të drejta, marrëdhënie e bashkëpunim ndërshtetëror e global. Qeverisja demokratike, së bashku me Institucionet dhe të Drejtën, bëjnë garantimin e proceseve të organizuara e qëllimore për rregullimin e proceseve shoqërore, politike, ekonomike e kulturore. Ato bëjnë edhe rregullimin juridik të sistemit politik të qeverisjes, si parakusht esencial për funksionimin demokratik të institucioneve dhe qeverisjes, si veprimtari e rregulluar me akte juridike.

Qeveria demokratike me institucionet përkatëse marrin pushtetin legjitim për qeverisje përmes pluralitetit organizativ, zgjedhjeve demokratike, përmes sundimit të ligjit e kushtetutshmërisë-rendit juridik, në të gjitha procedurat. Pushteti i fituar përmes procedurave legjitime dhe i rregulluar juridikisht për vendimmarrje e veprimtari institucionale i përmbahet sovranitetit kushtetues e ligjor, sovranitetit qytetar-votes, sovranitetit të parlamentit dhe sovranitetit të jashtëm shtetëror-kombëtar, si dhe të së drejtës ndërkombëtare. Territori, popullsia, pushteti e sovraniteti të ndërlidhura funksionalisht, janë elemente përmbajtësore të sistemit juridik e politik të qeverisjes. Pra, pavarësi shtetërore-territoriale dhe vetëqeverisje, me respektim të së drejtës vendore dhe të së drejtës ndërkombëtare. Llambro Filo, në këtë kontekst të përgjithshëm thekson se

“qeverisja është agjencia thelbësore përmes së cilës formulohen dhe realizohen veprimet e funksionet e saj në kuadrin e një komb-shteti të caktuar dhe të marrëdhënieve me komb-shtetet e tjera.” (Llambro, 2012:17)

Qeverisja me institucionet krijojnë dhe zbatojnë politika të subjekteve politike sipas kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, për ndikim në procese politike, ekonomike e kulturore. Këto politika qeverisëse janë veprimtari publike me ndikim në jetën publike dhe në atë private. Hejwood thekson se, funksionet themelore të qeverisjes janë: mbrojtja dhe marrëdhëniet e jashtme, zbatimi i ligjit, vetëmbrojtja e rendit politik, juridik, ekonomik, kulturor i vlerave, etj. drejt efektivitetit zhvillimor.⁴ (Hejwood, 2002) Këto janë disa nga karakteristikat përmbajtjesore të institucioneve dhe qeverisjes demokratike. Të tilla duhet të jenë edhe në realitetin dhe specifikat juridike qeverisëse e institucionale kosovare, me gjithë vështirësitë evidente të kushteve dhe vështirësive në hapat e parë të formimit, konsolidimit e funksionimit të mirëfilltë.

Institucionet dhe qeverisja demokratike me të drejtën, përmirësojnë funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë.⁵ (Schmidt, 2010) Qeverisja demokratike zhvillon sistemin, rregullimin normativ të sistemit-kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore, dhe vetë procesin e qeverisjes, për një mori ndikimesh e efektesh të domosdoshme për procese të shumta vitale. Racionalizojnë efikasitetin e punëve e veprimtarive, për të pasur efekte e rezultate të parapara. Ruajnë sistemin dhe institucionet nga ndikimet e jashtme destruktive. Sigurojnë funksionimin normal sipas përgjegjësive të vetë institucioneve, zhvillimin e tyre sipas nevojave momentale, qëllimeve e parashikimeve. Kontrollonjë

efektet dhe rezultatet. Ruajnë karakterin e hapur të procesit qeverisës dhe të institucioneve. Bëjnë mbrojtjen, përpunimin e kohezionin e interesave të grupeve e shtresave të caktuara. Medisoni, ndër të tjera theksonte: “Në kombe të civilizuar interesi i tokës, interesi i tregtisë, interesi i parasë, si dhe interesa të tjera të vogla, rriten dhe ndahen në klasa të ndryshme, secila e stimuluar nga sentimente dhe pikëpamje të ndryshme. Rregullimi i këtyre interesave të shumëllojshme dhe të mpleksura, përbën detyrën kryesore të legjislacionit modern.” (Shreder & Klik,1989:40)

Përmes politikave ekonomike dhe instrumenteve makroekonomike, qeverisja dhe institucionet ndikojnë në ecurit ekonomike, shpërndarjen e investimeve publike dhe mirëqenien ekonomike, sigurojnë parakushte biznesore, ndërvarësi ekonomike e financiare me jashtë, rritje ekonomike dhe shndërrimin e kësaj rritje në investime në sferat publike infrastrukturore e shërbime publike, në politikën sociale dhe zhvillim të sferave joekonomike.⁶(Dornbusch & Fischer, 2000:251-279) Ndërsa:

në vendet e tranzicionit, politikat ekonomike institucionale duhet bërë implementimin e reformave dhe strategjisë përmes BB dhe FMN-së dhe këshilltarëve ekonomikë akademikë; duhet të garantojë stabilitetin makroekonomik, liberalizim të çmimeve-sipas ligjeve të tregut vendor dhe global, politikë sociale sipas rrethanave, konkurrencën dhe bashkëpunimin sipas tregjeve globale, privatizimin dhe konkurrencën, në veçanti rregullimin dhe implementimin e legjislacionit përkatës⁷(Fall, 1991)

Procesi i qeverisjes përmes veprimtarive në institucione, përmes subjekteve politike dhe lidërshpit, votuesve, qytetarëve, zyrtarëve publikë, shoqërisë së organizuar civile, medieve, etj., krijon vullnetin politik dhe vendimmarrje përmes institucioneve përkatëse, në pajtim me vlerat e qëllimet si dhe në pajtim me kushtetutshmërinë e ligjshmërinë. Këto të fundit i plotëson, interpreton, zhvillon e ndryshon sipas procedurave të parapara dhe

nevojave zhvillimore momentale e afatmesme. Pra, qëllim ka sigurinë dhe garantimin relativ të proceseve kryesore të një vendi.

Hejwood thekson se, qeverisja bën institucionalizimin e politikave. Qeverisja me institucionet përkatëse janë proces i drejtimit, ndikimit e përpunimit të caktuar të interesave, në organizimin e tërësisë shoqërore të shtetit e shoqërisë dhe marrëdhënieve në mes të vendeve.⁸ (Hejwood, 2002:313-417 & 423-441) Procesi i qeverisjes është i ndërlidhur drejtpërsëdrejti me institucionet, ngase qeverisja demokratike bëhet kryesisht përmes institucioneve sipas kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Institucionet marrin karakter përmbajtësor funksional nga ky proces i qeverisjes dhe nga programet e subjekteve dhe nga ndikimet permanente të shoqërisë, grupeve të interesit dhe ndikimeve nga jashtë. Institucionet dhe qeverisja dallojnë për nga forma e rregullimi juridik i kompetencave, i raporteve në mes tyre, qëllimeve, funksionalitetit, interesave, vendimmarrjeve, efekteve, rezultateve, etj. Institucionet politike janë organe, mjete, hapësira, veprimtari procedurale e juridike, përmes të cilave bëhet normimi, rregullimi e zbatimi i raporteve, duke i thelluar e ndryshuar proceset në sfera të caktuara. Pra, institucionet politike dhe procesi i qeverisjes janë organe dhe funksione të krijuara nga një proces i gjatë historik në rrethana, struktura shoqërore e politike me interesa të caktuara, përmes proceseve shoqërore, ekonomike, politike e kulturore. Janë krijuar si rezultat i ballafaqimit, konflikteve, kompromiseve, harmonizimit dhe integritit të interesave; si rregulla të stabilizuara, parime të normuara e të pranuara për një kohë të gjatë,

funkionalee të qëndrueshme; si garanci të domosdoshme për rregullimin e funksionimin e tërësisë shoqërore, në rrethana e momente konkrete politike e shoqërore.

Duke folur për institucionet, ligjshmërinë e qeverisjen, Aleksis de Tokwil, ndër të tjera thotë se: “institucionet lindin duke e marrë përsipër përgjegjësinë e vetëqeverisjes së një brezi për të mbrojtur ligjshmërinë e fituar me vështirësi, të lirisë së individit, të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit për brezin tjetër.”(1998:31) Russo, kreator të institucioneve e konsideronte popullin “si vullnet të përgjithshëm dhe si marrëveshje konstitutive.” Ndërsa, S. Simoni, H. Spenser, E. Durkemi, M. Weber, e të tjerë, i konsideronin institucionet si “sende të jashtme” të veçanta nga shoqëria. (Giddens, 2004:298-334) Ky mendim, duket se vjen nga fakti se institucionet ishin krijuar historikisht nga gjeneratat dhe periudhat e kaluara, dhe për shoqëritë momentale dukeshin si të jashtme. Hegeli, institucionet i konsideronte si krijesa të “idesë së përgjithshme objektive” si realizim të saj.(1964:423) R. Orino theksonte se institucionet janë “ideja në vepër dhe përpjekja që të krijohet diçka.”(1959:39) Marksi dhe Engelsi e shihnin funksionin e institucioneve në ruajtjen e raporteve klasore “si prodhuese dhe riprodhuese” të atyre raporteve. Pikëpamjet se institucionet janë universale dhe të dobishme e funksionale për të gjitha kohërat dhe vendet, përfaqësohet kryesisht nga Lefever, Stras, Fugo, Altuser, Fukuyama, etj. Markuze mendonte se shoqëria mund të ekzistojë edhe pa institucione. (Giddens, 2004:298-334)

Pikëpamjet bashkëkohore për qeverisjen dhe institucionet demokratike, të përcaktuara më kushtetutat e vendeve konkrete, po karakterizohen më një mori të standardeve: sundimin e rendit dhe ligjit, konkurrencën përmes pluralizmit, sundimin e shumicës dhe respektimin e pakicës, kontrollimin e shumicës qeveritare, procesin zgjedhor demokratik,

konkurrencën pozitë- opozitë, kontrollin ndërinstitucional dhe kontrollin e administratës, kontrolli nga mediet e pavarura dhe shoqëria civile, respektim të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave etnike, decentralizim, implementim i Konventave dhe të së drejtes ndërkombëtare, debatet, përpunim të interesave konkrete gjatë vendimmarrjeve dhe shpërndarjes, sigurimin e buxhetit, sigurimin e shërbimeve publike, fondeve e politikave sociale, politikat ekonomike, integrim e synime globale, ngritjes së kulturës politike kognitive të votuesit, ruajtjes së karakterit të hapur të institucioneve, ndryshimit esencial të raportit shtet-shoqëri, mbrojtjen dhe interpretimin e kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, etj. Këto standarde parimore duhet t'i synojë edhe mirëqeverisja kosovare.

Bazat kryesore të mirëqeverisjes janë: konsolidimi juridik i procesit, llogaridhënia e lidershipit, transparenca në vendimmarrje, hapja për debate e konkurrencë, vëzhgimi i zbatimit të ligjit, politika e suksesshme ekonomike, iniciativa integruese, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje e procese, krijim i vlerave kulturore, ruajtje e ambientit, etj., në favor të cilësisë së jetës së qytetarit sot dhe në perspektivë. Qeverisja dhe institucionet demokratike mundësojnë zhvillim, tejkalim të krizave dhe para pengim të tyre. Të gjitha këto, duhet të jenë synim i qeverisjes dhe i institucioneve kosovare, në kushtet dhe rrethanat ekzistuese të përcaktuara me akte kushtetuese.

Varësisht nga format e organizimit dhe funksionimit të institucioneve e pushteteve, raporteve në mes tyre dhe praktikave qeverisëse në vende të ndryshme, kemi: qeverisje parlamentare, presidenciale dhe gjysëmpresidenciale, që përcaktohen për nga përgjegjësitë ndarja, e kontrolli reciprok në mes pushtetit legjislativ e ekzekutiv dhe ndaj institucioneve tjera. Për nga roli, kompetencat dhe funksionet, kemi institucione rregullative: legjislative, ekzekutive, gjyqësore, administrative, etj. Për nga funksionaliteti, rezultatet dhe efektet,

kemi: institucionet dhe qeverisjen e vendeve perëndimore, vendeve ish-socialiste, institucione të vendeve në zhvillim, etj. Për nga cilësia pjesëmarrëse e vendimmarrëse dhe mënyrat e qeverisjes kemi institucione autokratike dhe demokratike, dhe shumë forma e nënforma të tjera. Karakteristikat e qeverisjes dhe institucioneve varen nga aspekti konstitucional, forcat shoqërore, politike, ekonomike, kultura, tradita, etj. të vendeve e rajoneve konkrete. Praktikën e format e fituara gjatë historisë në vendet e zhvilluara, dallojnë dukshëm me ato në vendet që bëjnë emitimin e tyre. Një realitet i emitimit të dobët dhe tjetërsimit qeverisës e institucionale, e kemi edhe në Kosovë.

Përmes qeverisjes dhe institucioneve mbrohen dhe realizohen interesat të përgjithshme të publike, por, prioriteti i interesave dallon dukshëm, ngase përpunimi i interesave shkon në favoren e atyre që dominojnë në sferën ekonomike dhe grupeve qeverisëse të lidhura me to. Kjo varet nga roli dhe funksioni konkret i institucioneve dhe forcave politike e shoqërore në rastet konkrete.⁹ (Wilson, 1990) Në vendimmarrje, shpeshherë ndikojnë grupe të interesit dhe të presionit për interesat grupore, e jo siç propagandohet në teorinë dhe juridiksionin kushtetues: për qeverisje demokratike e interesat të përgjithshme. Edhe në qeverisjen e institucionet kosovare 1999-2012, u shfaqën grupe të interesit dhe grupe të presionit me ndikime negative, të kundërta me qëllimet politike e përcaktimeve juridike të qeverisjes demokratike.

Procesi i qeverisjes varet edhe nga bazat ideore të teorive politike; nga zgjidhjet kushtetuese e ligjore dhe nga niveli i zbatimit të tyre; nga ecurit ekonomike, tradita qeverisëse e institucionale, kultura në shumë sfera; nga forcat shoqërore e politike dhe interesat konkrete; ndikimet nga jashtë, etj. Të gjitha këto karakteristika, në vijën të

përgjithshme janë prezente edhe në rrethanat dhe kushtet qeverisëse e institucionale kosovare. Edhe qeverisja kosovare duhet të synojë institucione të hapura, origjinalitet e kreacion, transparencë e qëllime të qarta në pajtim me përcaktimet juridike. Të bëjë përpunimin e interesave dhe politikave që zbusin ekstremet, kompromise pozitive e funksionale për të gjitha shtresat sociale dhe qytetarët e vendit. Këto synime gjithherë duhet të jenë synime orientuese e qëllimore, duke mos e mistifikuar e konsideruar qeverisjen momentale si sistem institucional e qeverisës i përkryer, por, si sistem i hapur dhe në përshtatje të vazhdueshme me proceset, duke mos e humbur qëllimin dhe parimet, dhe aktiv në zgjidhjen e problemeve. Rezultatet e tilla qeverisëse e institucionale në Kosovë ende janë fillestare në realizimin e këtyre përcaktimeve juridike e politike, por, nevojat dhe proceset vendore, rajonale e globale e kërkojnë një rezultat të tillë.

Përcaktimet kushtetuese, ligjet, aktet nënligjore, procedurat dhe zbatimi i tyre-politika konstitucionale, janë themeli i domosdoshëm i mirëfilltë për sundimin e rendit shoqëror, rendit politik e juridik, ekonomik, moral e kulturor.¹⁰ (Hejwood, 2002:315-323) Procesi i qeverisjes demokratike, domosdo kërkon rregullimin juridik të përshtatshëm të këtij procesi, për të pamundësuar vendimmarrjet arbitrare, për të rritur kontrollin dhe përgjegjësinë, transparencën, sigurinë e llogaridhënien. Amarty Sen thekson se, institucionet dhe qeverisja liberale demokratike është mjet, qellim, e instrument i zhvillimit, që sigurojnë e garantojnë lirinë e individit, zhvillimin dhe aftësimin e tij. Ai nuk e konsideron zhvillim vetëm rritjen ekonomike, por shpërndarjen e asaj rritjeje për krijimin e kushteve të mirëqenies e zhvillimit human për të gjithë; asnjë qytetar të mos jetë i privuar nga mundësitë e barabarta për pjesëmarrje në shërbime publike e sociale: në

shkollim, mbrojtje shëndetësore, sociale, etj. Ngase, zhvillimi i lirë i individit është instrument-qëllim dhe mjet i zhvillimit të mirëfilltë, i cili ndikon në cilësinë e pjesëmarrjes në qeverisje.¹¹ (Amartya, 1999)

Proceset globale dhe ndikimi i tyre në qeverisjet e të gjitha vendeve është në proces të rritjes sasiore e cilësore me ndikime të drejtpërdrejta. Kjo rezulton nga lidhshmëria e ndërvarësia e të gjitha sferave në nivel rajonal e global.¹² (Soros, 1999:10) Proceset globale të fuqishme dhe ndikimi i tyre në qeverisjen e vendeve, po del si nevojë e domosdoshmeri për një qeverisje globale, këtë e theksojnë shumë autor edhe Pierre Calame (2009). Qeverisja bashkëkohore duhet ta ketë synim menaxhimin e proceseve në nivel vendi, të ndërlidhur me proceset, organizatat dhe të drejtën ndërkombëtare.

Institucionet në vendet e zhvilluara mbesin të hapura dhe funksionale, sado që ndërrohen forcat politike në proceset zgjedhore. (Lijphart, 1999) Ato i karakterizon: sundimi i ligjit dhe i rendit juridik e politik, institucione të hapura e efikase, respektimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave, niveli i lartë i zhvillimit ekonomik dhe i shpërndarjes përmes politikave sociale të favorshme, shpërqendrimi i burimeve të pushtetit, integrimi dhe bashkëpunimi. Mills, konstaton se në këto vende kemi edhe grupe të fuqishme të interesit, që kanë ndikime në vendimmarrjet qendrore për interesa të caktuara të korporatave të fuqishme dhe për interesa të “elitave të pushtetit,” që me ndikimet e lobimet e tyre, ndikojnë në vendimmarrje për interesa të caktuara dhe kanë ndikime në ecuritë e proceset ndërkombëtare, si dhe politikat konkrete ndaj rajoneve e shteteve konkrete. Në krye të partive dhe në qeverisje vijjnë dhe ndikojnë grupe të interesit që Mills

i quan “elita të pushtetit” që mbrojnë interesa të grupeve të fuqishme në vendimmarrjet kryesore, veçmas në politiken e jashtme. “Lobet e grupeve të interesit, fshehurazi apo haptas, janë shndërruar në udhëheqës të hapur dhe manovrojnë ndërrimin në klikat e partive kundërshtarë.”¹³ (Mills, 1956:267) Edhe Karl Dojç thekson interesat e grupeve të fuqishme të interesit: “Politika e jashtme e çdo vendi merret me ruajtjen dhe sigurimin e pavarësisë së vendit dhe me ndjekjen dhe mbrojtjen e interesave të tij ekonomike, veçmas të grupeve të tij të interesit më me influencë”.¹⁴ (Dojç, 1997:26)

Ndërrvarësia në mes vendeve, organizatat ndërkombëtare dhe korporatat, procesi integruar kanë ndikuar që procesi i qeverisjes dhe institucionet të marrin karakter integruar e bashkëpunim intenziv rajonal e global, thekson Jozeph dhe Welch.(2013:424-469). Këto procese kanë ndikuar akoma më shumë që qeverisja të bëhet sipas kushtetutshmërisë, ligjshmërisë e efikasitetit. Këto janë karakteristikat esenciale të institucioneve në këto vende. Ekziston ndarja e pushteteve dhe respektimi i tij, veçmas i gjyqësorit i cili është relativisht i pavarur dhe mjaft efikas, dhe shërbimet administrative. Në vendet e tranzicionit dhe në Kosovë si vend i vonuar në reformat e tranzicionit, synohen standarde qeverisëse të lartpërmendura. Të gjitha këto procese globale po ndikojnë edhe në qeverisjen dhe institucionet kosovare, e cila është në proces të konsolidimit institucional demokratik, të njohjeve, afirmimit dhe integritetit. Institucionet dhe qeverisja në vendet e tranzicionit, pra edhe në Kosovë, për nga forma dhe synimet janë të ngjashme me vendet e zhvilluara perëndimore, por për nga efektet janë ende të brishta e joefektive. Ukshin Hoti, në vitet 90-ta, theksonte se gjendjen në Kosovë e

karakterizon:“situata e komplikuar politike, mungesa e përvojës në jetën politike të demokracisë, njohuritë e mangëta për interesat, intencat dhe mundësitë e faktorit të jashtëm, trashëgimnia e mangët politike e faktorit të brendshëm.”(Hoti, 1997:143)

Një karakteristikë e qeverisjes kosovare, është fakti se institucionet janë të uzurpuara për interesa grupore. Këto grupe po i uzurpojnë udhëheqjet partiake dhe përmes procesit zgjedhor me shkelje të parimeve demokratike, po depërtojnë në institucione. Qëllimi i angazhimit të lidershit dhe aktivistëve partiakë ishte synimi për interesa egoiste, grupore dhe më pak për mirëqeverisje. Ata deklarohen për mbrojtje të interesave të përbashkëta, për interesa kombëtare, të qytetarit, etj., për të cilat janë të detyruar të veprojnë si rezultat i obligimeve juridike dhe i konkurrencës partiake, por qëllim kryesor kanë interesa e përvetësime personale e grupore. Në literaturë, kjo dukuri njihet si shteti i partive.¹⁵ Në rrethanat kosovare, këto grupe ishin më ndikim më specifik dhe më pasoja më të medha, në këto faza fillestare të konsolimit të institucioneve. Fërkime të interesave në mes subjekteve politike partiake, bëhen për përfitimet si grup duke keqpërdorur mjete publike dhe punësim nepotist e pa kritere në institucione e shërbime publike. Punësimi në sfera tjera private prodhuese e shërbyese është tejte i kufizuar, si rezultat i jo zhvillimit privat dhe i mungesës së investimeve.

Këto parti për ardhje në pushtet, përdorin metoda populliste, ideologjike, demagogjike, presione, pikëpamje ekstreme, gënjeshtër, përdorim të vetëdijes politike të së kaluarës, vetëdijen lokaliste, mediet e manipuluar, etj. Konkurrenca nuk është përmbajtjesore, ngase alternativat e qëllimet e tyre nuk dallojnë shumë. Procesi i

demokratizimit në Kosovë, kërkon edhe ndryshim të raportit në mes të shtetit e shoqërisë, për ta tejkaluar mentalitetin e kaluar mbi shtetin. Pra, të kuptohet parimi demokratik se shteti duhet t'i shërbejë shoqërisë, e jo ta sundojë atë. Mungesa e traditës qeverisëse demokratike, moszhvillimi i sferës private dhe përqendrimi i pushtetit partiak e grupor mbi institucionet, në administratë, në shërbimet dhe në korporata publike, paraqesin vështirësi për ndërrimin e këtij mentaliteti mbi raportin shtet-shoqëri, përkatësisht, shtet-qytetar. Ky konceptim do të ndikonte në avancimin e sundimit të ligjit dhe cilësinë e procesit zgjedhor dhe në kulturen politike.

Grupet dhe lëvizjet e interesit publik, sindikatat, shoqatat, mediet e pavarura e kritike, OJQ-të e shoqërisë civile, etj, jashtë ndikimit të partive e pushtetit, luajnë rol dhe ndikim pozitiv në procesin në qeverisje. Ato rrisin transparencën dhe pluralitetin e procesit të qeverisjes. Forcimi i shoqërisë civile e pasuron spektrin e grupeve të interesit publik dhe interesat e qytetarëve. Këto grupe, si të pavarura nga shteti, përmes aktivitetit dhe medieve të pavarura, krijojnë opinion të pavarur, plural e kritik dhe mundësojnë rritjen e transparencës në punën e institucioneve. Këto janë të rregulluara më kushtetutë e ligje përkatëse dhe aktive në realitetin qeverisës e institucional kosovar, por duhet fuqizuar me shum.¹⁶ (KCSF- CIVICUS, mars 2011) Në vendet e tranzicionit veçmas në Kosovë, si nevojë e integritetit e zhvillimit dhe dukurive negative në institucione, ndikojnë grupe të interesit të vendeve të zhvilluara. Këto grupe luajnë rol e ndikim të madh në procesin e qeverisjes. Këtë ndikim e arrijnë në saje të investimeve, bashkë investimeve përmes korporatave të jashtme, përmes politikës ekonomike e tregtare ndaj vendit dhe rajonit, me

anë të qëndrimeve, rekomandimeve e të presioneve përmes organizatave politike, financiare, sigurisë, tregtisë, etj., duke përkrahur ose refuzuar forca të caktuara politike, nganjëherë edhe përmes korrupsionit të bartësve të pushtetit, shantazhit, presioneve, medieve, etj., varësisht nga qëllimet dhe interesat konkrete. Mbikëqyrja ndërkombëtare dhe gjendja ekonomike, politike e institucionale në Kosovë, këtë mundësi ndikimi e kishte dhe ende e ka më të drejtpërdrejtë se sa në vendet tjera¹⁷ (Shala, 2001:156-172)

Autonomia e pushteteve dhe kontrollit reciprok në mes tyre në vendet e tranzicionit nuk është në nivelin e duhur, ngase udhëheqjet partiake po i uzurpojnë partitë dhe stitucionet dhe po ndikojnë negativisht në funksionimin, konkurrencën, në ndarjen e kontrollin ndërinstitutional. Edhe shoqëria civile dhe qytetarët, ende nuk janë opozitë e fuqishme kundër dukurive negative. Raporti pozitë-opozitë ishte i infektuar nga interesat e këtyre grupeve, që për qëllim kanë interesat privilegjuese në pushtet, e jo për qeverisje të mirëfilltë konkurrense. Pra, konkurrenca e tyre nuk është përmbajtësore dhe e sinqertë, mu për shkakun e depërtimit të grupeve të lartpërmendura me ndikim negativ. Për këtë arsye, në mes të partive ka tendosje e konkurrencë joparimore dhe mungesë të konsensusit në vendimmarrjet konstruktive dhe në efektet e institucioneve.

1.2. Pikëpamje moderne

Pikëpamjet teorike-analitike mbi qeverisjen dhe institucionet demokratike janë mjaft të pasura, veçmas ato moderne. Në këtë pjesë të punimit, do t'i paraqesim në vija të përgjithshme disa nga pikëpamjet dhe rezultatet empirike-hulumtuese mbi qeverisjen dhe institucionet demokratike, të cilat sqarojnë kompleksitetin, aspektin konstitucional,

faktorët, kushtet, efektet, defektet, rezultatet, matjet, standardet, treguesit, etj. të qeverisjes demokratike, në këndvështrim dhe në kontekst të krahasimit me dukuritë qeverisëse në Kosovë.¹⁸ Në veçanti, teoritë që ndërlidhen me sistemin juridik e politik pas gjysmës së shek.20, e sidomos analizat hulumtuese e kërkimore empirike mbi qeverisjen demokratike dhe institucionet pas viteve 90-ta dhe deri më sot.¹⁹ Ngase, na ndihmojnë si referenca për kuptimin e dukurive të procesit qeverisës në Kosovë.

Max Weber

Max Weber, analizon të drejtën e votimit, parlamentarizmin, udhëheqësin plebishitar, pjesëmarrjen, pushtetin, konkurrencën, promocionin, defektet politike, etj. në realitetin e shoqërisë gjermane. Weberi thekson institucionet, konkurrencën, vendimet e elektoratit dhe udhëheqjen e zgjedhur prej tij, psikologjinë e masave, interesat, procesin politik si tendencë e luftës së grupeve të interesit. Qarkullimin e elitave dhe konkurrencën në mes tyre e konsideron si një lloj kontrolli pozitiv për ndryshime, dhe se demokracia e tillë është më pozitive se autokracia. Megjithatë, ai kritikon faktin se konkurrentët ndjekin politika afatshkurta. Weber, pranon dobinë shoqërore të nxjerrjes së udhëheqjes dhe rregullave të lojës përmes legjislacionit. Por, ai njëkohësisht thekson se kjo është dytësore në raport me interesat e ngushta, ngjashëm siç është “profiti në raport me produktin” Qeveritë nuk synojnë mirëqenien e përgjithshme, ata kanë synime egoiste dhe interesa për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit. Mendonte së zgjedhësit nuk janë të informuar dhe të aftë për zgjedhje të arsyeshme, në veçanti në kuptimin e interesave afatgjata. Ai, kërkonte kushte paraprake për demokracinë: udhëheqje dhe administratë të kualifikuar, elektorat

dhe parlamentarë intelektualë, kontroll e pengesa për mosndërhyrjen ekstreme të shtetit në shoqëri dhe ekonomi, kërkonte vlera moral e përgjegjshmëri, delegim të detyrave publike tek institucionet eksperto-kratike dhe vetëkontroll e përmbajtje demokratike, duke respektuar rregullat e lojës.²⁰ (Weber, 1976; 2010; 2006)

Joseph Schumpeter

Joseph Schumpeter, analizoi institucionet dhe qeverisjen, krahas ndryshimeve strukturore në të gjitha sferat gjatë kapitalizmit. Ai supozonte se dinamikat dhe proceset do të dërgojnë në qeverisjen demokratike. Mendonte se socializmi është i papërcaktuar nga ana kulturore e politike, dhe se vetë proceset ekonomike e strukturore të shoqërisë në të ardhmen do të transformohen në qeverisje të re demokratike. Demokracinë e kuptonte si metodë politike dhe treg. Fliste edhe për rendin institucional: “Metoda demokratike është rendi i institucioneve për të marrë vendime politike, ku individët përmes luftës së konkurrencës për votat, marrin autorizim dhe legjitimitet për të marrë vendime” (Schumpeter, 1950:428) Qeveritë nuk synojnë mirëqenien e përgjithshme, ata kanë synime egoiste dhe interesa për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit. Zgjedhësit nuk janë të informuar dhe të aftë për zgjedhje të arsyeshme dhe në kuptimin e interesave afatgjata. Demokratizimi i masave, i shndërron partitë në instrumente burokratike të manipulimit dhe të kontrollit “psiko-teknik” të opinionit të masave.²¹ (Schumpeter, 1950:411)

Anthony Downs

Anthony Downs, përfaqëson pikëpamjet mbi qeverisjen demokratike në frymën analoge të ofertës dhe kërkesës së tregut. Partitë i konsideron si sipërmarrësit në

ekonomi, që janë të drejtuar nga fitimi dhe logjika kosto-përfitim. Synim kanë fitimin e zgjedhjeve dhe ruajtjen e pushtetit. Orientimi nga zgjedhësit i detyron partitë konkurrencte të sajojnë programet, idetë e vendimmarrjet. Në sistemin dypartiak, politika është më difuze dhe e njëjtë, ndërsa në sistemin shumëpartiak ka ideologjizim permanent dhe qeveri më pak të integruar dhe më pak të qëndrueshme, dhe si e tillë me pak zgjidh probleme thelbësore. Partitë e reja lindin kur ndryshon e drejta elektorale, kur ndodh ndryshim i thellë shpirtëror i elektoratit si rezultat i përmbysjeve, luftës, revolucionit, inflacionit, depresionit të madh dhe kur fraksionet në parti krijojnë pikëpamje më radikale, në kundërshtim me partinë tjetër të moderuar për çështje të rëndësishme. Për të fituar vota, pushteti është i orientuar në shpërndarjen e një sasive të fitimit nga të pasurit, drejtë të varfërve e shtresave të mesme që gjithherë janë shumicë dhe potencial për vota. Qeverisja demokratike sipas tij, duhet t'i plotësojë katër kushte: a) garën partiake në bazë të zgjedhjeve të përgjithshme, b) kohën periodike të zgjedhjeve, c) të drejtën e përgjithshme të zgjedhjeve, dhe d) pranimin e rezultatit të zgjedhjeve. Duke u nisur nga pikëpamja se zgjedhësit veprojnë arsyeshëm edhe nga fakti se partitë janë të interesuara për përfitime e ruajtje e rifitim të pushtetit dhe nga frika e konkurrentëve, partitë janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e zgjedhësve. Partitë kur humbin votat, e përshtatin ideologjinë e vet me programet dhe sjelljet e partisë fituese.²² (Downs, 1957) Ndërsa, Habermas theksonte se, Downs nuk merr parasysh edhe faktorë të tjerë: identifikimi afatgjatë i zgjedhësve me partinë, orientimi i zgjedhësve rreth problemeve të

diskutueshme, kompetencat e partive për të zgjidhur problemet, vlerësimi i kandidatëve dhe tradita kulturore e votuesve. (Hbermas, 1999:277-292)

Teoria e demokracisë pluraliste

Teoria e demokracisë pluraliste filloi me Bently-teoria e grupeve.(1908) Kjo teori është e bazuar në pikëpamjen se, interesat e shumta mund të ekuilibrohen dhe integrohen me konkurrencë e kompromis përmes aktorëve të shumtë, përfaqësues të interesave, që shprehin strukturën shumë dimensionale shoqërore dhe organizimeve të ndërmjetme, përmes vendimmarrjeve në institucionet përkatëse dhe qeverisjes. Ato grupe të interesit dhe lobe bashkë koordinohen dhe bashkërendojnë duke bërë kompromise për interesat e tyre. Sipas kësaj pikëpamjeje duhet krijuar liri të organizimit, shprehjes, kërkesave, manifestimeve si dhe krijimit të opinioneve pluraliste për interesa të llojllojshme. Si tejet me rëndësi, theksohet shpërndarja e burimeve të pushtetit: në shtet, në shoqëri dhe në ekonomi, si kusht paraprak i domosdoshëm për qeverisje demokratike.²³ (Bentley, 1908) Përfaqesuesi tjetër i kësaj teorie Truman, (1951) theksonte se synimi i teorisë pluraliste për qeverisje demokratike është pengimi dhe kufizimi i qeverisjes autoritare e totalitare, përmes përcaktimeve juridike shumë organizative e procedurale vendimmarrëse, si dhe kontroleve ndërinstitutionale. Kontrolli i tillë duhet të përdoret edhe ndaj shumicës në legjislativ dhe në ekzekutivin e zgjedhur në mënyrë demokratike. Ai është kundër parimit demokratik dhe vullnetit homogjen të shumicës “tiranisë së shumicës.”(Truman,1951) Vazhdues të pluralizmit modern në Amerikën e Veriut dhe hapësirën anglo-amerikan folëse ishte Robert A. Dahl, i cili mendon se për qeverisje

demokratike duhet të jetë në qendër shoqëria pluraliste. Ai thekson se, për të pasur qeverisje demokratike cilësore, nuk mjafton vetëm qeverisja konstitucionale, por pjesëmarrja efektive e qartë, votimi gjithëpërfshirës dhe dije-cilësi e pjesëmarrjes në zgjedhje, si në atë plebishitare ashtu edhe kontroll i vazhdueshëm i agjendës politike nga shoqëria sa më pluraliste. Ai preferonte jetën publike e shoqërore aktive me organizime, debate, në votime, në zgjedhjen dhe revokimin e përfaqësuesve dhe zotëruesve të posteve më të larta shtetërore, formim i vullnetit politik dhe vendimeve në shoqërinë civile. Pra, kërkonte shoqëri civile pluraliste dhe aktive të pa dominuar nga shteti, dhe shoqëri që kërkon nga shteti e politika. Sipas tij faktor primar e sovran qeverisës duhet të jetë shoqëria, e jo shteti dhe qeveria: "Government of the people and by the people" e jo "government for the people."²⁴ (Dahl, 1998)

Ndërsa, Ernest Fraenkel si neopluralist në Gjermani, preferon një rol më të madh të shtetit plural. Fraenkel, vendos shtetin plural në qendër. Ky pluralizëm duhet të jetë i ngritur në nivel të konstitucionit dhe si "konstruktion shtetëror" që përfaqëson legjitimitetin e strukturës shoqërore plurale, në bazë të së drejtës dhe organizimit plural. Institucionet pluraliste duhet të jenë në qendër të qeverisjes demokratike. "Shteti i së drejtës së legjitimuar në mënyrë autonome, të strukturuar në mënyrë heterogjene dhe të organizuar në mënyrë pluraliste."²⁵ (Fraenkel, 1991:326) Mendoj se, pluraliteti i dy sektorëve, (organizimeve shoqërore-civile dhe pluraliteti i strukture institucionale)

bashkërisht dhe reciprokisht plotësojnë procesin qeverisës demokratik. Decentralizimi, ndarja e pushteteve dhe qeverisja lokale/vendore e avancuar, është një formë e tillë.

Teoria sociale e demokracisë

Teoria sociale e demokracisë synon rregullimin gjithëpërfshirës të politikës, shtetit, hoqërisë dhe ekonomisë, në drejtim të shpërndarjes së pushtetit dhe mirëqenies, për të zvogëluar pabarazitë shoqërore në mes shtresave dhe individëve, për sigurimet bazë të ekzistencës dhe perspektivës së çdo individi. Në këto procese gjithnjë po lind një tip i ri i shtetit të ekonomisë së tregut: kapitalizmi i rregulluar sipas shtetit të mirëqenies, duke krijuar raporte të reja në mes të ekonomisë, shoqërisë, shtetit dhe mekanizmave të tregut.²⁶ (Meyer, 2005) Në vendet e zhvilluara kuota të mëdha të buxhetit po destinohen për politika sociale.

Teoria e pjesëmarrjes aktive politike

Teoria e demokracisë sipas pjesëmarrjes aktive politike në qendër, e thekson pjesëmarrjen aktive si pjesë thelbësore në formimin e vullnetit dhe në ndikimin në vendimmarrje. Pra, pjesëmarrje aktive në forma të ndryshme të manifestimit si: në zgjedhje, demokraci të drejtpërdrejtë, organizime grupore e subjekte asociative, në planifikim, njohje, e zbatim të ligjit. Kjo teori kërkon strategji aktive nga shoqëria, dhe pikërisht nga kjo quhet demokraci ekspansive, progresive, reflektuese, diskutuese, integruese, etj. Kjo nënkupton një shoqëri civile vitale, aktive, të informuar, kognitive, etj., ku nuk mund të manipulojnë skajshmërisht demagogjia dhe forcat autokratike. Si e tillë reflekton në krijimin e vullneteve politike, opinioneve, dhe rrjedhimisht ndikon në vendimmarrjet institucionale. Kjo teori është kundër apatisë. Pjesëmarrja e të gjithë këtyre faktorëve ndikon në proceset

politike, në formimin e vullnetit politik, gjykimin publik, informimin, intelektin dhe moralin qytetar në zgjidhjen e problemeve dhe në përkrahje.²⁷ (Giddens, 2007)

Teoritë kritike të demokracisë

Teoritë kritike të demokracisë theksojnë defekte strukturore të demokracisë në krijimin e vullnetit politik dhe në vendimmarrjet. Sipas tyre, qeverisja dhe institucionet asnjëherë nuk shprehin preferencat e qytetarëve dhe të elektoratit. Preferencat individuale e grupore të elektoratit, nuk vijnë në shprehje në proceset vendimmarrëse të institucioneve. Mënyrat e procedurat vendimmarrëse në institucione, janë larg përfilljes së interesave e preferencave të zgjedhësve gjatë rrafshimit të profilit politiko-ideologjik të partive, dhe orientimi i tyre nga tregu i votave dhe orientimi drejt çështjeve *ad hoc* të krijuara artificialisht. Strukturat e brendshme partiake dhe interesat e grupeve të interesit të organizuara mirë, janë faktorë që ndikojnë në vendimmarrjet institucionale. Filtra ka edhe në procesin parlamentar, aty përjashtohen interesat e përgjithshme, interesat e grupeve të paorganizuara. Institucionet dhe vendimmarrësit, orientohen vetëm nga interesat e grupeve me potencial momental të votave dhe atyre që rrezikojnë qetësinë dhe rendin, pra ato që imponohen. Grupet dhe interesat me nivel më të ulët të organizimit, që nuk rrezikojnë qëndrueshmërinë politike e ekonomike momentale, nuk u kushtohet vëmendje, siç janë shtresat e marginalizuara, edhe kur janë shumicë. Edhe jeta ekonomike është e pavarur. Pengesat juridike sistemore janë të pakapërcyeshme për reforma të thella në shumë sfera, si dhe mandatet e kufizuara kohore të të zgjedhurve.²⁸

(Riker, 1982) Këto pikëpamje kritike i gjejmë edhe të Lijphart.²⁹ (1994) Aanalizen e tyre e gjejmë dhe të Schmidt.³⁰ (2010)

Kjo teori kritikon edhe “parimin e shumicës” si “tirani e shumicës” kur vendos pa përfillur pakicën dhe kur nuk ka siguresa-barriera e garanci kushtetuese, ligjore e procedurale në vendimmarrje. Kjo tirani e pakicës e konsideruar si shumicë, në realitet nuk përbën shumicën, por e sundon shumicën në emër të shumicës, kinse si parim demokratik. Për shkak të kësaj gjendjeje, të raportit të shumicës dhe pakicës, kostove të vendimmarrjes dhe atyre tjetërsuese në procesin vendimmarrës, përfaqësuesit e kësaj teorie kërkojnë reforma institucionale qeverisëse. Këto reforma arrihen duke plotësuar “parimin e shumicës” me barriera sistemore juridike që detyrojnë bisedime, konsensus e bashkërendime, me kufizime përmes vetos, decentralizim, zgjedhje proporcionale dhe procedura të tjera juridike e kufizime kushtetuese, ligjore e procedurale.³¹ (Lijphart, 1994) Përfaqësuesit e kësaj teorie kritike, propozojnë këtë terapi:

kufizo diapazonin e vendimeve kolektive p.sh. kufizim kushtetues të politikës, me siguresa dhe kundërpesha kundër legjislativit dhe ekzekutivit. 2) kufizojë veprimtarinë e shtetit brenda një rrethi të vogël detyrash; 3) jepu qytetareve të drejtën për dëmshperblim për demet që u bëhen nga veprimtaria e institucioneve; 4) siguri dhe të drejta themeltare të patjetërsueshme; 5) kujdesu për decentralizimin e organizimit shtetëror; 6) siguroju qytetareve të drejtën e marrjes se iniciativave ligjore; 7) siguroju votimin e popullit për sa më shumë ligje; 8) mbaje hapur të drejtën për shtegtim të lirë.³² (Schmidt, 2010:265)

Teoria e demokracisë komplekse

Teoria e demokracisë komplekse, fillon me Fritz Scharpf-in. Ai mendon se përpos pjesëmarrjes, vetëzhvillimit dhe vetëvendosjes individuale, duhet vështiruar modelimin e pushtetit dhe mbrojtjen e pakicave, si dhe përfaqësimin më të mirë të interesave të nënshtresave në proceset e vendimmarrjeve, në zhvillimin e politikave më të

suksesshme, në organizimin dhe veprimin e sistemit institucional. Kërkon reforma dhe përshtatje në bazë të informacioneve sa më komplekse për interesat e shumta dhe speciale të shoqërisë, duke ngritur sisteme qendrore planifikimi, informimi, koordinimi e kontrolli, si dhe planifikim e parashikim afatmesëm e afatgjatë.³³ (Scharpf, 1970) Pra, sipas tij, kërkohet politikë aktive në zgjidhjen e problemeve. Këtë kriter të efektivitetit pozitiv e përcakton edhe përmes matjeve kosto-përfitim. Të gjitha projektet që sjellin përfitim neto të të gjithëve, në raport me status-quon, dhe kur përfitimi i grupit të caktuar është më i lartë se disfavoret që mund t'i ndodhin grupit tjetër. Scharpf thekson se, edhe ekonomia globale i ka vështirësuar politikat makroekonomike të vendit. Ai flet edhe për efektivitetin dhe legjitimitetin demokratik në BE dhe efektivitetin e saj në zgjidhjen e problemeve, dhe në rritjen e mirëqenies.³⁴ (Scharpf, 1970)

Efektet e formave qeverisese dhe të sistemit zgjedhor

Forma presidenciale dhe parlamentare, ka efekte dalluese në organizimin dhe funksionimin institucional e qeverisës, krahas faktorëve e rrethanave tjera. Këto forma dallohen për nga përshtatshmëria qeverisëse, efektevet, efikasiteti dhe rezultatet në rrethanat dhe proceset e caktuara. Në të dyja format, Parlamenti është ligjdhënës dhe kontrollon buxhetin dhe qeverinë. Por, dallohen për nga raportet në mes legjislativit dhe ekzekutivit në shumë nuanca kompetencash, ndarjesh dhe balancimeve të të drejtave e përgjegjësi, dhe efekteve ndaj institucioneve tjera.

Dalluese është mënyra e zgjedhjes, kontrollit dhe revokimit të qeverisë nga legjislativi.³⁵ (Hejwood, 2002:45-59) Në demokracinë parlamentare, legjislativi mund ta

kontrollon më drejtëpërdrejt dhe revokon ekzekutivin. Megjithëse, në vendet e tranzicionit shpeshherë shumica parlamentare e partisë apo kualicionit në pushtet, është aq e lidhur më qeverinë, saqë nuk ka shkarkim, as përgjegjësi e kontroll politik ndaj qeverisë. Ndërsa, në atë presidencial, ekzekutivi dhe parlamenti janë më të pavarura; legjislativi nuk mund ta shkarkojë ekzekutivin; ekzekutivi është më i mbyllur në raport me legjislativin. Shkarkimi mund të bëhet vetëm në raste abuzimi të theksuar, përmes procedurave të veçanta. Presidenti i zgjedhur drejtëpërdrejt, është President i shtetit dhe i Qeverisë. Ndalohet shpërndarja e parlamentit nga presidenti. Parti me pavarësi relative nga presidenti dhe parti me disiplinë me të dobët. Ndarja e pushteteve institucionale është më e relaksuar dhe më e theksuar.³⁶ (Schmidt, 2010:92-298)

Në sistemin parlamentar është më i theksuar roli i raporteve pozitive - opozitive. Opozita është më kontrolluese e kritikuese e qeverisë në parlament, kurse në atë presidencial legjislativi dhe ekzekutivi janë më tepër përballë njëri-tjetrit; ndërsa, në parlamentarizëm udhëheqësi i opozitës është një faktor potencial aktiv. Në sistemin presidencial nuk ka lider të opozitës. Në parlamentarizëm kërkohet parti të organizuara e më të disiplinuar. Në këtë formë, partitë janë kryesoret në krijimin e vullnetit politik dhe në vendimmarrje. Sipas Hejwood, karakteri i partive përcakton qeverisjen dhe proceset dhe marrjen e posteve në institucione. Organizimi i partive, vendimmarrjet partiake dhe sistemi zgjedhor, luajnë rol në qeverisjen dhe efektet e saja.(Hejwood, 2002:269-289)

Ekzistojnë pikëpamje se në vendet me traditë të shkurtër demokratike, sistemi presidencial mund të rrëshqasë në diktaturë, si rezultat i kompetencave të mëdha të

presidentit, veçmas kur parlamenti dhe shoqëria civile është e dobët. Në sistemet presidenciale, veçmas ato jo stabile, mungojnë strategjitë afatgjata, shpesh preferohet praktika qeverisëse me ndërhyrje të nxituara. Sistemi presidencial konsiderohet sistem më ngurtësi më të madhe institucionale. Në procesin e krahasimit, shumë autorë qeverisjen parlamentare e konsiderojnë më të përshtatshme se atë presidenciale. Kjo arsyetohet më: përfaqësim, mbrojtje të pakicave, pjesëmarrje të zgjedhësve dhe mënyrat e zgjidhjes së problemeve ekonomike. Kjo vlenë edhe për qeverisjen kosovare.

Omari thekson se “Forma e qeverisjes është një element shumë i rëndësishëm, madje formalisht më i rëndësishmi i formës së shtetit, sepse ka të bëjë pikërisht me organizimin e veprimtaritë e organeve të larta të pushtetit shtetëror si edhe me mënyrën e pjesëmarrjes së popullit në qeverisjen e shtetit.”(Omari, 2007:86) Sistemi presidencial konsiderohet pozitiv edhe për sa i përket qëndrueshmërisë qeverisëse dhe në ndërrimin e pushteteve, por konsiderohet se manipulon më sferën ekonomike dhe politikën financiare, veçmas para, gjatë dhe pas zgjedhjeve. Ka dallime edhe në procesin dhe efikasitetin legjislativ, në të drejtat politike dhe qytetare. Pra, ky sistem vlerësohet më pak demokratik. Por, edhe sistemet parlamentare, në të gjitha sistemet zgjedhore, mund të deformohen me korrupsion që mbulohet dhe përvetësohet nga partitë, përkatësisht, grupeve dominuese në parti dhe futja e tyre në institucione. Kjo varet edhe nga funksionimi, pavarësia dhe efikasiteti i gjyqësorit, administratës, dallimet sipas sistemit zgjedhor, etj.³⁷

Demokracitë përmes zgjedhjeve proporcionale, të moderuara, dhe më një numër të menaxhueshëm partish, konsiderohen formula më të suksesshme e më demokratike të

qeverisjes. Ka mendime së një sistem zgjedhor mazhoritar, mund t'i përfaqësojë dhe merr vendime efikase duke i bërë institucionet më të qëndrueshme e më efektive, se sa parlamentarizmi me parti të shumta e forca politike të dala nga sistemi zgjedhor proporcional. Në vendet e tranzicionit ku mungon tradita e kultura demokratike, sistemi zgjedhor mazhoritar me parti masive është më konfrontues. Në këto raste më i përshtatshëm është sistemi proporcional, ngase i zbut konfrontimet dhe i shpërndan forcat dhe i detyron bashkërendimin, bashkëpunimin dhe kompromis e konsensus në mes subjekteve politike dhe kufizon tiraninë e shumicës.

Në vendet anglo-amerikane qeverisjet patën një qëndrueshmëri, reforma, marrje të qetë të pushtetit nga opozita, integrim të grupeve të marginalizuara, etj. Këto pikëpamje u shprehen në studimin krahasues, si sukses i faktorit të kulturës politike dhe tradites në qeverisje. Shkaktar i krizave në Kontinentin Evropian, konsiderohet sistemi zgjedhor proporcional, ndërsa sistemi i shumicës në vendet anglo-amerikane kishte sistem me dy parti dominuese dhe ishte më stabil.³⁸ (Verba & Almond, 1963)

Por, sipas shumë autorëve, qëndrueshmëria politike mund të përmbushet me qeverisje demokratike edhe përmes përfaqësimit proporcional të shumë partive, bashkërendimit, bisedimeve, ('bargaining democracy'), konsensusëve ('consensus democracy') dhe kufizimeve e barrierave sistimore juridike. Ky qëndrim u përqaftua nga një numër i madh autorësh: Noghlen, Gehard Lehmurch, Schmidt, Arend Lijphart, etj. Ky i fundit e shtoi edhe termin demokraci e konsensusit. Kjo formë qeverisëse vlerësohet e suksesshme edhe për nivelin lokal e komunal, dhe si e domosdoshme në vendet e dala nga konfliktet

dhe me ndasi etnike. (Lijphart, 1994) Ky sistem zgjedhor rezulton në ndarjen e pushteteve dhe të votave, me qëllim që, asnjë parti e vetme të mos ketë shumicën dhe pushtetin për një kohë të gjatë, dhe krahas zgjidhjeve-siguresave juridike, të mos mund të bëjë ndryshime kushtetuese, të mos mund të luftojë ashpër kundër opozitës dhe pakicave, si dhe të mos uzurpojë pushtetin dhe institucionet përmes dukurisë “shteti i partive”.

Teoria e qeverisjes së moderuar

Teoria e qeverisjes së moderuar thekson së qeverisja përmes konkurrencave të shumicës që sjell sistemi dypartiak, përmes sistemit zgjedhor mazhoritar me karakteristikat përcjellëse, mund të sjell „rrezikun operacional të demokracisë së shumicës” ngase, ka një përqendrim të theksuar të pushtetit, konfrontim të theksuar të dy partive kryesore, etj, për dallim nga ajo e mirëkuptimit dhe qeverisjes konsensuale. Shpeshherë sistemi zgjedhor mazhoritar mund të kalojë në „tirani të shumicës” dhe „rrezikut operacional i demokracisë së shumicës.” Në vende me specifika të theksuara ndarëse mund të jetë tejet e papërshtatshme për qeverisjen demokratike, vlerësojnë përkrahësit e këtyre pikëpamjeve. Mendoj se, kjo vlenë edhe për realitetin kosovar në fazat e para të konsolidimit kushtetues, organizativ e funksional të qeverisjes.

Anton Lijphart³⁹ bën krahasimin në mes të këtyre dy formave zgjedhore dhe sistemit politik e juridik të qeverisjes, duke specifikuar rrezikun e demokracisë së shumicës dhe specifikave të asaj konsensuale. Ai thekson karakteristikat dalluese dhe zgjidhjet juridike përkatëse të tyre: Demokracia e shumicës karakterizohet me 10 cilësi:

1)Përqendrimi i pushtetit ekzekutiv në duart e një partie të shumicës që qeverisë e vetme.

2)Mbizotërimi i ekzekutivit ndaj legjislativit.

- 3) Sistemi më dy parti, apo tipi sipas numrit të partive të rëndësishme që i afrohet atij.
- 4) E drejta elektorale e shumicës.
- 5) Sistemi pluralist i grupeve të interesit.
- 6) Shteti unitar dhe i centralizuar.
- 7) Sistemi më një dhomë.
- 8) Kushtetuta e ndryshueshme më anën e shumicës së thjeshtë, apo mungesa e një kushtetute të shkruar.
- 9) E drejta e legjislativit kundrejt konstitucionalitetit të legjislacionit, për të marrë vendimin përfundimtar.
- 10) Bankë qendrore që varet nga ekzekutivi (Lijphart, 1999)

E kundërta e demokracisë së shumicës është ‘‘demokracia koncensuale’’ (‘‘consensus democracy’’) apo ‘‘demokracia e bisedimeve’’ (‘‘bargaining democracy’’) me këto cilësi:

- 1) Ndarja e pushtetit ekzekutiv në koalicion partiak.
- 2) Balancimi i pushtetit midis ekzekutivit dhe legjislativit.
- 3) Sistemi shumëpartiak.
- 4) E drejta elektorale proporcionale.
- 5) Sistem korporativ i raporteve shtet-shoqata.
- 6) Strukturë shtetërore federaliste dhe e decentralizuar.
- 7) Sistem më dy dhoma më fuqi të barabartë.
- 8) Kushtetutë e shkruar, që mund të ndryshohet vetëm më vështirësi dhe që kërkon miratimin e shumicave shumë të mëdha.
- 9) Kontroll të gjerë ligjor i legjislacionit.
- 10) Bankë qendrore autonome. (Lijphart, 1999)

Karakteristikat e të dy formave i kanë përparësitë dhe disfavoret e tyre. Lijphart theksoi elementet strukturore të sistemeve qeverisëse, partive, elektoratit dhe aspektit kushtetues për periudhën 1945-1996. Siç do të shohim më poshtë, sistemi qeverisës në Kosovë ka disa karakteristika të ‘‘demokracisë koncensuale’’ dhe të teorisë së moderuar të demokracisë për qëllime të caktuara qeverisëse, psh. Sistemin proporcional, Gjykatës kushtetuese, garancat për minoritetët, etj.

Qeverisja si ‘‘shtet i partive’’

Qeverisja si ‘‘shtet i partive’’⁴⁰ konsiderohet kur partitë shndërrohen në faktor kryesor dominant duke uzurpuar institucionet për interesa partiake e grupore, të cilat dominojnë në procesin e krijimit të vullnetit dhe të vendimmarrjes, duke futur kuadro partiake pa kritere

në administratë, në politikën e personelit, në sektorët e shërbimeve civile publike, dhe duke e uzurpuar shumicën e institucioneve themelore, deri edhe institucionin e parlamentit, për interesa partiake e grupe dhe vendimmarrje arbitrare. (Lejbhols, 1958:78-141) Sipas kësaj teorieve, vendimmarrjet parlamentare i marrin konferencat partiake dhe lideri partiak, e jo parlamenti. Schmidt,(2010) duke i komentuar e analizuar këto pikëpamje në këtë proces të qeverisjes, ku shfaqen dukuri të theksuara të përvetësimit e të keqpërdorimit të institucioneve e të parasë publike nga partitë dhe grupet, theksonte:

Nga demokracia kanë fituar edhe grupet e interesit dhe partitë politike. Madje, disa mendojnë se partitë politike janë nga përfituesit kryesor të demokratizimit. Sepse ato nuk përfitojnë vetëm nga financimi i partive, por kur përfaqësuesit e tyre kanë poste qeveritare, partitë komandojnë edhe levat e pushtetit, me anë të të cilave mund të shpërndajnë poste qeveritare dhe përfitime të tjera për aleatet e tyre aktual dhe të mundshëm, si dhe për pasuesit e tyre. Sipas një pikëpamje me ndikim, partitë politike kanë fituar në demokraci edhe cilësinë për të përcaktuar strukturat, duke krijuar një tip të ri të shtetit:” Demokracinë e shtetit partiak” ...”shtetin e partive” (Schmidt, 2010:359)

Në këtë drejtim lindi edhe teoria e dytë e “shtetit partiak”⁴¹ Teoria e diferencave të partive. Këtu vijnë në shprehje edhe anët pozitive të konkurrencës së programeve partiake, të cilat duhet të jenë të diferencuara nga njëra-tjetra në programe, qëllime, synime e sjellje, që në literaturë njihen si djathtiste, majtiste, liberalizëm, konservatorizëm, të qendrës, opozitare, etj.⁴² (Hibbs, 1977) Kjo teori ndërlidhet sipas analogjisë së ofertës që ofrojnë partitë, dhe kërkesës së konsumatorëve që janë kërkesa të elektoratit. Konsumatorët-zgjedhësit e përcaktojnë politikën e qeverisë së zgjedhur. Është vërtetuar se, sa më të mëdha të jenë dallimet ideologjike programore dhe elektorale ndërmjet partive, aq më shumë ka rezultate pozitive, dhe sipas kësaj pikëpamjeje kjo konkurrencë e dallimeve programore dhe dallimeve tjera, përmes zgjedhjeve e zbusin dukurinë “parti-shtet.” Partitë e majta më shumë i vlerësojnë barazinë dhe politikat sociale, sesa ato konservatore.

Këto të fundit orientohen drejt politikave pro-ekonomisë së tregut. Gjatë hulumtimeve të ndryshme është dëshmuar se qeveritë socialdemokrate dhe kristian-demokrate, mbështeten më shumë sesa partitë laike konservatore, në raport me programet shtetërore dhe në kuotat e shpenzimeve shtetërore.⁴³ (Gabriel & Stoess, 2001)

Një dukuri e mosdallimeve ndërpartiake në ideologji-programe, në veprime e qëllime, është shfaqur në vendet e tranzicionit dhe në Kosovë. Kjo dukuri e jo diferencave partiake është pengesë e madhe e tejkalimit të dukurive të shtetit të partive në vendet e tranzicionit dhe në Kosovë. E kur kësaj ia bashkangjesim edhe elektoratin specifik në këto faza të tranzicionit dhe mungesën e zhvillimit biznesor e ekonomik privat në këto faza, si dhe jo efektivitetin e gjyqësorit ndaj dukurive negative, nuk shihen rezultate të shpejta ndryshe. Por procesi konkurrues dhe dallimet partiake sado të vogla, luajnë rolin e tyre në tejkalimin e gjendjes në qeverisjen dhe efektet e saja në Kosovë, kuptohet krahas faktorëve të tjerë. Në kuadër të afirmimit sa më demokratik të qeverisjes, sipas teorive moderne, po theksohet dhe vlerësohet edhe përdorimi i demokracisë së drejtpërdrejtë-referendumit. Sa më shumë që aplikohen referendumet dhe iniciativat legjislative nga qytetarët dhe shoqëria civile, janë një tregues demokratik i qeverisjes. Në Kosovë, një formë e tillë juridikisht është e rregulluar por, ende nuk është përdorur.

2.3. Kushtet dhe standardët

Të gjitha teoritë e lartëcekura flasin edhe për krijimin e kushteve dhe standardeve për qeverisje demokratike. Këto mendime teorike dhe hulumtime praktike mbi kushtet e përshtatshme qeverisëse, përfshijnë një mori faktorësh esencialë ligjor, shoqëror, politikë, ekonomik, kulturorë dhe ndërkombëtarë, që janë ndikues esencialë në qeverisje. Faktor

esencial konsiderohet rregullimi i përshtatshëm juridik, i qartë dhe i qëllimshëm me rregullim përkatës kushtetues-politikat konstitucionale. Për qeverisjen efektive është i domosdoshëm edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, shpërqendrimi i pushtetit, rrethanat social-kulturore, rrethanat ndërkombëtare e rajonale, tradita-kohëzgjatja e qeverisjes demokratike, pozita gjeografike e gjeopolitike dhe ekonomike ndërkombëtare. Të gjithë këta faktorë vlejné edhe për efektet institucionale në Kosovë.

Vendet që shtrihen në mesin e vendeve të zhvilluara e kanë më lehtë qeverisjen demokratike, si dhe ato që integrohen mirëfilli me vendet demokratike dhe ato ekonomikisht të qëndrueshme.⁴⁴ (Schmidt 2010:418-432) Dahl, theksonte se për qeverisje demokratike duhen: premisat social-ekonomike dhe faktorët kulturo-politikë dhe shoqëria e strukturuar në mënyrë pluraliste, ku qytetarët kanë qëndrime dhe kulturë demokratike. Gjithashtu ai kërkonte kontroll të ushtrisë e policisë nga zyrtarë të zgjedhur. (Dahl, 1971) Për qeverisje demokratike të qëndrueshme është i domosdoshëm zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe shndërrimi i kësaj rritje në zhvillimin e sferave tjera. Ka shumë autorë të këtij qëndrimi, por analizues më i hershëm dhe më i plotë është Martin Lipset. “Sa më i pasur të jetë një vend, aq më të mëdha janë mundësitë për ta ruajtur demokracinë”⁴⁵ (Lipset, 1960:48) Por, krahas zhvillimit ekonomik, qeverisjes dhe institucioneve demokratike, duhet shtuar legjitimitetin politik me efektivitetin e tij, duke plotësuar interesat e shumicës së popullsisë, grupeve të fuqishme të interesit, zgjidhjen e konflikteve strukturore, duke i integruar politikisht shtresat e mesme dhe të ulëta,

theksonte Lipset.(1959:69-105) Zhvillimi ekonomik krijon mundësi për qeverisje demokratike dhe qëndrueshmërinë e saj. Lipset, konsiderohete se për qeverisje demokratike nevojiten të ardhura 4000 dollarë për frymë, me çmimet e vitit 1995.⁴⁶ (Lipset, 1960:53) Edhe qeverisja kosovare ka obligim krijimin e rrethanave ekonomike zhvillimore, përmes objektivave e instrumenteve makroekonomike; shndërrimin e zhvillimit ekonomik në zhvillimin e sferave tjera dhe anasjelltas. Të gjitha sferat duhet të jenë në favor të zhvillimit e perspektivës. Roli, funksioni dhe qëllimi kryesor i qeverisjes kosovare duhet të jetë shpejtimi i zhvillimit social–ekonomik. Qeverisja është instrument i krijimit të rrethanave e mundësive të ekonomisë së tregut dhe zhvillimit, integritit, sigurisë, etj, përmes politikave zhvillimore ekonomike e integruese.

Vanhanen theksonte se ”përqendrimi i burimeve të pushtetit çon në autokraci, kurse shpërndarja e burimeve të pushtetit, në të shumtën e rasteve, në demokraci”⁴⁷ (Vanhanen, 2003:28) Në shpërqendrim të pushtetit, luajnë rol format e shumta decentralizuese. Lipset(1960) kërkonte shpërndarjen e burimeve e resurseve të pushtetit në shoqëri dhe ekonomi. Pra, pushteti të mos i zotërojë këto dy burime. Në këtë pikëpamje futen edhe tregues tjerë të shpërndarjes së burimeve, si p.sh: burimet e dijes, ekonomisë, gjendjes së pronësisë, pronësisë agrare, informacionit, etj., në raport me pushtetin. Ai krahason nivelin e koncentrimit dhe shpërndarjes së pushtetit mbi burimet, në vendet e zhvilluara dhe në sistemet socialiste. (Lipset, 1960)

Zgjidhjet kushtetuese e ligjore, si detyrime e përgjegjësi juridike kushtetuese e ligjore, ndarja e pushtetit, etj, e kufizojnë pushtetin në raport me të drejtat dhe liritë politike e

sociale të njeriut. Shteti i së Drejtës, sipas Wolfganag Merkel-it, është përcaktues politik-institucional dhe siguron ‘regjime të pjesshme’, zgjedhje të përgjithshme të lira dhe të barabarta, të drejtat politike për të marrë pjesë, të drejtat e liritë qytetare, sigurimi institucional i kontrollit të pushteteve dhe sigurimit *de jure* dhe *de facto* i pushtetit efektiv të përfaqësuesve të përzgjedhur. Mosfunksionimi vetëm i njërit prej këtyre regjimeve, çon në mosfunksionimin e gjithë sistemit, thekson Merkel⁴⁸ (2010:30)

Faktorë tjerë me rëndësi për qeverisje demokratike, janë rrethanat ndërkombëtare pro demokratike. Kjo theksohet nga shumë autorë. Vendet që ishin nën sundimin kolonial britanik, me lehtë ruajtën format demokratike shtetërore sesa ato komuniste! Dihën ndikimet e blloqeve dhe raportet mes tyre, që reflektonin drejtpërsëdrejti në sistem politik dhe qeverisje me efektet dhe rezultatet përcjellëse. Ndryshimet gjatë viteve 90-ta në vendet ish-socialiste dhe proceset integruuese evropiane e globale po kërkojnë dhe përkrahin reforma institucionale e qeverisese në rajon dhe në Kosovë⁴⁹

Schmidt M. G. duke analizuar teoritë mbi demokracinë dhe hulumtimet empirike-analitike, si kërkesa dhe kushte të standardizuara i konsideron:

1)Ndarja e pushtetit shtetëror administrativ dhe neutralizimi i këtij pushteti, kryesisht përmes kontrollit civil të policisë dhe ushtrisë; 2)Shpërndarja e gjerë e pushtetit... 3)Një kulturë politike, ku një pjesë e madhe e popullsisë aspiron vlera të një zhvillimi jetësor...4)Vlerësimi i autonomisë dhe i lirisë individuale sidomos në vende, të cilat nga ana kulturore karakterizohen nga trashëgimia hebraiko-kristiane, nga ndarja e shtetit nga kisha dhe nga një gradë e lartë e besimit laik; 5)Mungesa e një sistemi me të madhe antiparti apo i shumë partive antidemokratike me ndikim; 6)Traditat e rrënjosura thellë liberal kushtetuese për kontrollin e pushteteve shtetërore; 7)Një popullsi etnikisht e relativisht homogjene, ose në rastin e heterogjenitetit etnik-rregullimi paqësor i konflikteve ndërmjet etnive, tipike për demokracinë bashkërenduese; 8)pavarësi, sipas të drejtës ndërkombëtare (apo delegim i legjitimuar i të drejtave të sovranitetit kombëtar tek organizatat mbi kombëtare), kufi të padiskutueshëm, si dhe një mjedis ndërkombëtar ku të mbizotërojnë fqinjë demokratik, në vend të autokracive; 9)barriera kundër

mbizotërimit të një partie të vetme në parlament dhe në qeveri; si dhe 10) ndërrimi i qeverive më njëfarë rregullsie, në mënyrë që humbësit e zgjedhjeve të mund të shprehin për një ndryshim pushtetesh. (2010:432)

Edhe proceset ndërkombëtare, ndërvarësia, proceset ekonomike dhe teknologjia informative më proceset globale integruese dhe legjislacioni e veprimtaria ndërkombëtare përmes organizatave ndërkombëtare, po ndikojnë në çdo vend, për të përfill dhe inkorporu konventa e praktika qeverisëse mjaft demokratike për qytetarin në raport më shtetin dhe shoqërinë. (Jozeph & Welch, 2013)

Vendet që kanë homogjenitet etnik, të gjuhës, fesë, etj. kanë parakushte për të qenë më stabile në qeverisje, se sa vendet që kanë një heterogjenitet etnik e fetar me traditë konfliktuoze. Konfliktet fetare dhe etnike po krijojnë tensione. Veçmas, aty ku nuk kanë traditë të demokracisë dhe kur keqpërdoren nga jashtë. Me rëndësi është edhe altruizmi dhe orientimi drejt mirëqenies së përgjithshme që duhet të dominojë tek elektorati dhe elitat. Teoritë kulturaliste flasin edhe për traditën kulturore, raportet në mes të përkatësive fetare të popullsisë me formën e qeverisjes. Qeverisjet demokratike funksionojnë me efektshëm në vendet me shkallë të lartë laike dhe më popullsi me fe kristiane, kryesisht në vendet e zhvilluara perëndimore. (Inglehart & Wellzel, Christian 2005:300) Në disa vende më përkatësi islame egziston mungesa e ndarjes se shtetit nga feja, ndikimi i fundamentalizmit fetar në politikë dhe shtet, lufta e ashpër për pushtet në mes të forcave laike dhe fetare fundamentaliste, fraksionet fetare përçarëse, niveli i ulët i zhvillimit, shpërndarje e dobët e burimeve të pushtetit e të ardhurave dhe egzistimi i ekonomive të fajdeve, etj.⁵⁰ (Fondacioni Bertelsmann, 2008)

Shumë autorë, si parakusht e faktor esencial në cilësinë qeverisëse, i theksojnë këto vlera kulturore: konsensusi votues-elitë, vlerat altruiste ose egoiste ndaj komunitetit, traditat ndaj institucioneve, traditat e respektimit të të drejtave të njeriut dhe ndaj së drejtës, arsimimi e njohuritë kognitive për kostot dhe përfitimet e qeverisjes demokratike, optimizmi, qëndrimi ndaj barazisë, ndaj korrupsionit, qëndrimet ndaj se kaluarës, marrëdhëniet ndër personale, përcaktimi i shumicës për demokraci, etj.⁵¹ (Inglehart & Wellzel, Christian, 2005)

Qeverisja në shumicën e vendeve islamike vazhdon të jetë akoma edhe sot e konstituar në mënyrë antidemokratike.⁵² (Merkel, 2003:61-85) Përpos aspektit historik, UNDP, si shkaqe numëron mungesën e demokracisë, pluralizmit, pjesëmarrjes kuptimplote politike të popullsisë dhe varfëria. (UNDP, 2002) Shumë autorë e theksojnë mungesën e laicitetit, mungesën e traditës së respektimit të të drejtave individuale, vënia në rend të parë e familjes dhe klanit para individit, prirje e lartë ndaj dhunës. Ndarje e dobët e pushteteve, tendenca fundamentaliste, përqendrim i pushtetit mbi ekonominë dhe mbi të ardhurat, mungesa e shpërndarjes, etj. (Hunter & Malik, 2005) Faktor në krijimin e mundësisë demokratike të qeverisjes është largimi i fesë nga shteti e politika dhe nga procesi i qeverisjes. Në Kosovë ky largim është i konsoliduar.

Një nga kushtet e domosdoshme për qeverisje demokratike kërkohet që së paku 45% të qytetarëve të jenë të përcaktuar për qeverisje demokratike. (Inglehart & Wellzel, Christian 2005). Pra, problem për qeverisje demokratike është edhe sigurimi i numrave.

Në këtë drejtim legjitimohet edhe doktrina e “zhvillimit human”. Po ashtu kërkohen vlera kulturore e humane të institucionalizuara dhe të mbrojtura juridikisht. Më rëndësi të posaçme janë edhe shprehia ndaj punës, ndaj biznesit dhe pronës dhe ndjenja e përgjegjësisë. Niveli social-ekonomik dhe proceset ekonomike, krijojnë motiv e vlera të reja kulturore e qeverisëse.

Të gjitha kushtet dhe standardet e lartpërmendura për qeverisjen demokratike, duhet t’i arrijë qeverisja dhe institucionet demokratike kosovare. Procesi qeverisës kosovar duhet të krijojë kushtet dhe standardet bazë të lartëcekura, për qeverisje demokratike e zhvillim institucional dhe integrim e afirmim ndërkombëtar të Shtetit të Kosovës. Shoqëria kosovare është përcaktuar për qeverisje demokratike sipas standardeve, praktikave, akteve juridike dhe procedurave të vendeve të zhvilluara demokratike, edhe pse i mungojnë nivelet e parakushteve të lartpërmendura për qeverisje demokratike. Por, për Kosovën standartet demokratike të vendeve të zhvilluara, do të shërbejnë si modele e standarde synuese; si referenca krahasuese e vlerësuese të cilësisë së qeverisjes dhe institucionalizimit kosovar. Kosova është në hapat e parë të konsolidimit dhe shoqëri e vonuar në tranzicion, me konstitucionalizem demokratik dhe vullnet politik në konsolidim për qeverisje e institucione demokratike. Ky përcaktim ka ardhur si rezultat i njohurive se, të gjitha format tjera qeverisëse jodemokratike janë më joproduktive dhe me pasoja të dëmshme në shumë sfera e procese.

Qeverisja demokratike, në krahasim nga format autokratike të qeverisjes pranohet si mënyrë më pozitive e më frytdhënëse, e cila i ka anët e forta të saj, por edhe anët e dobëta. Qeverisja demokratike dallohet nga format tjera për nga: pjesëmarrja, legjitimiteti, efektiviteti, efikasiteti, transparenca dhe rezultati politik. Cilësitë e saj janë aftësia për

përshtatje, ballafaqim demokratik me sfidat e politikës së brendshme, detyrimet për të dhënë llogari, mbështetja politike, synim drejt mirëqenies, siguria e qytetarëve, shprehia e punës dhe përgjegjësisë, ruajtjes së sistemit, respektimit të rregullave, drejtësisë procedurale, liberalitetit, etj., të cilat janë synime kushtetuese e moralo politike. Pra, këto janë arsyt që Kosova është përcaktuar për rendin kushtetues-qeverisës demokratik.

Matja dhe treguesit

Përpyekjet për matjen e cilësisë demokratike, efikasitetit, efektivitetit qeverisës dhe rezultateve përmes treguesve të shumtë të qeverisjes, janë në konsolidim cilësor të vazhdueshëm. Një mënyrë e suksesshme e treguesve bëhet nga shtjellimet dhe analizat e përfaqësuesve të hulumtimeve empirike mbi qeverisjen, Një krahasim tjetër po bëhet në bazë të rregullimeve kushtetuese të sistemit politiko-juridik, sipas nivelit të zbatimit dhe efekteve reale. Vlerësime po bëhen edhe në bazë të cilësisë së zgjedhjeve-pjesëmarrjes, sundimit të ligjit dhe të së drejtës, funksioneve reale të partive politike dhe kohezionit politik të shoqërisë, harmonizimit të interesave të shumta të grupeve e shtresave, në sajë të rezultateve në reformat politike dhe ekonomike, respektimit të të drejtave të njeriut, shpërndarjes së burimeve të pushtetit, menjanimit të dukurive negative në qeverisje, etj. Të gjitha këto po përdoren në matjen e vlerësimit të qeverisjes e institucioneve kosovare.

Tregues i rëndësishëm është e drejta e votimit, nga aspekti i sasisë dhe cilësisë pjesëmarrëse. Vlerësimi bëhet përmes respektimit të parimeve demokratike të zgjedhjeve. P.sh. Coppedge dhe Reinicke (1990) vlerësimin e bazon në katër tregues: 1) zgjedhje të ndershme në tërë vendin; 2) liria e mendimit; 3) liria për t'u organizuar në sisteme partiake dhe shoqata; 4) vënia në dispozicion të burimeve alternative të informacionit,

përveç atyre qeveritare. Ndërsa, Vanhanen⁵³ (1990) bazohet në dy faktorë: pjesëmarrja dhe niveli i garës. *Freedom House*, qeversjen demokratike dhe efektet institucionale i matë përmes një mori treguesish, proceseve e gjendjeve në këta sektorë:

A. Zgjedhjet

- 1) A zgjidhet shefi i qeverisë apo ndonjë autoritet tjetër qendror me zgjedhje të lira dhe të ndershme?
- 2) A zgjidhen përfaqësuesit e popullit në gjithë legjislativin shtetëror, me zgjedhje të lira dhe të ndershme?
- 3) A janë në rregull e drejta e votës dhe kuadri i saj referues?
- 4) A e gëzon populli të drejtën të organizohet sipas dëshirës në parti politike dhe në grupime të tjera politike konkurruese, dhe a është i hapur sistemi për ngritjen dhe rënien e partive dhe grupimeve?

B. Pluralizmi politik dhe pjesëmarrja

- 5) A merr opozita ndonjë pjesë domethënëse të votave dhe a ka ajo realisht mundësi për ta zgjeruar elektoratin e saj apo ta marr pushtetin me anë të zgjedhjeve?
- 6) A janë veprimet elektorale të popullit të lira nga mbizotërimi i ushtrisë apo i fuqive të huaja, i partive totalitare, i hierarkive fetare, i oligarkive ekonomike apo nga grupe të tjera të fuqishme?
- 7) A gëzojnë pakicat kulturore, etnike, fetare, dhe të tjera, të drejta të plota politike dhe mundësi pjesëmarrjeje?

C. Menyra e funksionimit të sistemit qeveritar

- 8) A i mbizotëron politikat e qeverisë shefi i qeverisë i zgjedhur në mënyrë të lirë si dhe përfaqësuesit e popullit në parlament?
- 9) A është e lire qeveria nga korrupsioni gjithëpërfshirës?
- 10) A është e detyruar qeveria të jap llogari zgjedhësve në periudhën midis zgjedhjeve? Dhe a operon ajo hapur në mënyrë transparente? (*Freedom House*)

Përpos listës së të drejtave politike-*Freedom House*, në 2003 përdor edhe 15 pyetje për matjen e lirive të qytetarëve:

A. Liria e mendimit dhe e besimit

1. A janë të lira dhe të pa varura mediet dhe format tjera të shprehjes kulturore?
2. A janë të lira institucionet dhe komunitetet fetare për të ushtruar besimin e tyre dhe për ta shprehur publikisht dhe privatisht këtë besim ?
3. A ka liri akademike, dhe a është sistemi arsimor i lirë nga indoktrinimi ekstenziv politik?
4. A është diskutimi privat i hapur dhe i lirë?

B. Liria e grumbullimit dhe e organizimit

5. A ekziston liria e grumbullimit dhe e demonstrimit, dhe a lejohet diskutimi publik?
6. A e gëzojnë organizatat joqeveritare të drejtën e organizimit ?
7. A ekzistojnë sindikatat e lira apo ekuivalente të tyre, dhe a zhvillohen negociata kolektive efektive. A ekzistojnë organizata të lira profesionale dhe të tjera private?

C. Shteti i së drejtës

8. A është i pavarur gjyqësori?
9. A është e rregulluar sipas shtetit ligjor e drejta civile dhe ajo penale?
10. A ka mbrojtje kundër terrorit politik, kundër heqjes së pajustificuar të lirisë, syrgjynosjes apo torturimit, dhe kush është përgjegjës për këto: përkrahësit apo kundërshtarët e sistemit? A ka luftë dhe kryengritje të armatosura?
11. A e garantojnë ligji, politikanet dhe praktikantët trajtimin e njëjlojtë të qytetarëve-

D. Autonomia personale dhe të drejtat individuale

12. A e kufizon shteti lëvizjen e lirë, lirinë e ushtrimit të profesionit dhe të arsimit?

13. A e gëzojnë qytetarët të drejtën e pronës dhe lirinë e biznesit? A ndikohet ekonomia private me anën e tarifave të zyrtareve, të forcave të sigurimit, të partive politike dhe të organizatave të tjera, apo krimi i organizuar?

14. A janë të sigurta liritë personale shoqërore, përfshirë barazinë gjinore, zgjidhjen e lirë të partnerit apo lirinë për të vendosur për numrin e fëmijëve?

15. A ekziston barazia e mundësive dhe liria nga shfrytëzimi ekonomikë? ⁵⁴(Freedom House, 2003:696)

Fondacioni Bertelsman 2008, matë dhe vlerëson procesin e transformimit drejt demokracisë dhe ndikimit në zhvillimin e ekonomisë së tregut, në vendet më të ardhura të ulta dhe të mesme. Analizon proceset transformuese, sa janë institucionet të qëndrueshme, si është ndarja e pushtetit, pjesëmarrja dhe liria politike, shteti ligjor, pranimi i institucioneve demokratike, integrimi politik dhe shoqëror, raporti shoqëri-shtet, kultura politike e qytetare, etj.⁵⁵ (Fondacioni Bertelsman, 2008) Edhe BB, FMN, UNDP, institucione të shumta të BE-së, OJQ-vendore, etj⁵⁶ analizojnë dhe vlerësojnë indikatorët e qeverisjes: cilësinë rregulluese, shtetin ligjor; pengimin e korrupsionit; pjesëmarrjen politike dhe llogaridhënien, qëndrueshmërinë politike, ecuritë ekonomike e financiare, etj. Edhe shumë organizata tjera ndërkombëtare e rajonale matin treguesit dhe gjendjen e cilësisë së qeverisjes dhe pasojat. Në veçanti organet e BE-së analizojnë, përcjellin, sugjerojnë dhe kërkojnë cilësi në qeverisjen e vendeve të interesuara për integrim.

Kreu II: Qeverisja dhe institucionet para vitit 1999

Çështja e Kosovës

Kuptimi i qeverisjes dhe i institucioneve në periudhën që po e hulumtojmë, nuk mund të bëhet pa kuptimin e traditës paraprake dhe shkaqeve e pasojave të para vitit 1999. Ngase, të gjitha ato përvoja e tradita qeverisese paraprake, procese e forca politike, etj., patën dhe kanë ndikim në qeverisjen dhe institucionalizimin e mëvonshëm. Përpos kushteve momentale, qeverisja varet edhe nga qëndrime, pikëpamje, sjellje e shprehi, të cilat janë krijuar si qëndrueshmëri psikologjike e kulturore. Institucionet, sistemi politik e juridik ndërron, por kultura e vjetër politike dhe pasojat e se kaluarës, vazhdojnë të ndikojnë edhe në fazat e mëvonshme, mu në sistemin e ri politik e juridik, kryesisht në nivelin e respektimit e zbatimit të tij.

Çështja e pazgjidhur dhe problemet qeverisese të Kosovës i kanë rrënjet dhe shkaqet që nga fillimi i shekullit të kaluar. Pas tërheqjes së pushtuesit turk nga territoret ballkanike, popullatës shqiptare në përgjithësi, nuk iu njoh e drejta për vetëvendosje, edhe pse, Lëvizja kombëtare shqiptare për pavarësi ishte unike në të gjitha trojet shqiptare. Më të drejtë thuhet se “Çështja e Kosovës u lind si pasojë e ciptimit të trungut etnik shqiptar” (Stavileci, 2005:5) Pavarësia e Shqipërisë së sotme pa gjysmën e kombit dhe trojeve etnike, nuk ishte vetëvendosje e plotë. (Norman, 1913;105-116,V.10,) Shqipëria, për shkak të kësaj ndarje, kishte gjithnjë presione dhe ndikime joparimore nga jashtë: nga vendet më ndikim dhe nga vendet fqinjë që përvetësuan troje etnike shqiptare. Kjo shprehej edhe ndaj procesit qeverisës, forcave politike dhe sistemit institucional në Shqipëri dhe në trojet etnike shqiptare në RSFJ. Kosovës së sotme dhe trojeve e popullatës shqiptare jashtë saj, jo vetëm që ju pamundësua e drejta legjitime kombëtare,

territoriale e politike e vetëvendosjes dhe e vetëqeverisjes, por ajo u ballafaqua më politika represive e gjenocidale, dhunë shtetore, asimilim, dëbim e pastrim etnik nga politikat qeveritare që ‘qeverisen’ teritorin dhe popullsinë kosovare.

Në vendimmarrjet ndërkombëtare ndaj rajonit, dominonte logjika e ndarjeve territoriale nga ‘fituesit’ e luftës dhe logjika e forcës në mes vendeve më ndikim pa përfillur dëshirat e synimet e popujve dhe ekzistimet territoriale administrative të mëparme otomane.⁵⁷(Norman, 1913,V.10:105-116) Ndarja dhe coptimi u ndodhi shumicës së trojeve shqiptare, pra edhe territorit kosovar si një pjesë e rëndësishme e këtij territori. Kjo logjikë e pazareve arbitrare dominoi në të gjitha Konferencat Ndërkombëtare, që nga Kongresi i Berlinit, ku trojet shqiptare mbetën të ndara e të copëtuara nga trugu kombëtar. Duke e analizuar çështjen e Kosovës nga aspekti historik e gjeostrategjik, vështruar nga pikëpamja e pazarllëqeve territoriale para Luftës së Parë Botërore, Historiani gjerman Holm Sundhaussen, ndër të tjera thotë se:

Mosdaljes në detë të Serbisë, iu kompenzua duke sakrifikuar parimet etnografike respektivisht, linguistike për shoshitje gjeostrategjike dhe kështu viset e banuara kompakt me shqiptar i lanë jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Ky ishte një gabim dhe u bë i drejtë, ndonëse ishte padrejtësi, ashtu si shumë ndryshime kufijsh që nuk rezultojnë nga zbatimi i së drejtës ekzistuese, por krijojnë të drejtë të re.⁵⁸ (Sundhaussen, 2012:28):

Shkak për mos arritje të vetëvendosjes ishin pasojat e okupimit afatgjatë turk, i cili nuk lejonte kërkesat paraprake të lëvizjes kombëtare për vetë administrim dhe vetëqeverisje; politika serbo-malazeze ekspansioniste; pamundësia për t’u mbrojtur e organizuar në nivel përkatës kundër pushtuesit; vendimmarrjet ndërkombëtare joparimore

dhe kompromiset e dëmshme të vendeve më ndikim ndaj rajonit; faktori politik vendor i pa konsoliduar në pajtim më rrethanat, etj.

Pas kësaj ndarje, popullata shqiptare jashtë Shqipërisë u ballafaqua me politikat hegjemoniste, asimiluese, gjenocidale, etj., që për qëllim kishin asimilimin, shpërnguljen dhe pastrimin etnik, pra pengimin e aspiratave për liri, barazi e avancim, që nënkupton pengim të vetëqeverisjes. Vetëdija kombëtare etnike e politike të shqiptarët e kësaj ane, ishte e theksuar dhe e qartë për liri kombëtare e shtetore. Mbretëria SKS praktikonte qeverisje të imponuar dhe pengonte çdo përpjekje liberale e demokratike për vetëqeverisje. Të gjitha këto përvoja të hidhura, lanë pasoja në mungesën e krijimit të traditës vetëqeverisëse në Kosovë.

Pas Luftës së Parë Botërore, në botë u forcua koncepti i parimit të kombësisë dhe shtetit kombëtar, si njëri ndër parimet udhëheqëse në marrëdhëniet ndërkombëtare. Këtë e tregon edhe emërtimi Lidhja e Kombeve. Koncepti i vetëvendosjes së kombeve, gjithnjë formësohej si parim dhe si proces. Kemi vetëvendosjen në BRSS përmes sistemit socialist e federativ, pra, teorinë e praktikën e Leninit mbi vetëvendosjen. (Institut za Uppedno Pravo, 1958) BRSS, afirmoi vetëvendosjen nacionale gjatë dhe pas revolucionit, por ajo nuk ishte e plotë dhe e mirëfilltë, ngase ajo u përdor prapë për dominim rus në Federatë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky sovranitet u reduktua kinse në interesa të klasës, partisë, internacionales komuniste, etj. Ndërsa, gjatë dhe pas Luftës së Dytë, dominimin e saj e zgjeroi edhe ndaj vendeve socialiste, pra edhe ndaj Shqipërisë. Në Luftën e Ftohtë (Vendimet e Jaltës, 1945) në marrëdhëniet ndërkombëtare, politika e BRSS ishte faktor dominues deri në vitet 90-ta. Parimi i vetëvendosjes në këto vende socialiste përmes federalizmit socialist nuk ishte i plotë dhe ishte i dëmshëm në raportet në mes kombeve

dhe me deformime qeverisëse. (Hasani, 2010) Edhe sot, në qëndrimet ndaj Kosovës, Shqipërisë dhe përkatësisë etnike shqiptare, Rusia ka politikë e qëndrime joparimore.

Pas Luftës së Parë botërore, Serbisë iu mundësua formimi i shtetit SKS më dominim serb, sipas logjikës së ndarjeve të territoreve përmes rivaliteteve dhe politikës së forcës. Serbisë në shtetin SKS i ishte dhënë roli i “kordonit sanitar” fillimisht kundër ndikimit sovjetik, më pas kundër ndërhyrjes së mëtejshme të faktorit gjerman në lindje. Ushtria serbe dhe elita politike serbe, e shfrytëzuan këtë mundësi për të realizuar ambiciet e tyre hegjemoniste. (Hasani, 2010:281) Këto pushtime dhe ndarje arbitrare të territoreve, vendimmarrjet ndërkombëtare i arsyetonin me sigurinë strategjike dhe kinse për paqen në Ballkan dhe paqen botërore.(Spenser, 1914, no 4, 563-582) Pra, logjika e rivaliteteve të vendeve me ndikim në konflikt, pas Luftës së Parë Botërore nuk përfillte realitete kombëtare e territoriale etnike dhe i dëmtonte pa masë popuj të tërë, veçmas kombin shqiptar. (Hasani, 2010) Kujdestare përfituese e zbatuese ishte politika shoviniste serbe.

Konfrontimi i interesave të vendeve më ndikim ndaj rajonit dhe instrumentalizimi i Serbisë në këto interesa, pas tërheqjes së pushtuesit turk dhe pas Luftës së Parë Botërore, trojet shqiptare mbetën të pushtuara dhe pa të drejta vetëqeverisëse. Edhe faktori politik shqiptar në të gjitha trojet ishte i lodhur, i pa konsoliduar, i painformuar dhe i manipuluar nga vendet me ndikime negative. Por, lufta çlirimtare në Vilajetin e Kosovës dhe në të gjitha trojet shqiptare për t’u liruar nga pushtuesi turk, si rezultat kishte rritjen e vetëdijes kombëtare për liri dhe shtet kombëtar shqiptar. Kjo vetëdije e formësuar kombëtare do të luan rol në rezistencën kundër pushtuesit të ri serbo-malazezë.

Si popullatë e pushtuar dhe e përndjekur, me mundësi të vogla rezistuese vetjake, zgjodhi rezistencën kundër asimilimit për të ruajtur identitetin e vet, duke u mbyllur në

zakonet e veta tradicionale, duke mos u inkuadruar në proceset politike asimiluese të pushtuesit. Dihet proceset dhe shpërnguljet masive, kryesisht për Turqi. Kishte kryengritje dhe rezistenca ushtarake guerile. Serbia sillte kolonë serbë dhe malazezë në këto troje për ta ndërruar strukturën etnike.⁵⁹ Përmes dhunës shtetërore dhe instrumentalizimit të etnisë serbo-malazeze në Kosovë, ushtronte politikë antishqiptare tejet antinjerëzore ndaj popullatës shumicë në këto troje. SKS ndaj territoreve shqiptare nuk përfillte asnjë specifikë etnike në qeverisje. Kosova dhe trojet shqiptare, ishin copëtuar në „banovina” dhe ballafaqoheshin me politika të padurueshme antishqiptare. Kjo gjendje e rëndë ndodhi deri në Luftën e Dytë Botërore.⁶⁰ (Malcom, 1998)

Pushtuesi gjerman e italian/fashizmi, pushtuan rajonin dhe larguan pushtuesin serb nga pjesa më e madhe e territorit të Kosovës. Popullata e shumëvuahtur kosovare, bashkimin me Shqipërinë e pushtuar nën okupim fashist, e mori si ngjarje të suksesshme në krahasim me pushtuesin e mëparshëm serb. Partia komuniste e Jugosllavisë (PKJ) dhe celulat komuniste shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri, ishin të orientuara dhe të frymëzuara nga teoria dhe idetë komuniste për tejkalimin e gjendjes së rëndë sociale dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare,⁶¹ të cilat i besonin propagandës nacional-çlirimtare për çlirim kombëtar. Popullata kosovare e pushtuar dhe e terrorizuar nga politika serbo-malazeze që nga viti 1911-12, duke e ditur prejardhjen e ndikimit komunist nga BRSS, nuk i besonte shumë ideve komuniste. Andaj, e gjithë kjo rrethanë në Kosovë dhe te popullata shqiptare

jashtë Shqipërisë, krijonte mosbesim ndaj propagandës dhe ideve komuniste. Forcat politike e ushtarake nacionalçlirimtare kosovare, më përfaqësues të tjerë mbajtjen Konferencën e Bujanit më 31dhjetor-1943,01,02 janar1944, ku u përcaktuan për vetëvendosje dhe bashkim më Shqipërinë. Por, elementet unitariste serbo-sllave i mohuan vendimmarrjet e kësaj Konference. Në Jaltë (1945) u ndanë sferat e interesit, në mes të fuqive të kohës më me ndikim.⁶² (Vendimet e Jaltës, 1945) Ndryshimet e kufijve në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishin të pamundura. Shqipëria mbeti nën ndikimet e Lindjes dhe BRSS-së. Të gjitha këto procese ndërkombëtare, ndikuan drejtpërsëdrejti dhe përcaktuan në vija të përgjithshme procesin e vetëvendosjes dhe ndikimin në qeverisje. Por, vetëvendosja e shqiptarve në RSFJ, mund të rregullohej më statusin e republikës së Kosovës dhe trojeve shqiptare, sikurse popujt dhe njësitet tjera në Federatë, por qëllimet jugosllave ishin krejt tjera. Në këtë rrjedhë të historisë, ndodhen procese, institucione, akte e dukuri qeverisëse me pasoja tejet negative. Në këto rrethana ndërkombëtare, rajonale e vendore, përgjegjësia konkrete u takonte edhe forcave politike vendore në ish-Jugosllavi, në Kosovë dhe në Shqipëri, veçmas për vendimmarrjet, veprimet dhe deformimet ekstreme gjatë luftës dhe pas luftës; për veprimet që u karakterizuan më teprime, gabime me pasoja të rënda e veprimtari ekstreme masakruese tejet jonjerëzore ndaj popullatës kosovare⁶³ (Pirraku, 2005) Rezistencat çlirimtare kombëtare në Kosovë, në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, u shtypen dhe u etiketuan si mbeturina të fashizmit dhe si reaksionare e kontrarevolucionare. Në një kontekst lidhur me komunizmin ndër

shqiptarët, Ukshin Hoti thotë se “ai sistem u është imponuar shqiptarëve, dhe se në literaturën politike të perëndimit, ngjarjet e vitit 1945 në Drenicë, cilësohen si kryengritja e parë antikomuniste në Evropë” (2014:107). Të gjitha këto procese negative e krijuan çështjen Kosovës, si çështje të pazgjidhur.

2.1. Statusi juridik dhe qeverisja

Në RSFJ, më së keqi e pësoi popullata shqiptare, ngase iu mohua e drejta për vetëvendosje e vetëqeverisje dhe barazia me popujt tjerë. Autonomia e dhënë Kosovës-e jo statusi i Republikës, dhe copëtimi i trojeve etnike shqiptarenë tri njësi federative, kishte për qëllim amortizimin e kërkesës së fuqishme për vetëvendosje dhe vetëqeverisje. Të gjitha këto procese e qellime negative, e përcaktuan statusin juridik të Kosovës në federalizmin RSFJ dhe procesin e qeverisjes dhe institucioneve përkatëse. Kapacitetet kadrovike në institucione ishin të frikësuar, të shantazhuara, të manipuluar, të hutuara, pa përkrahje dhe më deformime ndër më të ndryshmet. Forcat politike kosovare nuk kërkuan statusin e republikës brenda federatës si formë e avancuar e vetëvendosjes dhe barazisë. Për ta dobësuar e asimiluar popullatën shqiptare, politika jugosllave e ndikuar nga politika serbe, me pëlqimin e moskundërshtimit të njësive tjera federale, të lejuara e heshtazi nga kreu i shtetit federal dhe i partisë, trojet shqiptare i copëtuan në Republikën e Maqedonisë, Mal të Zi, dhe në Serbi-Luginën e Preshevës.

Kosova u aneksua nga Serbia në rrethana të administrimit ushtarak në Kuvendin e Prizrenit,(1945) i cili u organizua nga forcat politike serbe. Aty u vendos që Kosova ta jetë autonomi politiko territoriale në përberje të “Serbisë Federale në kuader të Jugosllavisë Federative.”(1945) Pra, iu mohu vetëvendosja. Këtë aneksim e quanin si “vullnet i popullit”, “vëllazërim bashkim”, “bashkim për zhvillim” etj. (Bajrami, 1996:20)

Federalizmi në RSFJ ishte rezultat i ekzistimit shumëkombësh dhe ruajtja e tërësisë territoriale të shtetit të mëparshëm. Në këtë ruajtje të shtetit kishin rol edhe vendet me ndikim. Cilësinë e këtij federalizmi e caktuan forcat e brendshme me qëllimet dhe kompromiset e tyre. Sa i përket popullatës dhe territoreve shqiptare, ato u copëtuan në tri njësi-Republika. Ndërsa, Kosovës i dhanë një status autonom. Kjo zgjidhje u përkufizua me Kushtetuten e RFPJ.(1946) Në Federatë, strukturën dhe elementet-njesitë konstituive përfaqësoeshin në Dhomen e Kombëve, ku ishin gjashtë republika dhe dy njësi autonome që njëkohësisht ishin edhe në kuader të Republikës së Serbisë. Njëra nga këto njësi autonome ishte Kosova. Pra, përcaktohej karakteri federativ i shtetit, i tipit republikan me sistem socialist. Karakterizohej me qeverisje administrative centraliste, me kompetenca të theksuara të organeve qendrore (federative) të pushtetit. Sistemi njëpartiak dhe ideologjia në emër të klasës punëtore e shndërronte qeverisjen në federalizëm të centralizuar në shumë rrafsh. Në veçanti, dominimi i kombit serb si kombi më i madh. Këtë dominim e thekson edhe Judah, (1997:143-145). Më 1950, fillon zbatimi i “vetëqeverisjes punëtore”, sipas Ligjit mbi vetëqeverisjen socialiste, (1950) Ligji mbi Vetëqeverisjen shoqërore dhe sistemin komunal (1953) më të cilët filluan proceset pakez më liberale të sistemit socialist të gjertanishëm. Si rrjedhojë fillon edhe zgjerimi i kompetencave të njësive federale me Ligjin Kushtetues të viteve (1950), dhe (1953), që përcaktonin juridikisht vetëqeverisjen socialiste në RSFJ (Djorgjeviç, 1971) Por, këtë zgjerim e fituan vetëm republikat, jo edhe krahinat autonome. Përkundrazi, ato e humbën edhe atë elementin e pakët konstitutiv në Federatë, si autonomi politiko territoriale, që tani u shndërruan në autonomi administrative në kuadër të Serbisë. Rryma politike e unitarizmit serb shprehej ashpër në të gjitha politikat e sferat e Federatës, por në veçanti politikat antishqiptare në Kosovë. Kjo rrymë u

tejkalua pjesërisht në vitin 1966-67. Shqiptarët e Kosovës i rezistuan politikave shtypëse gjatë kësaj periudhe, sistemit të dhunshëm serb e federativ dhe dominimit të kuadrove sllave në pushtetin kosovar, si dhe kuadrove të heshtura shqiptare. Populli i sfidonte qëllimet e politikave të tyre. Është e njohur demonstrata e studentëve dhe popullit në vitin 1968, me kërkesat kombëtare shqiptare për liri, afirmim, zhvillim e zgjidhje kushtetuese më afirmative. Proceset politike, ekonomike e zhvillimore dhe pozita e jashtme e RSFJ-së,⁶⁴ kërkonin ndryshime më cilësore në sistemin politik të vetëqeverisjes dhe ndryshime kushtetuese më demokratike. Këto procese pozitive u kurorëzuan me zgjidhjet kushtetuese cilësore të Kushtetutës së vitit 1974.

Federalizmi në RSFJ kishte dallime nga federatat klasike, veçmas me Kushtetën (1974) u reduktuan kompetencat e federatës dhe u avancuan kompetencat e njesive të Federatës. RSFJ, përcaktohet qartë shtet federativ që e përbejnë: “6 republika dhe 2 krahina autonome.” Me kushtetutën e vitit 1974 u avancuan edhe krahinat (pra edhe Kosova) në element konstituitiv i Federatës, me zgjidhje kushtetuese të avancuar dhe me kompetenca të avancuara në federatë dhe me lidhje tejet të kufizuara në raport me Republikën e Serbisë. Me Kushtetutën Federative (1974) Kosova ishte pjesë përbërë e Federatës (neni 1&2) Kosova kishte teritorin dhe kufijtë, të cilët nuk mund të ndryshonin pa pelqimin e Kuvendit të Kosovës. (neni 5) Në Kushtetutën Federative ishte përcaktuar barazia e kombeve dhe e kombësive. (neni 245) Karakteristikat sistemore e qeverisëse të federalizmit jugosllav karakterizoheshin me decentralizim të Federatës. Edhe sistemi

vetëqeverisës mundësonte vendimmarrje në nivel të njësive federative dhe në Komuna, në Organizata punuese, në Bashkësi të interesit.⁶⁵ (Salihu, 1998:310-344)

Avancimi i Kosovës, më Kushtetutën e Kosovës (1974) dhe më organet e saj ishte e ngjajshme më organet e njësive tjera, por dallohej për nga statusi. Psh. Kosova kishte Kryesinë e cila e përfaqëonte (neni 147). Kishte Kuvendin dhe qeverinë-këshillin ekzekutiv dhe organet e administratës, të njëjta me organet e republikave. (neni 150) Këto zgjidhje mundësuan dhe reflektuan procesin e qeverisjes dhe avancimin e proceseve politike afirmative të Kosovës në RSFJ. Kuvendi Federativ kishte dy dhoma: Dhoma federative që përmbante nga 30 përfaqësues të republikave dhe nga 20 nga krahinat të zgjedhur në parimin territorial të njësive. (neni 284, par.3) Dhoma e republikave dhe e Krahinave-dhoma federative, (neni 286, par.2) përbëhej nga 12 delegatë nga republikat dhe nga 8 delegatë nga krahinat. Vlen të theksohen edhe zgjidhjet kushtetuese të Shefit të shtetit-Kryesisë së RSFJ (neni 321) prej 8 anëtarësh, ku në mënyrë të barabartë përfaqësoheshin edhe krahinat. Edhe në Këshillin Ekzekutiv Federativ-Qeveria, krahinat përfaqësoheshin esencialisht. (neni 348, par.1) Ishte e përfaqësuar në Gjykatën Federative (neni 370, par.2) dhe në Gjykatën Kushtetuese. (neni 381, par.1) Kosova kishte pozitë të barabartë me ish-republikat në çështjet e ndryshimit të Kushtetutës së RSFJ. (neni 389, 399 dhe 402, par.2)

Ndryshimet dhe plotësimet kushtetuese ishin procedurë e ndërlikuar, për ta mbrojtur federalizmin nga forcat unitariste. Kosova, si njësi konstitutive federative, përfshihej në të gjitha fazat e këtij plotësimi e ndryshimi të Kushtetutës; nuk mund të fillohej procedura e as të bëheshin ndryshime në fazën e fundit, pa pëlqimin e të gjitha njësive federative, pra

edhe pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës. Edhe ndryshimi i kufijve të Kosovës nuk mund të bëhej pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës. (Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974) Federalizmin e RSFJ-së e shquan decentralizimi dhe forcimi i njësive federative, ngase e drejta e vetorganizimit dhe kompetencave të njësive ishte e theksuar. (Salihu, 1998) Këto zgjidhje ishin si rezultat edhe i specifikave të sistemit socialist i vetëqeverisjes, i federalizmit dhe shumëkombësisë. (Djordjevic, 1987, 1997; Djorgjeviç & Kilibarda, 1988) Me kushtetutën e vitit 1974, Kosova u avancua në element konstitutiv të Federatës, më zgjidhje kushtetuese avancuese. Por, mbetë formalisht në kuadër të Serbisë më kompetenca mjaftë të kufizuara të Republikës së Serbisë ndaj Kosovës. Por, sado afirmativ që ishte ky avancim juridik i Kosovës, i cili theksohet e afirmohet më të drejtë, prapë nuk ishte identike dhe e barabartë me republikat; e gjithë kjo ndikonte në qeverisje dhe në efektet e institucioneve të Kosovës, dhe do të ndikon edhe gjatë shpërbërjes së RSFJ-së në vitet 90-ta.

Qeverisja dhe institucionet politike pas Luftës së Dytë Botërore, u ballafaquan me rrethana zhvillimore e kulturore feudale. Vendi udhëhiqej nga një forcë dominuese e vetme politike-PKJ, e cila qeveriste pa konkurrencë, e gjithëpushtetshme, autoritare dhe me ndërhyrje arbitrare në çdo sferë, pra, edhe në atë ekonomike e ekzistenciale. Thirrej në rolin historik të klasës punëtore dhe rolit të partisë, e sundimit arbitrar të liderit të gjithëpushtetshëm e karizmatik. Kjo forcë politike kishte dalë nga lufta antifashiste dhe lufta civile njëkohësisht, me ngarkesa të rënda emocionale e traumatike. Karakteristikë institucionale e qeverisëse ishte uniteti i pushteteve i dominuar nga vija partiake, që në esencë ishte vendimarrje arbitrare e liderit dhe grupit të ngushtë, e jo e ndonjë partie të mirëfilltë, apo e institucioneve të mirëfillta. Karakteristikë e sistemit qeverisës e

përcaktuar edhe më Kushtetutë ishte uniteti i pushtetit; pra nuk kishte ndarje e kontroll reciprok të pushteteve. Dhe kur kësaj i shtohet ekzistimi i vetëm një force politike pa konkurrencë, teoria dogmatizohet dhe qeverisja ngurtësohet, arbitrarizohet përtej çdo mase. Burimet e pushtetit ishin të përqendruara tej mase. Edhe kuadri institucional i qeverisjes, për nga ngritja profesionale e intelektuale qeverisëse ishte e pa traditë. Këto forca politike, përkatësisht, institucionet dhe qeverisja, udhëhiqnin ekonominë pa ligjësi të tregut me planifikime të centralizuara. Prona ishte shoqërore, fshatarëve u lejohej pronësia mbi një sasi të tokës. Pra, mungonte konkurrenca në të gjitha fushat. Arbitrariteti në vendimmarrje, totalitarizmi në të gjitha sferat, censura në media, mohimi dhe ndalimi i lirisë së të menduarit ndryshe dhe shprehjes së lirë, lanë pasoja në të gjitha segmentet.

Partia Komuniste, më vonë Lidhja Komuniste, ishte përfaqësuese deklarative e interesit të klasës punëtore. Ky subjekt politik përcaktonte dhe udhëhiqte pa konkurrencë partiake. Nuk lejoheshin parti e organizime tjera partiake. Të gjitha këto, ishin shumëfish më të egra në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare në ish Jugosllavi. Pra, arbitrarizmi në vendimmarrje, përzierja autoritare në çdo sferë (totalitarizmi), thirrja në rolin historik të klasës punëtore dhe partisë (aspekti ideologjik), udhëheqja e ekonomisë jashtë ligjësive të tregut, ndalimi i shprehjes së mendimit të lirë, mungesa e kritikës dhe mendimit të kundërt, përqendrimi ekstrem dhe total i pushtetit mbi burimet ekzistenciale, etj., ishin disa nga karakteristikat kryesore të institucioneve dhe të qeverisjes në Kosovë.

Popullata shqiptare në RSFJ dhe në Kosovë, pas Luftës së Dytë Botërore u gjend e terrorizuar, e painformuar, e manipuluar, e paarsimuar, e papërvojë, e varfër skajshmërisht. Si e tillë u gjend e papërgatitur për procese politike të mirëfillta. Udhëheqja kishte dalë nga lufta me pasoja emocionale, e traumatizuar dhe e dogmatizuar nga teoria.

Nuk kishte shtresa të diferencuara klasore për të cilat fliste teoria politike. Procesin e qeverisjes e karakterizonte arbitrarizmi dhe pushteti i manipuluar e jonjerëzor, i pavetëdijshëm dhe me parashikime dogmatike. Në qeverisje dhe institucione, mbeteshin kuadro servile, të cilat në shumë nivele e rrafshe vendimmarrëse, e deformonin qeverisjen dhe institucionet akoma më shumë.⁶⁶ E gjithë kjo periudhë la pasojat të shumanshme. Varfëria ekstreme dhe mungesa e makinerisë, si dhe kultura feudale ndaj punës, prona shoqërore, menaxhimi i dobët, etj., riprodhonte varfëri dhe padrejtësi të madhe. Qëndrimi negativ i pushtetit ndaj pronës private kishte pasojat e veta. Mungesa e konkurrencës në të gjitha sferat dhe mungesa e ligjësisë të tregut nuk mundësonte zhvillim. Andaj, edhe procesi i qeverisjes me institucionet dhe proceset politike, nuk jepnin rezultate. Popullata shqiptare, mbyllej dhe largohej nga angazhimi politik. Krijohej një konformizëm i paparë i aktivistëve dhe përfaqësuesve zyrtarë në qeverisjen kosovare. Kundërshtimi i gjendjes e qeverisjes, etiketohej e ndëshkohej rëndë.

Në procesin e qeverisjes rrallë përfillej kushtetutshmëria dhe ligjshmëria. Bartësit e pushtetit dhe institucionet politike, konsideroheshin si forca politike të përhershme, pa konkurrencë që thirreshin në rolin historik të klasës punëtore. Uniteti i pushteteve dhe dirigjimi nga vija partiake e arbitrare e liderit, kishin si rezultat sistemin qeverisës e institucional burokratik e deformues tej mase. Nuk kishte gjyqësor të pavarur, as media të pavarura, as shoqëri civile. Organizatat tjera politike ishin në funksion të monizmit partiak dhe nuk kishin asnjë autonomi mendimi e veprimi. Udhëheqja politike i uzurponte

institucionet, dirigjonte dhe udhëhiqte edhe jetën ekonomike, ngase siç dihet, në ekonomi dominonte prona shoqërore. Udhëheqjet e menaxherët zgjidheshin nga vija partiake.

Zgjedhjet pa konkurrencë nuk sillnin ndryshime, krijonin papërgjegjësi dhe ecuri zhvillimore tejte të ngadalshme. Kjo shtresë udhëheqëse, në procesin e qeverisjes dhe vendimmarrjeve ishte dominuese, e pakontestueshme, e konsideronin veten kompetent e të pazëvendësueshëm për qeverisje në të gjitha sferat dhe kohërat. Këto grupe lidheshin nga të gjitha nivelet, sferat e rajonet dhe mbylleshin nga ndikimet e jashtme shoqërore dhe burokratizoheshin skajshmërisht. Zgjedhjet e pa konkurrencë sillnin njëtrajtshëm të njëjtat forca politike. Pra, kishte nivel të lartë përqendrim pushteti dhe mungesë konkurrence, krijim arbitrar i vullnetit politik dhe vendimmarrje arbitrare, mohim i të drejtave të njeriut, unitet i pushteteve, ishte edhe tirani e shumicës dhe sundim i masave të politizuara e të manipuluar skajshmërisht-popullizmi. Kjo ishte ‘përvoja dhe tradita’ qeverisëse kosovare, pasojat e së cilës reflektohen në kulturën politike edhe pas viteve të 90-ta.

Të gjitha këto dukuri ishin të theksuara në fazat etatiste para viteve 70-ta. Me vetëqeverisjen socialiste dhe avancimin kushtetues të Kosovës 1974, u arritë zhvillimi i disa sferave, veçmas në arsimim. Niveli i totalitarizmit tani ishte më i ulët. Roli dominues i partisë ishte më i dobët se në periudhën etatiste dhe në krahasim me vendet tjera socialiste, vetëqeverisja socialiste ishte shumë më liberale. Ishte larguar pakëz ndikimi partiak nga vendimmarrjet e drejtpërdrejta arbitrare. Tolerohesh një demokraci relative e organizatave territoriale. Në sistemin e vetëqeverisjes, Këshillat e punëtorëve, Bashkësitë e interesit dhe Organizatat punuese, kishin një liri relative vendimmarrëse e qeverisëse. (Kardel, 1960) Edhe pozita e RSFJ-së në botë, ishte e pa inkadruar në blloqe Lindje-Perëndim. Në viset rurale lejohej prona private dhe punësimi në botën e jashtme. Sistemi

socialist jugosllav quhej vetëqeverisje socialiste, dhe dallonte dukshëm nga socializmi në vendet e Lindjes, veçmas nga ai në Shqipëri. Me Kushtetutën e vitit 1974, Kosovës i njiheshin kompetencat e organizimit dhe ushtrimit autonom të shumë sferave.(Salihu, 1998:310-344) Qeverisja në ekonomi përmes Organizatave të Punës së Bashkuar, Këshillave të punëtorëve, Bashkësive të interesit, Sistemit komunal, Shërbimeve publike në arsim e kujdes shëndetësor, punësim në botën e jashtme, etj e karakterizonin vetqeverisjen socialiste. Pra, kishte rezultate relativisht të konsiderueshme. Në procesin e qeverisjes në nivel të Kosovës dhe në komuna praktikohej nivel i konsiderueshëm i decentralizimit të pushtetit. Kushtetuta Federative (1974) dhe ajo e Kosovës, (1974) Kosovën e avancuan me institucione politike legjislative, ekzekutive e gjyqësore autonome dhe organet e administratës me kompetenca organizative e vendimmarrëse në Kosovë, dhe përfaqësim pëmbajtësor e vendimmarrje në Federatë.

Karakteristikat e sistemit politik vetëqeverisës dhe karakteri shumë kombëtar i Federatës Jugosllave, tani pas vitit 1974 përmbante edhe elemente konfederative. Edhe institucionet politike asociative-Lidhja Komuniste me asociacionet tjera shoqëroro-politike, kishin organizim të veçantë në nivel të Kosovës, të cilat shprehnin autonominë përmbytësore të Kosovës në Federatë.(Salihu, 1984) Në këto vite, u shtua sasia dhe cilësia e arsimimit në të gjitha nivelet. Arsimitimi i popullatës ishte shndërruar në faktor zhvillimi të jetës politike. Tani shtresat studentore dhe intelektuale të lidhura me popullin, kishin dëshira dhe synime këmbëngulëse për zhvillim, barazi e liri. Rinia kërkonte qeverisje kosovare më të avancuar, më përgjegjëse dhe më atdhetare, pra më demokratike. Lindi ideja dhe kërkesa për avancim të statusit të Kosovës në Republikë, si instrument barazie e zhvillimi. Kërkoheshin institucione akoma më të pavarura dhe proces përkatës të

qeverisjes e përgjegjësish. Nga këto ide rezultuan edhe demonstratat e vitit' 81 dhe kërkesa dominuese për statusin e Republikës, sikurse njësitë tjera federative. Udhëheqja politike kosovare nuk mund ta menaxhonte situatën e as proceset politike.

Demonstratat e vitit' 81 krijuan lëvizje të fuqishme politike e kombëtare demokratike gjatë viteve në vijim. Influncuan në të gjitha poret institucionale dhe qeverisëse, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Federatë. Ishin edhe ecuritë e proceset rajonale e globale që reflektonin nevojat për ndryshime demokratike. Profesori Hoti, në këtë kontekst theksonte:

Kosova, me fjalë të tjera, as nuk e ka importuar, e as që mund ta importojë demokracinë. Dhe, nuk mund, gjithashtu, ta eksportojë atë. Ajo nuk mund ta ndërtojë demokracinë në baza të ekskluzivitetit nacional. Demokracinë në Kosovë nuk e lindën të tjerët, e as nuk u lind për qejfin e tyre. Ishte e ndërlidhur me proceset demokratike të Evropës dhe me synimet e tilla të njerëzimit. Demokracia në Kosovë u vetëlind në vitin 1981, kur qytetarët kërkuan që zëri i tyre të jetë suprem, demokracia në Kosovë do të rritet vetë, së bashku, e barabartë dhe e ndërlidhur me të tjerat dhe të tjerët. (Hoti, 1997)

Kishte edhe organizime të vogla politike ilegale, që përpiqeshin të veprojnë dhe ndikojnë në procese politike. Në Kosovë këto organizata ilegale ekzistonin që nga vitet 1945, edhe pse dënimet dhe represioni ndaj tyre ishte shumë i madh.⁶⁷ (Ajvazi, 2009)

Synimi i tyre kryesor ishte afirmimi, avancimi statusor e kombëtar i shqiptarëve në Kosovë dhe shqiptarëve në të gjitha trojet në Federatën e Jugosllavisë. Shfaqja e aktivitetit të tyre krijonte opinion, i cili demistifikonte teorinë zyrtare se çështja kombëtare e shqiptarëve është e zgjidhur në mënyrë të drejtë. Këto organizata përpiqeshin të informojnë qytetarët dhe opinionin e jashtëm se ndaj shqiptarëve bëhet politikë e padrejtë, plaçkitje e pasurive dhe moszhvillim. Këto i bënin përmes shkrimit të afisheve, literaturës së ndaluar, komunikatave, demonstratave, e formave tjera.⁶⁸

Pas vitit 1981, proceset politike në Kosovë u karakterizuan nga ndikimet e demonstratave të studentëve, inteligjencies e popullit, që përcilleshin më manifestime të vazhdueshme brenda dhe në mërgatë. Kërkesë dominuese e këtyre demonstratave ishte avancimi i statusit të Kosovës në Republikë, sikurse njësitë tjera federative. Ky avancim nënkuptonte zhvillim dhe barazi me Republikat tjera. Kosova si njësi federale ishte më e pazhvilluara në ish-Jugosllavi, edhe pse posedonte dy parakushte për zhvillim-popullsinë vitale dhe burimet natyrore. Gjendja zhvillimore ishte e pavolitshme dhe dominonte këmbëngulësia për afirmim e zhvillim, sidomos nga gjeneratat e reja. Nga kjo rridhte frymëzimi i kësaj lëvizjeje të fuqishme kombëtare. Kjo lëvizje gjithë popullore për Republikë, etiketohej si kontrarevolucion, separatizëm, shkatërrim të sistemit, prishje e rendit dhe integritetit territorial, etj. Pas kësaj kërkesë, politika serbe u vërsul ashpër kundër këtyre kërkesave dhe bartësve të tyre, kundër institucioneve autonome dhe gjithnjë përpiqej ta rrënojë autonominë përmbajtësore të Kosovës. (Magas, 1993:9-10) Kërkesa për Republikë ishte kërkesë për realizimin dhe garantimin e vetëvendosjes dhe vetëqeverisjes kosovare. Se sa ishte e drejtë e vizionare kërkesa për Republikë, e tregoi procesi gjatë shpërbërjes së RSFJ-së, dhe qëndrimeve e veprimeve të Bashkësisë Ndërkombëtare, e cila këtë të drejtë për vetëvendosje dhe shkëputje, ua njohu vetëm njësisë federative që kishin statusin e Republikës. Autonomia e Kosovës sipas Kushtetutës 1974 ishte e avancuar, por nuk ishte vetëvendosje, barazi e vetëqeverisje, siç propagandohej nga sistemi. Bashkësia Ndërkombëtare me shpërbërjen e Federatës së RSFJ-së gjatë viteve 90-ta, përkrahte vetëvendosjen vetëm njësisë federative me statusin e Republikës, e jo edhe atë etnike e as autonomitë si njësi federative në RSFJ. (Komisionit i Badinterit, 1991-92,93)

Mohimi i vetëvendosjes përcaktoi drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi procesin e qeverisjes dhe institucioneve, kuptohet krahas cilësisë së faktorit të brendshëm në momente e rrethana konkrete. Kjo lidhëshmëri kauzale e vetëvendosjes me institucionet dhe qeverisjen, u vërtetuan më së miri në rastin e Kosovës. Vetëvendosja dhe qeverisja kosovare është një proces që del nga kërkesa të brendshme e të domosdoshme, legjitime e këmbëngulëse, për një kohë të gjatë. Përpos faktorit vendor, cilësia e të cilit ishte esenciale, rol pozitiv luajtën edhe rrethanat ndërkombëtare në rajon, raportet dhe kompromiset e vendeve me ndikim, si dhe rendi dhe stabiliteti/destabiliteti ndërkombëtar që u krijua në rastin konkret. Vetëvendosja varej nga fakti se, sa faktori i brendshëm mund ta destabilizojë situatën rajonale dhe ndërkombëtare nëse nuk zgjidhet problemi, dhe sa e stabilizon gjendjen rajonale zgjidhja e problemit sipas kërkesave vendore. Për rendin dhe stabilitetin ndërkombëtar është integriteti territorial, por rasti i shpërbërjes së RSFJ-së tregoi se pa qeverisje e institucione demokratike, nuk mund të arsyetohet integriteti e sovraniteti territorial i as një vendi shumetnik. Fukuyama, thekson se mungesa e qeverisjes efikase, efektive e legjitime krijon jo stabilitet të brendshëm dhe ka pasoja direkt në destabilitetin ndërkombëtar.(Fukuyama, 2010) Për procesin e vetëvendosjes janë të rëndësishme vendimmarrjet ndërkombëtare, që determinohen nga një mori faktorësh e rrethanash rajonale e ndërkombëtare: rendi ndërkombëtar dhe e Drejta Ndërkombëtare, organizatat rajonale, rajoni konkret, proceset rajonale e globale dhe konfrontimet e kompromiset e vendeve me ndikim të interesuara në atë zonë. Këta janë faktorë përcaktues të proceseve, vendimmarrjeve e veprimeve konkrete ndërkombëtare. (Reka,1996:57-58) Të gjitha këto u reflektuan drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi në procesin e vetëvendosjes dhe ndaj qeverisjes e institucioneve kosovare.

Federatat socialiste, sado që kishin përmirësuar pozitën etnike e kombëtare në krahasim më sistemin e mëparshëm, në emër të sistemit socialist dhe ruajtjes së kufijve e integritetit dhe për t'i ruajtur dominimet, nuk ua kishin njohur e lejuar vetëvendosjen e plotë e reale kombeve në këto Federata.⁶⁹ (Hasani, 2010) Shqiptarëve u ishte mohuar vetëvendosja dhe vetëqeverisja brenda federatës, edhe pse i plotësonin të gjitha parakushtet për statusin e Republikës, dhe kishin të drejtë për barazi e shërim të së kaluarës. E gjithë kjo shprehej në procesin qeverisës, kushtetues e institucional. Kjo u shpreh edhe gjatë shkapërderdhjes së RSFJ-së.(Opinionet e Komisionit të Badinterit,1991-93)⁷⁰ dhe Rezolutave e vendimeve ndërkombëtare në këtë kohë dhe gjatë protektoratit. Kosova kishte disa elemente të subjektivitetit p.sh. Kosova është aneksuar më 1912; Kosova nuk ishte në përbërjen e shtetit serb në Kongresin e Berlinit(1878); Kosova kishte pozitën kushtetuese si element konstitutiv i RSFJ-së, veçmas me Kushtetutën 1974; suspendim antikushtetues të autonomisë gjatë vitit 1989; ishte pushtim i përcjell me gjenocid që nga viti 1912; sundohej pa "pëlqimin e të qeverisurve"; kishte elementin kompakt gjeografik, ekonomik, demografik e kulturor; vullnetin politik dhe aktet juridike burimore për pavarësi në vitet e 90-ta.(Stavileci, 2005:104) Mospranimi i vetëvendosjes krijonte krizë dhe jo stabilitet rajonal e ndërkombëtar-rasti i luftës. Kosova pas shpërbërjes së RSFJ-së, nuk i takonte Federatës Serbi-Mali i Zi, as në aspektin e integritetit territorial, as politik, e as juridik. Rezoluta e OKB nr. 2625 (1970) e ndërlidh të drejtën e një shteti për integritetin territorial me respektimin e së drejtës për vetëvendosje të popujve që jetojnë në territorin e tij, por e le të hapur se çfarë duhet të ndodhë, nëse shteti i shkel këto

obligime. Serbia e kishte shkel këtë Rezolutë, duke e robëruar e dhunuar këtë popull mizorisht me format gjenocidiale për një kohë të gjatë.⁷¹

Njohja e vetëvendosjes-pavarësisë së Kosovës (2008) e mundësoi realizimin e shtetit ligjor, demokracinë, të drejtat e njeriut dhe pakicave në Kosovë, zhvillimin, etj, me çka krijoi rend dhe stabilitet në rajon. Këto nuk mund t'i plotësonte kurrësi Serbia. Këto të drejta bazë janë në proces të mbarë në Kosovë, edhe pse u penguan për një kohë të gjatë. U penguan edhe gjatë bashkëqeverisjes me faktorin ndërkombëtar 1999-2008, si dhe pengesave të Serbisë dhe pengesave në integrim e afirmim nga disa shtete edhe pas shpalljes së Pavarësisë. Pra, lidhshmëria e lidhjes shkak-pasoj në mes të vetëvendosjes, qeverisjes dhe zhvillimit institucional e juridik, ekziston fuqishëm në rastin e Kosovës. Në Kosovë pas vitit 1990, nuk mjaftonte sistemi i pluralizmit e demokracisë, i të drejtave të njeriut dhe pakicave, pa vetëvendosje-pavarësinë. Ngase, Serbia nuk mund t'i afronte ato dhe konfliktet kishin rrënjë të thella afatgjate të padrejtësisë, shtypjes e gjenocidit. Vetëm Pavarësia e plotë dhe vetëqeverisja mund t'i zgjidhte këto padrejtësi.

Qeverisja dhe institucionet kosovare nuk mund të kuptohen e shpjegohen pa njohjen e procesit të vetëvendosjes në kohën e hapësirën kosovare.⁷² (Agani, 2002) Rasti i Kosovës, tregon ndikimet kauzale që kishte dhe ka procesi i vetëvendosjes në procesin e qeverisjes dhe në zhvillimin institucional e juridik. Vetëvendosja në formën e Pavarësisë, duhet ta përforcojë Kosovën në dobi të funksionimit të cilësisë së qeverisjes dhe institucioneve demokratike, si instrument i lirisë dhe zhvillimit. Kjo vlen posaçërisht për Kosovën, ngase proceset dhe problemet në Kosovë janë të kushtëzuara mu nga mohimi i

vetëvendosjes e lirisë së saj. Pra, çështja e Kosovës më të drejten publike, institucionet dhe qeverisjen, ishte çështje e vetëvendosjes, ngase, vetëm ajo do të krijonte kushte reale për zgjidhje të problemeve të shumta. Mohimi i vetëvendosjes, edhe pas ndërhyrjes së jashtme në Kosovë 1999-2008, ishte edhe mohim i vetëqeverisjes dhe i institucionalizimit të mirëfilltë demokratik dhe i kushtetutshmërisë. Ishte pengesë serioze e zhvillimit. Ndërsa pas vitit 2008, cilësia e qeverisjes i jep kuptim pavarësisë-institucioneve.

2.2. Rrënimi i autonomisë

Rrënimi i autonomisë së Kosovës u bë me Amendametet në Kushtetutën e Serbisë. (28 mars 1989) dhe më presione, shtetrrëhim e gjakderdhje nga ana e Serbisë në Kosovë. Në këtë gjendje të jashtëzakonshme të sigurisë, Serbia e suprimoi autonominë e Kosovës, duke krijuar rrethana të jashtëzakonshme edhe në Kuvendin e Kosovës, që të deklarohet për këto amendamente (23 mars 1989).⁷³ Politika unitariste serbe e filloi haptas dominimin serb në Federatë dhe luftën pushtuese e politikat gjenocidale, veçmas ndaj Kosovës. Në Kongresin e 14 të LKJ (1990) erdhi deri të përçarja dhe largimi i delegacioneve të Sllovenisë e Kroacisë. Më 1991 pasoi shpallja e Pavarësisë së Sllovenisë, Kroacisë, mandej Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës dhe e luftës së Serbisë për dominim e pushtim. Shkak kryesor i shpërbërjes së Federatës ishte politika dominuese e unitariste serbe⁷⁴ (Woodward,1995:199-222; Zimerman,1996; Judah, 1997:143-145) Politika serbe iu vërsul të gjitha institucioneve kosovare dhe ndërmarrjeve ekonomike për

ta rrënuar autonominë dhe ekonominë e Kosovës⁷⁵ (Riinvest,1997) Por, këtë heqje të autonomisë e deinstitutionalizim antikushtetues nuk e arriti lehtë, institucionet dhe mediat zyrtare bënë shumë vite propagandë e gënjeshtër për krijimin e opinionit në nivele të Federatës dhe në Serbi. Politika e Serbisë përpiqej të krijojë opinion kinse serbët dhe Serbia janë viktimë dhe të pabarabartë me republikat e tjera, dhe sipas tyre, e gjithë kjo rridhte si rezultat i rregullimit federativ. Atyre u nevojitej shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, shtetrrëthim, vrasje, burgosje e represion të ashpër sistematik shumëvjeçar. Këtë e arriti me ndryshime antikushtetuese dhe shkelje të procedurave dhe me okupim klasik të Kosovës gjatë vitit 1989/90, duke e deinstitutionalizuar e suprimuar në tërësi organet dhe qeverisjen autonome kosovare.

Përpos rrenimit të autonomisë së Kosovës, qëllim kishte edhe dominimin në Federatë. (Zimerman, 1996) Këto qëllime ndaj Federatës në tërësi u theksuan më vonë. Disa prej njësive federative kishin ngarkesa nacional-shoviniste ndaj përkatësisë shqiptare dhe ndaj Kosovës, ngase kishin popullsi e territore shqiptare në Republikat e tyre. Si të tilla, nuk e mbrojtën kushtetutshmërinë, aq më pak kërkesat dhe të drejtat kosovare. Këto republika shpresonin së Serbia do të ndalet vetëm me pretendimet ndaj Kosovës. Filloi haptas dominimin në Federatë dhe lufta pushtuese edhe ndaj popujve të tjerë. Më këto „ndryshime kushtetuese” të heqjes së autonomisë së dy krahinave (28 mars 1989) dhe futjen e tyre nën dominimin serb, Serbia krijoi debalancë qeverisëse e vendimmarrëse në Federatë dhe kështu u provokua edhe shpërbërja e RSFJ-së. (Judah, 1997; Zimerman, 1996) Destrukcioni politik e kushtetues kishte filluar gjatë viteve të 80-ta (Magas, 1993:9-

10) Rrënim i antikushtetues i autonomisë së Kosovës, kishte filluar me vlerësimet joreale e tendencioze të demonstratave⁸¹ dhe aksioneve e veprimeve antishqiptare e anti kosovare të politikës hegjemoniste serbe, me heshtjen e institucioneve federative dhe njësive federale, gjatë gjithë viteve të 80-ta. Më këto ndryshime në Kushtetutën e Serbisë, Kosovën e mbanin në gjendje të jashtëzakonshme në shtetrrëhim ushtarako-polikor e më reprezalje. Kosovës i hiqet subjektiviteti politik e juridik i autonomisë: organet e administratës krahinore u subordinuan nga organet e Serbisë, u reduktuan kompetencat e Këshillit ekzekutiv-qeverisë së Kosovës, ju morren kompetencat organeve të administratës, organeve të drejtësisë, u suspenduan organet e pushtetit komunal dhe u vendosen drejtori të dhunshme nëpër shum ndë marrje e institucione dhe u larguan nga puna dhe nga institucionet shumica e punëtorëve e drejtuesve të tyre. Më këto filloi dhe zgjati okupimi i Kosovës nga Serbia 1989-1999. Politika e Serbisë gjatë viteve të 90-ta kishte marr rrugën e gjenocidit ndaj popullatës shqiptare në Kosovë. (Zajmi, 1995) Pra shoqëria kosovare gjatë këtyre viteve u ballafaqua edhe më gjenocid.

2.3. Qëndresa shqiptare 1989/99

Popullata shqiptare e Kosovës e cila përbënte rreth 93% të popullsisë, në kushtet e okupimit dhe gjenocidit dhe gjatë shpërbërjes së Federatës, fuqishëm kërkonte vetëvendosjen dhe avancimin e barabartë institucional e kushtetues më njesitë tjera federative. Kjo kërkesë u fuqizua në vitet 90-ta pas okupimit dhe ndryshimeve rajonale e globale, jo vetëm si rezultat i represionit e okupimit serb, por edhe nga përcaktimet gjithëpopullore për barazi e zhvillim. Në këto rrethana filloi procesi i krijimit të institucioneve dhe e akteve juridike të pavarura. Kuvendi i Kosovës, i larguar nga objektet e tij, shpalli aktet burimore juridike të vetëvendosjes në rrethana të okupimit e gjenocidit:

Deklaratën Kushtetuese (2 Korrik/1990); miratoi Kushtetutën (7 Shtatorit/1990) në Kaçanik në rrethanat e okupimit; organizoi dhe e mbajti me sukses Referendumin për Pavarësi (1991); shpalli dhe organizoi zgjedhjet (1992). Edhe pse, këto akte kushtetuese e politike me institucionet përkatëse nuk ishin funksionale sa e si duhet, për shkak të okupimit dhe politikës represive e gjenocidale serbe, sipas konstitucionalistëve të shumtë dhe sipas profesor Bajramit, ishin vullnet politik dhe akte juridike legjitime të shtetësisë së Kosovës (Bajrami, 1997) Ishin vlera dhe përcaktime gjithë popullore për qeverisje e institucione politike të pavarura, në pajtim më vullnetin e qytetarëve të shprehura e aprovuara si akte legjitime në Kuvendin të Kosovës dhe përmes referendumit. Shkaqet për nivelin e funksionimit të këtyre institucioneve ishin objektive dhe subjektive. Ishte ballafaqimi i politikës çlirimtare kosovare në njërën anë dhe aktet jokushtetuese e politikat hegjemoniste okupuese të Serbisë, në anë tjetër. Përcaktimi për vetëvendosje dhe vetëqeverisje, rezistenca paqësore dhe ajo ushtarake më vonë, ishin procese dhe tendenca të rritjes, zhvillimit dhe përcaktimit për vetëvendosje, për liri, vetëqeverisje e zhvillim institucional demokratik, e jo vetëm për kundërvënie represionit të okupatorit. Nga kjo del edhe origjinaliteti i organizimit, veprimit, sakrificës për liri, barazi dhe demokraci.

Shpërbërja e Federatës dhe proceset globale e rajonale ishin të një rëndësie të veçantë. Këto rrethana favorizuan edhe proceset e brendshme për vendimmarrje historike të shoqërisë kosovare, të përcaktuara e të synuara vazhdimisht. Rrënimit të autonomisë (mars/1989) dhe okupimit policor e ushtarak të Kosovës, shoqëria kosovare më institucionet i bëri bojkotim total juridik, politik e institucional. Kosova u shndërrua në një koloni serbe. Kërkesa për pavarësi përmes akteve juridike,(1990) referendumimit (1991), rrënimi i autonomisë (1989), mungesa e RSFJ-së, pushteti policor e ushtarak pushtues,

etj., Kosovën e bënin vend të okupuar me përpjekje për çlirim. Thjesht, Serbia në Kosovë kishte vetëm prezencë policore e ushtarake dhe aspak prezencë politike e juridike legjitime. Si rezultat i bojkotimit total politik e juridik nga institucionet e popullësia e organizuar shqiptare, përmes akteve dhe përcaktimeve legjitime dhe proceset globale në rajon, çështjen e Kosovës e shndërruan në çështje të hapur që kërkonte zgjidhje. Okupatori serb, e pengonte organizimin dhe veprimtarinë institucionale.

Serbia, pa zgjedhur mjete dhe metoda, suspendoi të gjitha organet themelore të pushtetit autonom ekzistues. (Woodward, 1995) Largoi nga puna edhe përfaqësuesit e administratës së lartë, dhe tërë administratën lokale. Në ndërmarrjet shoqërore e publike e largoi menaxhmentin dhe punëtorët shqiptar. Ndaloj mediet dhe i okupoj objektet e tyre. Largoi nga objektet të gjithë studentët dhe nxënësit e mësimdhënësit. Në Kosovë ndodhi një homogjenizim i paparë, dhe si i tillë i bllokoi në tërësi organet jolegjitime të okupatorit serb. Forcat e sigurisë: Policia e Kosovës dhe Vetëmbrojtja, frontalisht e lëshuan bashkëveprimin me forcat okupuese serbe. U konsoliduan disa nga organet legjitime kosovare në kushte gjysmë ilegale. Në kushte të tilla vepronte edhe Kuvendi i Kosovës dhe qeveria e cila doli në ekzil.

Gjendja në Federatën Jugosllave, indoktrinimi i popullit serb, raporti i njësive federale me Serbinë, gjendja kaotike dhe kriza ekonomike, lufta, etj., ishin karakteristika të gjendjes politike e tragjike në ballkan dhe në RSFJ. (Woodward, 1995:199-222) Shpresa dhe besimi se proceset globale do të krijojnë rrethana më të lehta, sugjerimet e vendeve me ndikim për ta ruajtur paqen në rajon, mungesa e armatimit, etj., ishin faktorë e variable që ndikuan në specifikat dhe origjinalitetin e veprimtarisë rezistuese paqësore kosovare. Popullata kosovare u homogjenizua për mbijetesë dhe kundërvënie injoruese ndaj

pushtetit okupues serb, duke u përballur më sakrificat, vrasjet dhe represaljet serbe që ndodhnin çdo ditë, të cilat morën formë gjenocidiale. (KCSF- CIVICUS, mars 2011:20)

Akademik Stavileci, në një Sesion Shkencor (29 qershor/2000) të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës mbi “Gjenocidin serb ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve 90-ta” argumenton me një mori fakteve se në Kosovë ka ndodhë gjenocidi “Nxitja publike e akteve të urrejtjes dhe të armiqësisë, dhuna shtetërore ndaj shqiptarëve dhe aktet e drejtpërdrejta të gjenocidit ndaj shqiptarëve ‘përbëjnë një tërsi aktesh të ndërlidhura, të cilat tregojnë karakterin ciklik të gjenocidit të ushtruar ndaj shqiptarëve’.”(Stavileci 2005:38) Ai thekson se “motivi më i madh i pushtetit gjenocidial është lakmia për toka dhe synimi i ndryshimit të strukturës demografike të rajoneve me shumicë etnike tjetër” i cili argumenton se këto akte i përkasin gjenocidit dhe janë të denjshme më Konventën për pengimin dhe Denimin për Krimin e Gjenocidit, të vitit 1948. (Stavileci 2005:38)

Në mungesë të funksionimit të institucioneve rregullative e shtetërore, u formuan parti, shoqata, këshilla, sindikata e organizata të pavarura të cilat rregullonin jetën nën okupim. Ky mos inkuadrim në organet e Serbisë në Kosovë nga ana e qytetarëve, ishte i qind për qind. Organet ‘shtetërore e publike’ okupatori i formonte vetëm nga pakica serbe e Kosovës dhe serbët nga Serbia, e më vonë edhe me serbët nga Kroacia, si dhe me disa nga minoritetet tjera. Prezencën ‘politike e qeverisëse’ serbe në Kosovë, e karakterizonte vetëm presioni ushtarak e policor, pra okupues klasik që vërehej nga të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe vendet me ndikim. (Balla, 1993) Bojkotoi fuqishëm institucionet serbe në sferën juridike, politike e administrative. (Stavileci, 2001) Partitë kosovare shqiptare, kishin anëtarësuar tërë popullatën dhe disa nga minoritetet në subjekte partiake e

organizime të tjera, dhe përmes këtij organizimi luanin role e funksione të institucioneve rregullative. Nga shërbimet publike funksiononte procesi i arsimit, ku nxënësit e studentët dhe mësimdhënësit ishin më meritoret për sukseset në ato rrethana. Pra, shoqëria kosovare krijoi këto institucione vetjake specifike që ndikonin në shumicën e sferave shoqërore.

Aftësia e pamjaftueshme mbrojtëse e luftarake, shpresa që më vonë presioni diplomatik ndërkombëtar dhe sanksionet ndaj Serbisë do të japin rezultate, kompromitimi i Serbisë në luftën me njësitë tjera federative, interesi i vendeve me ndikim për ta ruajtur stabilitetin në rajon, pasiguria për përkrahje ushtarake nga jashtë, etj., ishin rrethana që ndikuan në përcaktim të rezistencës paqësore. Edhe pse kjo gjendje zgjati shumë dhe pati pasoja të mëdha, si dhe detyrimi i mëvonshëm që procesi të vazhdohet me rezistencë luftarake, këto akte juridike dhe veprimtari gjithëpopullore rezistuese ishin vullnet politik e akte juridike legjitime, të cilat nuk duhet nënçmuar, përkundrazi. Kosova pas aneksimit nga Serbia, nuk mori pjesë në asnjë proces politik e akt juridik në Federatën serbo-malazeze, e cila pretendonte të jetë vazhdimësi e RSFJ-së.

Shpërbërja e RSFJ-së, e shkaktuar nga përpjekjet për dominim të Serbisë, u shndërrua në konflikte ushtarake si burime të destabilitetit rajonal. Si të tilla paraqisnin edhe burime të destabilitetit ndërkombëtar, të cilat shkaktuan angazhim ndërkombëtar për menaxhimin e krizave në rajon. Këto kriza karakterizoheshin me konflikte etnike e përpjekje për ruajtje të dominimit serb në njërin anë, dhe shkëputje, çlirim e pavarësi, në anën tjetër. Ekuilibri si faktor i stabilitetit ndërkombëtar, që konceptohej gjatë Luftës së Ftohtë, tani kishte kaluar. Burimet e destabilitetit rridhnin nga brenda. Tani, sipas Komisionit arbitrar, Federata e RSFJ-së nuk ishte më shtet real, ishte në proces të shpërbërjes, ngase nuk

qeveriste efektshëm territorin dhe njësit e saja federative⁷⁶ (Arbitration Commission of the Peace Conference on Yugoslavia, 1991, 1992)

Bashkësia Ndërkombëtare procesin e vetëvendosjes së njësive federative dhe shpërbërjen e RSFJ-së, e menaxhoi me ndikimet e saja 10-vjeçare. Në këtë proces u përfshi KE, OKB, OSBE, SHBA, G-8, NATO-ja, FMN, BB dhe shumë organizata tjera rajonale e globale. Përpjekjet e Bashkësisë Ndërkombëtare filluan nga organizatat rajonale të KE/BE-së dhe angazhimin e SHBA-ve, të cilat përpiqeshin të pengojnë përhapjen e luftës dhe ndalimin e saj. Në fillim këto angazhime të jashtme ishin të ngadalshme, të paqarta dhe konfliktet konsideroheshin probleme të brendshme. Shpërbërja e Traktatit të Varshavës dhe ndërrimi i sistemit qeverisës e institucional socialist, shpërbërja e Federatave socialiste, procesi i vetëvendosjes së njësive federative dhe konfliktet përcjellëse, impononin ndryshim të rolit të NATO-s në rajon dhe rolin e organizatave rajonale e ndërkombëtare. Këto ndryshime përfshinin ndryshime strategjike, qasje të re ndaj sigurisë ndërkombëtare dhe evitimin e burimeve të krizave në këto rajone e procese. Shpërbërja e Federatës dhe kriza qeverisëse e ekonomike, krijoi destabilitet ndërkombëtar në rajon. Serbia kishte planifikuar dominimin në Federatë dhe krijimin e Serbisë së madhe që nga vitet e 80-ta. Këtë e kishte përpunuar Memorandumi i Akademisë së Shkencave në vitin 1986,⁷⁷ (Nase Teme, 1989 v.33, nr1-2/89:128-163) tani me zbatues Milosheviqin me politikë populliste, nacionaliste e shoviniste, duke u përpjekur për të dominuar në njësitë federative përmes përdorimit të armatës.

Ndaj heqjes së autonomisë së Kosovës dhe represionit policor e ushtarak, Bashkësia Ndërkombëtare nuk kishte ndonjë qëndrim të theksuar kundër. Mediet e jashtme

informonin dhe krijonin opinion të saktë për peshën e ngjarjeve. Ndryshimet e sistemit qeverises kishin filluar në të gjitha vendet socialiste. Shihej se nuk ka kthim prapa sa i përket sistemit të ri të qeverisjes. Ngase, edhe kriza ekonomike dhe moszhvillimi, ishin si rezultat i sistemit qeverisës në ekonominë socialiste dhe i federalizmit joparimor. Rënia e produktivitetit dhe inflacioni i madh e brente sistemin ekonomik. Kriza ekonomike, dominimi serb dhe nevojat për liri e zhvillim, ishin ndër faktorë thelbësorë për ndërrimin e sistemit qeverisës socialist dhe vetëvendosjen. Faktorit Ndërkombëtar e mbështeste rezistencen paqësore në Kosovë. Ngase i konvenonte një status quo dhe ruajtje e qetësisë në rajon. Qëndrimet e Bashkësisë ndërkombëtare ishin të pa koordinuara dhe nuk ishin të gatshëm të ballafaqoheshin seriozisht me këto probleme. Pikëpamjet e Bashkësisë Ndërkombëtare në fillim të krizës, ishin për mbrojtje të integritetit territorial të RSFJ-së. Këto qëndrime e trimëruan politikën dominuese serbe akoma më shumë, e cila nuk pranonte propozimet për ndryshime të marrëdhënieve në Federatë. Në këtë kohë kishte propozime për një Federatë asimetrike ose Konfederatë.

SHBA-të ia tërhoqën vërejtjen Serbisë „me vijën e kuqe” në rast konflikti të hapur në Kosovë. Përkrahnin rezistencën paqësore, por vetëvendosjen e jashtme dhe gjendjen okupuese nuk e kundërshtonin në mënyrë të prerë. Deklaronin se çështja e Kosovës duhet të zgjidhet ‘hap pas hapi’ me kthimin e autonomisë. Kërkohej sakrificë më e madhe dhe destabilizim ndërkombëtar në këtë rajon, për ta ndryshuar qasjen e Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës. Humbja e shpresës se çështja e Kosovës mund të zgjidhet në mënyrë paqësore dhe përmes formave të presionit, veçmas pas

Dejtonit,⁷⁸ (1995) në Kosovë u kuptua se këto metoda të rezistencës nuk mjaftojnë për ta angazhuar më seriozisht faktorin ndërkombëtar.

Politika kosovare dhe institucionet jofunksionale, kishin fuqi dhe autoritet vetëm mbi baza morale dhe konsiderata politike. (Salla, 1995, V26, 4, 434-435) Në rastin e Kosovës nuk mund të kthehej gjendja e më parme në asnjë rrafsh juridik. (Sejdiu, 1996:371-379) Kjo formë e rezistencës duke mos dhënë rezultate, filloj të topitej dhe pasivizohej. Faktori Ndërkombëtar shprehte pikëpamjet për zgjidhjen e çështjes së Kosovës përmes autonomisë pëmbajtësore. Të qytetarët e Kosovës ishte mbjell dëshira e flaktë për liri, barazi e zhvillim, pra, për pavarësi të plotë nga Serbia. Kështu filluan të forcohen pikëpamjet e subjekteve të caktuara politike dhe tek grupet e individët, se vetëm lufta e armatosur kundër okupatorit do ta zbërthente status kuon vendore dhe pikëpamjet e metodat e diplomacisë botërore. Grupimet me qëndrime alternative në diasporë, dhe grupimet e brendshme të orientuara për luftë, e krijuan institucionin e mbrojtjes dhe luftës për liri-Ushtinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). (Bugajski, 1998, V 21, 3, 19-23)

Lufta krijoi destabilitet të përgjithshëm dhe krizë humanitare e rrezikimin e paqes ndërkombëtare në rajon-mundësinë e përhapjes së luftës në rajon, prandaj si e tillë shkaktoi angazhimin shtesë të Bashkësisë Ndërkombëtare. Pa këtë rezistencë të kosovarëve nuk do të kishte vlerësime, akte e vendimmarrje ndërkombëtare që pasuan. Andaj, nga kjo del rëndësia e kësaj rezistence e sakrifice. Këtë e shkaktoi rezistenca politike e ushtarake dhe sakrificat e shumta gjithëpopullore, pa të cilat nuk mund të kishte procese të mirëfillta burimore as në sferën qeverisëse e institucionale kosovare. Politika

serbe me metodën e shpërnguljes, të dëbimit dhe pastrimit etnik, krijoi edhe krizën humanitare e cila, për kohën dhe rajonin ku ndodhte, ishte tejet e papranueshme. Populli dhe rinia kosovare të etshëm për liri dhe të gatshëm për sakrificë, me shpejtësi të madhe iu bashkuan radhëve të UÇK-së dhe rezistencës civile aktive. Mungesa e armatimit dhe politika masakruese e dëbuese ndaj popullatës civile e vështirësonte situatën, por populli kishte vendosur të jetojë i lirë dhe ishte i gatshëm për të gjitha sakrificat. Përkundër të gjitha vështirësive me të cilat përballej popullata, ajo vetëorganohej e institucionalizohej në rrethana specifike të luftës.

Mungesa e traditës në debat të forcave politike e partiake, si dhe mungesa e gatishmërisë për kompromise në udhëheqje dhe emocionet dominuese bajraktariste, si dhe lakmia ndaj fondeve monetare të diasporës, krijonte atmosferë jo bashkëpunuese në mes të përfaqësuesve politikë të UÇK-së me partitë politike në Kosovë dhe me Qeverinë në ekzil, të cilat pamundësuan krijimin e një fronti të gjerë politik. (Kelmendi, 1999) Gjendja e krijuar dhe dëshira për shtet, liri e zhvillim, ishin të fuqishme dhe të gjitha këto kishin krijuar legjitimitet për luftë çlirimtare të Kosovës.

Bashkësia ndërkombëtare në përkrahje të vetëvendosjes, njësive federative u kërkonte qeverisje dhe institucione demokratike funksionale.⁷⁹ (Hasani, 2010:218-264) Kriteret e shtetit ligjor, demokracisë, legjitimitetit, të drejtat e njeriut dhe pakicave, paqe e stabilitetin, etj., Kosova, nuk mund t'i arrinte në RFJ dhe me Serbinë në asnjë formë federalizmi. Këto mund të arriheshin vetëm më Pavarësinë e plotë të Kosovës nga Serbia. Risi e Bashkësia Ndërkombëtare në procesin e vetëvendosjes së njësive të RSFJ-së, ishin

edhe masat shtrënguese ndërkombëtare, si mjete e qëllime për të lehtësuar vetëvendosjen. Bashkësia Ndërkombëtare në përkrahje të vetëvendosjes kosovare ishte e vonuar, por edhe realiteti në terren ishte i ndërlikuar; ajo kishte pengesa të shumta vendimmarrëse, rivalitete në veprime e pengesa të së drejtës ndërkombëtare. Rasti i Kosovës ishte rast *sui generis* në shumë aspekte. Juridiksioni ndërkombëtar dhe parimet e vendimmarrjeve ndërkombëtare, ndërlidheshin më shumë faktorë e rrethana globale e rajonale.

Rezistenca gjithë popullore ishte gjithashtu specifike, meqë popullata ishte përcaktuar për liri dhe pavarësi, pa marr parasysh sakrificat. Dinte nga historia për politikën e pastrimit etnik, që kishte përdor Serbia ndaj trojeve shqiptare. Më guxim e vendosmëri përkrahte djemtë e vashat e luftës, duke sakrifikuar së bashku. Rezistenca këmbëngulëse dhe permanente paqësore, e tani edhe ushtarake, e ndërkombëtarizoi gjendjen e rëndë dhe problemin e pazgjidhur të Kosovës. Këto dy lloj rezistencash nuk ishin të ndara për nga roli historik që patën gjatë kësaj periudhe, edhe pse forcat bartëse të tyre rridhnin nga grupe e subjekte të ndryshme politike, të cilat nuk u koordinuan dhe nuk bashkëvepruan si duhet gjatë luftës dhe as pas saj. Shoqëria Kosovare, tani kishte përvojë disavjeçare në organizimin vetjak në rrethana të okupimit dhe reprezaljeve. Përmes organizimeve të këshillave emergjente dhe shoqatave të shumta humanitare, e ndihmonte zona-zonën dhe strehimin e popullatës së zonave të përfshira drejtpërdrejt nga lufta. Popullata civile ishte e përfshirë në luftë, ngase Serbia luftonte edhe më popullatë civile. Ishte e interesuar ta gjunjëzoi atë, ta dëbojë nga trojet e veta, ngase pastrimin etnik e kishte në programin politik dhe ushtarak. Përkrahje të shumanshme kishte nga institucionet dhe qytetarët e Republikes së Shqipërisë.

Kreu III: Administrimi ndërkombëtar i Kosovës

3.1. Konferenca e Rambujesë

Rezistenca ushtarake me rezistencën e popullatës civile në njerën anë dhe krimet e gjenocidi serb në anën tjetër, e destabilizuan rajonin. Si rezultat i kësaj, pasoi ndërhyrja ndërkombëtare më e drejtëpërdrejt diplomatike e ushtarake. Vazhdimi i vendosur i luftës heroike të kosovarëve, masakrimi i popullatës dhe frika e përhapjes së luftës e detyroi faktorin ndërkombëtar të ndryshoi qasjen dhe format ndaj zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Institucionet dhe diplomacia ndërkombëtare kishte vështirësitë e veta të rendit dhe së drejtës ndërkombëtare ekzistues dhe mentalitetin e vjetër diplomatik. Ndërhyrja ndërkombëtare në rajon dhe në çështjen e Kosovës ishte e vazhdueshme gjatë viteve të 90-ta, më një mori vendimeve, rezolutave, sanksioneve dhe presioneve. Reagimi i Bashkësisë ndërkombëtare rreth situatës në Kosovë bëhej edhe përmes Grupit të Kontaktit, i cili gjatë vitit 1998 ishte mjaftë aktiv në Takimet: në Londer (9 mars 1998 dhe 15 e 25 mars 1998); Deklarata e Bonit (29 prill dhe 9 maj 1998); në Londer (12 qershor 1998); në Bon (më 8 korrik 1998). Të gjitha këto 'Deklaratë për Kosovën', reagonin ndaj gjendjes në Kosovë dhe kërkonin respektimin e vlerave liberale të qeverisjes, kërkonin një vetëqeverisje autonome e demokratike në Kosovë. Këto vlera demokratike qeverisese i kishte penguar më ngulmë Serbia dhe RFJ që nga viti 1989. Deklarime të ngjajshme kemi edhe në OKB më një vargë rezolutave: Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Nr.1160 (31 mars 1998); Rezoluta e KS NR.1199 (23 shtator 1998); Rezoluta e KS Nr.1203 (24 tetor 1998); Në Deklaratën e Këshillit të NATO-s mbi Kosovën, (8 dhjetor 1998), ceket qartë përkrahja ndërkombëtare për ta ndalu krizën humanitare, për ta ndalë dhunën dhe për zgjidhjen e krizes në Kosovë. Grupi i Kontaktit më 9 mars 1998, e definoi agresorin në

Kosovë. KS i OKB më (31 mars 1998) aprovoi Rezolutën e njohur 1160, e cila mbështetet në Kaptinën e VII të Kartës së OKB-së. Qëndrimet e OKB-së garantonin integritetin territorial të RFJ-së, ndërsa për Kosovën cekej autonomia përmbajtësore.

Por, ndërhyrja e forumeve ndërkombëtare më drejtpërdrejtë në Kosovë ndodhi në vitin 1999. Ndërhyrja e Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë në vitin 1999 dhe veprimtaria e saj, krijoi rrethana të reja qeverisëse e institucionale përmes akteve juridike dhe veprimeve ndërkombëtare më të drejtëpërdrejta, kryesishtë më: Konferencën e Rambujesë (shkurt-mars/1999); Intervenimin NATO-s (mars,1999); Dokumentin e OKB: S/1999/699 (2 qershor 1999); dhe Rezoluta e KS e OKB-së nr. 1244, (12 qershor/1999) të cilat krijuan akte juridike e rrethana të reja qeverisëse e institucionale në Kosovë. Forumet ndërkombëtare për qeverisjen e Kosovës janë shprehur e përcaktuar përmes akteve juridike për çështjen e Kosovës. Pjesa përmbajtësore e këtyre akteve përcakton formën dhe specifikat e qeverisjes në Kosovë. Gjatë Administrimit ndërkombëtar 1999-2008, qeverisja dhe institucionalizimi në Kosovë bazohej kryesishtë në Rezoluten 1244 të OKB-së. Kjo Rezolutë, karakterizohej nga qëndrimet kompromisëse të kontradiktave ndërkombëtare ndaj statusit të Kosovës, të cilat reflektoheshin edhe në qeverisjen dhe institucionalizimin kosovar. Kjo Rezolutë në pikën 11 përcakton përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare në krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtësore në Kosovë deri në zgjidhjen politike në të ardhmen, duke marrë tërësishtë parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë: (S/1999/648), të cilat e përshkruajnë procesin qeverisës në këtë fazë kalimtare. Përmes këtyre vendimeve, akteve dhe veprimeve, Bashkësia ndërkombëtare krijoi rrethana të reja qeverisëse e institucionale në Kosovë më ndërhyrje të drejtpërdrejtë edhe në qeverisjen e saj.

Bashkësia ndërkombëtare, në proces të angazhimit të zgjidhjes së problemeve dhe ruajtjes së stabilitetit në rajon, organizoj një Konferencë ndërkombëtare në Rambuje të Francës, (6 shkurt 1999) për zgjidhjen e problemit të Kosovës, në të cilën morën pjesë delegacioni nga Kosova dhe ai nga Serbia, përmes menaxhimit nga Grupi i Kontaktit. Këtë situatë e shpreh edhe analisti Tim Judah, i cili e përcillte analizotë Konferencën:

Probleme të tjera madhore të projekt marrëveshjes ishin se askush nuk e dinte cili do të ishte mekanizmi që do të përcaktonte fatin e Kosovës pas tre vjetësh dhe se, kosovaret vazhdonin të ngulnin këmbë se duhet të bëhej patjetër një referendum për pavarësinë... Shprehur thjesht, ky thelb ishte që serbët të pranonin zbarkimin e trupave të NATO-s, por si shkëmbim, shqiptarët duhet të hiqnin dorë nga referendumi. Në këtë mënyrë, diplomatet mendonin se do të mund ta ngrinin konfliktin, ndoshta për një kohë shumë më të gjatë se sa periudha e ndërmjetme trevjeçare që po diskutohej tani. Për më tepër, ata shpresonin se deri atëherë, Milosheviqi do të kishte ikur, gjë që do ta bënte me të lehtë arritjen e një marrëveshjeje për statusin përfundimtar, duke pasur ndonjë qeveri më pak të ngurtë në Beograd. (22 shkurt 2003)

Delegacioni i Kosovës nuk ishte i pajtimit më pjesën që përmbante formën e qeverisjes, në veçanti, i frikësohej vendimmarrjeve të ardhshme ndërkombëtare rreth statusit të Kosovës, ngase historia e vendimmarrjeve ndërkombëtare për trojet shqiptare gjatë shekullit të kaluar ishte e hidhur. Delegacioni i Kosovës e kishte nënshkruar marrëveshjen e ofruar nga bashkëbiseduesit ndërkombëtar. Ndërsa, delegacioni serb kishte nënshkruar vetëm pjesën e Projekt-marrëveshjes politike për vetëqeverisjen në Kosovë. (Vendimet e Konferencës së Rambujesë, 1999)

Gjendja e rëndë në terren dhe dallimet ndërkombëtare, impononin kompromiset momentale nga ana kosovare. Kosovarët, në qoftë se nuk e pranonin marrëveshjen, frikoheshin se do të humbnin mbështetjen ndërkombëtare dhe një proces të avancuar të ndërhyrjes ndërkombëtare, por kishte rezerva sa i përket rezultatit përfundimtar; ajo këmbëngulte në referendum pas tri vitesh. Por, në vend të një referendumi, marrëveshja u modifikua ‘në vullnetin e popullit’ si njëri nga faktorët:

Tre vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, do të thirret një mbledhje ndërkombëtare për të përcaktuar mekanizmin për një zgjidhje përfundimtare për Kosovën, mbështetur në vullnetin e popullit, mendimet

e autoriteteve përkatëse, përpjekjet e secilës palë në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe më Aktin Final të Helsinkit . (Vendimet e Konferencës së Rambujesë, 1999 Aneksin II të: S/RES/1244).

E drejta ndërkombëtare pozitive dhe kontradiktat e vendeve më ndikim, krijojnë vështirësi në veprime të Bashkësisë ndërkombëtare. Përpos pengesave në të drejtën ndërkombëtare, kishte dallime në mes vendeve me ndikim global, të cilat shpreheshin në vendimmarrjet e forumeve ndërkombëtare dhe në KS të OKB-së. Andaj, edhe për këto arsye kërkohej kompromisi në këtë Konferencë për të ecur përpara. Kërkonin kompromise nga kosovarët për të siguruar pajtim politik për bashkëqeverisje përmes protektoratit civil ndërkombëtar. Në Rambuje u diskutua për të ardhmen e Kosovës në dy raunde por, nuk përfundoi me marrëveshje. Në Rambuje nuk nënshkruan: RFJ dhe as Rusia. Nënshkruan: Shqiptarët dhe vendet e BE dhe SHBA. Çështja mbeti e pamarrëveshje. Mospranimi i Projektmarrëveshjes nga ana e Serbisë pasoj ndërhyrje të NATO-s (24 marsi i vitit 1999). Serbia, vazhdojë me krime e pastrim etnik. Ky ishte hapi i parë i largimit të Serbisë nga Kosova, dhe parashihej zgjidhje e mëvonshme e statusit, krahas angazhimit ndërkombëtar, palëve dhe vullnetit të shprehur të popullit.

Në një intervistë të profesorit Fehmi Agani, pjesëmarrës aktiv në Konferencë, pas nënshkrimit të marrëveshjes nga pala shqiptare/kosovare, vlerësoi se:

Marrëveshja për paqen dhe qeverisjen në Kosovë, që u nënshkru vetëm nga pala shqiptare, dhe nuk u nënshkru nga pala serbe, është një hap i rëndësishëm në drejtim të zgjidhjes së problemit; nuk e zgjidhë problemin, por e hap një perspektivë për zgjidhjen e problemit. Pala serbe vazhdon me obstrukcionin duke mos e nënshkruar marrëveshjen dhe duke mos participuar në bisedime dhe duke injoruar procesin negociator, nuk ka koperuar me organizatorin e as me ne...me këtë obstrukcion pala serbe ka deshtuar. Kosova fiton një periudhë të stabilitet relativ dhe shkallë të konsiderueshme të vetëqeverimi. Nuk kemi iluzion, kjo marrëveshje nuk është realizim i i synimeve tona, nuk është pavarësi e Kosovës, por e rrenon në mënyrë shumë të fuqishme pozitën e Jugosllavisë dhe Serbisë në Kosovë. Kosovës i jep një mundësi të vetëorganizimit dhe funksionimit si shoqëri relativisht të pavarur, dhe mbi të gjitha mbetet e hapur perspektiva për një zgjidhje më të favorshme në drejtim të pavarësisë pas tri vitesh. (Agani, intervistë dhënë TVSH-së, më 18.03.1999)

Shumë nga pikëpamjet e qëndrimet e kësaj Konference mbi qeverisjen, u përfshinë në Rezolutën nr. 1244 të KS të OKB-së. “Duke marrë tërësisht Aneksin 2 dhe marrëveshjet

e Rambujesë S/1999/648” (pika 11.a) të cilat përcaktonin kryesisht sferën qeverisëse dhe institucionale:

Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë: a) Përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtjesore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare, duke marrë tërësisht parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648); (United Nations, Resolution 1244, 12 July 1999, P.11.; S/1999/779).

Konferenca e Rambujesë, hapi rrugën e ndërhyrjes së NATO-s dhe vendeve me ndikim në konfliktin e Kosovës dhe fillimin e zgjidhjes së problemit kosovar. Më 24 mars 1999, NATO filloi bombardimin e trupave ushtarake dhe paramilitare të Serbisë. Pas 78 ditë bombardimesh pasoi tërheqja e forcave serbe nga Kosova dhe vendosja e Misionit të Kombeve të Bashkuara-UNMIK në Kosovë dhe KFOR-it, sipas Rezolutës nr.1244 të KS të OKB-së. (10 June 1999)

Organizimi dhe rezultatet e kësaj Konference ishin kompromise dhe ndërvarësi e vendeve me ndikim të shprehura në Deklaratat e Gupit të kontaktit, dhe mundësive reale në teren. Ndërsa, në prizmin e synimeve të Kosovës për vetëqeverisje e pavarësi e liri të plotë, rezultatet e kësaj Konference paraqitnin një autonomi substanciale për periudhën 3 vjeçare. Por, në perspektivë dhe proces, parashihej gjetja e një zgjidhjeje politike ku do të merrej parasysh edhe vullneti i popullit, krahas faktorëve tjerë. Këto përcaktime politike kishin ndikime të drejtpërdrejta në aktet juridike për qeverisjen dhe institucionet kosovare. Reduktonin të drejtën e shoqërisë kosovare që të qeverisë vetveten në mënyrë të pavarur, dhe institucionet përcaktoheshin nga faktori ndërkombëtar në formën dhe përmbajtjen e një protektorati ndërkombëtar, ku kompetencat e faktorit kosovar në qeverisje ishin tejet të reduktuara. Pra, vendimet e Konferencës së Rambujesë ishin kompromise pozitive dhe pragmatike për Kosovën. Paskal Milo për Konferencën, thekson se, “Ishin vendimet e saj që çuan në tejkalimin e rrethanave dhe në kalimin nga diplomacia e kompromisit në

përdorimin e mjeteve e të metodave të luftës, nga formulimet ambigue të angazhimit ndërkombëtar në dislokimin e forcave të NATO-s në Kosovë, nga marrëdhënjet e dyshimta me UÇK-në njohjen e legjitimitetit të saj dhe nga pranimi i kamufluar dhe me dy kuptime i të drejtës për vetëvendosje të shqiptarëve të Kosovës në vetë-çlirimin e tyre nga pushtimi e sundimi i Serbisë” (Milo, 2010:41). Ky kompromis i mundësonte faktorit kosovar veprimtari në rrethana më të volitshme. “Vetëm veprimet ushtarake që u ndërmorën nga NATO, në mars-qershor 1999, arritën t’u shërbenin vlerave liberale të Perëndimit dhe si rezultat ruajtën edhe paqen e stabilitetin ndërkombëtar. (Hasani, 2010:274) .

Shikuar nga raporti i forcave ushtarake në teren dhe gjendjes institucionale ndërkombëtare, si dhe kuptimin e çështjes në proces, ky kompromis doli i suksesshëm. Do ishte edhe më i suksesshëm, sikur forcat politike të konsolidoheshin e të bashkëpunonin në mes veti suksesshëm dhe përgjegjshëm gjatë luftës dhe në fazat e pas luftës. Por, mungesa e traditës në debat dhe mbrojtja e interesave grupore dhe debatet tejet emocionale për ‘meritat historike’ të lidërshpit kosovar, e penguan konsolidimin dhe efektivitetin e duhur të faktorit politik vendor. Mungesa e kordinimit dhe konsensusit ndërpartiak dhe papërgjegjësia, ndikuan edhe në jo cilësinë e institucionalizimit dhe bashkëqeverisjes me faktorin ndërkombëtar në Kosovë.

3.2. Rezoluta 1244 e KS

Më 13 qershor 1999 në Kosovë depërtuan forcat e NATO-s nën Misionin e sigurisë-KFOR, dhe Misionin Civil Ndërkombëtar të OKB-së për Kosovën-UNMIK. Rezoluta 1244 e KS të OKB-së përmban rrethanat, shkaqet e ndërhyrjes dhe qëllimet e saj:

Duke rikujtuar Rezolutat 1160 (1998) të datës 31 mars 1998, 1199 (1998) të datës 23 shtator 1998, 1203 (1998) të datës 24 tetor 1998 dhe 1239 (1999) të datës 14 maj 1999, Duke shprehur keqardhje që

kërkesat e këtyre rezolutave nuk janë zbatuar plotësisht, i vendosur për ta zgjidhur situatën e rëndë humanitare në Kosovë, Republika Federale e Jugosllavisë, dhe për ta siguruar kthimin e lirë dhe të sigurt të të gjithë refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre,...Duke rikujtuar juridiksionin dhe mandatin e Gjykatës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Duke mirëpritur parimet e përgjithshme për një zgjidhje politike të krizës së Kosovës, të miratuara më 6 maj 1999 (S/1999/516, aneksi 1 i kësaj rezolute)...Kërkon në veçanti që RFJ t'i japë fund menjëherë dhe në mënyrë të verifikueshme dhunës dhe represionit në Kosovë, dhe të fillojë tërheqjen e plotë dhe të verifikueshme sipas fazave të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare në bazë të një orari të caktuar me të cilin do të sinkronizohet vendosja e pranisë ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë;...5. Vendors për dërgimin në Kosovë, nën mbikëqyrjen e OKB-së, të një pranie civile ndërkombëtare dhe të sigurisë, me pajisjet përkatëse dhe personelin e kërkuar (Rezolutën nr.1244 e KS të OKB, 1999)

Bashkësia Ndërkombëtare në Kosovë, bazë juridike qeverisëse e themeluese të institucioneve kishte Rezolutën e OKB/KS nr. 1244, e cila i referohej edhe Konferencës së Rambujesë, e pasuar edhe nga vendimet dhe parimet e Grupit-8 mbi implementimin e Rezolutës. Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, si akt bazë e qeverisjes, përcaktonte një protektorat të theksuar ndërkombëtar, me vendosjen e përgjegjësive kryesore civile e ushtarake të pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Parashihej konsolidimi e institucionalizimi për një vetëqeverisje autonome demokratike së bashku me Bashkësinë Ndërkombëtare dhe vendosja e funksioneve themelore civile administrative:

Vendors që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë:a) Përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtësore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare, duke marrë tërësisht parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);b) Kryerjen e funksioneve themelore civile administrative aty ku ka nevojë dhe për aq kohë sa kërkohet;c) Organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në zgjidhjen politike, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve;d) Bajtjen e përgjegjësive të veta administrative institucioneve që do të themelohen, duke mbikëqyrur dhe përkrahur konsolidimin e institucioneve të përkohshme lokale të Kosovës dhe të aktiviteteve të tjera për ndërtimin e paqes;e) Të ndihmohet një proces politik me qëllim të përcaktimit të statutit të ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysh marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);) Në një fazë përfundimtare, mbikëqyrjen e kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike. (United Nations, Resolution 1244, 12 July 1999, P.11.; S/1999/779).

Kjo Rezolutë, kishte kundërthënie e përcaktime për aspektin qeverisës dhe institucional, që ndëlidheshin më statusit e pazgjidhur të Kosovës. Rezoluta përcaktonte:

...pas tërheqjes do t'i lejohet kthimi një numri të personelit ushtarak dhe policor jugosllav dhe serb në Kosovë për t'i ushtruar funksionet në përputhje me aneksin 2; Duke ripohuar zotimin e të gjitha Shteteve Anëtare për sovranitetin dhe tërësinë territoriale të RFJ-së dhe të Shteteve të tjera në rajon, siç është parashtruar në Aktin Përfundimtar të Helsinkit dhe në aneksin 2,Duke ripohuar thirrjen në rezolutat e mëparshme për një autonomi përmbajtësore dhe për vetadministrim domethënës për Kosovën, Duke përcaktuar se gjendja në rajon vazhdon të paraqesë kërcënim për paqen dhe sigurinë

ndërkombëtare, i vendosur për ta garantuar sigurinë e personelit ndërkombëtar dhe zbatimin nga të gjitha palët e përfshira- të përgjegjësive të tyre në bazë të kësaj rezolute, dhe duke vepruar për këto qëllime sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,...10. Autorizon Sekretarin e Përgjithshëm, që me ndihmën e organizatave të tjera relevante ndërkombëtare, ta krijojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të vendosë një administratë të përkohshme për Kosovën nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë autonomi përmbajtjesore në kuadër të RFJ-së, dhe e cila do të sigurojë administrim kalimtar gjersa themelon dhe mbikëqyr zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. (Rezoluta nr.1244 e KS të OKB, 1999).

Thëniet në preambulë të kësaj Rezolute, për “ruajtje të sovranitetit të Federatës Jugosllave-RFJ” dhe “autonomi përmbajtjesore në kuadër të RFJ” janë në kundërshtim me Rezolutat e mëparme të KS të OKB-së: Rezoluta nr.757(1991) dhe nr.777(1992) me të cilat konstatohej joegzistimi i RSFJ-së dhe mosnjohja automatike e RFJ-Serbi dhe Mali i zi, ndërsa në Rezolutë insistohet në sovranitetin e RFJ-së. Ky konstatim në Rezolutë është kontradiktor dhe jashtë ndikimit real në Kosovë, por megjithatë nuk do jetë pa ndikim në procesin qeverisës, në formimin dhe konsolidimin institucional. Edhe vetë Serbia e Mali i Zi-RFJ ishin në proces të njohjes dhe konsolidimit ndërkombëtar të shtetit të tyre, por tani pa vullnetin dhe pa asnjë akt juridik e politik legjitim të Kosovës. Edhe Akti Përfundimtar i Helsinkit, pas shpërbërjes e RSFJ-së gjendej para rrethanave e kushteve të reja. Por, megjithatë, këto përcaktime kishin implikime në qeverisje e institucionalizim. Kuptimi i drejtë dhe i plotë i funksioneve e roleve të kësaj Rezolute, arrihet vetëm nga prizmi i proceseve në të ardhmen. Duke krahasuar qëllimet e intervenimit ndërkombëtar në Ballkan, në raport me integritetin territorial dhe vetëvendosjen, Hasani theksonte:

Për Bosnjë Hercegovinën u deklarua publikisht se qëllimi politik ishte zbatimi i parimeve bazë të ruajtjes së integritetit territorial të atij shteti, në rastin e Kosovës ruajtja e integritetit të ish-Republikës së Jugosllavisë[Serbi & Mali i zi-A. Sh.] ishte vetëm një efekt anësor i një veprimi ndërkombëtar, i cili synonte të pengonte një tragjedi njerëzore, që dukej sheshit se kërcënonte paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. (2010:41-42)

Statusi i Kosovës me këtë Rezolutë mbetej i papërcaktuar momentalisht, por theksohen qëllimet për zgjidhje politike të qëndrueshme: “Të ndihmohet një proces

politik me qëllim të përcaktimit të statutit të ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysh marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648)’’ (S/RES/1244 10 June 1999) Pra, parashihej dhe kërkohet krijimi i kushteve e rrethanave për ta përcaktuar statusin e ardhshëm: “Në një fazë përfundimtare, mbikëqyrjen e kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës, tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike’’(Rezoluten nr.1244 e KS të OKB, 1999,11)

Në të gjitha përcaktimet dhe pikat e kësaj Rezolute, vërehet kjo frymë e procesit drejt një zgjidhje statusore e politike në të ardhmen nga pozicioni i faktorëve ndërkombëtarë, palëve në konflikt dhe vullnetit të kosovarëve. Pra, thelbi i funksionit të kësaj Rezolute ishte “proces politik për të përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës’’, si një “zgjidhje e qëndrueshme.”(S/RES/1244, 10 June 1999) Edhe Serbia e Mali i Zi-RFJ, e cila pretendonte të jetë trashëgimtare e RSFJ-së, mori rrugën e ndarjes.

Qeverisja dhe institucionet kosovare pas vitit 1999 përcaktoheshin si bashkëqeverisje me faktorin ndërkombëtar, por me kompetenca të ekzagjeruara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) dhe UNMIK-ut, dhe KFOR-it si forcë ndërkombëtare e sigurisë. Rezoluta e KS e OKB-së nr. 1244, e autorizon Sekretarin e Përgjithshëm që në konsultim me Këshillin e Sigurimit, ta caktojë një Përfaqësues Special për ta kontrolluar zbatimin e pranisë civile dhe të bashkëpunojë ngushtë me praninë ndërkombëtare të sigurisë:

Autorizon Shtetet Anëtare dhe organizatat relevante ndërkombëtare për të vendosur një prani ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, siç parashihet në pikën 4 të aneksit 2, me të gjitha mjetet e nevojshme për t’i përmbushur përgjegjësitë e veta të parashtruara...Pohon nevojën për vendosjen e hershme dhe të shpejtë të një pranie efektive ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në Kosovë dhe kërkon që palët të bashkëpunojnë plotësisht në vendosjen e tyre;...a)Pengimin e ripërtëritjes së armiqësive, ruajtjen dhe atje ku është e nevojshme imponimin e armëpushimit, si dhe sigurimin e tërheqjes dhe parandalimin e kthimit në Kosovë të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të Federatës dhe të Republikës, përveç siç është paraparë në pikën 6 të aneksit (Rezoluten nr.1244 e KS të OKB,1999)

Faktori ushtarak dhe i sigurisë u konsolidua përmes KFOR-it dhe Policisë së UNMIKut. Forcat ushtarake të UÇK-së u transformuan në TMK, si një organizatë civile për raste emergjente, siç parashihej në Rezolutë: “Demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe të grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës.” (Rezolutën nr.1244 e KS të OKB,1999) Disa nga përfaqësuesit politik të UÇK-së themeluan parti politike dhe Qeverinë e Përkohshme.

Bashkësia Ndërkombëtare, Kosovën e shndërroi në territor me administrim e mbikëqyrje specifike ndërkombëtare-protektorat ndërkombëtar. Ky ishte një hap i madh pozitiv, ngase largonte Serbinë dhe RFJ-në nga Kosova dhe angazhonte drejtpërdrejtë Bashkësisë Ndërkombëtare në qeverisjen e Kosovës. Qeverisja dhe institucionet krijoheshin dhe bashkëvepronin nga faktori ndërkombëtar dhe ai kosovar. Kjo kishte rëndësi të madhe, edhe pse, ndikimi qeverisës e institucional i faktorit kosovar në këtë bashkëqeverisje ishte i kufizuar. Faktori politik vendor nuk kishte strategji, as operacionalizim të prioriteteve në raport me problemet, as në raport me bashkëqeverisjen me faktorin ndërkombëtar në Kosovë. Subjektet partiake bënë gara në mes veti për ‘meritat historike’ dhe për pushtet grupor e individual, duke mos u konsoliduar bashkërisht dhe duke u konfrontuar me akuza e shpifje të panevojshme në mes veti. Pra, dominonte konkurrenca për lavde dhe për pushtet fiktiv. Nuk kishte bashkërendim e as konsensus të duhur. Të gjitha këto shpreheshin drejtpërsëdrejti në humbjen e forcës vendimmarrëse të faktorit kosovar në procesin e bashkëqeverisjes me Administratën Ndërkombëtare në Kosovë.

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën (PSSP), në bashkëbisedime me subjektet politike të Kosovës, menjëherë pas lufte, arriti të

konsolidojë Këshillin e Përkohshëm Administrativ (KPA). Në Janar 2000, Formohet Këshilli i Përkohshëm Administrativ i Kosovës. (KPAK) Në Tetor 2000, mbahen zgjedhjet e para komunale. U themelu Këshilli Tranzitor i Kosovës (KTK), si dhe Departamentet administrative dhe administratorët e UNMIK-ut në nivelin komunal dhe institucionet qendrore e lokale kosovare.⁸⁰ (Narten, 2006)

Autoritet vendimmarrës absolut me „veton” e vet në sferën legjislative e ekzekutive ishte PSSP-ja, i cili qeveriste me anë të rregulloreve të UNMIK-ut, që i binte ad hok, sipas nevojave momentale. Sipas Demollit “legjislacioni i aprovuar nga UNMIK-u, shpeshherë ka qenë i krijuar sipas praktikave dhe parimeve të përgjithshme të *Common Law*.” (Demolli 2010:48) Gjendjen e vështirësonte akoma më shumë mungesa e një sistemi ligjor funksional. Aspekti ligjor e kushtetues nuk ishte burimor dhe i konsoliduar, ishte i imponuar dhe i pa harmonizuar. Situata e tillë ishte shkaku dhe pengesa kryesore për administrimin ndërkombëtar të suksesshëm në qeverisje e institucionalizim të mirëfilltë demokratik, konstitucional e efektiv, theksonte Savileci. (2005:49-60) Kishte numer shumë të vogël të ligjeve të miratuara. Pra, gjatë gjithë kohës deri në shpalljen e pavarësisë, Kosova perballej më mungesën e infrastruktures së plotë dhe të qartë juridike. Sistemi juridik që dilte nga Rezoluta 1244 kishte legjitimitet juridik ndërkombëtar por, pa bashkëqeverisje të mirëfilltë me vendorët dhe pa legjislacionin vendor kosovar, krijonte një kaos e vakum juridik dhe sistem ligjor kundërthënës, sistem dhe strukturë qeverisëse jo efektive. Bashkëqeverisja e faktorit ndërkombëtar me faktorin politik kosovar, mund të ishte me përmbajtje tjetër, varësisht nga cilësia e faktorit politik vendor. Ngase Rezoluta parashihte se “Negociatat ndërmjet palëve për arritjen e një zgjidhjeje nuk do të duhej të

vononin apo pengonin krijimin e institucioneve demokratike vetëqeverisëse.” (Rezoluta e KS të OKB-së 1244,1999, 11.b)

Sukseset në institucionalizim sipas këtij mandati ndërkombëtar ishin edhe të suksesshme, si psh.: kapërcimi i gjendjes kaotike e konfrontuese të forcave politike në Kosovë dhe kapërcimin e gjendjeve emergjente në shumë sfera. UNMIK-u i arriti qëllimet dhe obligimet fillestare të pranisë ndërkombëtare që ishin: vendosja e pranisë ndërkombëtare, armëpushimi, kthimi i refugjatëve, ndërtimi i institucioneve lokale dhe qendrore dhe rindërtimi. Sukseset në Regjistrimin, financimin dhe konsolidimin e partive politike dhe institucionet gjatë vitit 2002 dhe 2003. Këto suksese i thekson edhe Misioni i OSCE në Kosovë (2004/06/3082) dhe Raporti i UNMK (7 November/ 2005) Veçmas, mbajtja e zgjedhjeve lokale dhe në nivel vendi (2001) dhe në krijimin e institucioneve lokale e qendrore, konstituimin e Kuvendit, integrimin e komuniteteve pakicë në institucione dhe nxjerrjen e Kornizes Kushtetutës të vitit 2001.(Narten, 2006)

Te subjektet politike partiake-lidershipi i tyre, u shfaq mungesa e gatishmërisë për bashkëpunim ndërpartiak. Emocionet e krijuara më herët, krijojnë tensione në mes të Qeverisë së Përkohshme e dominuar nga forcat politike bartëse të rezistencës së armatosur dhe LDK-së me institucionet e më parme. Këto jo harmonizime ishin shprehur edhe gjatë luftës dhe me kohë morën formë e përmbajtje konfrontuese për mbrojtjen e interesave grupore në të dy anët. Kjo dukuri shkaktoi dëme në proceset politike për Kosovën dhe në procesin qeverisës e institucional. Këto tendenca e dëmtuan procesin e avancimit të faktorit të brendshëm kosovar në raport me faktorin ndërkombëtar në procesin e qeverisjes, dhe si pasoj, pati ngecje në procese dhe vështirësi në konstituimin e efektivitetin e institucioneve në ato pak kompetenca të IPVK.

Faktori Ndërkombëtar në Kosovë, i defaktorizoi subjektet kosovare në procesin e vendimmarrjes dhe qeverisjes. Ky faktor e pengonte qeverisjen e plotë demokratike sipas standardeve të vendeve të lira dhe rregullimin e lirë kushtetues e ligjor, ngase nuk ishte i lejuar statusi i Kosovës sipas vullnetit legjitim. Faktori ndërkombëtar ishte i pa harmonizuar në qëndrime e motive ndaj së ardhmes statusore të Kosovës, që shprehej në institucionalizim dhe në cilësi e efekte qeverisëse. Faktori i jashtëm ishte i interesuar dhe kishte edhe një mandat formal që faktori i brendshëm të mos ketë forcë dhe ndikim relevant në vendimmarrje. Bashkërenditja e forcave politike kosovare, mu për këtë rrethanë duhej të ishte më e koordinuar dhe më influencuese në procesin politik dhe në qeverisje e institucionalizim. Sikur të ishte i konsoliduar dhe i harmonizuar faktori politik vendor në këtë bashkëqeverisje me UNMIK-un, pa dyshim se do t'i avanconte proceset dhe reformat e brendshme. Liderhipi politik e partiak, tërë energjinë e harxhonte më grindje rreth meritave për të kaluarën; me etiketa asgjësuese reciproke, debate shterpe pozitë-opozitë dhe shumë pak konkurruese të mirëfillta, dhe jo bashkërenduese për zgjidhje të problemeve e nevojave aktuale vendore. Gjatë fushatave parazgjedhore dhe mediave manipulonin me emocione të popullatës, vetëm për ardhje në pushtet. Nuk u sqaronin qytetarëve rrethanat dhe problemet reale, thirreshin në merita të kaluara dhe thirreshin në të ardhmen, duke mos punuar për tejkalimin e gjendjes së vështirë momentale, as të status quo statusore. Në këtë mënyrë mashtronin qytetarët se problemi statusor është i zgjidhur dhe rrehnin gjoks dhe garonin se cili grup, parti e lider e kishte arritur këtë. Në këtë mënyrë dezinformuese e topitnin edhe angazhimin e qytetarëve dhe i konfrontonin kinse për konkurrencë pozitë-opozitë. Ndërsa ndaj vendimmarrjeve dhe

joefektivitetit të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, lidhshipi kosovar bëhej i dëgjueshëm e servil përtej mase.

3.3. Korniza Kushtetuese 2001

Kompetencat e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë (IPVK) u përcaktuan përmes Kornizës Kushtetuese 2001. Por, autoritet vendimmarrës absolut në raport me të gjitha institucionet kosovare, ishte PSSP-ja e OKB-së sipas Rezolutes nr.1244 të KS të OKB (1999) Në proces të përgatitjes dhe aprovimit të kësaj Kornize, roli i faktorit kosovar ishte tejet periferik. Kundërshtime verbale pati nga PDK-ja për të mos pranuar këtë Kornizë juridike, por këto nuk ishin kundërshtime të vendosura. Nuk u afruan alternativa tjera nga subjektet politike. Me të gjitha dobësitë dhe mangësitë, e varfër në shumë sfera dhe e vonuar dy vite pas lufte, kjo Kornizë kushtetuese paraqet një hap juridik në institucionalizimin e faktorit politik kosovar në institucione dhe në procesin qeverisës në nivel qendror dhe lokal. Të gjitha raportet dhe analizat e forumeve ndërkombëtare, ndër sukseset më të mëdha e konsiderojnë krijimin e asamblesë parlamentare dhe ato lokale me përfaqësues të minoriteteve sipas kornizës kushtetuese 2001. (Kramer & Dzihic, 2004:260) Kjo zgjidhje juridike e kushtetuese përcakton kompetencat, përgjegjësitë dhe obligimet e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVK) të konkretizuara dhe të harmonizuara edhe me ligjet e rregulloret e UNMIK-ut.

Këto zgjidhje kushtetuese ishin joadekuate për proceset aktuale, në veçanti për të ardhmen, ngase nuk kishte kompetenca përmbajtësore të institucioneve për vetëqeverisje demokratike. Rezoluta 1244 parashihte dhe e obligonte Bashkësinë Ndërkombëtare për bashkëqeverisje demokratike me institucionet kosovare, e jo imponimet në atë masë ekstreme. Pra, jo mbajtja peng dhe ruajtja e status quos për një kohë aq të gjatë, ngase

zgjidhja politike parashihej në një afat më të shkurtër dhe vetëqeverisja demokratike dhe reforma duhej të ishte misioni kryesor i saj. Në raport të rrethanave dhe dallimeve ndërkombëtare rreth statusit të Kosovës mund të arsyetohej, por mungesa e kompetencave përmbajtjesore dhe e përgjegjësia e faktorit vendor, pati pasoja praktike në procesin qeverisës e institucional; pasoja në mungesën e reformave, në mungesën e zhvillimit, mos luftimin e dukurive të shumta negative në procesin qeverisës, etj. Mungesa e përgjegjësisë dhe efektiviteti i dobët i institucioneve, pasoi me humbjen e besimit të qytetarët në subjektet politike kosovare, e edhe në Bashkësinë ndërkombëtare.

Në preambulë të kësaj kornize theksohej “mbrojtja dhe ruajtja e të gjitha komuniteteve në Kosovë, duke përfshirë të gjithë anëtarët e komuniteteve në procesin e ngritjes së institucioneve demokratike të vetëqeverisjes.” (maj, 2001) Këto përcaktime janë mjaft të avancuara, për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe u realizuan suksesshëm edhe sipas Konventës kornizë për minoritetët ⁸¹ (25 nëntor, 2005) Por, gjithnjë nga politika e Beogradit, pengohej inkuadrimi i pakicës serbe në institucione. (Mission in Kosovo, documents/mik 2003/10/698) Qëllimi i kësaj pengese bëhej për ta penguar procesin e institucionalizimit dhe qeverisjes. Grumbullimi i komunitetit serb në komunat veriore dhe mos inkuadrimi i saj në institucionet e qeverisjen kosovare, bëhej për të penguar sukseset në qeverisje e institucionalizim të Kosovës.

Në Kreun e III të kësaj Kornize garantohej të drejtat e njeriut dhe të drejtave të komuniteteve sipas Kornizës e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. (Weller, 2005) Në kreun e IV-të mbi Të Drejtat e Komuniteteve

dhe Anëtarëve të tyre, garanton dhe rezervon përfaqësimin në legjislativ të komuniteteve etnike jo shqiptare me 20 deputetë. Ky përfaqësim në legjislativ bëhet me një përqindje më të madhe se dyfishi i ekzistimit me përqindje të të gjitha minoriteteve. Njëherit edhe ndarja: 10 deputë për komunitetin pakicë serb, dhe 10 për komunitetet tjera pakicë, nuk i përgjigjet strukturës etnike të minoriteteve, ngase sipas Entit statistikor të Kosovës pakicat etnike në Kosovë përbëjnë rreth 8%. (2008) U konsoliduan garanci juridike për pjesëmarrje e vendimmarrje mjaft të avancuara për minoritetet pakicë në të gjitha institucionet, për sigurimin e barazisë dhe sigurisë nga çdo majorizim, si dhe për integrimin e tyre. (Hoxhaj, 2000) Në të gjitha institucionet është paraparë pjesëmarrje dhe përfaqësim i garantuar dhe i rezervuar për komunitetet pakicë. (Kreu II) Të gjitha komunitetet pakicë morën pjesë në jetën parlamentare dhe politike në zgjedhjet 2001 dhe në të gjitha zgjedhjet vijuese. (OSCE/2004/03/2335)

Sistemi elektoral zgjedhor proporcional dhe siguria për komunitetet pakicë, ishin aplikuar dhe kishin efektet e tyre në punën dhe funksionet e Kuvendit. Edhe pse pati vështirësi dhe pengesa në këtë drejtim, pati rezultate konkrete në vitet në vijim, kryesisht në përfaqësimin dhe integrimin e pakicave në parlament dhe në qeverinë kosovare. Pjesëmarrja e pakicave në administratën publike ishte 11.4% dhe në qeverisjen lokale 13.4%. (UNMIK, 2006) Mirëpo, të gjitha këto zgjidhje juridike, nuk u treguan sa duhet produktive për shkak të instrumentalizimit të pakicës serbe nga politika e Beogradit për ta penguar integrimin e mirëfilltë të kësaj pakice. (UNMK, 2003/10/698) Për ta penguar lirinë e komunitetit shumicë në Kosovë. Praktika tregoi se nuk ka barazi të pakicave pa barazi e përgjegjësi të shumicës-komunitetit shqiptar në Kosovë që është rreth 93% e

popullsisë.(ESK, 2008) Vullnetin dhe përcaktimin për vetëvendosje, pavarësi dhe vetëqeverisje e pengonte edhe faktori ndërkombëtar.

3.4. Cilësitë qeverisëse dhe institucionale

Siç theksuam edhe më lartë, rrethanat e pasluftës dhe mungesa e aspektit juridik kushtetues burimor, krijuan një qeverisje jo të mirëfilltë demokratike.. Ana juridike e procesit qeverisës dhe sferave tjera rregullohej më rregullore të UNMIK-ut, të cilat ishin jo të plota, të paqarta e kundërtënëse. Pra, mungesa e sistemit juridik kosovar dhe papërcaktueshmëria e kompetencave e përgjegjësisë të faktorit politik vendor, kishin si pasojë një gjendje kaotike institucionale dhe qeverisëse. (Stavileci, 2005:49-60) Veçmas, mospërfshirja përmbajtësore e faktorit kosovar në bashkëqeverisje me Administratën e Përkohshme Civile Ndërkombëtar në Kosovë. Kjo gjendje juridike dhe faktike e bashkëpunimit jo përmbajtjesor në mes të faktorit vendor me atë ndërkombëtar, ndikoi drejtpërsëdrejti në cilësinë e organizimit, funksionimit dhe efektit institucional. (Wiliam, 2002) Zgjedhjet e para pas lufte ishin ato lokale, të cilat u mbajtën më 28 tetor 2001. Kjo mungesë e kompetencave të faktorit vendor në qeverisje u përcoll edhe në përcaktimet e Kornizës Kushtetuese 2001. Megjithatë, u arrit konsolidimi i subjekteve partiake dhe sistem sadopak i efektshëm zgjedhor dhe funksional i institucioneve legjislative dhe ekzekutive të Kosovës. (OSCE, 2005) Më rëndësi ishte se këto institucione autonome ishin pa asnjë ndikim nga Serbia e RFJ-së.

Duke e përshkruar gjendjen qeverisëse asimetrike e jokooperuese në mes të Administrimit të Përkohshëm Civil Ndërkombëtar dhe vendasve, në dhjetor 2002, akademik E. Stavileci, ndër të tjera thekson se:

Një) UNMIK-un nuk e bën përgjegjës para institucioneve të zgjedhura të Kosovës; Dy) Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm i lënë kompetenca të pakufizuara, deri tek ajo e shpërndarjes së

vetë institucioneve të zgjedhura; Tre), i lë në fuqi shumë rregullore të diskutueshme të UNMIK-ut; Katër), Kuvendin e lë të zhveshur nga fuqia ligjvënëse e tij; Pesë), Kosovën e la si të vetmen shoqëri në Evropë pa Kushtetutë të veten; Gjashtë), qeverinë e la pa mundësinë e ushtrimit të ndikimit në proceset jetike; Shtatë), gjyqësinë e la pa autonominë, që e bën atë vetvetiu të jetë një degë e ndarë nga politika; Përgjithësisht, e la Kosovën pa sistem të ndërtuar politik dhe ekonomik burimor (2005:158)

Dështimet e Bashkësisë Ndërkombëtare dhe Administrimit Civil Ndërkombëtar në Kosovë, në sferën e krijimit të një qeverisje moderne dhe efektive demokratike, e raportojnë edhe një numër i organizatave dhe organeve ndërkombëtare në Kosovë. P.sh. kemi një Raport të tretë 2003-2004 të Ombudspersonit në Kosovë M. A. Novicki, i cili punoi 5 vite në këtë funksion, në të cilën theksohen të drejtat e njeriut dhe sfidat që ballafaqohet qytetari dhe shoqëria kosovare me qeverisjen dhe institucionet jodemokratike në Kosovë. Duke u thirrur në qëllimet dhe obligimet e Bashkësisë Ndërkombëtare në: "organizimin edhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për një vetëqeverisje demokratike dhe autonome derisa të arrihet një zgjidhje politike." (Rezoluta 1244, 1999, neni 11) Novicki, thekson se:

vetë UNMIK-u nuk është strukturuar në pajtim me parimet demokratike. Siç tashmë është kritikuar edhe në Raportin e Dytë vjetor, kur UNMIK-u u vendos si zëvendësim i shtetit, në vitin 1999, ai plotësisht injoroi njërin nga parimet themelore të demokracisë, respektivisht ndarjen e pushtetit. Pothuajse menjëherë pas emërimit të tij, PSSP nxjerri një rregullore të UNMIK-ut e cila i veshë atij pushtet total ekzekutiv dhe legjislativ dhe i lejon pushtet administrativ mbi gjyqësinë. Kjo mospërfillje e parimeve demokratike vazhdon të ketë ndikim negativ në funksionimin e emisionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe, mbi të gjitha, në ligjshmërinë demokratike të këtij misioni. Deri më tani, as UNMIK-u e as IPVQ-të, nuk kanë qenë në gjendje të përballen me paligjshmërinë e përgjithshme që momentalisht ekziston në Kosovë. (2005:15)

Ndër shkaqet që drejtpërsëdrejti ndikuan në jocilësinë qeverisëse gjatë bashkëqeverisjes kosovare me Bashkësinë Ndërkombëtare, është zhveshja e faktorit vendor nga kompetencat dhe rrjedhimisht nga përgjegjësia juridike për shumë sfera. Kjo nuk nënkupton edhe papërgjegjësinë morale e politike të subjekteve politike para qytetarëve e votuesve dhe proceseve politike.

Një gjendje jodemokratike e favorizon edhe mungesa e një gjykate kushtetuese apo i një Ode të Gjykatës Supreme për të vlerësuar ligjshmërinë e kushtetutshmërinë dhe

karakterin jodiskriminues të rregulloreve, ligjeve dhe akteve tjera në kontekst të të drejtave të njeriut, gjatë procesit qeverisës (Novicki, 2005:15) Edhe gjyqësori nuk ishte sa duhet i pavarur si rezultat i strukturës organizative qeverisëse të UNMIK-ut. Zhvillimet e sektorit ligjor shpesh ishin kaotike dhe me paralelizma, të cilat në sferën e aplikimit dhe joefikasitetit institucional, shpreheshin dëmshëm në papërshtatshmërinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut; pra, e pamundësonte qeverisjen demokratike. Administrimi i Gjyqësisë bëhej nga ekzekutivi si pjesë e ministrisë publike. Novicki, argumenton qartë pasojat jodemokratike në qeverisje, sektorin e zhvillimit ligjor-të cilin e konsideron si gjendje kaotike dhe joefektive të gjyqësorit dhe reflektimet e pasojat konkrete të të drejtave të njeriut në periudhën 1999-2005.(Novicki, 2005:15-31) Në këtë situatë juridike qeverisëse, e shoqëruar me pasigurinë e krijuar pas lufte, nuk mund të flitet për gjyqësi të pavarur e efikase. Pra, edhe si rezultat i kësaj gjendje, efektiviteti dhe efikasiteti qeverisës dhe institucional ishte i ultë. Për gjendjen joefikase e joefektive të sistemit administrativ dhe sistemit të drejtësisë në Kosovë, e thekson edhe OSCE duke folur edhe për strukturat paralele serbe në Kosovë. (Raportet, 2003 & 2007)

Uzurpimi i udhëheqjeve partiake nga grupet e interesit dhe të presionit, si grupe të korrupsionit, informalitetit, kontrabandës e krimit të organizuar, që shoqërohej me gjyqësinë jofunksionale e joefikase sa duhet, u bënë dukuri të vazhdueshme. Partitë ia hidhnin fajin vetëm faktorit ndërkombëtar. Pra, shfaqej korrupsioni në institucione publike, në gjyqësor, krimi i organizuar, kontrabanda, informaliteti, papërgjegjësia e jo llogaridhënia, vlera të paqarta, etj. Ishte prezent edhe përvoja e mangët e votuesve në qeverisjen demokratike. Kot votonin qytetarët, ngase mungonin kompetencat dhe përgjegjësitë; mungonin programet partiake dhe konkurrenca e mirëfilltë në mes tyre, si

dhe shkelja e parimeve demokratike gjatë procesit votues/zgjedhor. Institucionet karakterizoheshin me ushtrimin e dobët të atyre pak kompetencave.

Organizatat e shumta ndërkombëtare në raportet e tyre për institucionet dhe efektet qeverisëse në Kosovë i numrojnë dhe vlerësojnë sukseset, por gjithnjë e theksojnë edhe joefikasitetin dhe joefektivitetin e qeverisjes.⁸² (OSCE Mission in Kosovo, 2004, 2005; NDI, 2005) Lidhshipi dhe partitë politike në raport me ndërkombëtares nuk ishin opozitë për gjendjen jo të mirë në shumicën e sferave dhe as për dukuritë e lartpërmendura. Nuk ishin opozitë asnjëra nga subjektet partiake në institucione. Nuk ishin as kundër status quos statusore. Udhëheqjet partiake ishin të korruptuara dhe në një farë mënyre ishin edhe manipuluese. Ato krijojnë opinion mashtrues të qytetarët, kinse është e zgjidhur çështja e Pavarësisë. Mburreshin dhe shtyheshin në mes veti për meritat e kaluara, pa bërë asgjë për problemet ekzistuese. Në procesin zgjedhor konfrontoheshin me shpifje e etiketa, sharje e kërcënime kundër njëri-tjetrit. Pra, vinin në institucione pa konkurrencë të mirëfilltë dhe pa programe e vizione të qarta, shpesh duke manipuluar edhe më kutitë e votimit/josigurimin e votave dhe të procesit votues. Nuk garonin për qeverisje të mirëfilltë-mirëqeverisje, por vinin për privilegje dhe për keqpërdorime në emër të institucioneve dhe në emër të interesave e shërbimeve publike. Të gjitha këto dukuri e procese, ndikuan në humbjen e besimit të qytetarët në subjektet vendore dhe në faktorin ndërkombëtar. Si pasojë e gjithë kësaj kemi edhe pjesëmarrje të ultë të qytetarëve në zgjedhje dhe në procese politike. Pasojat e këtij realiteti për një kohë të gjatë ndikuan në pasigurinë për investime të brendshme dhe të jashtme, në jo cilësinë e procesit të

privatizimit dhe në mungesën e zhvillimit të qendrueshmë ekonomik më pasojë të shumanshme negative në shumicën e sferave. (Instituti Riinvest, 2000, 2003, 2005)

Njëra ndër obligimet e Administrimit Civil dhe Ushtarak Ndërkombëtar në Kosovë, ishte mbrojtja e të drejtave të njeriut, e përcaktuar edhe me Konventa e instrumente ndërkombëtare, të cekura në Rezolutën 1244 dhe në Kornizën Kushtetuese 2001. Por, përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë kishin imunitet dhe nuk u përgjigjeshin organeve gjyqësore e institucioneve kosovare. Si të tilla imunitete, bien në kundërshtim edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kjo situatë ishte paradoksale ngase, institucionët ndërkombëtarë në Kosovë, që janë të obliguara për sundimin e Ligjit, nuk mbajnë përgjegjësi ndaj personave e qytetarëve ndaj të cilëve janë të obliguar t'i mbrojnë dhe qeverisin. Ombudspersoni ndërkombëtar në Kosovë, përpos rekomandimeve dhe njoftimeve që i raporton të PSSP-ja dhe te institucionet kosovare, theksonte se nuk kishte institucione tjera efektive për mbrojtje të ligjshmërisë. Mungesa e ndonjë Ode kushtetuese apo Gjykatës Kushtetuese, krijonte vakum institucional të mbrojtjes së ligjshmërisë. Qytetarët e atakuar, në këto rrethana të rënda të të drejtave të njeriut e jo sundimit të ligjit „nuk mundën që në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes mjeteve ligjore, të fillojnë një procedurë për të siguruar që të ndërrohet një situatë e paligjshme”. (Novicki, 2005:15)

Gjatë kësaj periudhe partitë politike nuk profilizoheshin dhe nuk kishin programe të qarta e specifike, as ide të qarta dhe mënyra të zgjidhjes së problemeve. (OSCE Mission in Kosovo, *documents/mik/2004/06/3082*) Gjatë procesit zgjedhor, garonin me „merita” për Pavarësi, për të cilën tani nuk kontribonin fare, përkundrazi. Andaj, kjo fazë e bashkëqeverisjes me faktorin ndërkombëtar, sa i përket reformave dhe tejkalimit të fazës së tranzicionit, ishte humbje kohe. Nga subjektet politike dhe lidhshipit krijohej një

opinion i rrejshëm te qytetarët, kinse Pavarësia ishte punë e kryer. Gjatë bisedimeve-negociatave të Vjenës në krye më Ahtisarin për përcaktimin e statusit të Kosovës, lindi një lëvizje pak a shumë opozitare, e cila vepronte jashtë institucioneve, e cila e kundërshtonte qeverisjen e UNMIK-ut dhe institucionet kosovare për gjendjen e krijuar dhe kundërshtonte bisedimet për statusin-kërkonte referendum dhe vetëvendosje. Kjo ishte Lëvizja ‘Vetëvendosje’ e cila vepronte jashtë institucioneve, përmes protestave e formave tjera.

Bashkësia Ndërkombëtare e pamundësonte qeverisjen e pavarur, ruante status quon dhe pengonte bartjen e pushtetit përmbajtjesor në qeverisjen dhe institucionet kosovare. Bartja e qeverisjes përmbajtjesore te vendoret, do të ishte me interes për shumë sfera e qëllime demokratike për të gjithë, e veçmas për të ardhmen. Situata bëhej gjithnjë e më e padurueshme, mu nga fakti se nuk lejohej qeverisja nga institucionet vendore dhe nga praktikat e qëndrimet ndërkombëtare në Kosovë, të cilat ishin shndërruar në pengesë të qeverisjes së mirëfilltë demokratike dhe mungesë të rezultatëve në shumicën e sferave. Demokracia nuk funksiononte, ngase subjektet politike kosovare nuk kishin kompetenca dhe nuk ushtronin pushtetin e vërtetë në asnjë sferë e as institucion. Votuesit dhe zgjedhësit manipuloheshin në shumë aspekte. Organizatat dhe forumet ndërkombëtare në Kosovë, nuk ishin sa duhet efikase, efektive, mbikëqyrëse e as kontrolluese e vartësve të tyre në Kosovë. Në sferën e të drejtave të njeriut, mohohej demokracia dhe qeverisja demokratike. Wild, aspektin e rendit juridik e konsideronte si improvizim. (Wild, 2005:150) Kemi përplot forma institucionale pa përmbajtje reale kompetencash, dhe pa substancë të vërtetë qeverisëse. Të gjitha këto kishin si pasoj mungesën e reformave dhe mungesë në zhvillim si dhe në krijimin e parakushteve për integrimin e Kosovës në BE.

(Çollaku, 2006:11-32) Edhe mungesa e përvojës demokratike dhe këto dukuri negative, do kenë pasoja për të ardhmen qeverisëse demokratike në Kosovë.

Institucionet me kompetenca të kufizuara nuk ishin në gjendje që procesi i qeverisjes të zhvillohej realisht sipas procedurave demokratike. (Novicki, 2005:15-43) Subjektet politike dhe institucionet kosovare nuk ishin as opozitë e kësaj gjendjeje jodemokratike e stagnuese. Raporti pozitë-opozitë nuk ishte kuptimplotë. Raportet pozitë-opozitë ishin bajate, me inate bajraktareske e shumë pak kishte konkurrencë programore e dallime në qëllimet e tyre për qeverisje. Në raport më Bashkësinë Ndërkombëtare, duhej të ishin bashkërisht opozitë e gjendjes së status kuos institucionale e statusore të Kosovës, për t'i avancuar proceset. Partitë politike kosovare thirreshin në meritat e së kaluarës, propagandonin se e kanë fituar të ardhmen, por kurrësi nuk merreshin me të tanishmen stagnuese për reformat e tranzicionit dhe zhvillimit. Nuk krijonin vullnet të caktuar politik dhe as proces efikas vendimmarrës.

Nuk ishin të vetëdijshëm dhe nuk i njoftonin as qytetarët se proceset kryesore ende nuk janë kryer, dhe se duhet edhe shumë punë për arritjen e tyre. Nuk synonin qeverisje të mirëfilltë demokratike në ato pak kompetenca. për të siguruar rend e siguri, vlera dhe parakushte për reforma zhvillimore. Sjellja e subjekteve e liderëve kosovarë, i rriste paragjykimet ekzistuese edhe të ndërkombëtarët se, forcat politike kosovare ende nuk janë në gjendje ta qeverisin vendin. Një përshtypje e tillë krijohet edhe tek qytetarët, të të cilët bëhej topitja e angazhimit në procese politike me pasojat përcjellëse. Andaj, bashkëqeverisja deri në shpallje të Pavarësisë dhe pengesat që i bëheshin faktorit kosovar, tregon qartë qëllimet e Bashkësisë Ndërkombëtare për ta penguar Pavarësinë dhe qeverisjen demokratike.

Kjo qeverisje gjatë kësaj faze të administrimit ndërkombëtar 1999-2008, vështruar nga aspekti i efektivitetit, dhe në raport me nevojat dhe mundësitë, ishte qeverisje joaktive, joefikase dhe joefektive. Joefektiviteti i qeverisjes në Kosovë nga faktori ndërkombëtar ishte i qëllimshëm, për shkak të mandatit dhe të statusit të papërcaktuar të Kosovës. Statusi i papërcaktuar i Kosovës e pengonte faktorin vendor në institucionalizim e qeverisje të pavarur; kjo pengesë e qeverisjes së pavarur rezultonte në jodemokraci. Joefikasiteti e keqëqeverisja e faktorit kosovar në ato pak kompetenca, krijuan rrethana qeverisëse e institucionale me pasoja në humbjen e potencialit, humbje kohe, jokonsolidim i praktikave e vlerave demokratike dhe vonesë në reforma.

Analistët dhe ekonomistët e theksojnë reflektimin e kësaj situate juridike, qeverisëse e institucionale, në pengimin e zhvillimit ekonomik.(Riinvest, 2003) Jokonsolidimi i qendrushëm ekonomik i Kosovës është rezultat i politikave të gabuara ekonomike, por edhe si rezultat i dukurive të shumta negative në institucione. (Sadiku, 2004). Duke analizuar gjendjen qeverisëse dhe institucionale në këtë periudhë, akademik Stavileci , ndër të tjera theksonte:

Administrimi i Përkohshëm Civil Ndërkombëtar në Kosovë nuk është zhvilluar në drejtimin e duhur ose, së paku, jo në përputhje me misionin e tij. Kosova është bërë peng e mungesës së statusit dhe, për pasoj, kanë mbetur të bllokuara shumë procese zhvillimore. Është "eksperimentuar" shumë me Kosovën dhe qytetet e saj, të cilët ende nuk janë as shtetas e as qytetarë të Kosovës në kuptimin demokratik të fjalës. Institucionet e Kosovës ende janë "të eliminueshme dhe të pagarantuara. Janë të dhëna kushtimisht" dhe "nga vullneti i mirë", e jo siç do të duhej të ishin "permanente e të patjetërsueshme." Qeverisja ende mbahet në duart e një personi" ndërsa institucionet e Kosovës janë të kufizuara në vendimmarrje. Kështu, demokracia në Kosovë ende nuk ka shumë hapësirë që të ndërtohet, as brendapërbrenda shoqërisë, dhe as brendapërbrenda institucioneve që synojnë të qeverisin më shoqërinë. (2005:400)

Bashkësia Ndërkombëtare deklarohet për Shtetin Ligjor, demokracinë, të drejtat e njeriut, e në veçanti për të drejtat e pakicave, luftimin e dukurive negative në qeverisje, etj. Kosovës i kërkoheshin standarde demokratike (*UN Mission in Kosovo*, April 2002) në rrethana të mungesës së kompetencave. Megjithatë, sipas disa vlerësimeve disa nga

standartet tani ishin arritur. (UNMIK/PISG, March 2004) Por standardet e mirëfillta nuk mund të plotësoheshin pa institucione të pavarura, pa kompetenca e përgjegjësi politike e juridike të mirëfillta; pa transparencë për proceset, qëllimet dhe gjendjen e vërtetë. Për arritjen e këtyre standardeve dhe për të ecur përpara, qeverisjes kosovare i duheshin institucionet e shtetit të pavarur-Pavarësia dhe kompetencat, përgjegjësitë e obligimet juridiko-politike përkatëse. Ngase, me gjendjen e krijuar në bashkëqeverisjen me ndërkombëtare, nuk kishte ecje përpara. Durimit në popull i kishte ardhur fundi. Këtë e kishte kuptuar edhe Bashkësia Ndërkombëtare.

Bashkësia Ndërkombëtare, filloi të kuptoj se asgjë nuk mund të arrihet pa e institucionalizuar vullnetin politik të shumicës dhe të pakicave etnike në institucione të pavarura, dhe sipas legjislacionit kosovar. Kjo i mungonte Kosovës, si rezultat i pengesave të jashtme. Përpos Pavarësisë, asnjë alternativ tjetër statusore nuk vinte në shprehje dhe nuk mund të funksiononte sipas vlerave e sjelljeve demokratike. Kjo gjendje ishte rezultat i proceseve paraprake të brendshme e të jashtme dhe synim afatgjatë i shoqërisë kosovare. Kjo tërheqje zvarrë e proceseve politike dhe e mënyrës qeverisëse gjatë gjithë këtyre viteve, ishte tejet e dëmshme për shumicën e sferave vitale për Kosovën. Kjo gjendje nuk hasi në ndonjë kundërshtim serioz e të të subjekteve politike.

Sundimi ndërkombëtar në Kosovë, ruante një stabilitet pa progres të theksuar në asnjë sferë. Pasojat e këtij stagnimi do të shihen edhe pas Pavarësisë. Munguan reformat për një ekonomi tregu, ekzistonte një treg pa konkurrencë, pa ekonomi prodhuese dhe pa shërbime cilësore, papunësi e varfëri e theksuar. Pa siguri juridike, politike e ndërkufitare me Serbinë, veçmas në pjesën veriore. Edhe investitorët mungonin si rezultat i kësaj qeverisjeje dhe pasigurie dhe e mungesës së statusit të pavarur të Kosovës. Qëndrimet dhe

sjellja e subjekteve politike me lidershipin e tyre ndaj kësaj gjendje dhe ndaj faktorit ndërkombëtar ishte lojale dhe servile. Forcat politike duhej të vetëdijesheshin për këtë, dhe të konsolidonin strategji e politikë për tejkalimin e nënshtrimit ndaj faktorit ndërkombëtar dhe ndaj status quos në shumicën e sferave.

Në këto rrethana kemi OJQ të shumta të regjistruara, por me një shoqëri civile të pakosoliduar ngase, “sistemi i dyfishtë i qeverisjes dobësonte aftësinë e grupeve të qytetarëve për të ndikuar në vendimet publike.” (KCSF, 2005:3) Pra, nuk kishin sa duhet ndikim dhe instrument për t’i adresuar kërkesat e qytetarëve në raport me institucionet dhe qeverisjen aktuale. Edhe mediet nuk ishin kritike të mirëfillta-ishin kritike të njëanshme, nuk ishin as analitike e të pavarura sa duhej. Edhe bashkëpunimi i politikëbërjes me shkencën nuk ishin përmbajtësore. Pra të gjitha këto fakte, tregojnë se nuk u krijua partneriteti produktiv qeverises e as institucional me Bashkësinë Ndërkombëtare. Por, qeverisje me pozitat e subordinimit në raport me ndërkombëtarët, mosluftim të dukurive negative, rezultate tejet minimale në raport me nevojat dhe kapacitetet. E kur gjithë kësaj i shtojmë mbikëqyrjen strikte dhe vendimmarrjet nga ana e faktorit ndërkombëtar përmes qendrave të vendosjes globale, kuptojmë se ideja e instalimit të demokracisë së mirëfilltë qeverisëse e institucionale, ishte vetëm një synim e dëshirë e qytetarëve të saj. Kjo shihet me faktin se, shumicën e vendimeve të rëndësishme për sigurinë, gjyqësinë, pastaj rendin, etj. nuk i merrnin institucionet përmes qeveritarëve të zgjedhur më votën e lirë, por qendrat e tjera globale që menaxhonin procesin e instalimit të këtij sistemi qeverisës. Kjo praktikë e tillë afatgjate qeverisëse në Kosovë, pati rezultate minimale në krijimin e traditës demokratike në qeverisje dhe mungesën e luftimit të dukurive negative, mungesën e sundimit të rendit të mirëfilltë juridik, mungesë të zhvillimit, etj., të cilat u

përcollën me mungesë të llogaridhënies e përgjegjësisë, si dhe vlerave përkatëse, jo vetëm te qeverisësit, por edhe të qytetarët e votuesit.

Duke i analizuar vështirësitë qeverisëse në Kosovë, Stavileci theksonte se: “Përderisa Bashkësia Ndërkombëtare e mban peng njohjen e vullnetit të popullit të Kosovës për shtet të pavarur, nuk mund të ketë ndonjë përparim të gjendjes së përgjithshme në Kosovë. Shtetësia e Kosovës do të mund të ndihmonte prodhimin e një sigurie afatgjate në rajon” (Stavileci, 2005:200) Duke theksuar mungesën e karakterit demokratik të qeverisjes në Kosovë, shkaqet e saj kryesore Stavileci i gjen të mungesa e shtetësisë, lirisë dhe vetëvendosjes: “Në Kosovë nuk ka dhe nuk do të ketë demokraci për derisa ‘banorët e Kosovës’ privohen që të jenë shtetas dhe qytetarë të saj.” (Stavileci, 2005:178) Qeverisja e tillë në Kosovë, tani e shndërruar në traditë negative, do të ketë pasoja negative në demokracinë e vendit për një kohë të gjatë. Mungesa e një strukture të qartë qeverisëse, do të thotë edhe mungesë të një strukture llogaridhënëse, mungesë e përvojës dhe traditës pozitive, mungesë e reformave dhe mungesë e rezultateve institucionale, mungesë e zhvillimit të qendrueshmë ekonomik, si dhe mungesë e krijimit të vlerave përkatëse tek lidershipi dhe tek votuesit.

Anë negative e kësaj bashkëqeverisjeje ishte mungesa e thelbit të demokracisë në qeverisje dhe pengimi i faktorit vendor në qeverisjen përmbajtësore. Pengesa bëhej krijimin e juridiksionit dhe përgjegjësisë të institucioneve kryesore politike, pengesa në krijimin e vullnetit politik dhe vendimmarrjeve të rëndësishme, në mungesën e krijimit të traditës demokratike qeverisëse. Kjo ndodhi në fazat fillestare dhe deri më 2008. Pra, nuk përfilllej sa duhet faktori vendor kosovar. Bashkësia ndërkombëtare me faktorin kosovar kishte një bashkëpunim konsultimi e informimi. Kjo formë e bashkëqeverisjes, nuk ishte

përmbajtjesore dhe si pasojë e kësaj munguan efektet institucionale e qeverisëse. Si rezultat i kësaj, munguan sukseset në shumicën e sferave, dhe u shfaqen dukuri tejet negative në procesin qeverisës e institucional me pasoja në të gjitha sferat tjera.

Rrethanat e pasluftes karakterizoheshin me mungesë të institucioneve kosovare të sundimit të ligjit, si dhe me frikësimin e atyre egzistuese. Mosmarrëveshjet rreth statusit pengonin shkëmbimin e informacionit me institucionet e vendeve fqinjë të Kosovës. Andaj, në këto rrethana u shfaqen grupe të krimit të organizuar dhe vazhduan të mbesin aktive në Kosovë. Edhe bashkëpunimi i institucioneve kosovare me ato ndërkombëtare nuk ishte përmbajtësor, kjo shfaqej edhe në jobashkëpunimin për të penguar grupet e krimit të organizuar dhe zyrtarët e korruptuar. Këtë e thekson edhe Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme në Kosovë, (korrik 1999), i cili konstaton se ndërmarrjet e krimit të organizuar janë shume aktive në Kosovë. Me rënien e sundimit të ligjit pas luftës gjatë viteve 1998-1999, mungesa e zbatimit të ligjit, informaliteti dhe mungesa e mallrave, nxiti 'organizata' kriminale për tregun kontraband.

Faktori i jashtëm nuk mbante përgjegjësi e llogaridhënie ndaj qytetarëve dhe ndaj institucioneve kosovare. Subjektet politike kosovare në institucione, nuk kishin kompetenca në vendimmarrjet kryesore. Prandaj edhe e arsyetonin papërgjegjësinë e tyre para qytetarëve. Faktorin kosovar në procesin qeverisës e vendimmarrje, Bashkësia Ndërkombëtare e reduktoi në nivel konsultimi, propozimi, këshillimi e njoftimi. Mungesa e bashkëpunimit përmbajtësor në konsolidim të institucioneve dhe jo harmonizimit përmbajtësor në mes faktorit kosovar dhe atij ndërkombëtar në qeverisjen e Kosovës, i kushtoi shumë procesit politik, ekonomik, e shoqëror në përgjithësi dhe pozitës ndërkombëtare të Kosovës, në veçanti. Veçmas, në mungesën e krijimit të mirëfilltë të

përvojës qeverisëse demokratike dhe përgjegjësisë qeverisëse institucionale kosovare, e cila ishte më së e nevojshme për tejkalimin e gjendjes dhe avancimin e reformave.

Gjendjen e vështirësonte akoma më shumë mungesa e një sistemi ligjor funksional. Sistemi juridik që dilte nga Rezoluta 1244, e cila kishte legjitimitet juridik ndërkombëtar por, pa bashkëqeverisje të mirëfilltë me vendorët dhe pa legjislacionin vendor kosovar, krijonte një kaos e vakum juridik dhe sistem ligjor kundërtshënës, sistem dhe strukturë qeverisëse jo të plotë e jo funksionale. Situata e tillë ishte shkak dhe pengesa kryesore për administrimin ndërkombëtar të suksesshëm në qeverisje e institucionalizim të mirëfilltë demokratik, konstitucional e efektiv. (Savileci, 2005:49-60) Sadqë kishte edhe suksese në institucionalizim përshkak të reduktimit të kompetencave të institucioneve kishte numer shumë të vogël të ligjeve të miratuara në Kuvend. Pra, gjatë gjithë kohës deri në shpalljen e pavarësisë Kosova përballë mungesës e infrastruktures së plotë dhe të qartë të infrastruktures juridike, dhe strukturës paralele në veri më legjislacion e organe paralele serbe. Edhe OKB-ja nuk kishte shumë përvojë në administrimin e tillë ndërkombëtar të një territori, siç ishte tani në rastin e Kosovës. Statusi i pazgjidhur dhe Rezoluta kundërtshënëse sa i përket statusit, krijonte tensione që shpreheshin negativisht në institucionalizim, juridiksion dhe qeverisje. Ky fakt krijonte rrethana juridike dhe faktike jodemokratike në shumë sfera, por dhe në të drejtat e njeriut.

Kishte artificialitet në jetën politike në Kosovë, për shkakun se jeta politike e ka të pamundshme të zhvillohet lirisht kur mbahet nën mbikëqyrje dhe pa zgjidhje të statusit. (Ruffert, V. 50, part 3) Kjo mbikëqyrje e theksuar mund të ishte e arsyeshme në vitet e para të pasluftës, por kjo zgjati deri në 2008 dhe i frenoi të gjitha proceset vendore dhe integruese dhe krijoi një mjedis artificial, i cili e deformonte jetën politike e

rregullativen juridike në Kosovë duke i frenuar proceset. Shoqëria kosovare kishte nevojë për institucione të qëndrueshme, efikase, llogaridhënëse, me demokraci sipas rendit ligjor. Kishte nevojë për t'u ndihmuar në rrugën e saj drejt konsolidimit institucional, juridik e qeverisës. Një praktikë e tillë qeverisëse për një kohë të gjatë shkaktoi papërgjegjësi e jollogaridhënie te subjektet politike dhe lidershpi i tyre. Faktori politik institucional kosovar nuk kishte kompetenca e përgjegjësi dhe arsyetohej me këtë mungesë të kompetencave për luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar, mungesën e reformave e zhvillimit dhe për status quon statusore të Kosovës. Në këto rrethana disa nga bartësit e institucioneve ishin përfshirë në dukuritë negative dhe nuk i ushtronin me efektivitet as në ato pak kompetenca që i kishin. Pasojat e gjithë kësaj do të jenë afatgjata. Topiten angazhimin e mirëfilltë politik qytetar dhe humbjen e besimit. Vonuan reformat dhe mungesen e përvojës demokratike në qeverisje.

Paknaqësitë e qytetarëve me qeverisjen

Kosova me kompetenca tejet të kufizuara dhe me status të përkohshëm e të papërshtatshëm për një kohë aq të gjatë, ishte: mbajtje peng, bllokim, status quo e dëmshme, humbje kohe dhe pengesë për të gjitha proceset, në veçanti në efektivitetin e procesit qeverisës dhe institucional. Ishte rrethanë e përshtatshme e rritjes së papërgjegjësisë dhe lulëzim i dukurive negative në procesin e qeverisjes dhe humbje e besimit të qytetarët në forcat politike vendore. Rënie e besimit në procesin qeverisës, me pasoja momentale dhe rrjedhimisht me pasoja për të ardhmen. Kjo mënyrë afatgjatë e qeverisjes politike, institucionale e juridike, pati pasoja në të gjitha sferat. Kjo gjendje që mbretëroi për një kohë të gjatë dhe pa paralajmërim për ndryshime në të ardhmen, e irritoi popullatën. U përcoll me humbjen e besimit në subjektet partiake dhe në

institucionet kosovare e ndërkombëtare. Për këtë arsye kemi edhe dalje e pjesëmarrje tejet të ulët të qytetarëve në zgjedhje. U grumbulluan qëndrime negative edhe ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare dhe ndaj politikës serbe që nuk po ndryshonte, por edhe ndaj pakicës serbe në Kosovë që nuk integrohej sa duhet dhe ishte instrumentalizuar në favor të politikës zyrtare të Serbisë. Politika zyrtare e Serbisë e pengonte inkuadrimin e pakicës serbe në institucionet kosovare, (OSCE,documents/mik/2003/10/698) me qëllim për ta penguar vetëqeverisjen dhe vetëvendosjen e Kosovës. Kjo situatë e karakterizuar me mungesë totale të aktivitetit serioz të subjekteve kosovare për ta ndryshuar gjendjen, pati si pasojë humbjen e durimit dhe ndodhjen e protestave të marsit 2004. Këto ishin shkaqet esenciale të shpërthimit të kësaj pakënaqësie dhe demonstrimit agresiv.

Mënyrat e shfaqjes së pakënaqësisë ishin brutale, tejet emocionale, dhe të pakontrolluara (ICG-së për Ballkan, No 13117, mars, 2004) Ishin spontane dhe situatë e pamenaxhuar nga asnjë subjekt e forcë politike. Subjektet politike kosovare nuk luanin rolin as në qeverisje e institucione dhe si bartëse të dukurive negative të lartëcekura ishin pa ndikim moralo-politik tek protestuesit. Tani populli nuk priste asgjë pozitive nga ta. Papunësia e theksuar, mungesa e qarkullimit të fuqisë punëtore jashtë vendit, mungesa e investimeve, papërspektiva në të gjitha sferat, ndikoi që një pjesë e rinisë dhe qytetarëve të Kosovës, të shpërthej me demonstrata e mllef edhe kundër institucioneve të sigurisë së Bashkësisë Ndërkombëtare, edhe kundër monumenteve historike e fetare që Serbia i keqpërdorte për ta penguar Pavarësinë dhe lirinë e Kosovës. Kjo ishte një lëvizje e masave, presion kundër status quos, kundër mbajtjes peng të Kosovës dhe kundër moslejimit të Kosovës në qeverisje e institucione të pavarura. Format e kundërshtimit kundër vlerave historike e fetare kosovare serbe dhe kundër KFOR-it, nuk ishin të

qëlluara. Por, në natyrën e spontanitetit protestues të masave dhe mungesës politike kanalizuese, ndodhen gabime të cilat u kritikuan ashpër nga të gjithë faktorët. Por këto mllfe dhe gabime, i kishin shkaqet e thella. Ishin rezultat i pakënaqësisë së lartëcekur në qeverisjen aktuale ndërkombëtare e vendore në Kosovë, ishin kundër status quos, kundër vendimmarrjeve bllokuese në forumet ndërkombëtare për statusin e Kosovës, si dhe reagim mllfi ndaj politikës së Serbisë ndaj Kosovës.

Ngjarjet e Marsit 2004, ishin protesta kundër staus quos, kishin anët negative në mënyrën dhe efektet e manifestimit.⁸³ (Buerstedde, 2005:135-145) Duke mos pasur forcë politike opozitare të konsoliduar kundër status quos dhe të lodhur nga qeverisja e keqe në Kosovë, pezmi i protestave u karakterizua me spontanitet dhe më orientime vandaliste edhe ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare, e cila nuk mundëonte e as nuk lejonte vetëvendosje, as qeverisje, as legjitimitet, as zhvillim e qeverisje të mirëfilltë demokratike, për çka shoqëria kosovare kishte sakrifikuar dhe priste me pa durim. Kosova kishte nevojë për zgjidhje të problemeve të grumbulluara dhe nuk mund të duronte më staus quon. Përgjegjësia bie edhe mbi qeverisjen dhe institucionet e përbashkëta kosovare e ndërkombëtare në Kosovë, si dhe te vendimmarrësit ndërkombëtar për shtyrjen e vetëvendosjes kosovare. Mësimi nga kjo doli për të gjithë, se status quo nuk mund të ketë më.⁸⁴ (Whyte 2005:01-24) Zbërthimi ishte i komplikuar për shumë arsye dhe kishte qëndrime të paharmonizuara te vendet me ndikim dhe në forumet ndërkombëtare. Këto vështirësi silleshin jo vetëm rreth qëllimeve dhe rezultatit, por edhe për shkak të procedurave vendimmarrëse ndërkombëtare. Bashkësia Ndërkombëtare përmes OKB-së,

ngarkoi Ambasadorin Kai Aide për të siguruar fakte për gjendjen dhe propozimet e mëtutjeshme, në rrethanat e krijuara dhe proceset e vonuara.

Bashkësia Ndërkombëtare, në raport me të ardhmen statusore të Kosovës nuk kishte qëndrime koherente. E gjithë kjo ndikonte në karakteristikat qeverisëse e institucionale në Kosovë. Pikëpamjet për mbetje në kuadër të Federatës Serbi-Mali i Zi, ishin të parealizueshme, ngase populli i Kosovës nuk pranonte zgjidhje tjetër, përpos Pavarësisë. Dhe mund të krijonte destabilitet ndërkombëtar, qoftë edhe përmes luftës, rrugë të cilën kosovarët tani e kishin trasuar. Serbia dhe Mali i Zi-RFJ nuk mund të vendosnin në asnjë rrethanë legjitime, juridike, politike, e as imponuese për qeverisjen demokratike, e as integritetin territorial, as për statusin e Kosovës, pa përfilljen e vullnetit të popullit të Kosovës. Ky vullnet ishte paraparë të përfillet edhe në Rambuje dhe në Rezolutën 1244, si njëri nga elementet pa të cilin nuk mund të vendosej as statusi i saj, as stabiliteti ndërkombëtar në rajon. Këtu qëndron edhe madhështia e faktorit vendor, popullit me subjektet serioze politike, në raport me proceset ndërkombëtare. Faktori vendor tashmë ishte përcaktuar fuqishëm për Pavarësi e vetëvendosje të mirëfilltë.

Mohimi i qeverisjes demokratike në Kosovë, u bë shkaktar esencial i krizës së shtetit të RSFJ-së e RFJ-së, ngase, nuk lejonte qeverisjen demokratike në Kosovë. Tani pas vitit 1999 edhe po të donte, nuk kishte kurrfarë mundësie. Edhe shoqëria kosovare nuk mund ta realizonte qeverisjen dhe institucionet demokratike e legjitime pa statusin e Pavarur të Kosovës. Pra, vetëvendosja dhe qeverisja demokratike legjitime ishin të kushtëzuara drejtpërsëdrejti dhe reciprokisht. Qeverisja dhe institucionet demokratike u bënë faktori esencial dhe zbërthyes i situatës dhe statusit.

Raporti i ambasadorit Kai Aide

Pas dhunës së Marsit 2004 në Kosovë, OKB ngarkoi Ambasadorin Eide për të mbledhur fakte për rrjedhat, rezultatet, propozimet dhe rekomandimet e mëtejme për Kosovën. Këtë raport të përmbledhur duhej ta paraqiste në OKB, në nëntor 2005. Populli dhe diplomacia ndërkombëtare, ishte lodhur nga status quoja. Pasojat e status kuos dhe qeverisjen e UNMIK-ut e kritikoi edhe Aide në Raportin e tij. (Eide Report, 6 August 2004, 3 and 15) Nevojën për ecje përpara në zgjidhjen e statusit e kishin kuptuar të gjithë vendimmarrësit ndërkombëtar. Edhe gatishmëria bashkëpunuese e politikës kosovare me ndërkombëtares për bisedime rreth statusit, ishte stabilizuar. Pra, faktori politik kosovar së bashku me atë ndërkombëtar, ishin dëshmuar dhe përcaktuar bashkërisht për standarde demokratike dhe garancione të pakicave, në veçanti për atë serbe. (Narten, 2006) Por, politika destruktive e Serbisë e kishte instrumentalizuar skajshmërisht pakicën serbe në Kosovë, të cilën e pengonte në inkuadrim institucional e qeverisës.

Raporti i Ambasadorit Aide, preferonte bisedime për statusin e Kosovës. dhe ngritjen e kapaciteteve politike kosovare. (Eide Report, 7 October 2005) Doli edhe motoja “standardet para statusit” (UNMIK/PISG, march 2004) Kjo ndikoi në përgatitjen e faktorit vendor në qeverisje, legjitimitet e përgjegjësi për të ardhmen, i cili deri më tani ishte tejet minimal. (YVG Kosovo, 2005) Por standardet e kërkuara, faktori vendor nuk mund t’i përmbushte pa kompetenca e institucione të pavarura. Këtë, tani e kishte kuptuar edhe Bashkësia Ndërkombëtare me qëllime pozitive ndaj të ardhmes statusore të Kosovës. Bashkëqeverisja me Bashkësinë Ndërkombëtare zgjati më shumë se që parashihte Konferenca e Rambujesë. Kjo zgjatje nga Bashkësia Ndërkombëtare, ishte rezultat i hamendjeve se si të zgjidhet ky problem dhe i jo harmonizimit të vendeve me ndikim për

Pavarësinë e Kosovës. Edhe politika serbe nuk tregonte fleksibilitet dhe ndryshim të qasjes ndaj Kosovës. Kjo ndodhte edhe për nevoja të brendshme në Serbi; për ruajtje apo ardhje në pushtet me pikëpamje radikale ndaj Kosovës. Serbia shpresonte në ndryshime eventuale të pikëpamjeve ndërkombëtare ndaj Kosovës, si dhe shpresës së faktori rus do t'i bllokojë proceset ndërkombëtare përkrahëse ndaj Pavarësisë së Kosovës. Situata gjithnjë bëhej e padurueshme. Edhe Bashkësia Ndërkombëtare ishte bindur se status quoja statusore dhe qeverisëse nuk mund të funksiononte. (Eide Report, 07.10.2005)

Deklarata e Grupit të Kontaktit, (9 nëntor, 2005)

Grupi i Kontaktit: Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia, Rusia dhe ShBA, filluan të mendojnë ndryshe për çështjen kosovare, filluan të koordinohen së çfarë duhet bërë më tutje. Pesë shtetet Perëndimore–Kuint-i, erdhi në përfundim se pritja që Kosova të përmbushë “standardet para statusit” nuk do të funksiononte. Shqiptarët e Kosovës po bëheshin të padurueshëm. Kuinti u bind se procesi duhet të lëvizte përpara. Në nëntor të vitit 2005, Grupi i Kontaktit deklaroi parimet udhëzuese për zgjidhjen e statusit dhe parimet e qëllimet qeverisëse në Kosovë:

Çdo zgjidhje e cila është e njëanshme apo rezultat i dhunës nuk do të pranohet. Nuk do të ketë ndryshim të territorit të tashëm të Kosovës, ndarje të Kosovës apo bashkim të Kosovës me cilindo shtet apo pjesë të ndonjë shteti. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve rajonalë do të respektohet plotësisht. Grupi i Kontaktit gjithashtu insiston që zgjidhja e ardhshme duhet të sigurojë mekanizma për pjesëmarrje në qeveri të të gjitha bashkësive në Kosovë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Gjithashtu theksohet se struktura efikase e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet procesit të decentralizimit duhet të lehtësojë bashkëjetesën e bashkësive të ndryshme (Grupi i Kontaktit, 9 nëntor 2005)

Pra, kjo deklaratë e Grupit të Kontaktit kërkon sigurimin e mekanizmave “ për pjesëmarrje në qeveri të të gjitha bashkësive në Kosovë në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.” dhe decentralizim vetëqeverises për bashkëjetesën e komunitetëve etnike.

3.5. Plani i Ahtisarit

Sekretari Gjeneral i OKB-së emroi ish-Presidentin finlandez Marti Ahtisar-in dhe

Albert Rohanin si zëvendës, që të udhëheqë bisedimet dhe procesin e statusit të Kosovës. Këto emërime i miratoi KS i OKB-së. (10 nëndor 2005) Këto bisedime u mbajtën në Vjenë, ku morën pjesë Kosova dhe Serbia me ndërmjetësimin e Bashkësisë Ndërkombëtare. Ahtisari u përball me një detyrë të vështirë për shkak të pozicioneve të ndryshme rreth statusit të Kosovës dhe qëndrimet kundërshtarë të Beogradit (Weller, 2009) e cila, e përdorte pakicën serbe në Kosovë duke mos e lejuar të integrohej sa duhej në institucionet kosovare dhe duke krijuar struktura paralele.

Vendimmarrjet ndërkombëtare për statusin e Kosovës lidheshin drejtpërsëdrejti me stabilitetin rajonal, sepse, proceset e brendshme dhe ato rajonale e globale të përfshira në procese, do të dështonin në rast të moszgjidhjes së statusit të Kosovës më pavarësi. Ndërsa, sa i përket integritetit dhe sovranitetit të Serbisë, si dhe legjitimitetit politik, juridik e moral ndaj Kosovës, Serbia i kishte të humbura. Edhe shkëputja e Malit të Zi nga Republika Federale e Jugosllavisë-nga Serbia më 2006, ishte hap i ri dhe rrethanë e re për Kosovën dhe Bashkësinë ndërkombëtare. Çdo tentim zgjidhje me pak së pavarësi, do të krijonte destabilitet dhe krizë të sigurisë dhe konflikt të pashmangshëm. Por, edhe qëndrimet ruse dhe vendimmarrjet në KS të OKB-së diheshin dhe deklaroheshin. Më 2 mars 2007, Marti Ahtisari u dorëzoi palëve Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës; shkurtimisht: Planin e Ahtisarit 2007. Ndërsa më 26 mars 2007, versionin përfundimtar të këtij Propozimi si rekomandim për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ia dërgoi KS të OKB-së. Më 5 prill 2007, Kuvendi i Kosovës e miratoi Deklaratën aprovuese të këtij Propozimi Gjithëpërfshirës. Kuvendi i Serisë e refuzoi përmes një rezolute. KS i OKB-së nuk e paraqiti fare Projektrezolutën për përkrahje të këtij Propozimi, ngase Rusia paralajmroi se do verë

veton kundër këtij propozimi. Pati edhe përpjekje të tjera për tejkalimin e mosmarrëveshjeve por nuk u trguan të suksesshme (Weller, 2009:323-346, 361-375).

Përcaktimet kryesore në Propozimin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe zgjidhjet juridike-kushtetuese e ligjore, institucionalizimin dhe forma e qeverisjes, pasqyrohet në Nenin 1. Dispozitat e përgjithshme:

1.1 Kosova do të jetë shoqëri shumetnike, që do të qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore. 1.2 Ushtrimi i pushtetit publik në Kosovë do të bazohet në barazinë e të gjithë qytetarëve dhe respektimin e nivelit më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. 1.3 Kosova do të miratojë Kushtetutën. Kushtetuta e Kosovës do të përshkruajë dhe garantojë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë, të cilët janë të domosdoshëm për t'u siguruar se Kosova qeveriset sipas standardeve më të larta demokratike, dhe e cila do të promovojë bashkëjetesën paqësore dhe prosperitetin e të gjithë banorëve të saj. Kushtetuta do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në parimet dhe dispozitat e përfshira në Aneksin I të kësaj zgjidhjeje. 1.4 Kosova do të ketë ekonomi të hapur të tregut me konkurrencë të lirë. 1.5 Kosova do të gëzojë të drejtën e negocimit dhe lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të drejtën për të kërkuar anëtarësim në organizata ndërkombëtare. 1.6 Gjuhë zyrtare në Kosovë do të jenë gjuha shqipe dhe serbe. Gjuha turke, boshnjake dhe ajo romë do të kenë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal apo do të jenë në përdorim zyrtar në pajtim me ligjin. 1.7 Kosova do të ketë simbolet e veta të veçanta nacionale, duke përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilët pasqyrojnë karakterin e saj shumetnik. 1.8 Kosova nuk do të ketë pretendime territoriale ndaj asnjë shteti apo pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë bashkim me asnjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti. (Planit të Ahtisarit, 2007,1)

Plani parasheh mbikëqyrje ndërkombëtare në implementimin dhe zbatimin në sferat kryesore. Detyrimet e shumta juridike e politike, këtë pavarësi e bëjnë të kushtëzuar. Të gjitha këto kushtëzime e obligojnë shtetin e Kosovës që t'i përfshijë në Kushtetutën e Kosovës dhe përcakton detalisht formën institucionale dhe qeverisëse. Plani i Ahtisarit, parashihte mënyrat, procedurat dhe kohën e nxjerrjes e realizimit të Kushtetues dhe konsolidimin e institucioneve kryesore publike. Aneksi I i këtij Plani, obligon që Kushtetuta e ardhshme e Kosovës: “Në të gjitha dispozitat e saj do të jetë në pajtim me këtë zgjidhje dhe do të interpretohet në pajtim me këtë zgjidhje; në rast të mospërputhjeve mes dispozitave të Kushtetutës dhe dispozitave të kësaj zgjidhjeje, do të mbizotërojnë e fundit.” (Planit të Ahtisarit, 2007,1) Pra, përcaktimet e Planit të Ahtisarit, përcaktojnë

përmbajtjen obliguese që duhet përfshirë në Kushtetutën e Kosovës. Këto ishin preferenca obliguese ndërkombëtare. Si të tilla e përcaktojnë përmbajtjen dhe strukturën qeverisëse dhe institucionale kosovare. Pra ky Plan, parasheh një mbikëqyrje të theksuar dhe obliguese nga Komuniteti ndërkombëtar që të kontrollojë, mbikëqyrë dhe të ketë tërë pushtetin e domosdoshëm për të siguruar implementimin efektiv dhe efikas të kësaj zgjidhjeje. Kosova, obligohet të ftojë Bashkësinë ndërkombëtare që t'i ndihmojë në përmbushjen e suksesshme të obligimeve të saja sipas këtij propozimi.

12.1 Një Grup Drejtues Ndërkombëtar (GND), i cili do të përbëhet nga akterët kyç ndërkombëtarë, do të emërojë Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN) dhe do të kërkojnë nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratimin e emërimit. PCN-ja dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE), i emëruar nga Këshilli i Bashkimit Evropian do të jenë i njëjti person. 12.2 GND do të përkrahë dhe do t'i japë udhëzime Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në përmbushjen e mandatit të tij. 12.3 PCN-ja do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për mbikëqyrjen, dhe do të jetë autoriteti përfundimtar në Kosovë për sa i përket interpretimit të kësaj zgjidhjeje...12.4 ...PCN-së do t'i besohet ushtrimi i autoriteteve të caktuara për sigurimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të plotë të kësaj zgjidhjeje, përfshirë autoritetin për të ndërmarrë masa, sipas nevojës, për parandalim dhe përmirësimin e shkeljeve të kësaj zgjidhjeje. (Plani i Ahtisarit, 2007, 12.1, 12.2, 12.41)

Ky kushtëzim i Pavarësisë ka edhe anët pozitive, ngase procesi integrues i minoriteteve dhe afirmimi ndërkombëtar do të bëhet nga përkrahja ndërkombëtare, si dhe mbrojtja e siguria mbeten gjithashtu ndërkombëtare. Në mbështetjen e këtij Plani dhe procesit ndërkombëtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Kosova shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 2008. Plani i Ahtisarit shërbeu si bazë për këtë deklaratë dhe për një rol të vazhdueshëm ndërkombëtar. Prania ndërkombëtare në Kosovë vazhdoi përmes Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) e Përfaqësuesit Special të BE-së si udhëheqës i misionit evropian për siguri, mbrojtje dhe sundim të ligjit në Kosovë. Misionit të UE për Sundimin e Ligjit (EULEX), KFOR-it dhe një mori organizatave e ndikimeve ndërkombëtare. Ky plan përcakton edhe procesin mbikëqyrës të implementimit të tij dhe afatet:

12.6 Mandati i PCN-së do të vazhdohet përderisa Grupi Drejtues Ndërkombëtar të vlerësojë se Kosova ka përmbushur kushtet e parapara me këtë zgjidhje. GND-ja do të ofrojë udhëzime për zvogëlimin deri në tërheqjen përfundimtare të PCN-së.

12.7 GND-ja do të kryejë rishikimin e parë të mandatit të PCN-së, bazuar në gjendjen e zbatimit të kësaj zgjidhjeje jo më vonë se dy vite pas hyrjes së saj në fuqi. (12.6, dhe 12.7)

Plani i Ahtisarit u implementua në tërë Kosovën, pos Veriut. U implementua në komuna multietnike. Vetëm pjesa veriore mbeti jashtë institucioneve të Kosovës. Shumica e komunitetit serb të Veriut nuk e pranoi këtë plan, ngase ishte e dirigjuar nga Serbia, si dhe nga tolerimet e Bashkësisë ndërkombëtare për një kohë të gjatë. Pra, kjo fazë e stërzgatur e administrimit ndërkombëtar, duke minimizuar ndikimin e faktorit vendor kosovar në qeverisje, dhe duke mos e shtrirë pushtetin e institucioneve qendrore kosovare në Veri, pati pasoja tejet negative në qeverisjen dhe instiucionalizimin demokratik të Kosovës. Pasojat e mos integritit të kësaj pjese janë afatgjata, pra edhe pas shpalljes së Pavarësisë. Me propozimin e Planit të Ahtisarit për Statusin e Kosovës-pavarësi të mbikëqyrur dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës nga Kuvendi, filloi procesi dhe tejkalimi i status quos disa vjeçare.

Plani i Ahtisarit ishte rezultat i shumë rrethanave vendore e ndërkombëtare, të cilat ndikuan edhe në përcaktimet politike e juridike të qeverisjes. Krijimi i realiteteve artificiale në terren, vonesa e përcaktimit të statusit nga vetë Bashkësia ndërkombëtare, ndërhyrjet e Serbisë në moslejimin e minoritetit serb të inkuadrohet në institucione e bashkëqeverisje në Kosovë, qëndrimet e Ruisë, situata politike në Serbi,etj., ishin faktorë që imponuan zgjidhje të tilla të ndërlikuara. Plani i Ahtisarit, zgjidhjet e tilla i konsideronte pragmatike; mundësi që siguron dhe garanton mbrojtjen e drejtpërdrejtë të komuniteteve pakicë, brenda shtetit të pavarur demokratik të Kosovës. Por, ky plan i nenvlerëson interesat e komunitetit shqiptar shumicë në Kosovë dhe i krijon disa vështirësi për qeverisje efektive e efikase të shtetit të Kosovës; ofron zgjidhje kushtetuese e juridike specifike që dallojnë me shtetet tjera në botë. Është më rendësi të theksohet se

Kosova nuk përkufizohet si shtet i komunitetit shumicë; pra, nuk theksohet karakteri kombëtar-shqiptar i Republikës së Kosovës. Kjo vërehet edhe në simbolet kryesore shtetërore. Faktori i brendshëm politik e institucional kosovar gjatë bisedimeve për statusin dhe pas shpalljes së Propozimit, për ta tejkaluar status quon, u tregua fleksibil dhe i pranoi këto zgjidhje të këtij propozimi.

Plani i Ahtisarit për të drejtat e pakicave

Plani i Ahtisarit obligon Kosovën që të ruajë demokracinë multietnike, jo religjioze, me gjuhën shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare, me një ekonomi të tregut të hapur dhe me konkurrencë të lirë. Gjithashtu afron elemente kryesore për të drejtat minoritare dhe pronësore, një formë të fortë të qeverisjes lokale të decentralizuar në nivel të kompetencave komunale. Për të gjitha pakicat/komunitetet dhe komunitetin serb, veçmas për komunat më shumicë serbe në pjesën e Veriut, afron zgjidhje tejet të avancuara.⁸⁵

(Galluci, 2011) Profesor Bajrami, duke analizuar leshimet në fushën e decentralizimit që i bëhen pakicës serbe në këto bisedime e negociata të përfshira në planin e Ahtisarit, thekson se këto zgjidhje i tejkalojnë “dukshëm në këtë mënyrë edhe dispozitat e vetë Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, dhe të drejtat e komuniteteve (sigurimi i të drejtave të posaqme në fusha të caktuara, duke u mbështetur në Konventen kornizë të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare).” (Bajrami, 2010:22).

Në nivelin lokal Plani i Ahtisarit parasheh: (Neni 3.2) “mbrojtjen e identitetit nacional apo etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjitha Bashkësive dhe anëtarëve të saj.” (Neni 4) ofron të drejtën e kthimit dhe rivendosjes së pronës. (Neni 6) siguron që vetëqeverisja

lokale dhe komunat “do të kenë të drejtën e bashkëpunimit ndër komunal dhe ndërshtetëror mbi çështjet e interesit të përbashkët në ushtrimin e përgjegjësisë të veta.”

Aneksi I (Neni 8.3) i jep komunave të drejtën e burimeve lokale për të hyrat. Aneksi III (nen. 10) gjithashtu lejon që komunat të bashkëpunojnë dhe të marrin financim edhe nga Beogradi (Neni 8.4) për bashkëpunim “ndër komunal dhe ndërshtetëror në fushën e kompetencave të veta dhe të shprehura.” Aneksi II (Neni 4) i siguron bashkësive të drejtën që të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë gjuhën dhe kulturën e tyre; të marrin arsimim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhët e tyre; të themelojnë dhe të ruajnë shkollat; të ekspozojnë simbolet e bashkësisë; dhe të kenë mediet e veta. Aneksi I (Neni 1.6) siguron mundësinë që të mbahen dy shtetësi. Aneksi III definon qeverinë lokale, decentralizimin dhe lidhjet me Beogradin. Në (Nenin 3) i jep komunave fuqi të plotë dhe ekskluzive për zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e tokës, rregullimin urban, shërbimet publike, arsimim, shëndetësi dhe shërbime sociale, akomodim publik, licencimi i shërbimeve lokale dhe emërimi i rrugëve. (Neni 4) i jep komunave me shumicë serbe “të drejta pjesëmarrëse të shprehura në emërimin e Komandantit të Stacionit të Policisë.”

Ky planë i siguron Mitrovicës Veriore kompetenca për arsimim universitar dhe një spital. (Neni 5) kërkon që qeveria lokale t’ia delegojë komunave përgjegjësinë për regjistrime kadastrale dhe civile, regjistrimin e votuesve, regjistrimin e bizneseve dhe licencim, distribuimin e pagesave të asistencës sociale (me përjashtim të pensioneve) dhe mbrojtjen e pyllëzimit. (Neni 11) të përdorin material arsimor nga Serbia në shkollat lokale. Aneksi IV (neni 7) siguron që komunat do të kenë gjyqet e veta dhe (neni 2.2) mandaton që Institucionet kosovare do të pëfaqësohen më përbërjen etnike të komuniteteve pakicë, dhe shumë zgjidhje tjera favorizuese e afirmuese për pakicat

kombëtare, në veçanti atë serbe. (Plani i Ahtisarit, 2007)

Ndërsa në nivelin qendror, Plani i Ahtisarit pakicave u siguron pjesëmarrje të rezervuara dhe të mbrojtura e të garantuara në qeverinë qendrore. Aneksi I i këtij Plani, siguron kuota për pjesëmarrjen “jo-shumicë” në qeveri. (Neni 3) siguron njëzetë ulëse (nga 120) të rezervuara, për serbët dhjetë ulëse në Kuvendin e Kosovës, si dhe numrin minimal për pakica tjera kombëtare, për dy mandatet e para pas Pavarësisë. (Neni 3.7-9) siguron pjesëmarrjen dhe votimin e pakicave në Kuvend për çështjet të cilat ndikojnë në bashkësitë “jo-shumicë”. (Neni 5) kërkon një numër minimal të serbëve dhe përfaqësuesve tjerë të bashkësisë siç janë ministrat dhe zëvendës ministrat dhe mandaton që shërbimi civil të “reflekton llojllojshmërinë e njerëzve të Kosovës.” Aneksi I (Neni 6) gjithashtu i jep përfaqësuesve jo-shumicë një rol të theksuar në zgjedhjen e anëtarëve të Gjyqit Kushtetues etj. Garanci juridike mjaft të avancuara për pakicat etnike, që duhet t’i përmbajë kushtetuta dhe legjislacioni kosovar, janë të avancuara edhe sa i përket interpretimit dhe ndryshimeve të Kushtetutës. Kushtetuta, mes tjerash në aneksin I (Neni 10) në procesin e ndryshimit të Kushtetutës, do të parasheh: Për çdo ndryshim të Kushtetutës do të kërkohet miratimi i dy të tretave të deputetëve të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë. (Aneksi I Neni 10-1, 10.2) Asnjë ndryshim i Kushtetutës nuk mund të pakësojë të drejtat dhe liritë e paraqitura në nenin 2 të këtij Aneksi.

Pra, Plani i Ahtisarit ofron një numër të masave lidhur me policinë, doganat, gjyqet dhe infrastrukturën, si dhe disa zgjidhje me karakteristika të veçanta për Mitrovicën. Plani afon mekanizma për mbështetjen e Beogradit për nevojat komunale dhe sigurimin e transparencës të kësaj mbështetje nga institucionet qendrore në Prishtinë. Por, Serbët e

veriut e refuzuan Planin e Ahtisarit, i cili siguron një kornizë për një demokraci funksionale multietnike tejet të avancuar, edhepse të gjitha pakicat në Kosovë përbëjnë rreth 8% të popullsisë.⁸⁶ (ESK, 2006) Qëllimi i këtyre propozimeve ishte që, pakicës serbe t'i sigurojë status të veçantë për ta integruar dhe deinstrumentalizuar nga politika destruktive e Serbisë ndaj Kosovës. Ngase, Serbia destruktivitetin ndaj Kosovës e bënte përmes pakicës serbe në Kosovë, duke e enklavizuar dhe duke mos e lënë të inkuadrohet në institucionet dhe proceset kosovare duke krijuar organizime paralele në veri. Zgjidhjet e Planit të Ahtisarit kanë anët negative, ngase nga koncepti i multietnicitetit që afirmohej më të madhe, u kalua në Komuna me shumicë serbe e jo multietnike. Kjo ndarje në baza etnike nuk ishte parimore dhe nuk shpreh strukturën reale të popullsisë kosovare; më tepër e enklavizon shoqërinë kosovare, se sa që kontribuon në multietnicitetin e mirëfilltë. Në rastin e Kosovës nuk kishte konflikte ndëretnike, por ishte instrumentalizimi i pakicës serbe nga politikat dominuese të Serbisë; për ta penguar vetëvendosjen, institucionalizimin dhe qeverisjen, e jo për interesat dhe të drejtat e pakicës serbe. Për të amortizuar këtë instrumentalizim dhe pengesat tjera të Serbisë, zgjidhjet që i përfshin Plani i Ahtisarit u bënë të pranueshme për palën kosovare institucionale, edhepse, dihet se Kosova nuk është shoqëri e theksuar multietnike. Por, zgjidhja reale e këtij problemi të pakicës serbe, bëhet duke i penguar politikat ndërhyrëse të Serbisë dhe aleatëve të saj kundër Pavarësisë së Kosovës. Politika destruktive e Serbisë pas luftës dhe pas shpalljes së Pavarësisë, e keqpërdori komunitetin serb në Kosovë, duke e instrumentalizuar për qëllimet e veta, në shumë mënyra e qëllime. Kjo ceket edhe në Raportet e institucioneve

ndërkombëtare për Kosovën. Eide, theksonte se serbet këshillohen nga Serbia të mos kthehen e integrohen në qeverisjen kosovare dhe as në institucionet ndërkombëtare në Kosovë.⁸⁷ (Eide Report, 2005: 4)

Bashkësia ndërkombëtare në aktet juridike për qeverisjen në Kosovë, përpos shtetit ligjor, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, në fokus primar kishte të drejtat e pakicave. Në pajtim me këtë e ka fokusuar kërkesën për multietnicitetin, edhe pse dihet realiteti multietnik në Kosovë. Ky parim i ‘multietnicitetit’ nuk ka gjë të keqe, dhe e gjithë kjo do të shkonte në favor të demokracisë dhe prosperitetit, por problemi qëndron në atë se politika serbe, gjithnjë e kishte keqpërdorur e instrumentalizuar pakicën serbe dhe pjesërisht edhe pakicat tjera. Edhe sot, po e keqpërdor pakicën serbe në Kosovë, për të penguar Pavarësinë, qeverisjen dhe institucionet kosovare. Përmes kësaj pakice përpiqet ta enklavizoi Kosovën dhe ta pengojë institucionalizimin dhe qeverisjen e saj në pjesën veriore. Pra, Serbia është kundër multietnicitetit, barazisë e lirisë në Kosovë. Të gjitha aktet juridike të Serbisë edhe deklaratimet zyrtare institucionale, janë shprehur haptas kundër integritetit të pakicës serbe në institucionet në Kosovë.

Në frymën pragmatike të zgjidhjes së problemeve dhe tejkalimin e tyre në proces, këto zgjidhje duken të pranueshme, por këto zgjidhje duhet kontrolluar nga qëllimet destruktive. Zgjidhjet e përkohshme shkojnë në favor të proceseve afatgjata dhe krijojnë pozitivitet momental edhe për të ardhmen. Si të tilla duhet përkrahur ngase, këto zgjidhje stabilizohen dhe nuk do jenë pengesë në forcimin institucional dhe shtetin demokratik qytetar, me decentralizimin e mirëfilltë dhe përmes proceseve integruese të

mirëfillta. Pala kosovare besonte në këto procese përfundimtare, andaj i përqafoi zgjidhjet e tilla. Këto pengesa në integrimin e plotë të komunitetit pakicë serbe do të amortizohen e tejkalohen, kur të pengohen politikat ndërhyrëse destruktive të Serbisë.

Numër i konsiderueshëm i përfaqësuesve të vendeve me ndikim dhe i forumeve ndërkombëtare, e theksojnë qartë se nuk ka ndarje të Kosovës.⁸⁸ (Clinton & Ashton, dhjetor 2012:3; Balfour, gusht 2012:2; Fule, gusht 2012:2) Por, çdo herë duhet të kemi kujdes për ta penguar destruktivitetin. Pozita tejet e avancuar që u garantohej komuniteteve pakicë, devijon konceptin e multietnicitetit në Kosovë duke favorizuar më tepër pakicën serbe, jo vetëm në raport me minoritetet tjera në Kosovë, por edhe në raport me komunitetin shumicë-shqiptarët. Komunitetit shqiptar, i cili është mbi 92% të popullatës i mohuan simbolet kombëtare shqiptare në stemat e simbolet shtetërore.

Pra, Plani i Ahtisarit u largua nga koncepti multietnik duke e ndarë dhe enklavizuar pakicën serbe. Kjo zgjidhje e emërtim artificial-komuna serbe e jo komuna multietnike, kishte për qëllim enklavizimin e jo multietnicitetin dhe bashkëjetesën. Mbrojtja e pakicave dhe e të drejtave nacionale e qytetare sipas standardeve të avancuara, nuk e pengon perspektivën kosovare por, mosinkuadrimi i saj i qellimshëm destruktiv dhe instrumentalizimi i saj nga politika e Serbisë për destruktivitet në qeverisjen kosovare është shkaktare e problemeve. Këto zgjidhje të avancuara për pakicat nuk i kanë pakicat në vendet fqinje.

Kreu IV: Statusi i ri politik dhe juridik i Kosovës: Pavarësia

4.1. Pavarësia dhe Kushtetuta

Me krijimin e rrethanave ndërkombëtare dhe sipas Propozim-zgjidhjes së statusit të Kosovës (Ahtisarit, 2007), Kuvendi i Kosovës përmes Deklaratës së Pavarësisë, shpalli: “Kosovën republikë demokratike, laike e multietnike, të udhëhequr nga parimet e jo diskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit” (DP, shkurt 2008). Kosova më këtë Deklaratë, përcaktohet për respektimin e parimeve qeverisëse që ishin paraparë në Planin e Ahtisarit, në veçanti parimet e legjislacionit në Aneksin XII: mbrojtjen e barabartë sipas ligjit dhe jodiskriminimin, mbrojtjen dhe implementimin e të drejtave të komunitetëve pakicë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, etj. Këto parime qeverisëse ishin paraparë në Planin e Ahtisarit dhe tani u konfirmuan edhe më Deklaratën e Pavarësisë, si qëllime përmbajtjesore të qeverisjes dhe institucioneve:

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

2. Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jo diskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse. (17 shkurt, 2008, pika 1- 2)

Në Deklaratë shprehet edhe zotimi se do të miratohet edhe Kushtetuta në pajtim më Propozimin Gjithëpërfshirës, e cila do të siguroj parime qeverisëse demokratike, ndarje e balancim të pushteteve, rolin ligjvënës e përfaqësues dhe kontrollues të parlamentit, pjesëmarrje politike sipas konkurrencës plurale dhe votimit të lirë, garanci për sigurimin e barazisë së komuniteteve dhe të drejtave të njeriut, implementim i pluralizmit politik shumëpartiak dhe implementim të parimeve demokratike të sistemit zgjedhor.

Në pikën 3 të Deklaratës, theksohet qartë zotimi se do të respektohet miratimi dhe zbatimi i legjislacionit të paraparë, veçmas Aneksi XII dhe legjislacioni që mbron dhe promovon të drejtat e komunitetëve:

3. Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. (17 shkurt, 2008, pika 3.)

Kosova, me statusin shtet i pavarur, siguroi tërësi të drejtash dhe detyrime të një shteti sovran në kohë dhe hapësirë më synime e parime për integrim euroatlantik. Këto të drejta i legalizoi përmes dokumenteve e proceseve me mbikëqyerje ndërkombëtare. Subjektiviteti shtetror ka përkrahje ndërkombëtare nga e drejta dhe organizatat ndërkombëtare dhe në raportet me vendet tjera.

“Deklarata ishte hartuar në bashkëpunim me përfaqësues të qeverive të shteteve kryesore që përkrahen pavarësinë e Kosovës. Që në hyrje të Deklaratës riafirmohet dëshira për integrim euroatlantik, theksohet se Kosova është një rast i veçantë që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe që nuk është precedent për cilindo situatë tjetër”(Bajrami, 2010:22).

Kjo është një kurorëzim i synimeve afatgjata këmbëngulëse të popullit dhe emancipim i proceseve, i vendimmarrjeve dhe i veprimeve vendore e ndërkombëtare sipas së drejtës ndërkombëtare. Më fitimin e subjektivitetit shtetëror, banorët e Kosovës e fituan statusin e qytetarit/shtetas më të drejtat individuale, kolektive dhe ato ndërkombëtare. Bashkësia Ndërkombëtare po kërkon shtete funksionale efektive dhe efikase në sferën qeverisëse e institucionale, me zbatim edhe të ligjeve e konventave ndërkombëtare. Kjo ka rëndësi për obligimet institucionale në procesin e qeverisjes dhe shkon në të mirën e qytetarit, në barazinë e tij me qytetarët e shteteve tjera, dhe me përgjegjësinë e institucioneve të Republikës së Kosovës, si vend i pavarur e demokratik.

Deklarata e pavarësisë dhe pavarësia, ishte në pajtim më teoritë dhe të drejtën ndërkombëtare. (Sterio, 2009:267) Republika e Kosovës menjëherë pas shpalljes, u njoh

dhe u përkrah nga vende të rëndësishme me influencë ndërkombëtare. Procesi i njohjeve dhe i pranimit ndërkombëtar ishte proces jo i lehtë, i cili u shpreh edhe në vështirësitë në konstituimin institucional dhe qeverisës, veçmas në procesin afirmues e integrujes ndërkombëtar. Shtetet që e kanë njohur Kosovën menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë, i takojnë 2/3-ve të Prodhimit të Përgjithshëm Botëror dhe janë me ndikim në proceset, vendimmarrjet dhe janë anëtare të organizatave të rëndësishme rajonale e globale. Kjo ishte mjaft domethënëse. Pavarësia në vitet e para filloi me mbikëqyrje ndërkombëtare që kishte edhe anët pozitive në sferën qeverisëse e institucionale, veçmas në procesin e afirmimit ndërkombëtar, e cila theksohet edhe në preambull të Kushtetutës dhe ftohet prania ndërkombëtare civile për mbikëqyerjen e zbatimit të Planit të Ahtisarit, dhe ftohet misioni i sundimit të ligjit i udhëhequr nga BE dhe NATO me praninë ushtarake deri sa institucionet e Kosovës të konsolidohen me përgjegjësi e aftësim funksional. Kjo kishte rëndësi edhe për moslejimin e forcave eventuale destruktive. Në deklaratë, mirënjohet përkrahja e të gjitha organizatave ndërkombëtare dhe vendeve më ndikim pozitiv. Kosova merr obligime për respektimin e të gjitha akteve ndërkombëtare dhe respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të të gjitha vendeve fqinjë dhe dëshira për bashkëpunim, paqë e marrëdhënie të mira ndërmjet popujve.

Në fazat fillestare, shumica e njohjeve erdhën si rezultat i punës së sponsorëve Perëndimor të pavarësisë, SHBA-ve e vendeve të BE-së dhe veprimtarisë institucionale. Tani, me rëndësi ishte cilësia qeverisëse dhe integrimi i pakicës serbe të Veriut. Shteti i Kosovës ishte dhe është në proces të afirmimit, anëtarësimit e integritetit ndërkombëtar. Ky proces i njohjes ndikohet nga cilësia qeverisëse kosovare. Ngase, ky është faktori esencial i rezultateve në sferat tjera ekzistenciale, zhvillimore, integruese e stabilizuese në

rajon. Republika e Kosovës u ballafaqu me pamundësi të shtrirjes së pushtetit në pjesën veriore të territorit, ngase integrimi i pakicës serbe ishte i vështirë për shkak të ndërhyrjes së Serbisë. Planin e Ahtisarit dhe Pavarësinë e Kosovës nuk e pranoi Serbia. Nuk e pranoi as Rusia si vend me të drejtën e vetos në vendimmarrje në KS, edhe pse të dyja ishin aktive në Bisedimet e Vjenës për Statusin e Kosovës. Pra, ende vazhdon rivaliteti i Rusisë ndaj vendimeve ndërkombëtare për Pavarësinë e Kosovës. Këto rivalitete i shfrytëzonte dhe gjithnjë po përpiqet t'i shfrytëzojë Serbia, e cila edhe në realitetin e ri vazhdimisht po keqpërdor pakicën serbe në Veriun e Kosovës. Të gjitha këto rrethana vendore, rajonale e ndërkombëtare, u shprehen drejtpërdrejt në procesin e konstituimit institucional e shtetëror të Kosovës, dhe rrjedhimisht në qeverisje, në integrim e zhvillim. Megjithatë, procesi i njohjeve eci mbarë; vështirësitë dolën në pranimin e saj në OKB. Vështirësitë dalin nga vetoja e Rusisë në KS dhe mosnjohja nga të gjitha vendet e BE-se. Pesë vende të BE-së, ende nuk e kanë njohur. Kosova është pranuar në FMN, BB, BRZH, dhe në një mori organizatash ndërkombëtare e rajonale. E kanë njohur 25 vende të BE-së. Mosnjohja e 5 vendeve të BE-së është pengesë e procesit integrues të Kosovës në BE. Por gjithçka është në proces. Rol të veçantë në njohje dhe afirmim ka funksionaliteti, efikasiteti dhe cilësia qeverisëse kosovare. Ndërsa, kundërshtaret e Pavarësisë, përpiqen t'i pengojnë mu këto procese e efekte qeverisëse e institucionale, për ta penguar afirmimin e mëtejme ndërkombëtar të Kosovës.

Pas shpalljes së Pavarësisë, pasoi një ndërhyrje më e lehtë e ndërkombëtarëve në procesin qeverisës së sa në fazat e mëparshme, por megjithatë ishte Pavarësi e kushtëzuar dhe e kontrolluar sipas Planit të Ahtisarit (ankset IX-XI dhe nenet 11-13 i DP) të cilat kanë të bëjnë me praninë ndërkombëtare civile e ushtarake dhe përkrahjen ndërkombëtare

në fushen e sundimit të ligjit. Konsolidimi juridik dhe institucional paraqet njërin ndër hapat esencial të domosdoshëm të qeverisjes. Cilësia e këtij konsolidimi paraqet politiken konstitucionale dhe parimet bazë të sistemit politik e juridik kosovar. Më të përcaktohen obligimet juridike, procedurale, morale, politike, ekonomike të procesit qeverisës demokratik. Kushtetuta u miratu nga përfaqësuesit e zgjedhur në Kuvend,(u miratu më 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2008) Kushtetuta e Kosovës përcaktoi formën, karakterin, funksionet, organizimin dhe autorizimet e pushtetit qeverisës, duke u bazuar në Planin e Ahtisarit. Formën qeverisëse dhe parimet demokratike të qeverisjes i përcakton në Dispozitat themelore (Kapitulli I): Republikë parlamentare dhe demokratike. Përcakton raportet politike themelore, institucionet politike dhe raportet në mes tyre, liritë dhe të drejtat e njeriut-qytetarit, të drejtat e komuniteteve, shtet unik më pushtetin lokal komunal të decentralizuar. Përcakton prejardhjen e pushtetit-sovranin, si dhe mënyrat e procedurat e ardhjes në pushtet e qeverisje, procesin zgjedhor, procedurat e konstituimit të institucioneve, kompetencat dhe përgjegjësitë, dhe raportet në mes pushteteve sipas përgjegjësi konkrete. Përgjegjësit dhe parimet e Sistemit të Drejtësisë; Gjykatën kushtetuese me rolin interpretues të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë; ekonomi të hapur me ligjësitë e tregut. Përkufizohet si shtet i komuniteteve dhe qytetarëve. Është me rëndësi të ceket se nuk theksohet sikurse në shumicën e Kushtetutave si shtet i komunitetit shumicë, por i popullit, i komuniteteve dhe i qytetareve të saj. Kjo vërehet si në Planin e Ahtisarit, ashtu edhe në Kushtetutën e Kosovës, ku nuk theksohet karakteri kombëtar-shqiptar i Republikës së Kosovës. Kjo vërehet edhe në simbolet -Himnin dhe Flamurin.

Nuk pati debate të mirëfillta publike në procesin e Kushtetutëbërjes e as referendum. Nuk pati debat as në Kuvend. Procesi që i ngutshëm nga të gjitha forcat politike partiake

brenda institucioneve, të cilat ishin përcaktuar e pajtuar që Kushtetuta të jetë sipas përcaktimeve e propozimeve të Planit të Ahtisarit. Plani i Ahtisarit, përcakton në detaje mënyrat, procedurat, kohën, qëllimet dhe politikat konstitucionale, kompetencat dhe përmbajtjen e funksionimit të institucioneve. Plani, sado që kërkonte përfshirjen e parimeve dhe dispozitave të përfshira në Aneksin I të këtyre zgjidhjeve, ai lejonte që të mos kufizohet vetëm në këto parime: “Kushtetuta do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në parimet dhe dispozitat e përfshira në Aneksin I të kësaj zgjidhjeje.” (Plani i Ahtisarit, 2007, Neni 1.3) Euforia e bërjes së Kosovës së pavarur, ndikoi të subjektet politike parlamentare që zgjidhjet kushtetuese të përceptoheshin si perfekte dhe u dukej i pa nevojshëm debati cilësor e miratimi përmes referendumit.

Përmbajtja qëllimore politike e strategjike konstitucionale, shprehet qartë në preambulën e Kushtetutës:

Ne, Populli i Kosovës, të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet; Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit; Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social; Të sigurt që shteti i Kosovës do të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë Evropës, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje; Të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në Botë; Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike; Në mënyrë solemne, miratojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. (2008, preambula).

Në nenin (2.1) përkufizohet se “Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet në pajtim me Kushtetutën nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur me referendum, si dhe në forma tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.” Duke shprehur epërsinë e këtij akti dhe kushtetutshmërinë në procesin qeverisës, përkufizohet se “Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë”

(Neni 16.1, K-I) Ndërsa, në Dispozitat themelore (neni 4.) përcaktohet Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit:

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetut. 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë. 4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. 5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. 6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. 7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

Kushtetuta i rregullon qartë: Të drejtat dhe Liritë themelore, Të drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, Kompetencat, Strukturën dhe Funksionet-përgjegjësitë e Institucioneve, Sistemin e Drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Marrëdhëniet ekonomike, Qeverisjen lokale dhe organizimin territorial, Sektorin e sigurisë, Institucionet e pavarura, deri të Dispozitat përfundimtare dhe në Kapitullin e XIV Dispozitat kalimtare. Në pajtim me këto zgjidhje kushtetuese dhe ligjet, procedurat dhe aktet tjera nënligjore në pajtim me të, u konstituuan të gjitha institucionet themelore me kompetencat dhe përgjegjësitë.

Cilësia qeverisëse kosovare varet nga ky rend juridik e politikë konstitucionale dhe nga tradita e qeverisjes parlamentare. Varet nga përvetësimi praktik i raporteve e parimeve në mes organeve e institucioneve, nga zbatimi i parimeve demokratike, nga zbatimi i ligjit e politikave dhe nga forcat shoqërore, politike, kulturore e ekonomike, si dhe nga ndikimi i proceseve rajonale e globale. Funksionimi përmbajtësor i tyre, sipas aspektit juridik-kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, është thelbësore për procesin demokratik të qeverisjes kosovare. Kosova e arriti konsolidimin juridik dhe institucional, por më vështirësi të mëdha implementuese dhe me dukuri negative, e cilësuar si “demokraci me

defekte’’⁸⁹ (*Freedom House* 2010) e ngjajshme me vendet e tranzicionit. Këto dukuri negative u trashëguan edhe nga qeverisja paraprake gjatë protektoratit 1999-2008; pra në një menyrë ishin vazhdimësi e atyre shprehive e dukurive.

Sistemi qeverisës në Republikën e Kosovës, me disa nga përcaktimet kushtetuese, u konsolidua sipas Teorisë së moderuar të demokracisë dhe teorisë kritike ⁹⁰ me karakteristika të “demokracisë konsensuale” (“consensus democracy”) dhe “demokracisë së bisedimeve” (“bargaining democracy”), sistemit zgjedhor proporcional, mbrojtjes dhe interpretimit të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë nga Gjykata Kushtetuese dhe me pjesëmarrje të garantuar e garanci të shumta për pakicat etnike. Sistemi zgjedhor proporcional rezultoj qeverisje me shumë parti të mesme dhe të vogla. Ngase, faktori i jashtëm konsideronte se qeverisja përmes partive të mëdha e masive që do të sillte sistemi zgjedhor mazhoritar, do të sjellte një përqendrim e uzurpim të theksuar të institucioneve nga partia e madhe fituese dhe konfrontim të theksuar të dy partive kryesore, e cila mund të kalonte në “tirani të shumicës,” apo të dy shumicave. Në demokracitë e paqëndrueshme dhe pa traditë kulturore përkatëse demokratike, qeverisja nga partitë e mëdha masive do të merrte karakteristika qeverisëse tejte jodemokratike, konfrontuese e shantazhuese, dhe me dukuri negative të theksuara uzurpuese e keqpërdoruese nga partia në pushtet. Me traditë fillestare shumëpartiake ishte edhe Kosova, Sistemi zgjedhor/elektoral proporcional, me garanci të shumta për minoritetet, u konsiderua nga faktori ndërkombëtar si model i përshtatshëm për realitetin dhe qeverisjen kosovare momentale, ngase subjektet partiake i detyron në bashkëpunim e bashkërendim,

konsensus, tolerancë, në mes tyre në krijimin e pushtetit-pozitës, në konsolidimin e institucioneve dhe në vendimmarrjet e tyre. Pra, politikën konstitucionale, Kosova e arriti përmes sugjerimeve të Bashkësisë Ndërkombëtare dhe përmes negociatave në bisedimet për statusin. U përcaktua forma parlamentare e qeverisjes demokratike me sistem zgjedhor proporcional me një zonë, me garanci pjesëmarrëse e të rezervuara e vendimmarrje për pakicat etnike, interpretim dhe mbrojtje të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, balancim të pushteteve dhe me decentralizim-qeverisje lokale në nivelin komunal. Ky sistem elektoral proporcional dhe siguria për komunitetet pakicë, ishte aplikuar edhe gjatë administrimit ndërkombëtar.

Mbikëqyrja ndërkombëtare

Edhe pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës vazhdoi mbikëqyrja ndërkombëtare, me kompetenca të përcaktuara dhe të specifikuara në anekset (IX-XI) në Planin e Ahtisarit:

Komuniteti ndërkombëtar do të kontrollojë, mbikëqyrë dhe do të ketë tërë pushtetin e domosdoshëm për të siguruar implementimin efektiv dhe efikas të kësaj zgjidhjeje,...Kosova gjithashtu do të ftojë bashkësinë ndërkombëtare që t'i ndihmojë Kosovës në përmbushjen e suksesshme të obligimeve të saja. (neni 11pika1 & neni12.pika 1-4)

Përfaqësuesi civil ndërkombëtar në Kosovë (PCN) i cili emrohet nga Grupi ndërkombëtar drejtues (GND) dhe përfaqësuesi special i BE-së (PSBE), i cili emrohet nga Këshilli i BE-së, funksione këto që do të ushtrohen nga i njejti person. Ky institucion do të mbikëqyr përmbushjet e obligimeve kosovare ndaj zbatimit të marrëveshjeve (neni 1 i Aneksit IX) mbikëqyrte punën e institucioneve të Republikës së Kosovës, por jo sa duhej ato të institucioneve paralele serbe në Veri. PCN sipas nenit 2.2. kishte të drejtë të zgjedhë dhe emroj : Auditorin e Përgjithshëm(ndërkombëtar); përfaqësuesit ndërkombëtar anëtar të Bordit të Drejtorëve të Trustit të Kusimeve Pensionale; gjyqëtarët dhe prokuroret

ndërkombëtar; Drejtorin e doganave; Drejtorin e Administratës tatimore; Drejtorin e thesarit dhe Drejtorin Menagjues të Autoritetit Qendror të Bankar të Kosovës. PCN do të mbikqyr sundimin e ligjit, gjyqësorin, policin, doganen dhe shërbimin korrektues (nenet 2.3). PCN do të mbikqyr edhe institucionet civile të Kosovës (nenet 2.4-2.6) PCN do të kordinoj dhe kryesoj edhe Komitetin për kordinim i përbër nga Prania Ushtarake Ndërkombëtare(PUN), Misionin European për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes (MEPSM) dhe Misionit të OSBE-së.(neni 3)., Ndërhyrjet e PCN në punën e institucioneve kosovare nuk ishin të theksuara, ngase, institucionet e Kosovës i përmbaheshin më përpikëri përcaktimeve të Planit të Ahtisarit dhe atyre kushtetuese.

Prania Ushtarake Ndërkombëtare(PUN), e krijuar dhe e udhëhequr nga NATO përgjegjëse për sigurinë në tërë territorin e Kosovës dhe mbështetjen e trajnimit të FSK-së, si dhe kordinimin dhe këshillimin e PCN, sa i perket sigurisë. (neni 1.1 i aneksit XI). Kryesusi i PUN është autoriteti final në fushën e përdorimit të forcës ushtarake. (neni 2.1) Kosova do t'i afroj PUN statusin dhe imunitetet që i kishte afuar KFORit sipas rregullores 2000/47 të UNMIKut (neni 1.1 i aneksit XI).(neni2.3).

Misionin European për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes (MEPSM), i themeluar nga BE, do ti ndihmon autoriteteve të Kosovës në fuqizimin e metejmë të gjyqësorit, policisë dhe doganave dhe monitorim e këshilla në fushën e sundimit të ligjit(aneksi IX dhe X, neni 12 1 DP). Njëherit edhe institucionet e Kosovës duhet t'i afrojnë ndihmen e nevojshme për realizimin e detyrave të MEPSM (neni 3).

Procesi i mbikëqyrjes ndërkombëtare civile, vazhdoi deri në përmbylljen e saj, më 10 shtator 2012. Fundi i mbikëqyrjes ndërkombëtare civile të institucioneve, nga udhëheqësit e institucioneve Kosovare, konsiderohej arritje për Kosovën, ngase shënoi edhe plotësimin

e kritereve dhe kërkesave ndërkombëtare që përcaktoheshin nga Pakoja e Marti Ahtisarit.

Kryeministri Thaqi në këtë rast, në Kuvendin e Kosovës, theksoi:

Dialogu dhe mirëkuptimi duhet të vazhdojnë. Zgjidhjet duhet të arrihen dhe popujt duhet të pajtohen. Edhe një kapitull që sapo u mbyll në Ballkan, ai i emergjencës, i asistencës dhe i mbikëqyrjes. Mirëpo po ashtu u hap një kapitull i ri, ai i zhvillimit, i pajtimit dhe bashkëpunimit të popujve mes shteteve (Koha ditore, 11 shtator 2012:2)

Tash baza e vetme juridike qeverisëse në Kosovë, është Kushtetuta e Kosovës, e cila mbetet sipas Planit të Ahtisarit. Por, institucionet dhe qeverisja kosovare kishin probleme në shtrirjen e pushtetit në Veri edhe në ngritjen cilësore institucionale e qeverisëse. Përfaqësuesit e institucioneve, ndër sukseset e Republikës së Kosovës i theksojnë: shpalljen e pavarësisë; nxjerrjen e Kushtetutës; zbatimin e dispozitave të Planit të Ahtisarit; krijimin e komunave të reja me shumicë serbe; decentralizimin; mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore; miratimin e simboleve kombëtare/shtetërore-flamurit dhe himnit, duke reflektuar karakterin shumëtnik; konsolidimin e institucioneve publike dhe administratës dhe përfshirjen graduale të komuniteteve jo-shumicë. Problemet në veriun e Kosovës mbeten ende të pazgjidhura, sa i përket sundimit të ligjit dhe jofunksionimit demokratik i institucioneve në ato komuna. Por, njohja, integrimi e afirmimi i Kosovës ishte një proces i vazhdueshëm, por pjesa veriore ende e pa integruar po i minimizon edhe sukseset e arritura. Siguria vazhdon të bëhet nga KFORI, PUN, mandati i të cilave buron nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Rreg. 2000/47, UNMIK-ut, neni 2.3) dhe nga Marrëveshjet sipas planit të Ahtisarit. (neni 2.1) EULEX-i i krijuar nga Brukseli, do të shërbejë si organ ndihmës dhe plotësues, por edhe i veçantë për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Në negociatat që u zhvilluan në linjën New York - Bruksel, është pranuar që EULEX-i ta trajtojë veten si “neutrale ndaj statusit”; me këso qasjesh mund të gjendet në situatën e ndikimit politik, e jo vetëm në pajtim me

sistemin juridik të Republikës së Kosovës. FSK-ja ende nuk e ka rolin e sigurisë si çdo vend sovran. Andaj, përmbyllja e mbikëqyrjes ndërkombëtare (shtator 2012) nuk ishte bartje e plotë e kompetencave nga misionet përkatëse ndërkombëtare tek autoritetet e Kosovës, sidomos në sferën e sigurisë, mbrojtjes dhe në sferën e sundimit të ligjit.

Presionet ndërkombëtare dhe nevojat integruese të Serbisë, ka gjasë të ndikojnë dhe ta detyrojnë Serbinë të dialogojë me Kosovën, përmes ndërmjetësuesit Evropian. Organet e BE-së po përpiqen të gjejnë zgjidhje alternative për të mos u penguar e vonuar proceset integruese edhe për Kosovën. (Zyra e BE-së në Kosovë, janar 2012:20, Marrëdhëniët BE-Kosovë) Ndihma e BE-së përmes asistencës në Kosovë për konsolidimin e kapaciteteve institucionale e demokracinë, dhe për zhvillimin ekonomik ishte intensive. Asistenca financiare e saj për Kosovën është 565.mil. Euro. Ndërsa në total 2007-2012 përafërsisht 2 miliard Euro. (Zyra e BE-së në Kosovë-IPA, 2007-2012:18)

Me kërkesën e Serbisë e cila hasi në përkrahjen e OKB-së, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë iu kërkuar vlerësimi i ligjshmërisë së Aktit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), e cila përfaqëson Gjykatën e nivelit më të lartë të OKB-së, konstatoi se: “Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nga Kuvendi, më 17 shkurt 2008, nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Nuk e ka shkelur as Rezolutën 1244, dhe as Kornizën Kushtetuese 2001 të UNMIK-ut.”(Opinion i GJND/22 korrik 2010) Ky opinion ishte tejet i rëndësishëm në shumë aspekte, e në veçanti për konsolidimin institucional e qeverisës dhe për proces të afirmimit, njohjeve, inkuadrimin dhe integritetin të Republikës së Kosovës në institucione e organizata ndërkombëtare e rajonale; ishte një argument mbështetës shumë i rëndësishëm për të drejtën ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Ministri i jashtëm Hoxhaj, theksonte se:

Vendimi i GJND-së është një argument mbështetës shumë i rëndësishëm për të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe shtetësi, i cili është pasuar nga veprime të suksesshme të shtetndërtimit dhe konsolidimit që kanë luajtur një rol vendimtar në justifikimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Vendimi i GJND-së...ka siguruar argumente të mjaftueshme se Kosova është një rast unik, i pakrahasueshëm dhe i paprecedentë, që ka arritur të përmirësojë qeverisjen demokratike brenda vendit, të kontribuojë për paqen dhe stabilitetin rajonal, dhe nuk ka shkaktuar ndërkombëtarisht ndonjë efekt negativ zinxhir, (Kosova sot, 22 korrik 2010, 1)

4.2. Institucioni legjislativ dhe ekzekutiv

Parlamenti

Parlamenti me funksionet e tij paraqet institucionin bazë të sistemit qeverisës; paraqet institucionin përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës të institucioneve tjera. Funksioni bazë është ai legjislativ “Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”(Kushtetuta e R Kosovës 2008, K-IV, Neni 63) Funksioni përfaqësues, legjislativ, përgjegjës dhe kontrollues në raport me qeverinë dhe presidentin, dhe me institucionet tjera. Cilësia e Kompetencave dhe përgjegjësi, e përcaktojnë karakterin parlamentar të sistemit politik e juridik të qeverisjes, të cilat janë të parapara me Kushtetutë, me Ligje dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kuvendi i Republikës së Kosovës u konsolidu në aspektin juridik, me organet dhe veprimtarinë qeverisëse. Cilësia qeverisëse politikëbërëse dhe kontrolluese e efektive në veprimtarinë e parlamentit, po varët nga cilësia e forcave politike.

Parimet e konstituimit, strukturën, kompetencat, funksionet, rolet, etj., të Kuvendit të Republikës së Kosovës i përcaktonte Plani i Ahtisarit. (Ligjet e pakos Ahtisari). Përcaktonte strukturën e Parlamentit dhe përfaqësimin e komuniteteve pakicë:

Për dy mandatet e para zgjedhore pas miratimit të Kushtetutës, Kuvendi i Kosovës do të ketë (20) ulëse të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, në mënyrën vijuese: dhjetë (10) ulëse do t’u ndahen partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës dhe dhjetë (10) ulëse do t’u ndahen komuniteteve të tjera pakicë. (Plani i Ahtisarit, 2007, Neni 3)

Kjo strukturë përfaqësuese për minoritete ishte e ngjashme edhe gjatë fazës së Administrimit Ndërkombëtar. (Korniza Kushtetuese 2001) Kërkohet që në Listat e kandidatëve dhe përfaqësimit në Kuvend t'i kushtohet kujdes i duhur përfaqësimit gjinor.

Kushtetuta e Kosovës i përmban në tërësi të njëjtat propozime për parlamentin:

Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicionëve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. (Kapitulli-IV, nenin 64)

Të gjitha këto përcaktime u përfshin në Ligjin zgjedhor (Ligji nr. 03/l-073) për Kuvendin e Republikës së Kosovës i cili me kompetencat, funksionet legislative, përfaqësuese, mbikëqyrëse, zgjedhore-emërtuese, shkarkuese, ratifikuese, miratuese, e debatuese dhe vendimmarrjeve të shumta në procesin qeverisës dhe në raport me institucionet tjera. Kjo përcaktohet qartë me kompetencat e Kuvendit, të cilat e karakterizojnë Parlamentin si institucionin bazë të qeverisjes demokratike me sistem parlamentar dhe primar në raport me institucionet tjera. Kushtetuta në Kapitullin e IV, përcakton këto kompetenca të Kuvendit:

- (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
- (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin;
- (4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;
- (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;
- (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;
- (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit; (10)
- zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit të Prokurorisë së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;
- (13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- (14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj (K-IV, nenin 65)

Në Kompetencat e Kuvendit shihet qartë karakteri parlamentar i sistemit qeverisës, ku përcaktohet përparësia, kompetenca dhe përgjegjësia e Parlamentit në raport me ekzekutivin dhe institucionet tjera, si dhe në raport me proceset e shumta.

Garancitë mjaft të avancuara për minoritetet në numrin e vendeve të rezervuara të deputetëve, dhe përfaqësimin e tyre në organet, procedurat e vendimmarrjeve të Kuvendit janë të avancuara P.sh. Komisioni i Kuvendit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve:

...është komision i përhershëm i Kuvendit. Ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend. 2. Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh. (Kapitulli-III, Neni 78.1) [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve]

Edhe në procesin e amandamentimit, miratimin për ndryshimin e Kushtetutës, shfuqizimit të ligjeve me interes vital, kërkohet që shumica e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara e të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve jo shumicë, të jenë të pranishëm dhe të votojnë pro:

Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndër komunale dhe tej kufitare. (Kushtetuta 2008, K-IV, Neni 81) [Legjislacioni me Interes Vital]

Por, shumica e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara përfaqësues të Komuniteteve që nuk janë shumicë, mund t'i pengojnë miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve vetëm nëse prekin interesat dhe të drejtat e tyre “ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndër komunale dhe tej kufitare” e jo edhe proceset e ligjet tjera të Republikës së

Kosovës. Veprimet destruktive të komunitetit pakicë për t'i bllokuar proceset e interesat e komunitetit shumicë në Kosovë janë të papranueshme. Këto pengesa eventuale, duhet të jenë të papranueshme nga institucionet e Republikës së Kosovës, dhe duhet interpretuar qartë nga Gjykata kushtetuese.

Nisma Legjislative dhe Miratimi i Ligjeve, parashihet më Kushtetutë dhe sipas ligjit: “Nismën për të propozuar ligje mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushë veprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.” (Kushtetuta, 2008 K-IV, Neni 79) Kjo është konkretizuar dhe funksionale edhe me Ligjin nr. 04/-L-025 për nisma legjislative. Në procesin e Miratimit të Ligjeve janë përcaktuar kompetencat e Presidentit në të drejtën e tij në kthimin e ligjit dhe arsyet, të cilën mund ta ushtrojë vetëm një herë:

1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë. 2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar ...3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë. 4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur. (Kushtetuta 2008, K-IV, Neni 80)

Kuvendi u konsolidua dhe kreu me sukses funksionet kryesore qeverisëse, se bashku me qeverinë dhe institucionet tjera. Institucioni i Kuvendit në të gjitha funksionet, kompetencat dhe veprimtarinë e tij në procesin qeverisës demokratik, është i konsoliduar sipas dispozitave kushtetuese, me ligje dhe me rregulloren e punës së Kuvendit. Andaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës është i konsoliduar në aspektin juridik, më të gjitha organet dhe veprimtarinë qeverisëse. Si institucion përfaqësues i dalë nga zgjedhjet plurale me sistem zgjedhor proporcional i paraparë edhe me Kushtetutë, Kuvendi funksionon me konsolidimin struktural pozitiv-opozitiv. Si rezultat i sistemit proporcional zgjedhor,

mandateve të garantuara për komunitetet pakicë, pragut të ulët zgjedhor, etj, kemi përbërjen e Kuvendit multi partiak më numër të theksuar të partive të mesme dhe të vogla, të pozicionuara në pozitë dhe opozitë. Pas zgjedhjeve kemi koalicionet dhe aleancat për ta formuar shumicën parlamentare, zgjedhjen e Qeverisë, grupet parlamentare, zbatimin e kompetencave e funksioneve të Parlamentit. Të gjitha këto po përcillen me vështirësi në konsolidim të institucioneve dhe në vendimmarrje, megjithatë po tejkalohen në bazë të rregullimit kushtetues, ligjor e procedural, si dhe me demokraci bashkërenduese ndërmjet subjekteve. Kjo konsiderohet si pozitive dhe mbrojtje nga “tirania e shumicës”.

Shumëpartizmi në parlament është si rezultat i sistemit zgjedhor proporcional dhe pragut të ultë zgjedhor, nga jo profilizimi programor i partive, nga përfitimet grupore të udhëheqjeve partiake, si dhe nga dalja në skenë e forcave të reja politike. Ky pluralitet partiak krijonte vështirësi qeverisëse, kryesisht në konsolidimin e pozitës, sepse asnjë subjekt politik nuk fitonte 51%. Pozitën e krijonte subjekti që fitonte vota më shumë se subjektet tjerat, fitonte rreth 30%, duke bërë koalicion pas zgjedhor me ndonjërin nga subjektet tjera dhe me përfaqësimin e garantuar të komuniteteve pakicë. Këto vështirësi rrjedhnin nga sistemi proporcional zgjedhor dhe sjellin vështirësi në konsolidimin institucional pas zgjedhjeve, vështirësi në vendimmarrje e jo efektivitet.

Në vendet me traditë fillestare pluraliste, këtë pluralitet të theksuar më të gjitha mangësitë dhe vështirësitë e tij, e konsiderojnë si anë pozitive. (Lijphart, 1994, 1992) Edhe në Kosovë ky sistem zgjedhor proporcional duket më demokratik dhe më plural në krijimin e vullneteve politike dhe në procese vendimmarrëse. Të gjitha këto po shprehen në cilësinë, rolin e funksionet dhe efektet e Kuvendit të Kosovës, veçmas në raportet me përgjegjësitë ndaj ekzekutivit dhe institucioneve tjera. Deri me tani nuk ekzistojnë

diferenca programore të mëdha në mes të partivee dhe në qëllime. Ndryshimi i sistemit zgjedhor proporcional në atë mazhoritar, do të sjell sistem dypartiak në parlament me karakteristikat përcjellëse. Ndërsa, sistemi zgjedhor i përzier do t'i zbutë efektet ekstreme të të dy formave të pastra zgjedhore.

Përgjegjësia politike e qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës, përkatësisht, ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse, kontrolluese dhe shkarkuese ndaj ekzekutivit nuk ishte në nivelin e duhur. Deputetët e partive në pushtet-pozitës, nuk i kritikojnë lëshimet, keqpërdorimet dhe dobësitë e qeverisë. Nuk i kritikojnë e kontrollojnë sa e si duhet, përkundrazi i mbrojnë dukuritë negative të qeverisë. Liderhipi partiak drejtpërdrejt po ndikonë te deputetët në vendimmarrjet e tyre. Në sistemin proporcional deputeti nuk është i lidhur shumë me bazën elektorale, më tepër është i orientuar nga lideri dhe udhëheqja partiake se sa nga baza elektorale. Këto tendenca të theksuara të kontrollit të legjislativit nga ana e Qeverisë, pa dyshim se janë elemente të autokracisë partiake. Një qëndrim i tillë tolerant ndaj dukurive negative të subjektit në pozitë, i cili ka shumicën në Kuvend dhe opozita jo unike, po rezulton në mungesën e përgjegjësisë politike (parlamentare) të Qeverisë. Deputetët shumicë të pozitës shumë rrallë marrin kritikojnë Qeverinë.

Dukuritë negative në procesin zgjedhor dhe mungesa e demokracisë së brendshme partiake po krijojnë praktika negative në funksionimin e legjislativit, përkatësisht në obligimet kushtetuese të Kuvendit ndaj qeverisë, dhe rrjedhimisht, në hallkat tjera qeverisëse e institucionale. (KDI, 04 gusht 2013:2) Problemet po shfaqen edhe pas hyrjes në fuqi të ligjeve, pasi që këto ligje nuk janë të zbatueshme në praktikë, ligje të cilat po duhet amendamentuar në shumicën e rasteve. P.sh. në një raport monitorues të KDI-së theksohet se “në Planin legjislativ të Kuvendit për vitin 2013, në rreth 60% të

projektligjeve janë për plotësim-ndryshim, madje disa ligje që janë miratuar vitin e kaluar. Kjo tregon se ligjet që po miratohen nuk po arrijnë të gjejnë zbatim dhe menjëherë po krijohet nevoja që të plotësohen apo ndryshohen.”(KDI, gusht 2013:2)

Sipas rezultateve monitoruese në të gjitha Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, konstatohet se një ndër vërejtjet kryesore ka qenë jo sundimi i ligjit. (KE:RaportI i progresit,2011, 2012) Në veçanti si dobësi e sistemit juridik ishte joharmonizimi i një numri të madh i ligjeve të aplikueshme në Kosovë, kjo ishte si rezultat i mospunës efektive të Kuvendit dhe qeverisë. Kjo gjendje jo e knaqshme e qeverisjes kishte ardhë nga jo cilësia e funksioneve të Kuvendit dhe raportit të tij ndaj institucioneve tjera. Kjo po reflektohet në mos ndryshim të realitetit në Kosovë në drejtim të fuqizimit, implementimit e sundimit të ligjit. Ngase, Kuvendi po karakterizohet me mbikëqyrjen e dobët parlamentare, ndikim i qeverisë-partisë dhe liderit mbi Parlamentin, kualiteti e monitorimi i dobët i ligjeve, debatet jocilësore, përfaqësimi jocilësor, jo efikasiteti i komisioneve parlamentare, transparenca jo e plotë, vështirësitë në zgjidhjen e Presidentit, emërimet dhe zgjedhjet jocilësore të bordeve dhe drejtuesve të institucioneve të pavarura, të anëtarëve të KGJK-ës, KPK-ës, të bordeve të korporatave dhe të shërbimeve publike, të ambasadorëve, etj. dobësi të veprimtarisë së Kuvendit.

Në një Tryezë të organizuar nga Forumi 2015 dhe KDI, u cek se: “Kuvendi i Kosovës miraton ligje, por ato ligje nuk fuqizohen, nuk aplikohen, nuk ekzekutohen sa duhet në institucionet dhe nuk shihet efekti i tyre”. (KDI, gusht 2013:2) Ndër shkaqet kryesore theksohen “Elitat e korruptuara të udhëheqjeve të partive, të cilat depërtojnë deri në Parlament, në ekzekutiv dhe në institucionet tjera, prandaj janë përgjegjëse pse ne nuk kemi një demokraci në qeverisje.”(Forum 2015; KDI, shtator 2013:3) Shkak i

kësaj dukurie janë edhe zgjedhjet e manipuluarat e me shkelje të parimeve demokratike të këtij procesi dhe jo efektiviteti i gjyqësorit. Karakteristikë tjetër është mosangazhimi i mirëfilltë i grupeve parlamentare të opozitës dhe mos koordinimi i tyre për bashkëveprim, dhe shkak i mungesës së karakterit të mirëfilltë opozitar. Shumë rrallë ka kërkesa për mocion ndaj Qeverisë. Pra, është prezent mungesa e ushtrimit të kontrollit të duhur të parlamentit ndaj qeverisë edhe ndaj organeve e institucioneve tjera.

Institucionet që formohen nga Kuvendi si organe e institucione të pavarura, veprimtaria e të cilave përcaktohet me Kushtetutë dhe me ligj, e që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me qeverisjen, janë të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutës. Këto institucione u formuan nga Kuvendi. Veprimtaria e të gjitha këtyre organeve është e rregulluar me Kushtetutë dhe me ligjet përkatëse.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) si institucion i pavarur, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, ushtron kompetencat vetëm në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore të zbatueshme. Guvernatori i Bankës Qendrore ushtron edhe detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të saj. “Qeverisja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe procedurat e zgjedhjes dhe të nominimit të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës rregullohen me ligjin, i cili duhet të sigurojë pavarësinë dhe autonominë e saj.” (Kushtetuta e Kosovës 2008) Banka Qendrore me kompetencat, rolet dhe funksionet e përgjegjësitë, së bashku me institucionet tjera, luan dhe zbaton politikat ekonomike dhe objektivat makroekonomike në Kosovë. Kushtetuta, BQK-në e përkufizon si subjekt juridik publik, që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Objektivat e BQK-së, sipas ligjit në fuqi, janë nxitja dhe mbajtja e një sistemi financiar stabil, të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave, të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit

të çmimeve vendore. (Ligjin nr. 03/L-209) Banka Qendrore po i mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve, brenda përcaktimeve kushtetuese e ligjore. Banka Qendrore po i përmbush objektivat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi në bashkëpunim me FMN dhe Organizatat tjera financiare.

Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Institucioni i Avokatit të Popullit, ndonëse në mandatin e tij nuk ka fuqi ekzekutive, Kushtetuta dhe ligji (Ligji Nr.03-L-195) i japin autoritet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Obligim primar ka hetimin, trajtimin dhe kontrollin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut-të qytetarëve nga institucionet publike dhe rekomandon zgjidhjen e çështjeve në dobi të qytetarëve në rast se konstatohen shkeljet. Avokati i Popullit, si i pavarur në ushtrimin e detyrës, nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës. “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.” (Kushtetuta 2008, K-XII, Neni 135) Si organ i pavarur, propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj. Njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. “Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës.” (Kushtetuta 2008, K-XII, Neni 135) Duke qenë një institucion i pavarur, i krijuar me Kushtetutë, dhe i emëruar nga Parlamenti, ky institucion ndërmjetësonë në mes të qytetarit dhe gjykatave, administratës, policisë, etj., në mënyrë që të drejtat e shkelura të

riparohen pas ndërhyrjes së tij. Njëkohësisht ky institucion u rekomandon institucioneve kryesore për gjendjen dhe nevojat për ndryshime. “Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.” (Kushtetuta 2008, K-XII, Neni 132) Pas shpalljes së pavarësisë, ky institucion po i kryen këto role dhe funksione, dhe sipas shumë vlerësimeve e konstatimeve të këtij institucioni, rezultatet nuk janë të kënaqshme.

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Në bazë të propozimit të Presidentit: “Kuvendi vendos për shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij, në bazë të propozimit të Presidentit ose me nismën e një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.” (Kushtetuta 2008, Neni 136)

Auditori i Përgjithshëm kontrollon:

- (1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
- (2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;
- (3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Neni 137.1.2.3)

I raporton Kuvendit për zbatimin e Buxhetit të Shtetit dhe jep mendimin për raportin e Qeverisë lidhur me shpenzimet financiare të vitit të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi. Informon Kuvendin për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkohet, si dhe Raportin vjetor për veprimtarinë e vet. (Ligji Nr. 02/L-74) Ky institucion po i kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ i përhershëm përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumeve

dhe shpall rezultatet e tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Veprimtaria e tij është e rregulluar më Ligjin 03-L-072. Kushtetuta përcakton:

Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi apo grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara e të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara e të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë. (Kushtetuta 2008, Neni 139)

Ky institucion i ka kryer më sukses obligimet dhe përgjegjësitë sipas Kushtetutës dhe ligjit dhe ishte efikas, por gjatëprocesit zgjedhor/votues janë shfaqë shkelje të konsiderueshme.

Komisioni i Pavarur i Medieve

Për sigurimin e pavarësisë së medieve kontribon edhe Komisioni i Pavarur i Medieve, i cili është „organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publikë e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.” (Kushtetuta 2008, Neni 141) Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen sipas ligjit, përmes një procesi transparent.

Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin e kompetencat e tyre dhe të cilat funksionojnë në mënyrë të pavarur. Ato kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj. “Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t’u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.” (Kushtetuta 2008, Neni 142)

Të gjitha këto institucione të pavarura të Kuvendit janë konsoliduar në pajtim me aspektin juridik. Ato janë funksionale, por cilësia e veprimtarisë dhe niveli i autonomisë së tyre po varet nga cilësia e institucioneve kryesore politike, nga dukurit negative në institucione dhe në sferat tjera.

Qeveria

Parimet, strukturën, kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës i përcakton Kushtetuta në Kapitullin VI, Nenet 92-97. Qeveria është e përbërë nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat, të cilët zgjidhen dhe kontrollohen nga Parlamenti. “Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar, që nuk janë deputetë të Kuvendit.” (Kushtetuta 2008, K-VI, Neni 96.6.) Qeveria është ushtruese kryesore e pushtetit ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet. Ministrat dhe organet e tjera ekzekutive themelohen sipas nevojës, për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë. Ndërsa, numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj.

3. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësisë të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.

4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo. (Kushtetuta 2008, Kreun VI, nenin 92)

Përgjegjësia e Qeverisë para Kuvendit përcaktohet me Kushtetutë, më Nenin 97.1 të K-VI): “Qeveria për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Kosovës”. Ekzistojnë një varg balancash në raportet Kuvend-Qeveri. Zgjedhja, kontrolli dhe përgjegjësia e Qeverisë nga Kuvendi, dhe në anën tjetër, veprimtaria e Qeverisë dhe raporti i saj ndaj institucioneve tjera, është e bazuar në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet. Funksionet, efektet, efikasiteti dhe rezultatet reale duhet analizuar sipas rezultateve e manifestimit konkret.

Kompetencat e Qeverisë, të përcaktuara në (Nenin 93) janë thelbësore, ngase kërkojnë, mundësojnë dhe obligojnë zbatimin e politikave qeveritare në të gjithë sektorët e shoqërisë së vendit dhe raportet me vendet tjera.

Qeveria ka këto kompetenca kyçe qeverisëse, që tregojnë qartë formën e sistemit politik e juridik parlamentar. Kompetencat e saj janë:

- (1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
- (2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;
- (3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
- (4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
- (5) propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (6) udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës;
- (7) udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike;
- (8) i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës;
- (9) propozon amendamentimin e Kushtetutës;
- (10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (11) ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, K-VI, Neni 93) [Kompetencat e Qeverisë]

Kryeministri, si udhëheqës i Qeverisë, ushtron funksionet e tij qeverisëse në raport edhe me institucionet tjera. Ai ka pozitë kyçe në Qeveri, prandaj ka këto kompetenca:

- (1) përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë;
- (2) siguron që të gjitha Ministritë të veprojnë në pajtim me politikat qeveritare;
- (3) siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë;(4) ndërron anëtarët e Qeverisë, pa pëlqimin e Kuvendit;
- (5) kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;
- (6) emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- (7) këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës;
- (8) së bashku me Presidentin, emëron Drejtorin, Zëvendës drejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- (9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;
- (10) kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, K-VI, Neni 94 [Kompetencat e Qeverisë]),

Pas zgjedhjeve parlamentare, sipas (Nenit 95.1) të Kapitullit VI, kërkohet bashkëpunim në mes Presidentit të Republikës së Kosovës me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend. Presidenti, “cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit”(K-V,Neni 84.14) [Kompetencat e Presidentit].

Sistemi proporcional elektoral në Kosovë duke sjell parti jo të shumicave absolute, e detyron partinë që ka fituar më se shumti vota të krijojë aleancë me subjekte tjera dhe me përfaqësues të minoriteteve, për ta krijuar shumicën në parlament dhe konstituimin e Kuvendit. Pra, duhet të kryehen një varg marrëveshesh në bashkëpunim me subjektet partiake, për ta themeluar pozitën dhe ekzekutivin-qeverinë, dhe për zgjedhjen e Presidentit, e cila bëhej në të njejtën kohë gjatë dy zgjedhjeve të fundit parlamentare. Dispozita kushtetuese përcakton: “Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.” (Kushtetuta 2008, K-V, nenin 84. 14.1) Në këtë Pikë të këtij neni, nuk specifikohet mirë se propozimi i kandidatit për kryeministër bëhet “në konsultim me partinë politike ose koalicionin” apo siç parashihet në pikën 14. të neni 84 të Kapitullit V: “...pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit.”(14) Ky dallim në këto dy dispozita duhet të harmonizohet. Pas kësaj “Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit. Qeveria konsiderohet e zgjedhur, nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.”(Kushtetuta 2008, K-VI, Neni 95 p. 2-3) [Zgjedhja e Qeverisë]

Pra Qeveria, sikurse edhe pozita në parlament nuk i përket vetëm një partie të vetme, ngase asnjë subjekt nuk po mund t’i fiton zgjedhjet mbi 50% si rezultat i sistemit proporcional zgjedhor. Një praktikë e tillë po ndodh vazhdimisht deri më tani. Edhe opozita ishte e shpërndar në disa parti të mesme.

Kushtetuta e Kosovës përmban dispozitat për pjesëmarrjen e Komuniteteve pakicë në Ministrinë dhe Përfaqësimin në ekzekutiv, në pajtim të plotë me planin e Ahtisarit:

3. Në Qeveri do të jenë së paku një (1) Ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) Ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë.
4. Do të jenë së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti Serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitete të tjera jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria do të ketë edhe një zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin Serb, dhe një (1) tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. (K-VI, Neni 96) [Ministrinë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]

Bashkëpërgjegjësia e Qeverisë si dhe përgjegjësia individuale e saj, përcaktohet qartë. Përgjegjësia individuale vjen si pasojë e vendimeve në fushat e veprimtarisë. Kjo ndarje e përgjegjësisë individuale është me rëndësi për efikasitetin brenda qeverisë. “Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësi për vendimet që merr Qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësisë të tyre.” (Kushtetuta 2008, K-VI, Neni 97.2) [Përgjegjësia] Kryeministri e ka në kompetencë të vet t’i “ndërron anëtarët e Qeverisë, pa pëlqimin e Kuvendit.” (Kushtetuta 2008, K-VI, Neni 94.4) [Kompetencat e Kryeministrit] Në Kushtetutë kemi një varg kompetencash e përgjegjësisë që përcaktojnë bashkëpunim të Kryeministrit me Presidentin.

Presidenti

Sipas sistemit politik dhe Kushtetutës të Republikës së Kosovës “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.” (Neni 84) Kompetencat dhe përgjegjësitë në procesin qeverisës të këtij institucioni përcaktohen qartë në Neni 84 të Kapitullit V, të cilat paraqesin kompetenca tejet të avancuara si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Kompetencat e Presidentit janë mjaft të avancuara. Presidenti zgjidhet nga Parlamenti. Shumë nga kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë, Presidenti i kryen në konsultim dhe bashkëpunim me Kryeministrin, Kuvendin, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kompetenca Presidentit, janë:

- (1) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;
 - (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
 - (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e pare të tij;
 - (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
 - (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
 - (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
 - (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
 - (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
 - (9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
 - (10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;
 - (11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;
 - (12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
 - (13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
 - (14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
 - (15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
 - (16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
 - (17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
 - (18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
 - (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
 - (20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;
 - (21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
 - (22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;
 - (23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
 - (24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;
 - (25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;
 - (26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
 - (27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
 - (28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
 - (29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;
 - (30) se paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushë veprimtarinë e tij/saj.
- (K-V, Neni 84) [Kompetencat e Presidentit]

Numri aq i madh i kompetencave të rëndësishme, në fillim të krijon përshtypjen e ekzistimit të sistemit gjysmë presidencial. Por, shtyllë e pushtetit ekzekutiv është qeveria me Kryeministrin e saj.

Procesi i Zgjedhjes së Presidentit nga Kuvendi është i rregulluar me (nenin 86) të Kapitullit V dhe më ligjin zgjedhor. (Ligji nr. 03/I-073) Ky proces po has në vështirësi në

sigurimin e shumicës në Parlament. Raportet në mes të subjekteve politike dhe vështirësitë për të krijuar pozitën, institucionin e Presidentit po e përdorin si mjet për krijimin e këtyre kualicioneve paszgjedhore. Si rezultat i kësaj nuk po përfillen sa duhet cilësitë e përshtatshme, vlerat dhe karakteristikat që duhet t'i ketë kandidati për President. Si rrjedhojë e kësaj, vazhdimisht janë shfaqur vështirësi në zgjedhjen e Presidentit. Në propozimet për ndryshimet dhe reformat zgjedhore, kanë dalë kërkesa që Presidenti të zgjidhet drejtpërsëdrejti nga qytetarët. Subjektet parlamentare kanë të drejtë të propozojnë kandidatë për President. Procedurat për zgjedhjen e Presidentit janë:

1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.
4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës.
6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh. (Kushtetuta 2008, Neni 86) [Zgjedhja e Presidentit]

Pra, shpërndarja e Kuvendit nëse nuk zgjidhet Presidenti i Republikës së Kosovës as në votimin e tretë; caktimi i kandidatit nga kualicionet paszgjedhore për të kriju pozitën; vështirësitë që dalin në zgjedhjen e presidentit nga Parlamenti dhe pamundësia e zgjedhjes se kandidatit cilësor për president, i arsyeton propozimet dhe kërkesën për zgjedhje të tij/saj të drejtpërdrejtë nga qytetaret, e jo nga Parlamenti.

Forma parlamentare qeverisëse, më qeverinë si shtyllë kryesore të ekzekutivit dhe Presidentin më kompetencat ekzistuese, për rrethanat e kulturën politike momentale në Kosovë, është e përshtatshme për qeverisjen demokratike. Duket i përshtatshëm në menaxhimin e krizave, në konstituimin e institucioneve, në efektet dhe stabilitetin qeverisës demokratik. Ndërsa, roli unifikues, përfaqësues dhe i forcimit të kohezionit të shoqërisë kosovare që ka presidenti, kërkon zgjedhjen e drejtpërdrejtë të tij nga votuesit e

jo nga parlamenti. I zgjedhur nga qytetarët, si udhëheqës plebishitar, jashtë ndikimit ekstrem të ngushtë grupor e partiak në parlament, është më legjitim, më efikas dhe më efektiv në funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e tij. Edhe në raport me parlamentin dhe qeverinë dhe me proceset qeverisëse e politike, presidenti me këto kompetenca ekzistuese është një faktor stabilizues. Pra, kompetencat dhe përgjegjësitë e tanishme janë të avancuara dhe mund të jenë të njëjtat, por vetëm zgjedhja e drejtpërdrejtë nga qytetaret ka refleksione më pozitive në procesin qeverisës dhe institucional. Kompetencat duhet të jenë të njëjtat për të mos ndryshuar karakterin parlamentar ekzistues të qeverisjes. Subjektet i detyron të dalin me kandidatë më unifikues. Mënyra e tanishme e zgjidhjes është e papërshtatshme. Edhe mënyra e zgjedhjes për herën e tretë (61-vota) është e ngushtë për legjitimitet dhe efektivitet të Presidentit. Mënyra ekzistuese po i mundëson dhe i imponon pozitës të kandidojë kandidatë më orientim të ngushtë partiak e klanor, e jo të përshtatshëm për rolin dhe funksionin që parasheh Kushtetuta. Zgjedhja e kandidatit sipas mënyrës së tanishme është një grumbull mekanik i votave dhe pazar ndërpartiak i koalicioneve, për të krijuar pozitën pa përfillur vlerat dhe cilësitë e duhura të kandidatit për atë funksion. Njëkohësisht edhe shpërndarja e Kuvendit dhe përsëritja e zgjedhjeve në rast të mos votimit të presidentit nga kuvendi, është e papërshtatshme.

Shkarkimi i Presidentit bëhet nga Kuvendi, nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe nëse është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë, si dhe paaftësia e shkaktuar nga sëmundja e rëndë-me mendimin e konsiliumit mjekësor, përmes vendimit të Gjykatës Kushtetuese:

Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës. 2. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës mund të iniciohet nga një e treta (1/3) e deputetëve të Kuvendit, të cilët nënshkruajnë një petition, i cili shpjegon

arsyet për shkarkim. Në rast se peticioni supozon sëmundjen e rëndë, Kuvendi do të kërkojë mendimin e konsiliumit mjekësor për gjendjen shëndetësore të Presidentit. Në rast se peticioni supozon ndonjë shkelje të rëndë të Kushtetutës, peticioni duhet t'i dorëzohet menjëherë Gjykatës Kushtetuese, e cila vendosë për këtë çështje brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e peticionit (Kapitulli V, Neni 91) [Shkarkimi i Presidentit]

Pra, rol në shkarkimin e Presidentit ka Gjykata Kushtetuese, e jo vetëm forcat momentale politike në Kuvend. Në Kosovë nuk po ndodhin shumë pate legjislative, për shkakun se Presidenti dhe Kryeministri vjen nga partia-koalicioni që në Kuvend e ka shumicën dhe nuk ka vështirësi të mëdha në aprovimin e miratimin e ligjeve dhe politikave. Presidenti ka të drejtë kthimin e ligjit vetëm një herë.

4.3. Sistemi i drejtësisë dhe Gjykata kushtetuese

Sistemi i Drejtësisë

Sistemin e Drejtësisë në Republikën e Kosovës e përbëjnë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial (KPK), Sistemi i Gjyqësorit, Prokuroria e Shtetit, dhe Avokatura. Organizimi dhe Juridiksioni për funksionin, kompetencat dhe procedurat gjyqësore të këtij institucioni e pushteti të pavarur, janë përcaktuar qartë me Kushtetutë e me ligje dhe me Kodet përkatëse. Është përcaktuar edhe mënyra e zgjedhjes/emërimi dhe shkarkimi i gjykatësve, mandati, riemërimi dhe imuniteti. Pushtetin gjyqësor sot e ushtrojnë Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor. (Kushtetuta 2008, K-VII, Neni 103) [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]

Nga janari 2013 parashihet organizimi dhe funksionimi i Sistemit gjyqësor, (Vendimi i Qeverisë, dhjetor, 2012) i cili do të ristrukturohet në: Gjykatë Supreme që është autoriteti më i lartë gjyqësor; Gjykata e Apelit si shkallë e dytë me seli në Prishtinë, e cila do të merret me zgjidhjen e të gjitha rasteve të ankesave të të gjitha gjykatave në territorin

e Kosovës; dhe shtatë gjykatat themelore me departamentet dhe degët përkatëse. Gjykata Themelore në Prishtinë, ka departamentet e specializuara për çështje ekonomike dhe administrative. Pra, nuk kemi Gjykatë Administrative të veçantë. Ndërsa, në kuadër të shtatë qendrave themelore do të ekzistojë Departamenti për Krime të Rënda, ai i përgjithshëm dhe Departamenti për të Mitur.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton dhe përmban parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor: “Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik, i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata...Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.”(K-VII, Neni 102, par. 2-3) [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] Kushtetuta dhe ligji sigurojnë pavarësinë dhe paanësinë e gjykatësve gjatë procedurave dhe proceseve gjyqësore. Është e rregulluar dyshkallësia, kontrolli i ligjshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, dhe përdorimi i mjeteve juridike të rregullta e të jashtëzakonshme:

4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Neni 102 p. 4-5)

Pra, në aspektin normativ, parimet themelore janë të qarta dhe të plota sipas standardeve demokratike bashkëkohore të sistemit gjyqësor. Gjyqësori kosovar karakterizohet nga rregullimi i ligjshmërisë, dyshkallësisë, depolitizimit dhe mëvetësisë, si dhe emërimi dhe shkarkimi i gjykatësve, mandati dhe riemërimi, imuniteti, etj., është i pavarur juridikisht, në raport me organet ekzekutive e legjislative. Plani i Ahtisarit për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe Kushtetuta e Kosovës përcakton depolitizimin dhe mëvetësinë në raport me organet ekzekutive e legjislative. Plani i Ahtisarit kërkonte që Kushtetuta të përmbajë këto zgjidhje: “Gjyqtarët dhe prokurorët do të emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Kosovës vetëm pas propozimit të bërë nga Këshilli Gjyqësor i

Kosovës” (KGJK) “Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor... Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij... siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme,...”(Plani i Ahtisarit, 2007, Neni.6.4) Këto zgjidhje i përmban edhe Kushtetuta dhe ligjet përkatëse të Kosovës. Pra, paanësinë dhe pavarësinë nga ndikimet politike të institucioneve politike dhe shtetërore e siguron KGJK-ës me kompetencat dhe funksionet e tij të shumta si në emërimin, kontrollin, propozimin dhe masat disiplinore e kontrolluese. Kjo përkufizohet në nenin 108 (KGJK) të Kapitullit VII:

3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është po ashtu përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve.

5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja. Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj. (K-VII, Neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës])

Aspekti apolitik i gjyqtarëve është i rregulluar me Kapitullin VII në Nenin (106.12) ku: “Gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj.”(Neni 106.1) [Papajtueshmëria] Si dhe pika 2. e këtij neni: “Gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit.” (Neni 106. 2) [Papajtueshmëria] Pavarësinë e forcon edhe zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës “për mandatin shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij.” (Neni 107.4), përcakton emërtimin, shkarkimin dhe imunitetin: “Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e

tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë.” (Neni 103) [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]

Në përbërjen e gjyqësorit, për ta pasqyruar shumëllojshmërinë etnike të Kosovës, i është kushtuar rëndësi multietnicitetit dhe barazisë gjinore. P.sh. kërkohet që, “Të paktën (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me juridiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë” (Neni 104) [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] Kjo shihet edhe në nenin 104.2 “Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore. Përbërja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Para dhënies së propozimit për emërim ose riemërim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës këshillohet me gjykatën përkatëse.” (Neni 103.7) [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]

Me ligj të veçantë mund të krijohen edhe gjykata të specializuara për çështje të veçanta. “Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme.” (Neni 104.1) [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] Në Nenin 104 “Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.” (Neni 105 p.1-2) [Mandati dhe Riemërimi] Mandati fillestar për gjyqtarët është trevjeçar. Në raste të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin. Ndërsa, Neni 105 përcakton : “Kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe...kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve.” (Neni 105) [Mandati dhe Riemërimi] Pavarësinë e gjyqësorit e fuqizon edhe imuniteti. Pjesëmarrja e Presidentit dhe e Kuvendit në procedurat e lartëcekura, në veçanti KGJK dhe KPK, në proceset: emëruese, riemëruese, propozuese, shkarkuese, disiplinore, mandatet-koha, etj. janë një shoshitje në përzgjedhjen e kuadrit në këtë institucion tejet të rëndësishëm. (Ligjet/2010-199) Por e gjithë kjo varet nga cilësia e subjekteve politike e lidershipit dhe e deputetëve, cilësia e funksioneve të Parlamentit dhe cilësia e veprimtarisë së ekzekutivit. Kjo cilësi ndikon në autonominë dhe efektivitetin e gjyqësorit, sepse sado që gjyqësori është autonom në aspektin formal juridik, ka një ndikim joformal reciprok në mes pushteteve përmes dukurive negative, që ndikojnë dhe depërtojnë edhe në pushtetin e gjyqësorit. Dukuritë negative në cilindo nga tri pushtetet dhe dukuritë negative në shoqëri, ndikojnë tërthorazi dhe drejtëpërdrejtë edhe në gjyqësorin.

Në sistemin e Drejtësisë rol kyç ka institucioni i Prokurorisë së shtetit, si institucion i pavarur. Kushtetuta dhe ligjet e kanë rregulluar sferën e organizimit, kompetencave dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit: “Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.” (Neni 109.1-4) [Prokurori i Shtetit] Edhe ky institucion është i paanshëm dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit. Prokuroria e Shtetit duhet të pasqyrojë përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore.

Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçar, me pa mundësi riemërimi. Pavarësinë në

kryerjen e funksioneve të institucionit të Kryeprokurorit të Shtetit e siguron Këshilli Prokurorial i Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Ky organ i lartë juridik siguron që Prokuroria e Shtetit të jetë e pavarur, profesionale dhe e paanshme: “Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë dhe disiplinojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t’i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t’i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.”(Neni 110.2) [Këshilli Prokurorial i Kosovës] Edhe “Avokatura është profesion i pavarur, e cila ofron shërbime sikur është e rregulluar me ligj.” (Neni 111.1) [Avokatura] Kompetenca të caktuara, në bazë të ligjit, ka edhe Oda e Avokatëve në organizim, përfaqësim dhe disiplinim të sferës së avokaturës. (Lgji nr. 03/L-117)

Me gjithë përcaktimet juridike të qarta dhe sukseset në konsolidimin e institucionit të drejtësisë, (Kushtetuta, 2008 dhe Ligji nr. 03/L-199,2010) gjithnjë po kërkohen masa serioze në sistemin e drejtësisë, për ta përmirësuar efikasitetin, për ta luftuar pasivitetin dhe dukuritë tjera negative brenda gjyqësorit. Po kërkohet konsolidim efektiv në hetimin dhe dënimin e keqpërdoruesve në institucionet e larta, ngase pasojat e këtyre dukurive dhe jodenimi i tyre, po reflektojnë drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në të gjitha sferat vitale.

Krahas gjyqësorit vendor, në Republikën e Kosovës vepron edhe Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX-i) në veçanti në rastet më serioze. Në përpjekjet e thellimit të reformave është kërkuar që në Këshillin Gjyqësor të Kosovës të jenë edhe 3 përfaqësues të EULEX-it. Në koordinimin me faktorin ndërkombëtar, më EULEX-in, Zyrës së BE-së dhe gjyqësorin vendor, po kërkohen reforma të thella dhe efektivitet të sistemit të

drejtësisë, duke filluar nga emërtimi, riemërtimi, tejkalimi i mos efikasitetit, prioritetin e lëndëve, dënimin e bartësve të korrupsionit në institucione dhe krimet të organizuar. Përkrahja ndërkombëtare në konsolidimin e sistemit gjyqësor, ka qenë edhe në formën e trajnimeve, në infrastrukturë dhe në krijimin e kushteve hapësinore, monitorim, etj. Kompleksi i godinave në Prishtinë i këtij pushteti, financohet nga BE-ja me 23 mil. Euro donacion. Janë arritur suksese në konsolidimin e institucioneve të këtij pushteti. Por, sipas shumë raporteve, Kosovës i duhet një gjyqësi akoma më e pavarur, më e reformuar, më e depolitizuar, e pa korruptuar, më e efektshme dhe më e përgjegjshme. (shih:Raportin e GJEA, tetor/2012; UNDP, 2012; *Freedom House*, 2012) Duke i përfillur këto parime dhe parakushte, ky pushtet ‘kontrollohet’ përmes respektimit të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, sipas rezultateve konkrete dhe sidomos sipas parametrave efektiv.

Konsolidimi juridik dhe normativ është në nivel, por në funksionimin real ka dukuri negative. Shumica e raporteve vendore dhe ndërkombëtare, opinionet e qytetarëve dhe vëzhgimet e afërta hulumtuese, tregojnë dukuri të gjendjes jofunksionale e joefektive në këtë institucion esencial për sundim të ligjit dhe qeverisjes demokratike. KGJK, Raportet e Komisionit Evropian, Raportet e Ombudspersonit, QJQ-të dhe shoqëria e gjerë civile, mediet dhe opinioni i qytetarëve, ndër dukuritë më të theksuara negative në gjykata i konsiderojnë: a)Jo efikasitetin: numër i madh i lëndëve të pakryera, të vjetruara dhe të humbura. Raste të shumta gjyqësore, që nuk kryhen me vite. Raste të caktuara, në kundërshtim me parimet elementare, që kryhen me prioritete të diktuar nga interesa të caktuara. b)Aktvendimet, vendimet, aktgjykimet, aktet gjyqësore,etj nuk janë të cilësisë së duhur profesionale. c)Nuk ka ngritje të aktakuzave ndaj kryesve serb të krimeve krimeve të bëra gjatë luftës, as nga gjyqësori vendor, as nga EULEX-i. d)Heshtja e gjyqësorit-

Prokurorisë së Shtetit dhe organet tjera të ndjekjes, ndaj kryesve të veprave penale të keqbërësve në institucione të larta.

Jo efektiviteti i sistemit të drejtësisë në bazë të ligjeve dhe kodeve, është njëri nga faktorët që po ndikon drejtpërdrejt në favorizimin e korrupsionit dhe të gjitha dukurive negative brenda institucioneve. Qytetarët kosovarë kërkojnë pavarësi, efikasitet dhe efektivitet më të madh të këtij pushteti; kërkojnë të merren vendime cilësore për të gjithë bartësit e veprave të denueshme, veçmas, atyre për keqpërdorime me parandë dhe pronën publike, të cilet janë nga bartësit e politikës në institucionet e larta. Kërkojnë zbatimin e vendimeve të gjykatave dhe të konfiskohen pasurit e përfituara përmes veprave penale. Të rriten kapacitetet dhe numri i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës. Por të gjitha këto, nuk mund të bëhen pa mbështetjen e institucioneve përkatëse politike e shtetërore. Kjo mbështetje e duhur po mungon ngase, një pjesë e lidërshit të lartë në institucione janë bartës të këtyre keqpërdorimeve.

Mos luftimi i korrupsionit në organet e larta dhe depërtimi i bartësve të tyre në shumicën e institucioneve, po ndikon edhe në shfaqjen e dukurive negative në gjyqësor. Pra, pushteti politik i korruptuar nuk kërkon gjyqësor efikas e llogaridhënës. Në mes tyre bëhet një marrëveshje joformale toleruese reciproke. Përmes emërtimeve nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv të antarëve të KGJK-ës, KPK-së, emërtimeve, buxhetit, nepotizmit etj. ndikohet në pushtetin gjyqësor të Kosovës. Mungon ndarja dhe kontrolli i mirëfilltë reciprok i pushteteve dhe përgjegjësia politike, juridike e morale, në shumicën e institucioneve dhe në të gjitha nivelet, dhe rrjedhimisht, të gjitha këto dukuri ndikojnë në gjyqësor. Në emër të pavarësisë së gjyqësorit mbrohet jo efikasiteti, mospuna dhe jo efektiviteti i gjyqësorit në mos luftimin e dukurive negative brenda institucioneve. Pra,

Gjyqësori nuk është në masën e duhur i mbështetur dhe i mbrojtur nga institucionet shtetërore; nuk kërkohet efikasiteti dhe efektiviteti i organeve të drejtësisë për rastet e lartpërmendura. Sipas Raportit të Gjykatës Europiane të Auditorëve, nuk po kërkohet dhe mbështetet realisht efektiviteti, siguria dhe efikasiteti i gjyqësorit nga institucionet kryesore të vendit. Theksohet se mungesa e fshehtësisë, kërcënimet dhe kritikrat publike në media, po shkaktojnë që gjykatësit dhe prokurorët të veprojnë në bazë të shqetësimeve politike, e jo atyre ligjore. (GJEA, tetor, 2012) Edhe OSBE, thekson problemin e jo plotësimi të pozitive në gjyqësor dhe mungesë të kandidatëve të kualifikuar, ngase shpeshherë refuzohen të kualifikuarit për arsye politike. (OSBE, janar 2012)

Gjykata kushtetuese

Mbrojtjen dhe interpretimin e kushtetutshmërisë e ligjshmërisë në procesin qeverisës, në veprimtarinë, organizimin e konsolidimin institucional, dhe në sferat tjera, e bënë Gjykata kushtetuese si institucion i pavarur. Gjykata kushtetuese, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e përputhshmërisë së akteve ligjore e nënligjore dhe veprimtarisë së institucioneve, më Kushtetutën. Pra, funksioni themelor i Gjykatës Kushtetuese është interpretimi i Kushtetutës referuar përputhshmërisë ose jo përputhshmërisë së akteve ligjore e nënligjore dhe veprimtarisë e vendimmarrjeve institucionale, amendamenteve kushtetuese, etj., kur palët e autorizuara i procedojnë rastet në gjykatë. Kushtetuta e Kosovës, përcakton qartë të gjitha parimet organizative e funksionale të Gjykatës kushtetuese. Përkufizon rolet, procedurat dhe kompetencat : “1.Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. 2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.” (K-VIII,Neni

112, 1-2) [Parimet e Përgjithshme] Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, janë të detyrueshme për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, bëhet shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës...ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës...me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, (Neni 116, Efekti Juridik i Vendimeve)

E gjithë kjo garanton qeverisje demokratike dhe paraqet një barrierë institucionale ndaj vendimeve eventuale jokushtetuese të forcave të caktuara në legjislativ, ekzekutiv, administratë, gjyqësor dhe institucioni apo organi tjetër. Gjykata Kushtetuese interpreton dhe mbron sistemin konstitucional të procesit qeverisës dhe veprimtarinë e institucioneve në pajtim me kushtetutshmërinë e ligjshmërinë. Kjo ka rëndësi të madhe e të pakrahasueshme për qeverisjen demokratike, për ruajtjen dhe garantimin e qeverisjes demokratike në bazë të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë. Pengon autokracinë dhe arbitraritetin qeverisës e institucional në vendimmarrje. Nuk lejon forcat e caktuara momentale politike të bëjnë veprime, vendime e ndryshime arbitrare, e interpretime të njëanshme për interesa momentale afatshkurta e përfituese grupore, në kundërshtim me Kushtetutën. “Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës” (Neni 113) [Juridiksioni dhe Palët e autorizuar]

Gjykata Kushtetuese ka në kompetencë të vendosë vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës nga palët e autorizuar, sipas procedurave. Palë e autorizuar për nisje të procedimit kushtetutar është: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit, Qeveria e Republikës së Kosovës, Komuna, tridhjetë e më

shumë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gjykatat, si dhe personat juridikë e fizikë pasi t'i plotësojnë kushtet paraprake me ligj, po që se më parë i ka shtjerë mjetet juridike të lejuara. Në Nenin 113 të Juridiksionit dhe të Palëve të Autorizuara, përkufizohen çështjet për të cilat mund të kërkohej interpretimi: çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën, përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën, përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve. Edhe “Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.” (Neni 113) Edhe: Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje për përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë. (Neni 113)[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

Përbërjen, emërtimin, mënyrën e zgjedhjes, kompetencat, procedurat e qasjes dhe Mandatin e Gjykatës Kushtetuese, e përcakton qartë Kushtetuta e Kosovës:

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen. 2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi. 3. Vendimi për të propozuar shtatë (7) nga gjyqtarët, varet nga miratimi i dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. 5. Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, bëhet nga gjyqtarët të Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë të gjyqtarëve të

Gjykatës, për mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e gjyqtarit. (Neni 114) [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]

Pra, siç shihet, autonomia e kësaj Gjykate garantohet me Kushtetutë dhe me ligj. Kjo vërehet edhe në sferën e Organizimit të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese. “Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.” (Neni 115) [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]. Gjykata kushtetuese në një Raport vjetor (2011) thekson se, kjo Gjykatë po i kryen më sukses punet dhe përgjegjësit e veta kushtetuese e ligjore në raport me qeverisjen demokratike, në interpretimin në bazë të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. (Constitutional Court of the Republic of Kosovo, Annual Report, 2011)

4.4. Administrata publike dhe Sektori i sigurisë

Administrata publike

Parimet organizative e funksionale të Shërbimit civil në Kosovë i përmban Kushtetuta në Kapitullin VI në (nenin 101), të cilat janë të rregulluara e të zbërthyera më ligj. Përbërja e shërbimit civil pasqyron shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore dhe pjesëtarë të minoriteteve në meset multietnike. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM) për shërbimin civil, siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Avokati i Popullit, si institucion i kontrollit të administratës, është funksional në mbikëqyrjen e këtij shërbimi. Veprimtaria e Administrata publike, është e rregulluar përmes kodit administrativ dhe Ligjit të Procedurës Administrative. Janë funksionale të gjitha organet e administratës në të gjitha nivelet. Është përcaktuar kontrolli parlamentar, ekzekutiv, gjyqësor, kontrolli nga Gjykata kushtetuese, nga Ombudspersoni dhe nga kontrolli i brendshëm i administratës . (Ligji Nr. 03 / L-199; Ligji nr. 03/L-189; Ligji nr. 02 / L-28; Nr. 03 / L-202) Ankesa dhe pjesëmarrja

aktive e palës në të gjitha fazat e Procedurës administrative është e rregulluar. Edhe konflikti administrativ si kontroll gjyqësor i aktit administrativ, gjithashtu (Ligji nr. 02/l-28 për procedurën administrative dhe Ligji për konfliktet Administrative) Edhe tubimet e qytetarëve, mediet dhe shoqëria civile po luajnë rol në kontrollin e administratës, edhe pse këto të fundit nuk janë kontrolle juridike, ato janë parime kushtetuese për të kontribuar në kontrollin e administratës dhe qeverisjes.

Ministritë, sekretariatet, inspektoriatet, agjencitë, entet, drejtoritë, byrotë, etj. në nivel vendi dhe në ato lokale-komunale funksionojnë sipas Kushtetutës dhe ligjit. (Ligjet/2010-189) Kontrolli nga Avokati i Popullit dhe format tjera parlamentare, si pyetjet nga deputetët dhe kërkesat tjera ndaj ekzekutivit për punën e administratës, po luajnë rol në pasqyrimin dhe përmirësim në administratë. Më rëndësi është monitorimi i brendshëm i administratës, i cili është në konsolidim e sipër si rezultat i implementimit të të arriturave teknologjike. Kontrolli gjyqësor po bëhet nga gjykatat e rregullta. Në Gjykatën Themelore në Prishtinë është departamenti i specializuar për çështje administrative por, Kosova ka nevojë për të pasur Gjykatën Administrative. Mundësitë dhe nevojat për një kontroll më cilësor ndaj administratës janë më se të domosdoshme, ngase do të kontribonin në ngritjen e cilësisë në efikasitet dhe efektivitet të administratës.

Implementimi i akteve administrative juridike varet nga cilësia e punonjësve, efikasiteti dhe efektiviteti i organeve të administratës dhe shërbimit civil, si dhe nga cilësia e institucioneve mbikëqyrëse e përgjegjëse. Dukuritë negative në institucionet tjera po shprehen dhe shkaktojnë shfaqjen e dukurive negative edhe në administratë. Me implementimin e teknologjisë informative-TI, janë bërë hapa drejt një administrate më transparente dhe më efikase. Aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit po

mundëson efektivitet të administratës në fushveprimtarinë e saj, në zbatimin e politikave qeverisëse dhe në cilësinë shërbyese. Krijimi i këtij mjedisi të shërbimeve elektronike po i mundëson qytetarit shërbim civil më cilësor dhe më efikas se sa në të kaluarën. Por, Kosovës i nevojitet avancim i mëtejshëm në krijimin e një administrate që përmbanë komponente e kritere të qeverisjes së mire:

si besueshmërinë, parashikueshmërinë, llogaridhënien dhe transparencën, si dhe kompetencat teknike dhe drejtuese, kapacitetin organizativ, qëndrueshmërinë financiare dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Ndonëse kriteret e përgjithshme të qeverisjes së mirë janë universale, këto Parime janë të dizajnuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA)” (KFOS-2012 [PDF.]Parimet e Administratës Publike - sigma)

“Qeverisja e mirë” në vendet e BE-së është përfshirë në Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore.(Neni. 41)⁹¹ Ndërsa në “Hapësira Administrative Evropiane” është krijuar nga Dokumentet SIGMA në vitin 1999.⁹² (Nr. 27) Kushtet e acquis dhe direktivat e udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i këtyre Parimeve. Këto parime janë standarde dhe kërkesa ndërkombëtare, dhe praktika të mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e OECD. Si standard minimal për një administratë të mirë, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre Parimeve themelore. (KFOS, 2012) Andaj, edhe Kosovës i duhen reforma për arritje të standardeve të tilla në administratë.

Implementimi i të arriturave të teknologjisë informative po e modernizon administratën dhe po krijon një menaxhim më efikas dhe kjo është thelbësore për efektivitet dhe efikasitet në sferat tjera. (MAP, 2011) Por, ende ka nevojë për reforma të thella kuadroviqe dhe teknologjike, organizative dhe të kontrollit, për të arritur cilësinë dhe efikasitetin e kërkuar. Shoqëria kosovare ka potencial të tillë për shërbime më efikase

dhe më cilësore, sikur të mos ishin dukuritë negative. Udhëheqjet partiake që po depërtojnë në institucionet, po punësojnë familjarë dhe anëtarë të grupit, pa kriteret e kërkuara. Pra, ka nepotizëm të theksuar. Konkursi dhe përzgjedhja përmes konkursit të mirëfilltë në Kosovë nuk ekziston. Ka mbi punësim, nepotizëm, militantizëm partiak, mospërfillje kriteresh profesionale, mungesë gradimi dhe paga personale të ulta.

Sipas Raporteve të BE-së, raporteve të Freedom House, opinioneve të qytetarëve, bizneseve, si dhe nga vetë të punësuarit në administratë, del konstatimi se, qeverisjes dhe shoqërisë kosovare i nevojitet një administratë më e depolitizuar dhe pa ndikim të udhëheqjes e lidershit partiak. Administrata duhet të funksionoi sipas ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe vlerave etike e profesionale.⁹³ (Dokumentet e SIGMA-s, Nr. 27) Të kontrollohet më mirë nga parlamenti, nga kontrolli i brendshëm i administratës, qeveria, gjykata kushtetuese e gjyqësori. Ekzistimi dhe krijimi i gjykatës administrative do të rriste efikasitetin dhe efektivitetin e punëve dhe organeve të administratës. Kontrolli nga ekzekutivi dhe monitorimi i brendshëm i administratës duhet të jetë më në nivel. Organet administrative të të gjitha niveleve, duhet t'i zbatojnë politikat qeveritare dhe të ofrojnë shërbime civile sipas ligjshmërisë. Andaj, këkesat e qytetarëve dhe të monitoruesve të jashtëm, dhe studimi MSA, po kërkojnë reforma në administratë. Po kërkojnë staf profesional e jo sipas vijave partiake e grupe. Edhe politikat arsimore t'i kushtojnë rëndësi hapjes së departamenteve të veçanta, për të aftësuar staf për administratë kompetente. Për të zbatuar politikat qeverisja, patjetër i duhet një administratë më cilësore, më efikase dhe më efektive në të gjitha nivelet e sektorët.

Sektori i sigurisë

Sektori i sigurisë është i rregulluar me Kushtetutë në Kapitullit XI, neni 125-131 dhe me ligjet përkatëse. Sipas dispozitave kushtetuese, institucionet e sigurisë obligohen të veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike, si dhe me ligjet e aktet nënligjore e procedurale përkatëse. Karakteristikat dhe Parimet e Përgjithshme të institucioneve të sigurisë, përcaktohen në (Nenin 125) “Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet.” (K-XI, Neni 125) Janë organe dhe institucione të cilat mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve, veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike. Institucionet e sektorit të sigurisë pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike. Në këtë sferë mjaft të ndjeshme për rrethanat në rajon dhe në Kosovë, Republika e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë po i respekton marrëveshjet e aplikueshme ndërkombëtare, bashkëpunimin me organet ndërkombëtare të sigurisë dhe me homologët rajonal.

Më rëndësi të veçantë është Kontrolli Civil dhe Demokratik mbi institucionet e sigurisë, si domosdoshmëri për qeverisje demokratike. Këtë e garanton Kushtetuta dhe ligjet përkatëse. Rregullimin ligjor e nënligjor, konsolidimin organizativ dhe kontrollin civil demokratik të këtij sektori, Republika e Kosovës po e kryen me sukses.⁹⁴(Qehaja, mars 2012) Konsolidimin dhe veprimtarinë e Institucioneve të Sigurisë dhe kontrollin civil demokratik sipas Kushtetutës e kryen: “Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyr buxhetin dhe politikat e institucioneve të sigurisë dhe rregullohet me ligj.”(Neni 125.5) [Parimet e Përgjithshme] Këshilli i Sigurisë i Kosovës është organ tejet i rëndësishëm:

Këshilli i Sigurisë i Kosovës paraqet bashkëpunimin ndërinstitucional: nga Qeveria, Kryeministri, Presidenti dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet ndërkombëtare. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë përgatit: a) strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës, b) ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës, c) kryesohet nga Kryeministri me mbështetje nga Qeveria, përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, d) Këshilli është i obliguar të bashkërendojë punën e tij ngushtësisht me Presidentin, dhe e) do të bashkëpunojë ngushtësisht me autoritetet ndërkombëtare. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Neni 127) [Këshilli i Sigurisë i Kosovës]

Prania Ushtarake Ndërkombëtare

Prania Ushtarake Ndërkombëtare, si forcë ushtarake ndërkombëtare (KFOR), po krijon sigurinë e cila ishte paraparë me nenin 14 të Rezolutës 1244 :

14.1 NATO do të krijojë një Prani Ushtarake Ndërkombëtare (PUN) për të përkrahur implementimin e kësaj zgjidhjeje, siç parashihet me Aneksin XI të saj.

14.2 Kjo PUN do të udhëhiqet nga NATO-ja dhe do të veprojë nën autoritetin e Këshillit Veri atlantik dhe do të nënshtrohet udhëzimeve dhe kontrollit politik të tij, përmes zinxhirit komandues të NATO-s. Prania ushtarake e NATO-s në Kosovë nuk parandalon krijimin e një misioni përcjellës në të ardhmen nga ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare të sigurisë, pas rishikimit të mandatit. (Rezoluta 1244, Neni 14. Prania Ushtarake Ndërkombëtare)

Përkrahja e jashtme ushtarake dhe mbrojtëse, ka ndikuar në kursimin e shpenzimeve të buxhetit të vogël të Kosovës. Ka krijuar besim në mes komuniteteve dhe tek minoriteti serb në proces të integritetit. Nuk ka lejuar manipulime të opinionit për gjendjen e sigurisë, etj. Forcë mbrojtëse mbetet PUN, organizatë ndërkombëtare e sigurisë, forcë ushtarake e konsoliduar në bashkëpunim me NATO-n për sigurinë e Kosovës.

Konsolidimi i FSK-së

Konsolidimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës-FSK-ës si forcë profesionale dhe shumetnike, u realizua me sukses, si “një komponentë e armatosur lehtë, e aftë për të kryer funksione specifike të sigurisë...një organizatë civile brenda Qeverisë e cila do të ushtrojë kontroll civil mbi FSK-në, në pajtim me këtë zgjidhje.” (Plani i Ahtisarit 1.1) Ushtrimin e kontrollit civil të FSK-së e bënë Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera vendore, krahas faktorit bashkëpunues ndërkombëtar si monitorues i kësaj force dhe sipas zgjidhjeve juridike në fuqi.(Ligji nr.03/L-046) Ndërsa sipas Kushtetutës, FSK paraqet

forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, e cila mbrohet qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj. “Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila gjithmonë i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve civile të zgjedhura në mënyrë demokratike.” (Kushtetuta 2008, K-XI, Neni 126.3) FSK, pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.

Kosovës si çdo vend i pavarur, i lirë e demokratik i duhet institucioni i armatës. Kosovës i mungon forca ushtarake, e cila do të krijonte siguri dhe mundësi integruese e bashkëpunuese në sferën e sigurisë dhe roleve tjera. Për këtë proces kërkohen edhe ndryshime kushtetuese e ligjore përkatëse. Në fudvitin 2012 nuk parashihet transformimi i FSK-së në institucionin ushtarak të Republikës së Kosovës. Autoritetet vendase deklarojnë se gjatë vitit 2013 pritet të dalin me rekomandime për ndërtimi e kapaciteteve të ushtrisë së Kosovës. Krijimi i ushtrisë së Kosovës është veprim i domosdoshëm, ngase është institucion i domosdoshëm për tu përballur më kërcënime dhe rreziqe. Pra, ky institucion tejet i rëndësishëm i mungon Republikës së Kosovës. Andaj, institucionet relevante dhe lidërshipi, shoqëria civile, me faktorin ndërkombëtar me ndikime pozitive, duhet ta konsolidojnë këtë institucion të sigurisë vendore, rajonale e globale.

Policia e Kosovës

Me sukses të veçantë u konsolidua Policia e Republikës së Kosovës. Trajnimet dhe mbështetja ndërkombëtare që nga viti 1999, këtë institucion e ka aftësuar për ruajtjen e rendit dhe sigurinë publike. si forcë profesioniste, përbërja e se cilës e pasqyron shumëllojshmërinë etnike. Mbikëqyret nga institucionet kryesore politike dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme. Me nenin 128, të Kushtetutës parashihet që:

“Kryeministri emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës me rekomandimin e Qeverisë dhe në pajtim me ligjin. Organizimi i brendshëm i Policisë së Kosovës, rregullohet me ligj.”(Neni 128, pika 3) [Policia e Kosovës] Ka zinxhirë të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë. Policia e Kosovës lehtëson bashkëpunimin me autoritetet komunale dhe udhëheqësit e bashkësive përmes themelimit të Këshillave Lokale: „Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare.”(Kushtetuta 2008, Neni 128) [Policia e Kosovës] Organizimi dhe veprimtaria e saj është rregulluar me ligj në mars 2012. (Ligji nr.04/L-076)

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

Organ më rëndësi që zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë së Republikës së Kosovës, është Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), e cila duhet të jetë profesioniste, politikisht e paanshme, shumetnike dhe e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar me ligj. „Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku e emërojnë Drejtorin, Zëvendës drejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Kualifikimi dhe mandati, rregullohen me ligj.” (Kushtetuta 2008, Neni 129) Kjo agjenci ka për detyrë ligjore t’ë informojë Presidentin dhe Kryeministrin për kërcënimet eventuale të vendit. (Ligji për AKI/ L. nr.03/L-063)

Autoriteti Civil i Aviacionit

Autoriteti Civil i Aviacionit të Republikës së Kosovës është organ i cili rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është afrues i shërbimeve të

navigacionit ajror. Është konstituuar dhe vepron sikur është përcaktuar me ligj. “Autoriteti Civil i Aviacionit bashkëpunon plotësisht me autoritetet relevante ndërkombëtare dhe vendore, të përcaktuara me ligj.” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Neni 130) [Autoriteti Civil i Aviacionit]

Gjendja e Jashtëzakonshme

Kur ka nevojë për masa emergjente, nga rreziqet e brendshme ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike, fatkeqësi natyrore, etj., Presidenti i Republikës, sipas kompetencave që ka, shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme. Është me rëndësi që:

2. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave nuk mund të ndryshohet. Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me këtë nen. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Neni 131.2) [Gjendja e Jashtëzakonshme]

Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Kryeministrin, shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme. Ai njëkohësisht shpall dekretin, i cili përcakton natyrën e kërcënimit dhe çfarëdo kufizimi për të drejtat dhe liritë ku “Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë, as efekt.” (Kushtetuta 2008, Neni 131.6) [Gjendja e Jashtëzakonshme] Pra, Kuvendi në këtë vendimmarrje ka rol dhe përgjegjësi të veçantë:

6. Kuvendi mund të vendosë kufizime të tilla, sipas nevojës, për sa i përket kohëzgjatjes dhe shkallës së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Kur Presidenti konstaton se rreziku ndaj Republikës së Kosovës është i natyrës së jashtëzakonshme, Kuvendi mund të vendosë që Gjendja e Jashtëzakonshme të zgjasë më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, vetëm nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit. 7. Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme. (Kushtetuta 2008, Neni 131) [Gjendja e Jashtëzakonshme]

Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme ushtron funksionet ekzekutive në rrethanat e jashtëzakonshme sipas ligjit, i cili drejtohet

nga Presidenti i Republikës së Kosovës.(Ligji nr. 03/L-050) Ky Këshill është i obliguar të bashkëpunojë ngushtë me Qeverinë, Kuvendin dhe më misionet ndërkombëtare në Republikën e Kosovës. Roli i misionëve ndërkombëtare mbi sigurinë në Republikën e Kosovës dhe raportin më institucionet e sigurisë dhe më institucionet në Kosovë, është konkretizuar në Programin e Partneritetit të NATO-s për Paqë në Kosovë. (Vrajolli & Kallaba, prill, 2012)

5.5. Vetëqeverisja komunale

Qeverisja lokale si formë e decentralizimit, paraqet njërin ndër parimet më esenciale dhe të domosdoshme të qeverisjes demokratike; për shërbime më cilësore publike, rritje të qëndrueshme ekonomike dhe zhvillim të të gjitha sferave publike e private. Qeverisja lokale dhe decentralizimi në Kosovë, njësi bazë ka komunat, të cilat gëzojnë një shkallë të lartë të vetëqeverisjes locale. Komunat po gëzojnë shkallë të lartë të qeverisjes lokale në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale dhe po sigurojnë pjesëmarrje e nevoja të të gjithë qytetarëve. „Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.” (Kushtetuta 2008, K-X, Nenin 123.4 & Ligji Nr. 03/L-072)

Komunat kanë të drejtë për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar në fushat e kompetencave të tyre vetjake dhe të zgjeruara.

3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Neni 124.p.3-7)

Në Kosovë qeverisja lokale po i arrin në praktikë këto efekte: a) Po ofron mundësinë për pjesëmarrje më të drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjet për çështje me interes publik lokal. b) Po u ofron qytetarëve dhe organeve lokale përgjegjësi, obligime dhe detyra. c) Po u ofron qytetarëve shërbime publike më efikase, më cilësore dhe vlera përkatëse për çështjet lokale. ç) Po u mundëson qytetarëve më shumë transparencë, kontroll dhe kërkim të llogaridhëniës e përgjegjësisë së Qeverisjes lokale. d) Po ngrit aktivitetin pjesëmarrës të qytetarëve në procese. e) Po rrit kapacitetet e resurseve qeverisëse e administrative lokale. ë) Po pengon politikat centraliste, dhe pasojat e politikave të tilla. h) Po krijon parakushte e hapësirë për liri, barazi, afirmim e përfaqësim të komuniteteve etnike pakicë. i) Po mundëson rritje ekonomike dhe zhvillim të të gjitha sferave publike e private në nivel komunal. Siguron dhe lehtëson realizimin e balancimit të zhvillimit rajonal ekonomik të vendit, në infrastrukturë, etj. j) Po lehtëson bashkëpunimin ndër komunal, regjional të komuniteteve dhe liberalizon bashkëpunimin me komunat e vendeve fqinje. Pra, po përgatit dhe lehtëson proceset, sferat dhe nivelet integruese. Po ngrit mirëqenien, cilësinë e jetesës, alternativat dhe kulturë me vlera përkatëse. g) Po rrit mundësitë për Sundimin e ligjit, demokracinë, reformimin e administratës, lirinë dhe të drejtat e njeriut dhe, në veçanti respektimin dhe sigurinë e të drejtave të komuniteteve.

Qeverisja komunale në aspektin rregullativ juridik paraqet avancim të qeverisjes demokratike sipas formave më liberale të decentralizimit, sipas standardeve e praktikave evropiane të qeverisjes lokale. Kapitulli i X, përcakton:

Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues. (Kushtetuta 2008, Nenin 123,p.4) [Parimet e Përgjithshme]

Kjo është kërkesë nga qytetarët dhe komunitetet etnike të Republikës së Kosovës, për zhvillim e prosperitet për të gjithë. Kjo zgjidhje juridike po realizohet me sukses, ngase:

Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në afrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Neni 123, p.4 [Parimet e Përgjithshme])

Për të realizuar të gjitha këto të drejta e qëllime për interesin lokal, janë rregulluar e funksionalizuar edhe Kompetencat komunale të parapara me Kushtetutë, në:

a. Zhvillimi lokal ekonomik; b. Planifikimi urban dhe rural; c. Përdorimi dhe zhvillimi itokës; d. Implementimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve të kontrollit të ndërtimit; e. Mbrojtja lokale e mjedisit; f. Afrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes locale. (Neni 3. p.1) [Kompetencat komunale]

Autoritetet qendrore në Kosovë delegojnë përgjegjësi te komunat si Kompetenca të deleguara komunale vijuese:

a. Regjistrat kadastror; b. Regjistrat civilë; c. Regjistrimi i votuesve; d. Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve; e. Shpërndarja e pagesave të ndihmës sociale (duke përjashtuar pensionet) dhe f. Mbrojtjen e pyjeve. (Kushtetuta 2008, Neni 5.p.2) [Kompetencat e deleguara komunale]

Aktivitetet komunale në vendimet dhe aktet ligjore në fushat e kompetencave të tyre vetjake do të rishqyrtohen nga autoriteti mbikëqyrës administrativ në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjin në fuqi. Sipas Kushtetutës kjo bëhet nga ana e shqyrtimit administrativ të akteve komunale:

Autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kërkojë nga komuna që të rishqyrtojnë vendimet apo aktet tjera ligjore që konsiderohen se janë në mospërputhje me Kushtetutën apo ligjet e miratuara në pajtim me këtë zgjidhje...autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kundërshtojë vendimin apo aktin tjetër ligjor në gjykatën e qarkut kompetente për territorin e komunës. Gjykata e qarkut, si masë të përkohshme, mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të vendimit të kontestuar apo aktit tjetër ligjor...autoritetet qendrore mund të shqyrtojnë përshtatshmërinë e vendimit komunal të dhënë apo të aktit tjetër, krahas pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje dhe, së këndejmi, mund të pezullojnë, modifikojnë apo zëvendësojnë, sipas nevojës, ekzekutimin e vendimit komunal. (Neni 6.) [Shqyrtimi administrativ i aktiviteteve komunal]

Vetëqeverisja lokale komunale po i kryen me sukses funksionet e veta të rregulluara edhe më ligj, (Ligji Nr. 03/L-040) pos komunave veriore.

Kreu V:Konsolidimi i institucioneve dhe efektet qeverisëse

Faktorët

Procesi i qeverisjes ishte ballafaquar me kushte e rrethana të pavolitshme: pengesa të jashtme; mungesë të traditës demokratike plurale; nivel të ultë të zhvillimit ekonomik dhe ambient biznesor të papërshtatshëm; vonesë në reformat e tranzicionit; përqendrim të pushtetit mbi burimet dhe sektorët ekzistencialë; dukuri negative në institucione; mungesë të opozitës së mirëfilltë; etj. Të gjitha këto rrethana, shkaqe dhe pasoja, ndikuan drejtpërsëdrejti në karakteristikat dhe efektet institucionale e qeverisëse 2008-2012. Qeverisja dhe institucionet kishin obligim kushtetues e ligjor të ballafaqohen me këto kushte e sfida të papërshtatshme për qeverisje demokratike dhe t'i shndërrojnë ato në kushte e rrethana të përshtatshme. Ky ishte misioni konsolidues i procesit dhe sistemit demokratik të qeverisjes në Kosovë, i cili arrihej me fuqizimin e kushtetutshmërisë në qeverisje dhe sundimin e ligjit si parakusht primar. Qeverisja përmes institucioneve të pavarura dhe zbatimit të së drejtës krijoi siguri dhe rend. Por, cilësia dhe efektet nuk ishin të knaqshme e të mjaftueshme në shum sektor. Edhe pas shpalljes së Pavarësisë vazhdoi përzierja e Serbisë në Kosovë-veçmas në Veriun e saj. Mungesa e zhvillimit të sferave biznesore private ka ndikuar që përqendrimi i pushtetit mbi burimet ekzistenciale të jetë i lartë. Uzurpimi i partive politike dhe i institucioneve nga grupe të interesit dhe të presionit, korrupsioni i lartë, kontrabanda dhe informaliteti, lidership me elemente autoritare, ishte vazhdimësi nga qeverisja e kaluar. Edhe shoqëria civile ishte në hapat e parë të konsolidimit. Votuesit ende nuk ishin të përcaktuar sa duhet për qeverisje të mirëfilltë demokratike. Mungesa e forcave opozitare, mungesa e diferencave programore e qëllimore të partive politike, mediet jo sa duhet analitike e të pavarura, ndikuan në nivelin e sundimit të ligjit, rendit dhe në efektivitetin e sistemit politik e juridik, pas pavarësisë..

5.1. Sundimi i ligjit

Politika konstitucionale kosovare ka përcaktuar zgjidhje kushtetuese e ligjore për të arritur efektet e caktuara qëllimore të qeverisjes. Këto zgjidhje kushtetuese e ligjore përcaktojnë rend dhe stabilitet, shtet të së drejtës, veçmas kur ato zbatohen në mënyrë efektive në praktikë. Si të tilla, ato po pengojnë arbitraritetin në proces të vendimmarrjeve dhe gjatë procesit të qeverisjes. Aspekti kushtetues i trajtuar në Kreun e kaluar dhe legjislacioni në përgjithësi, po luajnë rol përcaktues dhe janë mjete kryesore juridike që po përcaktojnë juridikisht rendin juridik në Republikën e Kosovës.

Përcaktimet kushtetuese parimisht janë të plota e jo kundërthënëse. Sipas rendit juridik, Kosova ka një sistem kushtetues e institucional të konsoliduar. Kosova si shtet unik, republikë parlamentare, sistem zgjedhor proporcional, pluralitet partiak, balancim të pushteteve, gjykatë kushtetuese, me qeverisje të avancuar lokale në nivelin komunal, etj., konsiderohet sistem qeverisës i përshtatshëm demokratik për shoqërinë dhe proceset aktuale. Ligjet dhe aktet e tjera juridike janë në pajtim me Kushtetutën dhe pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta; Republika e Kosovës po e respekton të drejtën ndërkombëtare; secili person dhe organ në Republikën e Kosovës po u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës. Por, zbatimi i tyre nuk është i efektshëm, kërkohej përkushtim institucional dhe legjislacion sekondar zbatues sipas kushteve e rrethanave specifike në proceset dhe sferat konkrete. Edhe Raportet e progresit për Kosoven 2010-2012, e theksojnë se ka nevojë të krijohen mekanizma plotësues e legjislacion sekondar për zbatim dhe implementim të qëllimeve të Kushtetutës, në funksion të zbatimit e konsolidimit të politikave (KE: *Raporti i Progresit, për Kosovën*, 2012)

Sistemi parlamentar me rendin kushtetues e ligjor në Kosovë nuk është pengesë për cilësinë qeverisëse, sadoqë gjatë procesit dhe shfaqjes së pengesave e dukurive dalin nevoja për amendamentim. Pengesë e efektivitetit qeverisës është niveli i ultë i zbatimit të tij. Pra, ka nevoj që legjislacioni ekzistues të plotësohet për të arritur implementim-zbatim në pajtim me parimet e zgjidhjet kushtetuese e ligjore të rendit juridik. Pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare,(2010) duhej ndryshuar e përshtatur zgjidhjet juridike, por gjithmonë duke qenë të kujdesshëm dhe të matur për të ruajtur parimet e demokratie. Pas Pavarësisë (2008) u arritën suksese konkrete në konsolidimin institucional e juridik të qeverisjes, por kërkohet zbatim më efikas, më cilësor e më efektiv i rendit juridik e politik, veçmas në luftimin e dukurive negative në institucione dhe në zhvillimin e qendrueshmë ekonomik. Për rezultatet e arritura dhe tejkalimin e dukurive negative, si dhe identifikimin e politikave të qeverisjes më të hapur në Republikën e Kosovës, Forum 2015 & KFOS, ndër të tjera konstaton:

Në lidhje me rritjen e llogaridhënies dhe të integriteti publik, janë aprovuar disa ligje si: ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve publikë, ligji për mbrojtjen e informatorëve dhe ligji për prokurimin publik. Ligji për financimin e partive politike dhe konfliktin e interesit duhet të përmirësohen edhe më. Zbatimi i plotë i këtij legjislacioni është sfidë për institucionet e Kosovës në të ardhmen, ndërsa korrupsioni është shqetësimi kryesor i shoqërisë..⁹⁵ (Forum 2015 - projekt operacional i KFOS,2013:76)

Esenciale në konsolidimin demokratik të qeverisjesiste sundimi i ligjit, i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë në funksionimin dhe veprimtarinë e të gjitha institucioneve. Sundimi i ligjit ishte kriteri themelor i vlerësimit të cilësisë demokratike të qeverisjes dhe institucioneve; ishte garanci kundër vendimmarrjeve arbitrare dhe kundër anarkisë e papërgjegjësisë, si dhe faktori kryesor i sigurisë, i efektivitetit institucional

qeverisës dhe i zhvillimit. Por, efektiviteti i gjyqësorit dhe policisë hetuese nuk ishte i mjaftueshëm në trajtimin e korrupsionit të lartë dhe krimit të organizuar. Kjo mungesë e ka damtuar më se shumti sundimin e ligjit në Kosovë. Kjo ka ndodhë ngase, institucionet për sundimin e ligjit vuanin nga ndikimi politik. Gjykatësve e prokurorëve u ka munguar siguria dhe përkrahja adekuate, dhe nuk kishte masa disiplinore e zhgarkim për joefikasitet. Presioni politik dhe pasiguria i pengonte gjykatësit dhe prokurorët vendorë për të vepruar mbi rastet e korrupsionit të lartë. (Agjencioni Kundër Korrupsionit: *Raport vjetor: Janar-dhjetor 2012*) Hezitimi i institucioneve për të luftuar korrupsionin, ndikimi politik në organet e ndjekjes dhe në sistemin e drejtësisë, e ka deformuar thellësisht sundimin e ligjit. Besimi se qeveria dhe gjyqësori do të luftojnë korrupsionin është i ulët. Qytetarët pranojnë ekzistimin e korrupsionit zyrtar, dhe ata nuk i besojnë zyrtarëve qeveritarë e liderve, që do të luftojnë atë në mënyrë të besueshme. (Transparency International, *Global Corruption Barometer 2013: Kosovo*,) Si rezultat i këtij opinioni dhe jobesimit të publikut, po bie edhe gadishmëria e luftimit të korrupsionit në Kosovë.

Mungesa e përvojës së mjaftueshme për të zënë hapin e zhvillimit të demokracisë së konsoliduar dhe reformave të tranzicionit ishte shumë evidente. Demokracia kosovare kishte nevojë për më shumë kohë dhe përvojë. Politika kontrollohej nga grupe të ngushta elitash të cilat vendosin për proceset politike, për ekonominë dhe sferën publike. Ekziston një përqendrim i pushtetit mbi burimet e pakta ekzistenciale publike dhe jozhvillim i sferës private në prodhim e shërbime. Andaj, pjesëmarrja e pavarur qytetare në politikë për qeverisje demokratike, është e vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Institucionet dhe aspekti juridik janë të pamjaftueshme për ekzistencën e demokracisë liberale, pa një shoqëri të pavarur me zhvillim ekonomik privat të përbërë nga një varg grupesh

‘diagonale’ të interest dhe pa përvojë e kulturë demokratike të implementuar në shumë nivele, pa njohuri kognitive të votuesit, pa zhvillim ekonomik të biznesit privat ku shumica e qytetarëve mund të gjejnë ekzistencën materiale dhe ushtrimin e punës profesionale, etj., ishte veshtirë të krijohej qendrueshmëri demokratike qeverisëse. Si rezultat i këtyre rrethanave, demokracia kosovare 2008-2012, rrezikohej të degjenerojë në autoritarizëm, arbitraritet dhe anarki. Dukuritë negative vazhduan të jenë evidente në institucionet kosovare, edhe pas pavarësisë. Edhe sundimi i ligjit në qeverisje dhe në të gjitha sferat, ishte në hapat e parë. Por, mu qeverisja efektive demokratike duhej ta tejkalojë këtë gjendje përmes fuqizimit të ligjit dhe rendit juridik, edhe pse kishte vështirësi të mëdha implementuese.

Fukuyama, duke analizuar forcën dhe aftësinë e institucioneve në rolin e forcimit të ligjit e shtetëndërtimit, propozonte reduktimin e shtrirjes së tepruar të shtetit dhe pushtetit në sferën shoqërore e ekonomike. Ai theksonte se forca e institucioneve përfaqëson:

aftësinë për të formuluar dhe zbatuar politika dhe aprovuar ligje; për të administruar siç duhet dhe me minimumin e burokracisë; për të kontrolluar ryshfetin, korrupsionin dhe mitdhënien; për të pasur një nivel të lartë transparence dhe përgjegjshmëri në institucionet qeveritare dhe më e rëndësishmja, për të zbatuar ligjet. (2010:33)

Ai theksonte se, ka pasur keqkuptime rreth reduktimit të shtetit. Ky reduktim dhe jo shtrirje e shtetit duhet të ndodhë në raport me ligjesit ekonomike, e jo të dobësohet shteti-institucionet dhe qeverisja në tërësi, veçmas sundimi i rendit dhe i ligjit. Për shkak të kësaj të fundit, në vendet në zhvillim dhe në vende të tranzicionit, pra edhe në Kosovë, ka ndodhur dështim në reformat dhe objektivat e liberalizimit të ekonomisë, thekson ai. Reformat në disa vende të tranzicionit e edhe në Kosovë, pa forcimin e institucioneve në sferën e sundimit të ligjit, i kanë sjellë në situatë akoma më të keqe shumë sfera. Ai theksonte se „në disa vende, mungesa e kuadrit të duhur institucional i la pa e zbatuar fare

atë,[reformën ekonomike- A. Sh.] Problemi qëndron në dështimin konceptual themelor për të ndarë dimensionet e ndryshme të shtetit dhe për të kuptuar se si lidhen ato me zhvillimin ekonomik’’ (Fukuyama, 2010, 29) E tërë kjo në njëfarë mase, po ndodh edhe në Kosovë; kjo ka ndodhur edhe nga ’’mungesa e kuadrit të duhur institucional.’’ Qeverisja kosovare duhej të fokusohet kryesisht në sundimin e rendit, ligjit dhe infrastrukturës publike në njërën anë, dhe liberalizimin ekonomik në anën tjetër. Pa konkurrencë e liberalizim të mirëfilltë e zhvillimi ekonomik, nuk ka as konsolidim e stabilitet qeverisëse demokratik, por edhe pa sundimin e ligjit nuk mund të arrihen asnjëra. Edhe stafi cilësor institucional shpesh herë i ka munguar institucioneve dhe qeverisjes, si rezultat i dukurive negative dhe diferencimit negativ të kuadrove që bënin politikën e deformuara partiake për interesa të ngushta grupore e keqpërdoruese.

Dështimi në sundimin e ligjit u konfirmua disa herë edhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Këto Raporte evidentojnë dhe konstatojnë dështimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ku theksohet se, politika dhe Drejtësia mbeten ende të pafuqishme. (KE: Raporti i Progresit, për Kosovën, 2012) Në hulumtimin e opinionëve dhe perceptimeve të qytetarëve del se drejtësia është e korruptuar dhe e paafte, e lidhur me politikën grupore nepotiste e keqpërdoruese. Këtë konstatim e thonë edhe vetë zyrtarët. (Transparency International, dhjetor/2012; Agjensia Kosovare Antikorrupsion, Raportet 2010-2012) Sistemi i drejtësisë duhej filluar nga vetja dhe denimi i grupeve keqpërdoruese në pushtet e institucione. Sipas Raporteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sistemi gjyqësor është me një efikasitet të ulët, me siguri të ulët dhe me buxhet të ultë. Në këtë gjendje e ka vështirë të korrë rezultate në sundimin e ligjit. (KGJK, shtator 2009)

Pavarësia, efikasiteti dhe rezultatet e gjyqësorit janë të vështira si rezultat i shumë rrethanave. Zgjidhjet juridike e procedurale për emërtimin e prokurorëve e gjyqtarëve ende nuk po e sigurojnë pavarësinë e duhur. Filli i ndikimit negativ të politikës në gjyqësor rrjedh nga fakti se udhëheqjet partiake dhe lidhshipi i tyre janë të korruptuara dhe po i uzurpojnë institucionet legjislative dhe ekzekutive. Kjo po u mundëson ndikimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në gjyqësor dhe në situatën e tërësishme të sigurisë, dhe në cilësinë qeverisëse. Grupet e korrupsionit të futura në institucione, nuk i krijojnë mbështetje e siguri gjyqësorit. Pasiguria është një fakt i mospasurës së gjyqësorit kundër këtyre dukurive, ndoshta njëri ndër shkaqet kryesore. Aspekti juridik e ka të rregulluar pavarësinë e këtij pushteti, por një tolerancë reciproke ekziston për t'i mbrojtur dukuritë negative dhe bartësit e tyre në të dyja anët.

Përkrahja ndërkombëtare në fushën e sundimit të ligjit vazhdoi edhe pas shpalljes së Pavarësisë. Këtë e parashihte edhe Plani i Ahtisarit:

13.1 Bashkimi Evropian do të themelojë Misionin Evropian për Politikë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (MEPSM).

13.2 MEPSM-ja do t'i ndihmojë autoritetet kosovare në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë dhe në zhvillimin e fuqizimin e mëtejshëm të gjyqësorit të pavarur, shërbimit policor dhe doganor, duke siguruar se këto institucione veprojnë jashtë ndikimit politik dhe në pajtueshmëri me standardet e pranuar ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë evropiane.

13.3 MEPSM-ja do të përkrahë implementimin e kësaj zgjidhjeje dhe do të ofrojë këshillim, monitorim dhe njoftim në fushën e sundimit të ligjit në përgjithësi, duke mbajtur autoritete të caktuara, në veçanti sa i përket gjyqësorit, shërbimit policor, ati doganor dhe korrektues, nën modalitetet dhe përgjatë një periudhe kohore të përcaktuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian. (Plani i Ahtisarit, 2007, p.13.1-2)

Ky bashkëpunim vazhdoi edhe pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare. Në një Raport të Gjykatës Europiane të Auditorëve, konstatohet se angazhimi i BE-së nuk ka dhënë rezultate në sundimin e ligjit. Si shkaqe konsiderohen “mungesa e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, mos koordinimi i duhur mes EULEX-it dhe Zyrës së BE-së, numri i vogël i gjykatësve dhe prokurorëve vendorë në Kosovë” (GJEA, 2012:4) si dhe konstaton se „situata lidhur me krimin e organizuar nuk ka

ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme që nga ardhja e Bashkësisë Ndërkombëtare në vitin 1999.” (GJEA,2012:4) Efektet i ka penguar edhe mosnjohja e Pavarësisë së Kosovës nga 5 vende të BE-së. Deklarimet e BE për mos liberalizimin e vizave e lidhin drejtpërsëdrejti me mos luftimin e korrupsionit dhe mos vullnetin politik i institucioneve kryesore të vendit, për ta luftuar këtë dukuri dhe dukuritë tjera negative.

Ky jo prioritet dhe jo efikasitet i Qeverisë dhe institucioneve tjera për ta luftuar korrupsionin në institucionet e larta, vjen nga fakti se bartësit e dukurive negative janë nga vetë përfaqësuesit e lartë të institucioneve dhe subjekteve politike. Faktor tjetër është edhe bashkëpunimi jocilësor në mes të autoriteteve të Kosovës dhe BE-së, si dhe mos koordinimi i vet faktorit ndërkombëtar sa i përket efikasitetit për sundimin e ligjit. Për ta ndryshuar gjendjen u themelu Strategjia përfundimtare në mes të Qeveria, zyra e BE-së dhe EULEX-i. (dhjetor 2012) Këto dukuri i konstaton edhe Presidentja: “Nuk ka angazhim e bashkëpunim cilësor ndërmjet policisë hetuese dhe prokurorisë.” (Jahjaga, A., *Lufta kundër korrupsionit*, 21.12.2012:2)

Edhe shoqëria civile dhe mediet kohëve të fundit duken më aktive dhe më të vendosura në kontributin dhënë sundimit të ligjit. Por, mosfunksionimi i hallkave tjera edhe këtë angazhim e ka topitur. Edhe opozita nuk është e mirëfilltë, ngase disa parti opozitare sa ishin në pushtet, por edhe tani në opozitë, nuk po i luftojnë dukuritë negative, sepse disa nga udhëheqjet dhe militantët e tyre janë të përfshirë në këto dukuri. Lufta e tyre kundër dukurive negative të shumica e subjekteve partiake dhe lidërshipt të tyre është në nivelin deklarativ e manipulues, por jo në rrafshin dhe angazhimin faktik.

Edhe mungesa e kapaciteteve të EULEX-it, i cili karakterizohet me staf jo edhe aq të kualifikuar, me mandate të shkurta, ka mundësi edhe të korrupsionit brenda tyre si rezultat

i kontrollit të ultë ndaj tyre, etj., nuk ka treguar sukses për një kohë të gjatë. Në pjesën Veriore të Kosovës ky mision nuk ishte funksional sa duhet, për shkak të përzierjes së strukturave të shtetit serb, (GJEA: Raportin special 2012) si dhe qëndrimeve toleruese ndaj tyre nga misionet ndërkombëtare në Kosovë dhe nga jashtë. Misioni i EULEX-it, për luftimin e veprave të korrupsionit dhe krimit të organizuar, do përkrahej fuqishëm nga qytetarët, por rastet e tilla të ndjekjes janë të rralla dhe dështuese gjatë procesit gjyqësor. Ndërsa, kur ngrihen dyshime e aktakuza ndaj bartësve të Luftës, kemi dyshime, protesta dhe kundërshti nga qytetaret, ngase mendojnë se janë të motivuara politikisht, Qytetaret kanë vrejtje se ky Mision nuk ngrit aktakuza kundër bartësve serbë të krimeve e gjenocidit ndaj popullatës kosovare para dhe gjatë luftës, ndërsa dyshimet ndaj disa udhëheqësve të Luftës së UÇK-së, nuk janë të argumentuara sa duhet nga pala akuzuese. Andaj, një pjesë e madhe e qytetarëve këto akuza i konsideron si të motivuara politikisht.

Në nëntor 2012 u nënshkrua Marrëveshja për fuqizimin e sundimit të ligjit në mes Qeverisë, Zyrës së BE-së dhe EULEX-it, mbi objektivat e përbashkëta deri më qershor 2014. Në këtë marrëvesh kryesisht, flitet për fuqizimin e sundimit të ligjit. Për ta fuqizuar sistemin e drejtësisë, ceken 12 pika të bashkëpunimit. Disa nga kryesoret janë: forcimi i Policisë, i Doganave dhe ngritja e nivelit të pavarësisë së tyre nga ndërhyrjet e politikës. Marrëveshja parasheh fuqizim të kapaciteteve në këta sektorë dhe sundimin e rendit e ligjit për forcimin e sigurisë. Përkrahje ka edhe në aspektin material e financiar, p.sh. BE-ja ndau 63 milionë për ndërtimin e objektit të Ministrisë dhe gjykatave në Prishtinë. Qëllimet e këtij bashkëpunimi janë krijimi funksional i një sistemi të drejtësisë, i cili nuk

guxon të jetë i lidhur me asnjë parti politike apo grup të interesit ekonomik.⁹⁶
(Ministria e drejtësisë, 2012)

Kosova në këtë periudhë të konsolidimit institucional mund të ishte e suksesshme në sundimin e ligjit, rendit dhe sistemit juridik, po t'i konsolidonte parakushtet për zgjedhje demokratike, me ushtrimin më të suksesshëm të pushtetit dhe kontrollit parlamentar, me formacione ekzekutive kompetente e më përgjegjëse, dhe me instalimin e një gjyqësori të pavarur nga politika e korruptuar. Këto parakushte kanë filluar të konsolidohen gjatë këtyre katër viteve pas pavarësisë. por kërkohej cilësi dhe efikasitet më i madh në sundimin e ligjit, rendit juridik e politik në të gjitha veprimtaritë e institucioneve dhe në raportet në mes tyre, dhe rrjedhimisht në sferat tjera të shoqërisë kosovare. Konsolidimi i qeverisjes së mirë në: sundimin e ligjit, kontrolli ekzekutiv, qeverisja financiare, transparenca e përgjithshme, përfaqësimi, mbikëqyrja parlamentare dhe efikasiteti gjyqësor, ishin domosdoshmëri për zhvillimin institucional demokratik.

Në një hulumtimin për gjendjen në Sektorin e sigurisë në Kosovë, të ndërmarr gjatë periudhës trevjeçare (2009-2011) konstatohet:

Spektori i sigurisë në Kosovë është në fazë të hershme të zhvillimit ngase arkitektura e plotë e sigurisë filloj së ndërtuari vetëm pas fillimit të vitit 2008 e këndej. Megjithatë, brenda kësaj periudhe kohore një progres i konsideruar është arritur në aspektin e reformimit të disa institucioneve që ishin themeluar në periudhën menjëherë të pas-luftës (Policia e Kosovës) si dhe u konsoliduan institucionet e reja që u ndërtuan nga zeroja (Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë). Zhvillimi institucional i sektorit të sigurisë ishte kompleks duke pasur parasysh sfidat politike dhe problemet në njohjen e shtetësisë së Kosovës; trashëgimia e sistemit socialist dhe në veçanti trashëgimia e pjesëtarëve të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë (UÇK) që kanë influencuar në masë të madhe sektorin e sigurisë; roli i madh i bashkësisë ndërkombëtare që jo-gjithherë ishte i mirëfilltë si dhe problemet e tjera të brendshme. (Floian Qehaja- KCSS-QKSS , 2012, 4)

Sundimi i ligjit, i rendit dhe i sistemit juridik në gjithë strukturën e procesit qeverisës, në të gjitha institucionet e nivelet, do të ndikonte drejtpërsëdrejti në arritjen e një ndjenje

të sigurisë; do të ndikonte në zhvillimin dhe stabilitetin ekonomik dhe njëkohësisht do të ndikonte edhe në rindërtimin e një sistemi vlerash të përbashkëta për të tejkaluar një gjendjen; do të krijonte një optimizëm të bazuar, i cili është më se i domosdoshëm për shoqërinë kosovare. Politikat qeveritare përmes liberalizimit dhe politikave ekonomike të suksesshme, arsimimit cilësor të popullatës, integritit, stabilitetit politik, vlerave demokratike, etj. do të krijonte ambient të përshtatshëm biznesor. Kjo do të arrihej nëse seriozisht luftohen dukuritë negative në institucione. Edhe përkrahja më këmbëngulëse nga institucionet rajonale e globale në procesin integruar e afirmim të mëtejshëm ndërkombëtar të Kosovës, duhej të ishte më e vendosur dhe më urgjente.

Procesi i transformimit të shoqërisë, qeverisjes dhe efikasitetit të institucioneve, cilësohet si faktori esencial i tejkalimit të së kaluarës dhe pasojave të saj. Aspekti juridik është thelbësor, por implementimi përmbajtësor po varej edhe nga tradita, kultura, ekonomia, transparenca, motivimi i qytetarëve, etj., të cilat njëkohësisht duhet konsoliduar e përshtatur sa më pare proceseve aktuale demokratike. Rapoti i *Freedom House* për demokracinë në vendet e tranzicionit, thekson se këto vende janë gjithnjë e më shumë duke u sunduar nga qeveri autokratike. Në pjesën për Ballkanin, thuhet se korrupsioni në këtë rajon ka vazhduar të thellohet, pavarësisht presionit nga BE dhe institucionet ndërkombëtare për të forcuar pavarësinë e gjyqësorit. Gazetarët që mbulojnë pasqyrimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, përballen me presion politik, kërcënime dhe sulme. Sipas këtij hulumtimi, përpos dukurive të lartëpërmendura, në Kosovë kanë shënuar rënie edhe kushtet për shoqërinë civile. Raporti thekson se “Kosova ka shënuar përmirësime në vitin 2011, si rezultat i reformave gjyqësore...ngjarjet më 2012

kanë sugjeruar se këto ndryshime nuk kanë adresuar dobësitë themelore në sistemin gjyqësor të vendit.” (Freedom House,2013)

Mungesa e efikasitetit të institucioneve për një kohë të gjatë, krijoi rrethana të fuqizimit të grupeve e dukurive negative, të cilat depërtuan në struktura të udhëheqjeve partiake dhe në institucionet kryesore politike qendrore e lokale. Si të tilla, Këto grupe u ndërlidhën me disa nga grupet e biznesit, përfituan përmes dukurive negative: korrupsionit, privatizimit të manipuluar, keqpërdorimeve të parasë publike, duke u bërë uzurpuese të institucioneve dhe procesit qeverisës. Grupet e tilla u korruptuan gjatë procesit të manipuluar të privatizimit, keqpërdorimit të tenderëve dhe shpenzimeve buxhetore të qeverisë, nepotizmit dhe konflikteve të interesit (Agjensia Kosovar Antikorrupsion, *Raportet 2010-2012*) dhe nga fondet e donatorëve gjatë viteve 90. Ato depërtuan në subjekte politike ose të ndërlidhura me to, po i financojnë fushatat parazgjedhore për udhëheqjet partiake që favorizojnë dukuritë negative. Manipulojnë procesin zgjedhor dhe opinionin përmes medieve të varura dhe shantazheve. Sjellin lojalistët e tyre në institucionet kryesore dhe ato operative. Këto dukuri dhe bartësit e tyre po e pengojnë qeverisjen demokratike dhe po krijojnë jo legjitimitet e pasiguri.

Organizatat Ndërkombëtare monitoruese e hulumtuese të qeverisjes në Kosovë, për gjendjen e rëndë ekonomike dhe dukuritë në institucione, i bëjnë përgjegjës kryesorë bartësit e pushtetit P.sh. Ndër dukuritë më negative dhe më të dëmshme konsiderohen korrupsioni, krimi i organizuar, papunësia dhe varfëria. Në një hulumtim të UNDP-së, përmes hulumtimit të opinionit të qytetarëve të Kosovës, konstatohet se:

Më se 70% të qytetarëve e vlerësojnë të keqe politikën ekonomike, si rezultat i papërgjegjësisë së shumicës së drejtuesve politik. Në institucionet është i shprehur korrupsioni në dogana, gjyqësor, në korporatat publike, etj. Korrupsioni është i shprehur kryesisht në shpenzimet qeveritare dhe në tenderët investues të qeverisë. Si rezultat i kësaj, cilësia e punë kryerjeve është tejet e ulët. Administrata është e pa reformuar, jo efikase, e stërngarkuar dhe e politizuar. Përgjegjësinë kryesore për ngecjen e aspektit

ekonomik mbi 67% të qytetarëve e fajësojnë qeverisjen kosovare. Rreth 12% përgjegjës për jetën e rëndë ekonomike i bëjnë ndërkombëtarët. Shëndeti dhe mirëqenia vijnë si rezultat i papunësisë dhe ndjenjës së pasigurisë në punë. Rreth 45% të papunë në mesin e të rinjve është 73%, dhe në mesin e gjinisë femërore është 81%. Tregu i punës rritet çdo vit më 30.000 punëkërkes të ri. Papunësia dhe varfëria si rezultat i korrupsionit dhe mungesës së investimeve, paraqesin ndër dukurit tejet penguese për zhvillimin ekonomik të vendit... korrupsioni konsiderohet të jetë një sëmundje publike ... dhe një pengesë e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit ekonomik. Ndikon në mirëqenien e qytetarëve dhe promovim të pabarazisë si dhe në shëndetin e qytetarëve. (UNDP-Pulsi publik 2011)

Këto dukuri i theksojnë edhe Raportet e Progresit nga KE, Raportet nga FMN, BB, studimi i MSA-së 2011-2012 dhe nga shumë organizata tjera.

Dukuritë negative janë të theksuara, ngase vetë bartësit e pushtetit dhe institucioneve janë të përfshira në dukuri negative. Në Barometrin Global të Korrupsionit për 2010 të “Transparency International”, partitë politike janë identifikuar si fushë më e prekur nga korrupsioni në Kosovë dhe përpjekja e qeverisë për luftimin e tij vlerësohet tejet e paefektshme, ngase mungon vullneti politik. Kosovën këtë vit (2012) e renditi në vendin e 105-të në listën e shteteve më të korruptuara, kurse vetëm një vit më parë ishte në vendin e 112-të. Krahasuar me vendet e rajonit, Kosova i ka punët më së keqi me korrupsion, përpos Shqipërisë, që renditet e 113-ta në listë. (Transparency International, dhjetor/2012)

Edhe Raportet e *Freedom House* përmbajnë vlerësime të qarta mbi qeverisjen në Kosovë. Sipas tij, Kosova cilësohet si shtet me nivel të lartë të korrupsionit, sidomos në ndërmarrjet publike, ku dominon edhe punësimi në bazë të nepotizmit dhe një administratë publike të politizuar. Gjithashtu në këtë raport cilësohet si një vend me shkallë të lartë të ekonomisë informale dhe mungesë të kapaciteteve për ta luftuar atë. Funkcionimi i sistemit gjyqësor, i cili është qenësor për sundim të ligjit, cilësohet si jo i pavarur” (Raportet e *Freedom House*, Kosova sot, dhjetor 2012:2)

Sipas Barometrit Global të Korrupsionit nga "Transparency International",

66 % e të anketuarve në Kosovë mendojnë se niveli i korrupsionit është rritur në masë të madhe; kurse 26% prej tyre, mendojnë se ka mbetur i njëjtë. Ndërkaq, rreth 67% e të anketuarve konfirmojnë se korrupsioni në sektorin publik mbetet si një prej problemeve më serioze në vend. Fakt brengosës është

korupsioni edhe në sektorët kyç, ku Gjyqësori zë vendin e parë, partitë politike, shërbimet shëndetësore, Parlamenti, biznesi, sistemi i edukimit dhe shërbyesit civilë. Ndërkaq, sa i përket mitos, të anketuarit theksojnë se më së shumti kanë paguar mito në sektorin e Shëndetësisë 16%; sistemin gjyqësor 12 %, policinë 6%, shërbimet për regjistrim dhe dhënien e lejeve 4%, sistemin e edukimit dhe taksave 3%. Përceptimi qytetar për nivelin e korupsionit në Kosovë është në rritje. (Transparency International, dhjetor/2012)

Shefi i zyrës ndërlidhëse të Komisionit European në Kosovë, në përfundim të mandatit në një intervistë, vlerësoi se

Lufta kundër korupsionit, reformimi i sistemit zgjedhor, reforma e administratës publike, zhvillimi ekonomik i vendit, janë disa nga kushtet që duhet t'i përmbushin institucionet, nëse dëshirojnë që ta shpien vendin drejt integritit në BE...përveç institucioneve që kanë obligim të luftojnë korupsionin, duhet kujtuar se korupsioni është problem edhe i shoqërisë dhe i mentalitetit (Khalidun, gusht 2012:2)

Bartësit e nivelit të lartë të korupsionit janë të futur në institucione, andaj, edhe ndjekja penale e korupsionit nga agjencitë e zbatimit të ligjit, është e dobët dhe e ndërlikuar, si rezultat i ndërhyrjeve politike. Ky fenomen i theksuar dëmton buxhetin e shtetit, ekonominë dhe shoqërinë, duke i deformuar investimet publike, investimet dhe reformat në edukim e shëndetësi, pozitën materiale të punonjësve që financohen nga buxheti, fondet sociale, pensionet, vlerat, etj. Dukuritë e tilla pengonin donacionet dhe investimet e jashtme. Se sa është e dëmshme kjo dukuri, tregon edhe përshkrimi i gjendjes nga Ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, i cili në një fjalë rasti, para kuadrove të gjyqësorit kosovar, theksoi:

Asnjë afarist i arsyeshëm nuk do të dëshironte të investoj në një vend ku korupsioni bënë kërdrinë....Nëse partneret ndërkombëtar e dinë se vetëm elita politike do të përfitonte nga ndihmat ndaj Kosovës, e jo tërë qytetaria, atëherë ata do të zgjedhin që të dërgojnë fondet e tyre diku tjetër...Çrrënjësja e korupsionit, do të ofronte mundësi të njëjta qytetarëve dhe qasje të njëjtë në shërbimet publike...Të ardhurat shtetërore do të investoheshin në projekte dhe shërbime nga të cilat do të përfitonin të gjithë kosovaret, e jo të kanalizohen për të mbushur xhepat e politikanëve...Zyrtaret kosovarë dhe partitë politike janë aq shumë të ngatërruar në këtë dukuri,saqë, është e pamundshme të korrigjohet gjendja pa përpjekjet e tyre pozitive. (Dell, mars 2012)

Mënyrat dhe instrumentet e luftimit të dukurive negative të lart trajtuara janë të shumta. Si p.sh: krijimi i vlerave antikorrupsion të qytetarët; informacioni i drejtë dhe sa më i plotë; shoqëri civile të fuqishme; forcimin e kulturës mirë qeverisëse: qëndrimeve, sjelljeve e veprimeve antikorrupsion; krijimin i një fushate të fuqishme publicitare për të

rritur perceptimet të qytetarët mbi pasojat e korrupsionit dhe për mënyrat e zbulimit, lajmërimin dhe luftimin e tij përmes organeve përkatëse. Krijimin e një besueshmërie të qytetarët se kjo mund të arrihet. Përkrahje e organeve kompetente për zbulim, hetim dhe dënim. Ndëshkimin e subjekteve partiake e lidërshpin e tyre përmes votës dhe pengimin e vjedhjeve të votave nga ana e tyre. Pra, krijimin e vullnetit politik dhe vendimmarrjeve për luftimin e dukurive negative. Kornizë ligjore antikorrupsion sa më të plotë, të qartë e specifike dhe përmirësim të kuadrit e institucioneve për zbatim të ligjit. Ratifikimi, zbatimi dhe monitorimi i konventave e akteve ndërkombëtare antikorrupsion. Bashkëpunim me organet rajonale e ndërkombëtare për luftimin e këtyre dukurive.

Përmirësimi i institucioneve në përgjithësi, dhe i atyre që luftojnë korrupsionin në veçanti, ishin masa urgjente. Këtyre masave i nevojtej një staf me integritet moral e të guximshëm, me përkrahje të pakufizuar dhe të shumanshme. Formimi i institucioneve e organeve shtesë, të posaçme për sferat ku është e shfaqur kjo dukuri do ta kishte gjithmonë përkrahjen qytetare. Llogaridhënia dhe luftimi i kësaj dukurie brenda institucioneve të larta, e jo vetëm në nivelet e ulëta të korrupsionit, duhej të ishte orientim i qartë dhe i përhershëm. Kërkohej lidërshpi i ri, i ndershëm e opozitar në bashkëpunim me lidërshpin e gjertanishëm të pa kompromituar, ngase lidërshpiti me integritet, i afrohen dhe i afron gjithashtu stafin dhe kuadrin e tillë, dhe anasjelltas. Kërkohej shtimi i konkurrencës dhe liberalizimi i tregut, reduktim i rregullativit administrativ për veprimtari biznesore dhe tregti të lire, privatizim i mirëfilltë dhe shtim i konkurrencës në të gjitha sektorët. Pra, urgjentisht kërkohej shpejtim e thellim i reformave të tranzicionit. Kërkohehin medie plurale të përgjegjshme dhe informimi i pavarur, i guximshëm, i mbrojtur e i përkrahur për të mbledhur, analizuar, hulumtuar e publikuar informacion të

konsiderueshëm për dukuritë dhe për bartësit e pasojat e korrupsionit. Kërkohej presion dhe mbështetje nga jashtë, transparencë dhe kontroll i veçantë për investimet publike, për shpenzimet e qeverisë dhe të subvencioneve shtetërore, paga të larta shërbyesve civilë, dhe në veçanti stafit të organeve që luftojnë dukuritë negative, etj. Bashkimi dhe bashkërendimi i këtyre faktorëve dhe sferave kryesore, do të kishte rezultate në efikasitet dhe efekte më të larta të institucioneve. Të gjitha këto veprimtari në konsolidimin institucional 2008-2012, ishin prezente dhe kishin rezultatet dhe efektet e para, por nevojat, kërkesat dhe mundësitë ishin shumë më të mëdha dhe më urgjente.

Kërkoheshin ndryshime e angazhime të shumanshme, duke përfshirë edhe mentalitetin e përgjegjësinë e angazhimit qytetar. Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga në takimin e pestë përmbyllës të Këshillit Kombëtar kundër Korrupsionit, theksonte se:

Lufta kundër korrupsionit nuk është vetëm luftë e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe e mekanizmave ndërkombëtarë, por edhe angazhim i gjithë shoqërisë sonë dhe synon vendosjen e plotë të parimit të rendit dhe të sundimit të ligjit bazuar në ndërtimin e shtetit të së drejtës. Kjo luftë duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe transparente... një shoqëri me korrupsion të lartë në shoqëri, e dëmton jo vetëm shtetin nga brenda, por edhe në arenën ndërkombëtare. (Jahjaga, 21.dhjetor 2012:2)

Propozimet e këtij Këshilli parashohin se ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve dhe specializim në ndjekjen e veprave të korrupsionit, duke filluar nga mbledhja e informacioneve dhe profesionalizmi në ndërtimin e rasteve. Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet fuqizuar në rolin e prokurorive në ndjekjen e veprave korruptuese. Kapacitetet e Brendshme të Prokurorisë dhe gjyqtarëve duhet të shtohen sipas standardit të integritetit të lartë etik e profesional. KGjK të kërkojë prioritet për shqyrtimin e rasteve të korrupsionit të lartë në institucione. (KKK, dhjetor 2012) Pra, ky këshill kërkon rezultate konkrete dhe përgjegjësi përkatëse; kërkon reforma sistëmore dhe strukturore sipas praktikave e standardeve të Bashkimit Evropian; bashkëpunimin serioz dhe përmbajtësor me strukturat e BE-së, për çrrënjosjen e korrupsionit. (KKK: *Lufta kundër Korrupsionit*, 2012)

Luftimi i dukurive negative në qeverisje duke filluar nga bartësit kryesorë të pushtetit/institucioneve, ishte domosdoshmëri për të ndryshuar esencialisht procesin qeverisës. Pa luftimin e këtyre dukurive, nuk mund të ketë as rritje të GDP-së, as rritje e zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, as integrim, as evitim të pasojave përcjellëse. Njëri ndër faktorët e moszhvillimit ishte edhe cilësia në arësim e edukim. p.sh Indeksi i zhvillimit human, Kosovën e rangon midis vendit 85-89 në listën e 170 vendeve: afër Shqipërisë, B&H, dhe Maqedonisë. (BB: *HDR-2004*) Sfidë tjetër për institucionet kosovare ishte zbutja e varfërisë në Kosovë, ngase varfëria e lartë: 15%-18% në varfëri të skajshme, 37%-47% në kushtet e varfërisë (BB:*Report 2010*) kishte pasoja të thella në zhvillimin human dhe rrjedhimisht në të gjitha sferat.

Në Planin dhe Strategjinë Kombëtare kundër korrupsionit 2012-2017, konfirmohet se nga vetë institucionet egzistimi i kësaj dukurie, dhe fakti se ishte dëmtuar dukshëm edhe aftësia e institucioneve për luftimin e këtyre dukurie. (Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimin të Organizuar 2012,) Pranohet qartë nga vetë institucionet, nga elita politike, nga KGJK, KPK, etj, se egzistojnë këto dukuri në vetë institucionet e larta dhe se mungon gadishmeria e luftimit të tyre dhe politika për mirëqeverisje. Emërimet politike për institucionet relevante bëheshin nga nepotizmi dhe lidhjet nëpërmjet korrupsionit dhe depërtimi i madh i kësaj dukurie në institucionet kryesore. Kjo tani pranohet edhe nga një pjesë e elitave, nga fraksionet në pushtet, ndërsa opozita i kritikon këto dukuri duke i parë vetëm të partitë në pushtet, por dukuri të tilla kishte në të gjitha udhëheqjet e partive në institucione.

Procesi i vonuar i konstituimit të institucioneve të pavarura dhe funksionimi i brishtë i të gjitha institucioneve për një kohë të gjatë, kishte krijuar rrethana për lulëzimin e

dukurive negative. Edhe mekanizmi antikorrupsion shpeshherë ishte burim i korrupsionit. Gjyqësori vendor, nuk kishte qenë në gjendje të merret me raste të krimeve serioze: krimit të organizuar, krimit ekonomik, korrupsionit të lartë, krimeve të luftës. Të gjitha këto mos efikasitete e jo rezultate konkrete e kanë topitur edhe angazhimin serioze të qytetarëve dhe organizatave tjera për luftimin e këtyre dukurive. Si rezultat i kësaj kemi edhe dukuri tjera negative në shoqëri dhe humbje të besimit në institucione. Projektligji për konfiskimin e pasurisë të përfituar paligjshëm doli në dëgjim publik; nga qeveria konsiderohet si bazë e mirë juridike për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Mirëpo, Organizatat joqeveritare dhe opozita kishin vërejtje se nuk është i përshtatshëm për ta luajtur rolin, veçmas për personat e përfshirë e pasuruar në mënyra të paligjshme deri me tani.

Kosova pas pavarësisë, për të ndërtuar profilin e vet institucional e qeverisë demokratik, duhej të luftonte dukuritë negative dhe të përballej me sfidat e lartpërmendura. Qytetarët me padurim prisnin fillimin serioz të luftës kundër korrupsionit dhe grupeve të krimit të organizuar, veçmas të atyre që janë brenda institucioneve, pra politikanëve dhe zyrtarëve të korruptuar. Qytetarët kishin filluar t'i kuptojnë edhe dobësitë e shprehita e veta negative në procesin politik, në procesin zgjedhor, në përceptimet dhe qëndrimet politike të gjertanishme. Pra, kishin filluar të ngrisin nivelin e kulturës dhe përcaktimin për qeverisje demokratike; si rezultat i kësaj, cilësia e pjesëmarrjes së tyre në procesin qeverisës do të jenë ndryshe.

5.2. Subjektet politike dhe institucionet

Faktorë dhe aktorë esenciale i qeverisjes dhe zhvillimit institucional, janë subjektet politike dhe lidhshëria e tyre. Subjektet partiake, synojnë pushtetin si përfaqësues të zgjedhur në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën, për të ndikuar në proceset politike,

kulturore, ekonomike, integruese dhe në shërbime publike për qytetarët. Rolet dhe funksionet e partive janë të shumanshme. Ato kanë obligime juridike e morale, janë përgjegjëse, llogaridhënëse për këto role e funksione, sipas sistemit politik e rendit juridik në përgjithësi.⁹⁷ (Hejwood, 2002:245-289) Edhe partitë politike kosovare dhe lidhshipi i tyre, janë të thirrura dhe të obliguara t'i realizojnë e jetësojnë në praktikë politikat e obligimet qeverisëse sipas kushtetutshmërisë, ligjshmërisë e programeve-politikave; përmes krijimit e realizimit të vullnetit politik dhe vendimmarrjeve institucionale. Andaj, konsolidimi cilësor i tyre dhe respektimi i përcaktimeve kushtetuese e ligjore nga ana e tyre, ishte thelbësor për procesin dhe rezultatet qeverisëse 2008-2012.

Sistemi elektoral proporcional dhe pragu i ulët, politizimi i shoqërisë dhe përpjekjet për zgjidhje të problemeve të grumbulluara, privilegjet që afron hyrja në institucione qeverisëse dhe ndjenjat përkatëse, jo zhvillimi i sektorëve prodhues e shërbyes privat, etj., kanë ndikuar në ekzistimin e numrit të madh të partive. Kishim personalizim të garës ndërpartiake në bazë të liderëve partiakë, në bazë të kaluarës së tyre, krenarisë lokaliste, etj., por shumë pak për programet. Pra, atoishin pa profilizim të mirëfilltë programor qeverisës. Pas shpalljes së Pavarësisë 2008, paksa filloi ndryshimi. Partitë, në programet e tyre dhe gjatë fushatave paraelektorale, filluan të flasin edhe për probleme të tjera sociale, ekonomike, infrastrukturore, sigurinë, luftimin e dukurive negative, etj. Por, jo më programe e strategji të mirëfillta, por vetëm me deklarata sa për të fituar votat.

Bazë e interesave konfliktuoze ndërpartiake ishin dukuritë përvetësuese pas ardhjes në pushtet, e jo dallimet dhe gara për qeverisje më të mirë. Euforia të votuesit dhe njohuritë

jo të plota për interesat reale, mungesa e debateve të mirëfillta, krijonin klimë partiake e ndërpartiake të pafavorshme. Edhe mediet ishin të varura e kritike të njëanshme, u mungonte karakteri i pavarur analizues e kritik. Edhe shoqëria civile nuk mund të konsolidohej sa e si duhet në këto rrethana. Struktura shtresore e shoqërisë është e pa diferencuar, si rezultat i jo zhvillimit privat në prodhim e shërbime. Partitë, si forca politike të rezistencës paraprake, thirrshin në meritat e rezistencës së kaluar, ndërsa shumë pak për problemet ekzistuese, si: varfëria, papunësia, mungesa e infrastrukturës, shërbimet publike, zhvillimi ekonomik, etj. Ato nuk ofronin projekte dhe programe të qarta për zgjidhjen e këtyre problemeve. Pas shpalljes se Pavarësisë filluan të ndryshojnë deklaratimet programore, por ato orientime programore ishin ende të paqarta e jo specifike⁹⁸ ngase, mungonte shtresëzimi real i shoqërisë dhe rrjedhimisht, përpunimi e shpërndarja reale e interesave dhe parakushteve e mundësive sipas orientimeve eventuale programore. Ato deklarohen me retorikë boshe për problemet sociale, ekonomike, e jo me veprime, politika e programe konkrete.⁹⁹ (KDI, janar 2009) Profilizimi programor nënkupton një qëllim dhe një plan veprimi i zbatuar në praktikë, për të arritur qëllim dhe efekte konkrete; duke iu dhënë qytetarëve një sistem të qartë reference për politiken ekonomike, makroekonomike, financiare, fiskale, sociale, arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes së ambientit, zhvillimin ekonomik, zhdukjen e varfërisë e papunësisë e dukurive negative.

Në Kosovë gjatë periudhës 1999-2012, mungonte pjesëmarrja masive e qytetarëve në votime; mungonte ndëshkimi përmes votës, për të kërkuar llogari për gabimet, dështimet dhe devijimet. Një numër i konsiderueshëm i votuesve dhe simpatizantëve

partiakë nuk e kishin këtë gatishmëri kritike ndaj liderit dhe subjektit që i votojnë; fajtorin e gjenin te subjekti dhe lideri tjetër konkures. Partitë nuk po mund të demokratizohen. Si rezultat i funksionimit të brishtë të institucioneve për luftimin e dukurive negative në institucione, udhëheqjet partiake po e uzurpojnë partinë, pushtetin dhe institucionet për interesa të ngushta grupore e keqpërdoruese. Qytetarët duhej të kërkojnë përgjegjësi konkrete nga elitat dhe liderët partiak. Militantët dhe simpatizantët partiakë nuk kanë qëndrim kritik ndaj lidërshit partiak të tyre, edhe kur ky lidërship nuk është efektiv dhe kur bënë shkelje juridike e moralo-politike. Konsolidimi i institucioneve pas shpalljes së Pavarësisë, si dhe prania e problemeve, si: varfëria, papunësia, mungesa e investimeve, infrastrukturës, shërbimeve publike të dobëta, dukuritë negative, etj., kërkonin programe partiake të qarta e specifike për zgjidhje të problemeve, e jo retorikë të zbrazët e demagogji. Kërkohej edhe tek qytetarët dhe votuesit një vetëdije e re politike në favor të kognitives dhe përgjegjësisë në procesin politik e votues.

Pa profilizim real programor, qëllimor e veprues në këtë drejtim, anëtarësia lidhej kryesisht me kryetarin e partisë, tek i cili koncentrohej pushteti partiak edhe ndaj institucioneve, i cili vendos për interesat dhe vendimmarrjet. Pra, lideri po shndërrohet në thelb të identitetit të partisë, (KDI, 2009) ndërsa në institucione si autokrat e arbitrar. Profilizimi i qartë i partisë do të ndikonte sadopak në demokratizimin e vet partisë dhe në rolin e ndryshuar të liderit partiak. Më profilizim do të vinte në shprehje dominimi i ideve, programeve e qëllimeve qeverisëse, si dhe dallimet programore dhe konkurrenca reale në mes tyre, do të ndikonte edhe në zbutjen e konfliktualitetit ndërpartiak. Subjektet partiake dhe lidërshi i tyre duhej të ballafaqohen me sfida të reja të demokratizimit të partive, shtetit dhe shoqërisë.

Partitë, pas shpalljes së Pavarësisë, nuk mund të arsyetoheshin më për mungesë të kompetencave dhe nuk mund t'ia hedhin fajin faktorit ndërkombëtar, siç vepronin më parë. Ato, për ta ndryshuar gjendjen, kërkohej të afrojnë projekte e programe të qarta për zgjidhjen e problemeve, të specifikojnë programet dhe politikat në afate, sidomos në mënyrat dhe veprimtarinë konkrete implementuese. Profilizimi mundëson qarkullimin e elitave dhe freskimin e klasës politike të Kosovës. Praktikak ekzistuese të gjertanishme në jetën partiake, institucionale e qeverisëse, kishin krijuar klanizim, duke i keqpërdoruar fondet publike, donacionet vullnetare të viteve të nëntëdhjeta dhe ato gjatë luftës, pushtetin ekonomik, procesin jo të mirëfilltë të privatizimit, tenderët e korruptuar, shpenzimet e pakontrolluara të buxhetit në emër të shpenzimeve qeveritare për mallrat e shërbimet, nepotizëm në punësim në administratë dhe në shërbime publike, keqpërdorime në korporatat publike, informalitet, kontrabandë, shpëlarje të parave, etj. Pra, aktiviteti partiak përmes qeverisjes se papërgjegjshme u ka mundësuar përvetësime personale e grupe. Si rezultat i këtyre rrethanave përvetësuese përmes keqpërdorimeve, po krijohen grupe të interesit dhe grupe të presionit të konsoliduara në udhëheqjet partiake dhe jeta ndërpartiake po përshkohej me debate të ashpra, fyerje dhe etiketime. Edhe partitë opozitare kur vinin ose ishin në pozitë, vepronin ndryshe nga deklaratimet dhe premtimet e dhëna gjatë fushatës. Kjo kishte ndikuar të një pjesë e elektoratit, të humb besimin se do ketë parti të mirëfillta opozitare, prandaj një pjesë e qytetarëve është pasivizuar në procesin e votimit. Të gjitha këto po ndikojnë në veprimtarinë institucionale, në legjitimitetin dhe autoritetin, efektivitetin dhe efikasitetin qeverisëse kosovare.

Pjesëmarrja e qytetarëve në votime është e vogël, dhe sillet diku rreth 45%. Shkaqet kryesore për këtë janë dukuritë negative të lartëcekura të elitave politike e partiake në

institucione dhe në qeverisje, të cilat kishin dështuar t'i tërheqin qytetarët dhe të zgjidhin problemet e grumbulluara. Për këto arsye ato shpenzonin shumë energji dhe burime materiale e fizike për të komunikuar me masat, në mënyrë që t'i bindin për të siguruar përkrahjen për të dalë në votime. Asnjë subjekt partiak apo koalicion në zgjedhje nuk fituan shumicën e votave të qytetarëve; fitonin rreth 30% nga votuesit e dalë në zgjedhje, (Raportet KQZ, 2008-2012) që i bie 12-14% të votueve më të drejtë vote. Kjo është edhe si pasojë e sistemit zgjedhor proporcional. Kjo po e detyron partinë që ka fituar më shumë se tjerat subjekte, të siguroj partnerin paszgjedhor për të krijuar pozitën.

Institucionet, Lidershipi dhe Interesat

Siq theksuam edhe më lartë, fërkimet partiake rreth hyrjes në institucione politike, ndërlidheshin me interesa për punësim të familjarëve në institucione dhe në administratë e shërbime publike, keqpërdorime me mjete e pronë publike, tenderëve, informalitetit, kontrabandës, etj. Punësimi në sfera tjera private prodhuese e shërbyese ishte tejet i kufizuar në Kosovë, si rezultat i jo zhvillimit. Mungesa e konsolidimit ekonomik dhe mosfunksionimi i mirëfilltë i institucioneve të ndjekjes, ka ndikuar që lidershipi i partive politike të interesohet për përvetësime grupore në këto faza dhe rrethana kaotike, e jo për konsolidimin dhe funksionimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore. Ky lidership për ardhje në pushtet përdorte metoda populliste, ideologjike, lokaliste, demagogjike dhe vetëdijen politike të së kaluarës. Duke i instrumentalizuar mediet dhe duke e shprehur përmes tyre luftën klanore në favor të interesave tejet të ngushta, duke e manipuluar opinionin dhe votuesit e lodhur nga pa përspektiva. Këto grupe partiake me liderin autoritar, kur hynin në institucione, ndikonin në mënyrë arbitrare, ekstreme, jodemokratike dhe pa debat të mirëfilltë. Edhe raporti pozitë-opozitë ishte i infektuar nga

interesat e këtyre grupeve, që kanë për qëllim korrupsionin dhe privilegjet e pushtetit e jo garë për mirëqeverisje të mirëfilltë. Pra, konkurrenca e tyre nuk ishte e sinqertë, mu për shkakun e depërtimit të grupeve të lartpërmendura në institucione dhe me ndikim negativ. Mu për këtë, në mes të partive kishte tendosje e konkurrencë joparimore e jo konstruktive. E gjithë kjo ndikonte në funksionimin e institucioneve politike, në mënyrën vendimmarrëse, në sundimin e ligjit e rendit juridik, në investimet, sigurinë, cilësinë e shërbimeve publike, integritet dhe zhvillim. Grupet partiake ishin të interesuara për të vënë nën kontroll shumicën e institucioneve, administratën dhe ndikimin në korporata publike, me qëllim të ruajtës së pushtetit për interesa grupore. Përpiqeshin të dërgojnë vartësit e tyre grupor në gjyqësor, prokurori, AKI-në, bordet e kompanive publike dhe në shumicën e institucioneve e shërbimeve publike. Në Kosovë, një kontroll dhe uzurpim të tillë të institucioneve më efekte të mëdha negative: korrupsion të lartë, nepotizëm të theksuar dhe ikje nga përgjegjësia, e thekson edhe (KIPRED (Qershor 2012).

Shoqëria e varfër e Kosovës nuk ka shtresëzim plural socio-ekonomik. Proceset vendimmarrëse në institucione përplasen në procesin e shpërndarjes së të ardhurave dhe buxhetit të vendit për interesat e ndryshme rajonale. Përpos punësimit në administratë dhe në shërbime publike, ka interesim për të marrë tenderë, për të ndikuar në privatizim dhe në partneritetin publiko-privat. Konfliktet e interesave lidhën me ndarjet e buxhetit për investimet nëpër Komuna. Partitë në pushtet në fushatat parazgjedhore dhe pas saj, këto mjete i orientojnë sipas përkatësisë partiake në pushtetin lokal dhe përdoren për të fituar vota në fushatat parazgjedhore dhe dhënien e tenderëve sipas kriterëve grupore të shoqëruara me korrupsion dhe me punë jocilësore në këto investime. Kosova kishte parti të liderëve dhe votues emocional në lidhjet grupore, fisnore, rajonale, etj. Pra, jo

sipas programeve, sukseseve e cilësisë në procesin qeverisës. Përfaqësues të këtyre grupeve grupoheshin pas liderit, i cili ndërkohë ishte i detyruar të punojë për këto grupe, bëhej imun dhe familjarizohej me dukuritë negative, financohej e përkrahej nga ta dhe korruptoheshin së bashku. Tanimë është i njohur fenomeni se, nëse lideri është i korruptuar në shumë aspekte, të korruptuarit vetë i afron dhe i afrohen, dhe e kundërta e saj. Në Kosovë, si rezultat i traditës dhe nivelit të zbatimit të ligjit, po ndodh e para. Edhe një pjesë e inteligjencies, për interesa materiale momentale, po i përshtatet situatës dhe nuk është kritike e vepruese e mirëfilltë.

E kaluara e një partie dhe lidërshipt të saj është njëri nga kriteret parashikuese, por fushatat dhe zhurma parazgjedhore po i huton votuesit e simpatizuesit me emocione, sentimentalizëm e motive identifikimi, si dhe me premtime e përfytyrime joreale. Në Kosovë dominonte vota „historike” si identifikim i së kaluarës rezistuese, se sa vota ekonomike, shërbyese, etj. Votuesit-qytetarët i manipulojnë duke u premtuar favore për të ardhmen e largët dhe duke manipuluar me krenarinë e se kaluarës, përmes përkatësisë lokaliste e krahinore dhe duke mos u marr dot me të sotmen-realitetin. Ata përdorin premtimet boshe për të ardhmen, si p.sh. integrimi në BE, NATO, liberalizim të vizave, etj., të cilat i pengonte vetëveprimtaria e lidërshipt partiak. Pra, manipulojnë me qytetarët e painformuar drejtë për proceset dhe shkaqet e tyre. Në skenën politike kosovare, aktet e ndodhura si skandale, janë procese të imponuara nga elitat politike. (OEGJ, 2013) Lidërshipi partiak, përcaktimet kushtetuese dhe institucionale i përdor vetëm si retorikë pa përmbajtje qëllimore, vetëm për të ardhur në pushtet. Qëllim kryesor kanë jo qeverisjen e mirëfilltë, as garën për mirëqeverisje, por për përvetësime grupe. Mirëqeverisja,

ligjshmëria, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike, forcimi i institucioneve, siguria, integrimi, mirëqenia dhe perspektiva, për ta janë interesa e qëllime të rendit të dytë .

Në Kosovë, rol dhe ndikim të madh në procesin politiko-ekonomik kanë grupet e interesit e të presionit të vendeve më të zhvilluara sesa Kosova. Këto grupe, ndikim e rol të madh luanin në procesin politik e ekonomik, ngase Kosova është vonuar në reforma dhe ende i ka institucionet e brishta, ka nevoja ekonomike e dukuri negative institucionale e qeverisese të lartëpermendura. Këtë ndikim e bëjnë gjatë procesit të bashkëpunimit, privatizimit, integritit ekonomik, politik, të sigurisë, partneritetit publiko-privat, privatizimit, tenderëve, me anë të investimeve, përmes politikës ekonomike të korporatave shumëkombëshe, etj. Këto ndikime i realizojnë në bazë të qëndrimeve, rekomandimeve, presioneve, duke përkrahur ose kundërshtuar forca të caktuara politike, por edhe përmes lobimeve dhe përmes korrupsionit të liderëve e zyrtarve në institucione. (Shala, 2001)

Pra, demokracia partiake ka ngecur shumë, meqë ende i mungojnë reformat e duhura organizative dhe reformat programore. Në veçanti duhet shikuar edhe financimi i tyre. (KDI, 2011:226) Mungonte ndëshkimi i tyre nga qytetari përmes votës. Kjo vjen edhe si rezultat i jo dallimeve partiake. Partitë politike e kishin të vështirë lirim nga lidhshipi i korrupsionit, i cili nuk dëshiron reforma partiake si rezultat i dukurive përfituese dhe mungesës së opozitës së mirëfilltë, si dhe mosndëshkimit nga gjyqësori e as nga votuesi. Prandaj, partitë duhej të profilizoheshin dhe të gjenin lidhship me identitet tjetër, konkurrentë në bazë të parimeve demokratike rreth çështjeve kryesore, si taksat, ndarja e parasë publike, politika sociale, ekonomia, etj. Sfidë serioze ishte përmirësimi i demokracisë brenda partive politike dhe rrjedhimisht në institucione e qeverisje. Partitë politike i kishin filluar reformat e brendshme pas pavarësimit të vendit, por format

joformale të vendimmarrjes mbeten më të preferuara. Vendimet më të rëndësishme për partinë dhe institucionet merreshin në forume e takime joformale, duke anashkaluar organet e partisë dhe institucionet. Këto praktika të vendimmarrjes joformale, mbanin të fuqishëm rolin e liderit të partisë, që ushtronte fuqi më të mëdha se sa janë të përcaktuara me dokumentet e partisë. Partitë nuk kishin arritur të profilizohen ideologjikisht, gjë që e bënte të cenueshëm kohezionin brenda partive. Pra, të gjitha këto shpreheshin negativisht në qeverisjen dhe efikasitetin institucional 2008-2012.

Më shumë ndikonte dukuria e bashkëpunimit në mes klaneve dhe grupeve keqpërdoruese, sesa bashkëpunimi real ndërpartiak për procese pozitive. Grupet e interesit dhe grupet e presionit bashkëpunojnë me grupet e ngjashme të partive tjera, sidomos kur janë në pyetje tenderët dhe dukuritë tjera negative. Shpesh i ndanin edhe sferat e rajonet për keqpërdorim. Fenomenet përfituese të paligjshme të grupeve të elitave partiake po e vonojnë demokracinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Karakteristikat e lidershipit jocilësor e jodemokratik në qeverisjen kosovare janë: paraqitja si të gjithëdijshtëm e të pagabueshëm, arrogantë, mosbesues, ikje nga debati i mirëfilltë, nuk mund t'u thuhet e vërteta, servilizëm i tepruar ndaj vendimmarrësve të vendeve me ndikim, ekipe të dobëta rreth tyre të cilët nuk i zbatojnë as idetë e tyre. Andaj, tejkalimi i këtyre dukurive negative, do të ndikonte në përmirësimin qeverisës e institucional.

Sistemi zgjedhor

Sistemi zgjedhor proporcional i paraparë në Planin e Ahtisarit dhe në Kushtetutën e Kosovës e Ligjin zgjedhor (L-03/1-073), u konsiderua më i përshtatshëm për rrethanat kosovare momentale, se sa sistemi elektoral maxhoritar dhe ai i përzier. Sistemi parlamentar i qeverisjes u konsideru më i përshtatshëm për Kosovën, ngase, në sistemin

presidencial fituesi e merr tërë pushtetin dhe kjo forcon ndjenjën e marginalizimit të kandidatit të opozitës së mundur dhe përkrahësit e tij; gjë që në vendet pa traditë siq ishte Kosova mund të shpiete në polarizim, ekstremizëm dhe prishje të rendit. Ndërsa në sistemin parlamentar, kandidati i mundur dhe subjekti partiak opozitar është në opozitë, dhe luanë rol aktiv si opozitë. Edhe roli i Parlamentit në raport me ekzekutivin në sistemin parlamentar, është më i theksuar.

Në Kosovë sistemi elektoral proporcional ka rezultuar në shumëpartizëm, me parti jo masive. Kjo praktikë e zvogëlonte sadopak dominimin e një partie masive në dukuritë negative parti-shtet dhe në polarizim e konfrontim ekstrem të dy partive kryesore. Por, si pozita në institucione ashtu edhe opozita është e fragmentarizuar në disa parti të mesme e të vogla. Kjo gjendje ndikonte në jo efikasitet e jo efektivitet të sistemit politik, por i ka detyruar subjektet në bashkëpunim, bashkërendim, debat dhe kompromis e konsensus ndërpartiak të domosdoshëm, dhe jo në konfrontim dy polar të shumicave. Këto zgjidhje juridike po sjellin praktika e përvoja demokratike të rëndësishme. Opozita gjithashtu ka të drejtat e obligimet pjesëmarrëse dhe mund të jetë aktive në institucionet dhe funksionet e parlamentit si dhe në disa institucione tjera kontrolluese. Sistemi maxhoritar në vendet e tranzicionit krijon dy parti masive dhe konfrontim ekstrem të tyre.

Shumica e studiuesve pajtohen se sistemet tepër proporcionale prodhojnë jo-stabilitet të qeverisjes, vështirësi në konsolidim institucional pas zgjedhjeve dhe vështirësi në vendimmarrje. Ndërsa, sistemi maxhoritar konsiderohet me stabilitetin qeverisës dhe efikasitet në vendimmarrje. (Bajrami, 1997; Hejwood, 2002:245-289; Katz, 1997) Sistemet e plota proporcionale u mundësojnë partive të vogla të ekzistojnë dhe të jenë të fokusuara në një apo disa çështje dhe më vonë mund të bëhen me shumë ndikim. Kjo

është pozitive për Kosovën, ngase po u krijohen mundësi më të lehta partive opozitare për të dal në skenë. Është më i përshtatshëm edhe për parti të pakicave etnike, megjithëse atyre në Kosovë u është garantuar e rezervuar pjesëmarrja dhe kompetencat e përgjegjësitë në dy mandate pas shpalljes së Pavarësisë, dhe garancione kushtetuese për pjesëmarrje e vendimmarrje në të gjitha institucionet.

Vendi ku ka jo stabilitet kronik, jo traditë e bashkërenditje dhe mungesë të debatit konstruktiv dhe konsensualitetit, mund ta shpie procesin qeverisës drejt kolapsit të demokracisë dhe mungesën e efikasitetit dhe efektivitetit qeverisës. Si faktor stimulues konsiderohet edhe sistemi proporcional. (IDEA 7, korrik 2011) Pjesërisht, një dukuri e tillë ndodhte në Kosovë, por vështirësitë në vendimmarrje dhe efektivitet mund të ndodhin edhe në atë mazhoritar, nëse tradita dhe kultura politike mungon dhe dukuritë negative shtrijnë rrënjë. Pra, si sistemi mazhoritar dhe ai proporcional mund të jenë jodemokratik, konfliktuoz, jostabil e jo efektiv. Në Kosovë, dukuritë e ngjashme i tejkalonte faktori i jashtëm, por tani ka filluar bashkëpunimi dhe janë zbutur konfrontimet ekstreme. Modeli qeverisës i Kosovës, si qeverisje parlamentare me sistem elektoral proporcional është i qëlluar, por sjellte vështirësi vendimmarrëse në procesin qeverisës dhe në veçanti në formimin e institucioneve-pozitës menjëherë pas zgjedhjeve. Këto vështirësi tejkaloheshin përmes ndërmjetësimeve ndërkombëtarëve me role e qëllime pozitive. Këto përvoja janë ndërhyrje e jashtme, e jo zgjidhje e pjekuri e faktorit vendor qeverisës. Megjithatë, në Kosovë 2008-2012, ruhej një demokraci e qëndrueshme.

Sistemi proporcional u mundësonte daljen në skenë dhe konsolidim partive të reja, që në fillim ishin të vogla për nga anëtarësia dhe simpatizantët. Mundësonte pluralizëm si element demokratik, por nga ana tjetër i fragmentarizonte tepër subjektet politike dhe

përcillej me vështirësitë në konsolidim institucional dhe në vendimmarrje. Gjithashtu i detyroj të krijojnë kulturë politike të bashkëpunimit, kompromiseve, konsensusit dhe bashkërendimit ndërpartiak. Për demokracinë fillestare në Kosovë, një sistem zgjedhor tërësisht mazhoritar nuk është i përshtatshëm, ngase prodhon dy „tirani të shumicave” dhe konfrontime emocionale jo të përshtatshme, më jo tolerancë dhe thellim të dukurive negative parti-shtet. Por, edhe sistemi tërësisht proporcional po krijon fragmentarizim të tepruar. Andaj, një sistem zgjedhor i përzier mund të jetë më i përshtatshëm.

Keqpërdorimet e theksuara në procesin zgjedhor dhe krizat që u krijuan në procesin e konsolidimit të institucioneve, veçmas në zgjedhjen e presidentit, krijuan opinionin dhe kërkesa për ndryshime të sistemit zgjedhor, të cilat do të implikohen edhe në ndryshimet tjera kushtetuese. Në veçanti vështirësi dolën rreth zgjedhjes së Presidentit. U fajësua sistemi zgjedhor dhe mënyra e zgjedhjes së Presidentit. Për ta ndryshuar sistemin dhe ligjin zgjedhor, duhet amandamentuar edhe aktet kushtetuese ndërlidhëse, në veçanti, nëse ndryshohet mënyra e zgjedhjes së Presidentit-zgjidhet nga qytetarët. Si rezultat i marrëveshjes së tri subjekteve partiake-PDK, LDK dhe AKR, përmes ndërmjetësimit të Ambasadorit të SHBA-ve për zgjedhjen e presidentit, u vendos të formohen grupet punuese për përgatitjen e ndryshime kushtetuese. Kuvendi i Republikës krijoi komisionet për ndryshimet kushtetuese, që përfshinin sferën zgjedhore, si dhe përshtatjet e këtyre ndryshimeve me implikimet në pjesët tjera, si rezultat edhe i përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare. Për këto ndryshime, u krijuan grupet përkatëse punuese të subjekteve dhe profesionistëve. Komisioni hasi në vështirësi në koordinimin e propozimeve rreth numrit të zonave zgjedhore, natyra e listave zgjedhore të hapura apo të mbyllura, pastaj pragut zgjedhor, sistemi i shpërndarjes së ulëseve në Parlament, etj.

Komisioni ka kërkuar ndihmë prej udhëheqësve të subjekteve të mëdha politike për realizimin e ndryshimeve, por nuk ishte gjetur një zgjidhje e pranueshme. Mendimet dhe propozimet për ndryshimin e sistemit proporcional në atë mazhoritar, apo të përzier dhe ndryshimin e zonave, ndryshimin e listave të hapura, zgjedhja e presidentit nga qytetaret, etj., janë në rritje. Edhe vendet e rezervuara për minoritetet duhet ndryshuar dhe kushtëzuar sipas pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje, ngase ndryshimet i obligojnë subjektet e tyre politike për pjesëmarrje më cilësore dhe më aktive në zgjedhje dhe në institucione, pra në procesin integruar. Ndërsa sa i përket zonave zgjedhore, grupet punuese dhe subjektet kishte propozime që Kosova të ndahet në disa zona zgjedhore. Ekzistimi i shumë zonave ndikon në lidhshmërinë më të madhe të deputetit-kandidatit me bazën e votuesve. Pra, është më demokratike dhe më legjitime, ngase subjekti detyrohet të kandidojë kandidatin më cilësor për atë bazë; njëkohësisht edhe deputeti lidhet më tepër me bazën dhe bëhet përfaqësimi i zonave. Sistemi i kombinuar mazhoritar-proporcional duket të jetë më i përshtatshëm. P.sh. 60% të deputetëve të zgjidhen me shumicë mazhoritare në zonat përkatëse, ndërsa 40% sipas përqindjes së votave të mbetura nga të gjitha zonat; ose 50% me 50%. Sistemi i kombinuar do të absorbonte të gjitha anët pozitive të të dyja sistemeve zgjedhore dhe do të relativizonte ndikimet negative të të dyja sistemeve, veçmas në zgjedhjet nacionale parlamentare. Ndërsa në zgjedhjet lokale sistemi proporcional është më i përshtatshëm. Kryetarët e komunave po zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga votuesit. Kjo po funksionon mirë dhe po e rrit legjitimitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e këtij institucioni në shumë aspekte. (Brajshori & Ternava, 2013) Edhe në zgjedhjet për asamblatë komunale ndryshimet zgjedhore mund të jenë me sistem të kombinuar mazhoritar-proporcional, shumica e këshilltarëve të zgjidhen me

shumicë votash, ndërsa pjesa tjetër të plotësohet nga proporcionaliteti i tërësishëm i votave në nivel komunal. Por, edhe sistemi i pastër proporcional për zgjedhjet komunale është i përshtatshëm.

Abuzimet e shumta në procesin zgjedhor e votues, ishin rezultat i kulturës e traditës politike, por edhe i mosfunksionimit të sistemit gjyqësor, përkatësisht jo dënimi i keqpërdoruesve. P.sh. për keqpërdoruesit e procesit zgjedhor, vendimet gjyqësore janë zvarritur shumë dhe dënimet ishin minimale. (KGJK, Raporti vjetor 2012) Është rezultat i kulturës politike të militantëve partiakë dhe mosangazhimi serioz i lidërshipt të subjekteve politike për menjanimin e dukurive negative. (KIPRED, prill 2011)

Sipas përcaktimeve kushtetuese, Presidenti duhet të jetë jopartiak, së paku gjatë mandatit, ngase përfaqëson unitetin. Ai zgjidhet nga Kuvendi. Ka propozime të zgjidhet drejtpërdrejt nga elektorati, për të qenë më cilësor në rolin dhe funksionet që kërkohen dhe tejkalimet e vështirësitë e zgjedhjes së tij/saj nga Kuvendi. Por, ndryshimet u zvarriten. Kompetencat dhe përgjegjësitë e tij janë të avancuara dhe mund të jenë të njëjtat, për të mos ndryshuar karakterin parlamentar të qeverisjes, por zgjedhja nga qytetarët drejtpërdrejt nxjerr kandidatët dhe Presidentin më cilësor për kompetencat, rolet dhe funksionet që ka ky institucion. Zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit nga qytetarët, i shtynë subjektet politike të dalin me kandidatë më unifikues dhe më të përshtatshëm e cilësor për ushtrimin e roleve dhe funksioneve të përcaktuara më kushtetutë dhe ligje. Shumica e votuesve do të përcaktoheshin për kandidatin më cilësi përkatëse. Kjo mënyrë e zgjedhjes së presidentit forcon legjitimitetin dhe forcën vendimmarrëse, qeverisëse dhe stabilizuese. Edhe gjatë zgjedhjeve parlamentare, presidenti i zgjedhur nga qytetarët, tani për pesë vite, do të luante rol pozitiv në stabilitet dhe qeverisje sipas kompetencave, gjatë

procesit zgjedhor e konsolidues të institucioneve. Në krizat eventuale qeveritare dhe gjatë procesit zgjedhor, funksionimi stabil i institucionit të presidentit i zgjedhur drejtpërdrejt, mund t'i kryen më mirë detyrat e funksionet e përcaktuara më kushtetutë, do jetë më i pavarur nga grupet e ngushta partiake. Pra, ndryshimet kushtetuese e ligjore në mënyrën e zgjedhjes së tanishme të presidentit, duket se janë më pragmatike

Ndryshimet kushtetuese e ligjore të sistemit zgjedhor duhet të mbrojnë parimet demokratike të sistemit, ngase përmirësimi i këtij procesi do të ndikonte sado pak në zgjedhjen e një klase më të përgjegjshme politike. Ky sistem do të filtronte përgjegjësinë, do të ndihmonte në demokratizimin e partive politike, do t'i detyronte partitë për të gjetur kandidatë me më reputacion dhe do të përmirësonte procesin zgjedhor dhe qeverisës. Institucionet e Kosovës janë zotuar se do t'i përmbyllin reformat e ndryshimeve kushtetuese e ligjore përkatëse, deri në fund të vitit 2012. Më vonë parapanë të kryhen në tremujorin e fundit të 2013-ës. Përcaktimi për të bërë ndryshimet kushtetuese dhe ligjore është përfshirë edhe në rubrikën e kërkesave të KE-së përmes MSA, që u referohet kritereve politike. (KE:Raportin e progresit, 2012) Ndryshimet nuk ndodhen, ngase subjektet në pushtet dhe shumica e atyre opozitare, nuk ishin për ndryshime reale në procesin zgjedhor dhe qeverisës, ngase ju dukeshin të papërshtatshme për interesa të ngushta grupore të udhëheqjeve partiake.

5.3. Kushtet për qeverisje demokratike

Qeverisja kosovare u ballafaqu me kushte të pavolitshme për qeverisje demokratike, të cilat përcaktuan në masë të madhe rezultatet qeverisëse e institucionale në periudhën 2008-2012. Kushtet që ndikuan në nivelin e konsolidimit të institucioneve dhe qeverisjes demokratike në Kosovë, pas pavarësisë ishin të shumtë: a) politikat konstitucionale dhe

niveli i zbatimit të tyre; b) niveli i zhvillimit ekonomik; c) balancimi i pushteteve dhe decentralizimi; ç) Shpërqendrimi i pushtetit; d) tradita dhe rrethanat social-kulturore; e) rrethanat ndërkombëtare e rajonale; ë) procesi i integritetit. etj.

Ndarja dhe kontrolli reciprok i pushteteve

Njëri ndër parimet esenciale të qeverisjes demokratike është ndarja/balancimi dhe kontrolli reciprok në mes të pushteteve, sipas parimit që asnjëri pushtet nuk mund ta urdhërojë pushtetin tjetër të nxjerrë ndonjë akt apo veprim jashtë përkufizimit të kompetencave të veta dhe mekanizmave institucionalë për kontrollin reciprok. Kjo ndarje siguron lirinë politike, ngase e kufizon pushtetin e një organi/pushteti nga organi tjetër dhe e kufizon mundësinë e keqpërdorimit të pushtetit. Në Dispozitat themelore përcaktohet Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit: “Kosova është Republikë Demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë.” (neni 4.1, K-I) Në pajtim me këto zgjidhje kushtetuese dhe ligjet, procedurat dhe aktet tjera nënligjore në pajtim me të, u konstituuan të gjitha institucionet, me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.

Parlamenti me funksionet e tij paraqet institucionin bazë dhe institucion përfaqësues e mbikëqyrës i institucioneve tjera. Përpos funksionit dhe karakterit përfaqësues, funksion tjetër bazë i tij është legjvënia; “Kuvendi është institucion legjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.” (K-IV, Neni 63) Funksioni i tij përfaqësues, legjislativ, përgjegjës dhe kontrollues ndaj pushteteve tjera, e përcakton karakterin parlamentar të sistemit politik e juridik të qeverisjes. Kontrolli parlamentar ndaj pushteteve tjera bëhet në bazë të funksionit legjislativ, funksionit zgjedhor/emertues, funksionit mbikëqyrës të Parlamentit, i cili zgjedh dhe shkarkon Qeverinë, Kryetarin e

Republikës, shtron votëbesimin ndaj ekzekutivit. Përmes instrumenteve të mos/miratimin e buxhetit, raporteve e punës së Ekzekutivit para Parlamentit, kontrolleve të përhershme dhe të përkohshme: pyetjet e deputetëve, interpelancave parlamentare dhe komisioneve parlamentare. Ky kontrolli parlamentarishte relativishtë efektiv.

Kishim kontrollin parlamentar përmes komisioneve parlamentare: raportimin e qeverisë në komisionet parlamentare; kontrollin e zbatimit të buxhetit të shtetit; seancat dëgjimore; raportet e kontrollit të komisioneve; komisionet hetimore, etj., të cilat funksiononin, por ky kontroll ende nuk ishte në nivelin e duhur. (KE:MSA, 2012) Një tendencë e tillë e uljes së vazhdueshme e efektivitetit të ushtrimit të *kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit* është evidente në Kosovë (KIPRED, 2009) Funksionet mbikëqyrëse të Parlamentit përmes bugjetit, emërtimeve në KGJK, KPK dhe kompetencave tjera në raport me Gjyqësorin, indirekt bëjnë një balancim dhe ndikim në efikasitetin dhe efektivitetin e këtij pushteti. Por, efektiviteti i institucioneve dhe thellimi i dukurive negative, kërkojnë fuqizim të kontrollit parlamentar. Në një punim kerkimor konstatohet se “Pavarësisht kompetencave kushtetuese, Kuvendi i Kosovës ende nuk po mund të gjejë forma dhe vullnet për ushtrimin e tyre, me theks të veçantë rolin mbikëqyrës mbi pushtetin ekzekutiv.” (Osmanaj, 2012:296-297). Kontrolli parlamentar ndaj të gjitha institucioneve duhet ngritur sipas praktikave dhe rregulloreve efikase bashkëkohore. OECD dhe BE, kanë përgaditë pikëpamje, praktika dhe dokumente për marrëdhëniet në mes institucioneve të kontrollit të lartë të shtetit dhe komisioneve parlamentare. (Dokumenti SIGMA-s nr. 33, 2002) Praktikrat e tilla vlejné edhe për Kosovën, për kontrollin parlamentar përmes komisioneve dhe formave tjera efektive.

Sipas kompetencave të Ekzekutivit (Qeveria dhe Presidenti), të zgjedhur nga shumica parlamentare, realizonte ndikimi në pushtetin legjislativ dhe në sistemin e drejtësisë, duke afruar projektligje, zbatuar ligjet dhe vendimet e Parlamentit, vendimet gjyqësore dhe aktet nënligjore. Qeveria udhëheqte dhe përcaktonte politikat kryesore dhe ndikonte në dinamikën e Parlamentit, duke propozuar ligje dhe politika konkrete zhvillimore dhe buxhetore. Ajo, sipas kompetencave, zgjedhte, emëronte dhe shkarkonte bartësit e organeve publike sipas përcaktimeve kushtetuese e ligjore.

Edhe Presidenti i Republikës, sipas përcaktimeve kushtetuese, kishte autonominë dhe kontrollin ndaj pushteteve tjera. Me sukses ushtroj kompetencat e vet: propozonte mandatarin e qeverisë, kandidatët në organet e larta të gjyqësorit dhe në Gjykatën Kushtetuese, kompetencat në raport me Forcat e Sigurisë, nënshkrimin dhe dekretimin e ligjeve të miratuara në Parlament, përdori veto ndaj ligjeve dhe akteve tjera të miratuara në Parlament, etj. Kjo autonomi dhe kontroll reciprok i pushteteve është i rregulluar, si në aspektin e rendit dhe sistemit juridik-kushtetues, ashtu edhe në atë ligjor e nënligjor, i cili respektohej dhe po funksiononte në parim, por kishte joefikasitet dhe joefektivitet.

Funksionet e kontrollit të Parlamentit ishte i ultë, si rezultat i dukurive, shkaqeve dhe pasojave negative të lartëpërmendura. Njëra ndër to është mungesa e përgjegjësisë parlamentare-politike e qeverisë. Mungon kontrolli i duhur parlamentar ndaj ekzekutivit dhe ndaj joefikasitetit e jo efektivitetit të pushtetit gjyqësor edhe ndaj administratës. Sipas analizave dominimi i ekzekutivit ndaj legjislativit ishte dukuri e theksuar, në vend që të jetë e kundërta. Udhëheqja partiake në pozitë me elementet autokratike, ishte shumë influencuese karshi institucioneve: ndaj parlamentit, drejtësisë, administratës, shoqërisë civile, medieve, ekonomisë, etj. Ndikimet e udhëheqjes partiake e kontrollonin

ekzekutivin dhe legjislativin Vendimmarrjet nuk bëheshin përmes debateve të mjaftueshme dhe procedurave të rregullta. Kishte ndikime në emërtimet nepotiste në gjyqësor, në administratë, në institucione tjera të pavarura, si dhe në kompani e shërbime publike. Pra, kishte nepotizëm të theksuar dhe konflikt interesi. Këto dukuri i theksonin edhe shumë organizata monitoruese vendore e ndërkombëtare. (NDI dhe USAID, 2008)

Pra, ndarja dhe kontrollimi reciprok i të tri pushteteve shtetërore dhe pavarësia reciproke është e sanksionuar me Kushtetutë dhe ligj. Por, nuk implementohen realisht përcaktimet dhe obligimet juridike e politike. Andaj, cilësia demokratike e qeverisjes kosovare është e ulët. Mungonte përgjegjësia politike/parlamentare e qeverisë, ngase, përkatësia partiake e deputetëve të subjekteve në pushtet, iste mbrojtëse fanatike e politikës qeveritare, edhe kur ajo nuk jepte rezultate dhe kur bënte qeverisje jocilësore, joefektive, e edhe kur ishte bartëse e keqpërdorimeve. Të gjitha këto ndikonin në rendin dhe zbatimin juridik të ndarjes dhe kontrollit ndërinstitucional. Këto dukuri i theksojnë dhe analizojnë një numër i theksuar i OJQ-ve, Psh. kemi një analizë të KDI mbi progresin funksional të institucioneve kosovare, veçmas gjendjen e *kontrollit parlamentar* ndaj qeverisë, të cilin e vlerëson si tejet të ultë; konstaton se Qeveria po vendos se si duhet të sillet dhe çka duhet të bëjë Kuvendi! (KDI-2012) Në konstatime të ngjajshme arrijnë edhe levizja FOL. (2012) Dihet kompetencat zinxhirore të gjitha institucioneve, por Kuvendi është institucioni më i lartë qeverisës në vend. Por kjo nuk po ndodh. Pra, ekzekutivi dominon dhe përcakton vendimmarrjet në Kuvend! Për këto arsye nuk ka ndarje funksionale të mirëfilltë e balancim të pushteteve, as përgjegjësi parlamentare-politike të qeverisë dhe administratës, as të institucioneve tjera para Parlamentit. Opozita shpeshherë ishte destruktive dhe me mungesë të alternativave e debatit të mirëfilltë.

Tradita dhe kultura politike

Kultura politike në Kosovë, po ndikon në sistemin e qeverisjes dhe fuqinë politike të institucioneve, duke filluar nga besimet e qytetarëve, paragjykimet dhe menyrat e metodat e veprimtarisë politike. Tradita politike është shumë e rëndësishme për kuptimin e veprimtarisë politike dhe ndryshimin pozitiv të saj në favor të mirëqeverisjes demokratike sipas nevojave dhe proceseve zhvillimore kosovare. Detyrimet juridike, kushtetuese e ligjore, ndarja e pushtetit, etj., kufizojnë pushtetin dhe obligojnë por, cilësia implementuese varet edhe nga kultura e tradita politike, e cila në Kosovë nuk ishte e favorshme. Shoqëria kosovare, kishte një të kaluar specifike në jetën politike, juridike e partiake, pra një praktikë dhe kultur qeverisese e cila ka lënë gjurmë në vetëdijen politike, në qëndrime, shprehi e sjellje politike dhe në veprimtarinë politike e qeverisëse, e cila nuk është lehtë të ndryshohet, pa ndryshime të thella në shumë sektorë.

Mungesa e transparencës dhe paqartësia e proceseve politike në të kaluarën, sistemi arbitrar i qeverisjes paraprake, rrethanat e rënda të okupimit, vendimmarrjet ndërkombëtare të paqarta dhe shpeshherë jo parimore e jo të drejta, kanë krijuar qëndrime e sjellje politike specifike të qytetarëve ndaj institucioneve dhe ndaj procesit qeverisës. Për shkak të ndrydhjes dhe manipulimeve mbi të vërtetat dhe njohuritë e mangëta për sistemin qeverisës të demokracisë së sotme dhe mungesa e ekonomisë së tregut të hapur, kanë ndikuar në shfaqjen e nivelit jo të kënaqshëm të vetëdijes politike dhe për veprimtarinë e qeverisjes. Të gjitha këto kanë ndikuar në sferën e perceptimeve, sjelljeve dhe shprehive. Edhe mediet kanë pasur rolin e tyre, së bashku me leadershipin e subjekteve politike dhe interesat e sjelljet konkrete të tyre. Të gjitha së bashku, kishin krijuar specifikat kulturore të trupit elektorale dhe procesin votues, në zgjedhjen e bartësve të

institucioneve dhe cilësinë e rezultatet në procesin qeverisës. Pra, vetëdija politike e zgjedhësve/trupit elektoral ishte euforike, emocionale dhe jo njohëse për shumë procese politike, ekonomike, qeverisëse, moskuptimin e interesave e pasojave. Kjo kulturë politike te qytetarët ndikoj edhe në lidhshimin kosovar. Nuk thuhet kot: si është kultura politike, e ngjashme është edhe qeverisja. Por, çështja është si të ndryshohen të dyja së bashku. Në vizitën e fundit Kosovës, Sekretarja Clinton ndër të tjera tha se “duhet ndryshuar qeveria,[qeverisja-A.SH.] por duhet ndryshuar edhe populli.” (Kosova sot, tetor/2012)

Qeverisja ishte e ndikuar nga kultura e tradita politike e popullsisë e ndërlidhur me të gjithë faktorët e proceset tjera, si pengesa serioze por që duhet tejkaluar e ndryshuar. (KCSF- CIVICUS, mars 2011:20) Pa ndryshimin e vetëdijes politike të votuesit, që shkon në favor të krijimit të vlerave, qëndrimeve, votimit, sjelljeve, veprimeve, njohjeve, përgjegjësisë, kërkesave, preferencave, etj., nuk ka ndryshim të procesit qeverisës dhe ndryshim institucional. Pra, kërkohej njohuri të qytetarëve mbi shkaqet dhe pasojat e veprimtarive të tyre në jetën politike dhe kuptimin e veprimtarisë e përgjegjësisë së institucioneve të ndërlidhura me rolin dhe përgjegjësinë e qytetarëve në këtë proces. Këto njohuri ishin të mangëta, andaj duhej investuar në thellimin e njohurive të qytetarëve mbi: institucionet, mënyrat e organizimit, procedurat, qëllimet, të drejtat, rolin, funksionet, obligimet, pasojat dhe përgjegjësinë e të gjithë aktorëve. Vetëdijësimi i qytetarëve për rolin që luan cilësia e angazhimit të tyre si votues, si qytetarë dhe marrja e përgjegjësisë në këtë proces ka rëndësi të shumëfishtë. Konceptimi i drejtë dhe i plotë i përgjegjësisë qytetare dhe i pjesëmarrjes në jetën politike, është më së e domosdoshme.

Pa pjesëmarrje cilësore e të përgjegjshme të qytetarëve, që nënkupton kulturë dhe traditë në këtë proces, nuk ka as elita politike e lidhshim cilësor dhe rrjedhimisht, as

qeverisje efektive demokratike. (KFOS, 2013) Pjesëmarrja dhe angazhimi i mirëfilltë i shoqërinë civile është faktor i domosdoshëm në kërkim llogaridhënie e qeverisësve në shumë mënyra. Kjo çështje në Kosovën ishte duke u konsoliduar. Konsolidimi i mirëfilltë ka për qëllim njohjen për pasojat e keqëqeverisjes, mënyrat e parandalimit, krijimin e qëndrimeve kritike dhe përgjegjësisë, kërkim kontrolli nga institucionet përkatëse, në veçanti përmirësimin e procesit të votimit dhe kundërshtimit qytetar me të gjitha mënyrat demokratike e institucionale. Pra, krijimin e kulturës politike njohëse, kritike e vepruese. Ndëshkimin me votë dhe me të gjitha manifestimet demokratike e ligjore ndaj keqëqeverisjes. Pa këtë kulturë nuk ka sistem demokratik të qeverisjes në Kosovë.

Cilësia vepruese e institucioneve varet nga votuesit, nga vetëdijes së tyre politike, vlerat dhe tradita, cilësia e informimit, edukimit dhe arsimimit, shëndetit, etj. Kjo varet nga fakti se sa qytetarët ishin përgatitur për debate e pjesëmarrje cilësore në vendimmarrje, në jetën publike e politike. Nga kjo varet edhe cilësia e votimit, cilësia e subjekteve politike, e lidershit, shoqërisë civile, medieve, etj., përkatësisht, rezultati konkret i veprimtarisë së tyre dhe i institucioneve në pajtim me rendin e sistemin juridik. Nga kjo kulturë u ndikuan edhe efektet e rezultatët institucionale 2008-2012, të cilat ishin pozitive, por edhe neglizhente e me rezultate jo të kënaqshme.

Kosova ka rini të shkathtë dhe fuqi punëtore të lartë, por të paangazhuar. (Enti Statistikor i Kosovës, 2007:16) Këtu kërkohet cilësi e arsimimit dhe e edukimit, që të përmirësohen shkathtësitë, aftësitë shërbyese, prodhuese, pjesëmarrëse e vendimmarrëse në të gjitha nivelet, në hap me nevojat, mundësitë, kërkesat e proceset e brendshme, rajonale e globale. Pra, në rolin e tyre në qeverisjen e vendit, si votues, si qytetarë e klientë të shërbimeve publike, si punëtorë e kapacitet ekonomik, rolin në integrim, në

luftimin e dukurive negative, respektim të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, respektim i i pakicës, respektim i mendimit të kundërt, etj. Pra, sovrani-qytetari dhe kultura politike e tij është themeli dhe shtylla më e rëndësishme e ndërtesës së sistemit politik dhe zbatimit juridik. Zgjidhjet kushtetuese dhe politikat konstitucionale demokratike, niveli social-ekonomik, shpërqendrimi i burimeve të pushtetit, etj., janë kushte dhe parakushte më së të domosdoshme, por ato kërkojnë edhe forca shoqërore e politike me traditë politike e kulturore qeverisëse demokratike. Në Kosovë kjo traditë mungonte, si rezultat i së kaluarës qeverisëse. Por, me rëndësi është kuptimi i nevojës së domosdoshme në orientimin e elektoratit dhe elitave drejt kuptimit dhe angazhimit për ndryshimin e gjendjes. Pra, Kosova nuk i kishte në nivelin e duhur vlerat kulturore si parakusht e faktor esencial për cilësinë demokratike qeverisëse, si: konsensusin votues-elitë, vlerat altruiste ndaj komunitetit, traditat pozitive ndaj institucioneve dhe ndaj së drejtës, traditat e respektimit të të drejtave të njeriut, arsimimin e njohuritë për kostot dhe përfitimet e qeverisjes demokratike, njohuritë mbi kostot afatgjata të keqqeverisjes, optimizmin, qëndrimin ndaj barazisë, ndaj korrupsionit, qëndrimet ndaj së kaluarës, marrëdhënieve ndër personale, përcaktimin për demokraci, etj. Ende nuk janë në nivelin e duhur. respekti ndaj individit, lirisë, ideja e barazisë, besimin në fuqinë e fjalës, rëndësinë e diskutimit dhe kulturës së debatit konstruktiv dhe kompromisit. Kemi mungesën e traditës së respektimit të të drejtave individuale, kemi vënie në rend të parë të klanit para individit, prirje ndaj dhunës, tendenca për qeverisje jodemokratike. Andaj, për të arritur efektet e duhura qeverisëse duhet ndryshuar kulturen qeverisëse.

Psikologjia politike shpjegon qartë shumë faktorë ndikues në qeverisje, si ligjësitë psikike e psiko-sociale dhe shkaqet e pasojat e tyre, shpjegon gjendjen e demokracisë së

një vendi përmes dukurive kulturore, sistemit të vlerave të vjetra e të reja, i grupeve e individëve dhe liderve.(Hana, 2009) Këto dukuri vlejné edhe në specifikat e realiteteve kosovare: në proceset zgjedhore, në ekonomi, qëndrim ndaj punës, menaxhimit, iniciativës biznesore, kulturës së ndërmarrësisë, qëndrimet ndaj pronës dhe ligjit.

Praktika qeverisëse e kaluar dhe kjo e sotme me cilësinë e mediave, ka krijuar opinione dhe kultur politike specifike në Kosovë.(TRENET, 2009) Niveli i ultë zhvillimor ekonomik privat dhe papunësia ekstreme, si dhe përqendrimi i pushtetit vendimmarrës i liderve partiak me dukurit negative të tyre, kanë krijuar sjellje dhe shprehje të mos përceptimit të drejtë të konkurrencës ndërpartiake, për moskuptimin e debatit dhe rolin e mendimit të kundërt, alergji të theksuar dhe kundërshtim e etiketim ndaj mendimit të tjetrit. Subjekti tjetër partiak nuk përceptohet si konkurrent dhe aktor i domosdoshëm i debatit por si kundërshtar dhe armik! Perceptimi i tillë ishte i fuqishëm tek elektorati kosovar dhe të lidershipi. Keqëqeverisjen e adreson jo të udhëheqja partiake për të cilën voton, por të kundërshtari partiak, pa marr parasysh faktet. Udhëheqjen e koncepton si sunduese dhe jo si përfaqësuese, shërbyese e përgjegjëse në rezultate.

Kultura politike dhe krijimi i opinioneve, janë në gjendje të palakmueshme. E gjithë kjo po ndikon tërthorazi në aktivitetin politik . (MEDIA, 2009) Ndjenja e përkatësisë partiake e lokaliste, po shfrytëzohet si mobilizim i simpatizantëve kundër partive tjera, dhe fajësim paushall e etiketues të partisë e kandidatit tjetër. Debatit politik është shumë primitiv, pa argumente të mjaftueshme dhe vetëm për ta degraduar, e jo për konkurrencë të mirëfilltë programore e qeverisëse. Këto sjellje po i praktikojné udhëheqjet partiake gjatë fushatave parazgjedhore dhe gjatë vendimmarrjeve në institucione, përmes medieve të varura, kritike të njëanshme e jo analitike sa duhet. Debatit politik bëhej shumë

polarizues dhe primitiv me qëndrime, sjellje e vlerësime emocionale pa njohje të mirëfilltë të fakteve, interesave, proceseve e programeve.

Në një ligjëratë mbi Demokracinë dhe shoqërinë civile në Kosovë, mbajtur në Shkollën Politike në Prishtinë, analisti J. Bugajski, ndër të tjera, theksonte:

Demokracia e konsoliduar në Kosovë mundë të arrihet më një sistem të qëndrueshëm partiak, ose le të themi një sistem i rregulluar partiak, bashkë me institucionet demokratike të qeverisjes, mediat e lira dhe një shoqëri civile që lulëzon, do të kontribuojnë në kontrollimin pengues të mudësisë së mbizotërimit të ekstremistëve, qofshin ata komunistë, populistë, nacionalistë ose të tjerë, ose të daljes në sipërfaqe të demagogëve autoritarë, ose e kundërta, një tatëpjetë e tij në shtet të dobët, të brishtë dhe në dështim e sipër, gjë që përbën një rrezik tjetër në rast të mungesës së një rrjeti demokratik në shoqëri. Për fat të keq kjo e fundit ende po ndodh. (Bugajski, 2008)

Vetëdijesimi i qytetarëve mbi shkaqet dhe pasojat e gjendjes së krijuar dhe mënyrat e tejkalimit të saj, mund të bëhej përmes: forcimit të shoqërisë civile; medieve të pavarura, analitike e kritike; krijimit të subjekteve e pikëpamjeve të mirëfillta opozitare; manifestimeve qytetare në forma demokratike e institucionale; sigurimit së procesit zgjedhor; debateve në shoqëri, në institute shkencore, debate të mirëfillta mediatike, debateve të mirëfillta pozitë-opozitë; etj. Të gjitha këto, do të sjellin kultur të re politike dhe ndryshime në proces. Do të sjellin qëndrime, sjellje e veprime konkrete të qytetarët dhe krijimin e subjekteve e lidershit tjetër. Por, të gjitha këto do japin rezultate, vetëm nëse ecet me rritjen ekonomike. Elitat keqëqeverisese vijnë nga votuesit dhe përkrahësit e tij jocilësor. Përhapja e korrupsionit për një kohë të gjatë ka ndikuar në krijimin e një kulture tolerante tek qytetaret. Votuesit, ndryshimin e gjendjes e mendojnë duke e përmbysur pozitën nga opozita jo me konkurrencë vlerash, programesh e me debate konstruktive. Ata nuk e kuptojnë sa duhet se, duhet ndryshuar të dyja njëkohësisht-poziten dhe opozitën; ndryshimin e menyrës se gjertanishme të qeverisjes, e jo rrotullimin e tyre.

Në rezultatet e mbikëqyrjes së qeverisjes ndikonte shoqëria civile dhe mediet, si dhe të mekanizmat përkatës institucional. Veprimtaria e një mori të OJQ-ve, vlerësuese të

qeverisjes, adresonin çështje të shumta dhe ishin të mirëseardhura. (Haxhikadrija & Hoxha, 2011) P.sh. grupet për mbrojtjen e mjedisit, ato për të drejtat e konsumatorëve, bizneseve të caktuara, grupet e komunitetit, sindikatat, iniciativat e shtresave të caktuara, lëvizjet dhe protestat kundër dukurive negative, etj, janë forma demokratike të pjesëmarrjes së qytetarëve, të cilat duhet të fuqizohen për t'i tejkaluar dukuritë negative në qeverisje. Të gjitha këto rrisin mbikëqyrjen, pjesëmarrjen qytetare dhe transparencën, përgjegjësinë e llogaridhënien. Pra, në krijimin e vlerave të reja dhe kulturën demokratike të qeverisjes. Por, sipas Raportit të Progresit “kuptimi i publikut për rolin e shoqërisë civile mbetet i ultë.” (KE, 2010:17) Ende nuk është në nivelin e duhur, por është punë urgjente për ta konsoliduar akoma më mire. (KCSF, 2010)

Merkel, W., analizon kulturën politike të vendet ish-komuniste-ndikimin e saj në konsolidimin e demokracisë në vendet paskomuniste të cilat, janë ndikuese në konsolidimin e sistemeve elektorale dhe përfaqësimit politik dhe tek cilësitë demokratike në qeverisje. Këto dukuri negative më të theksuara i sheh në grupin e dytë të “demokracisë defektoze” tek Serbia, Maqedonia, Shqipëria dhe Bosnja. (Merkel, 2010: 19-23). Edhe Kosova ka dukuri të shumta të “demokracisë defektoze”, por ka edhe specifikat e veta të shumta pozitive që janë si parakushte positive. Pritet një konsolidim i ri kultures politike.

Sfidat e demokracisë dhe sundimit të ligjit, nevojat për rritjen ekonomike, papunësia, varfëria, dukuritë negative, etj kërkonin kulturë të re politike demokratike më aktive. Gjeneratat e reja dhe proceset globale e evropiane në rajon, kërkonin krijimin e parakushteve për zhvillim e integrim. Andaj, asnjë grup politik i përfshirë në dukuri negative, nuk mund t'i frenoj këto procese për një kohë të gjatë, dhe pa vonesë do përballlet më forma të shumta kundërshtimi ndaj dukurive negative në institucione. Por, që

nga shpallja e pavarësisë e deri në fundin e vitit 2012, nuk kemi kundërshtime e manifestime serioze kundër kësaj gjendje.

Shpërqendrimi i pushtetit

Për qeverisje demokratike në Kosovë, kërkohet shpërqendrim-largim i pushtetit shtetëror e partiak ndaj burimeve shoqërore dhe ekonomike: në pronësi, kapital, dije, informim, shërbimeve publike dhe në kushtet për veprimtari biznesi dhe në marrëdhënie ekonomike e tregtare me jashtë. Pa zhvillimin ekonomik të sferës private, nuk mund të ketë shpërqendrim të pushtetit, por as shoqëri civile të mirëfilltë. Patjetër duhet shpërqendrimi i pushtetit mbi burimet dhe sektorët ekzistencialë. Ngase, deri më tani mundësitë për punësim dhe ekzistencë kishte kryesisht në sferat publike, drejtuese e të cilave janë elitat partiake dhe grupet e interesit e presionit në pushtet, të krijuara nga dukuritë negative në institucione e qeverisje; të cilat janë shndërruar në uzurpues të institucioneve dhe korporatave e ndërmarrjeve publike. Institucionet dhe qeverisja e mirëfilltë kosovare duhet t'i mbrojë dhe sigurojë qytetarët nga presioni i grupeve të presionit, nga grupet e korruptuara në pushtet dhe nga grupet e ndërlidhura me to. Këto grupe me këtë gjendje uzurpuese dhe me këtë përqendrim të pushtetit mbi burimet ekzistenciale, ishin pengesë për efekte pozitive të qeverisjes, ngase krijonin pasiguri për investime dhe rrjedhimisht mungesë konkurrence.

Votuesit në këtë situatë të varfërisë, papunësisë e joperspektivës (MPM, 2011:8) shumë lehtë manipuloheshin nga demagogjitë partiake, prandaj po vrapojnë pas uzurpuesve të pushtetit, duke shpresuar punësim në sferën publike dhe për ndonjë përfitim premtues. Dallimet në mes qeverisjes demokratike dhe asaj autokratike, Vanhanen e theksonte se “përqendrimi i burimeve të pushtetit çon në autokraci, kurse shpërqendrimi i

burimeve të pushtetit, në të shumtën e rasteve, në demokraci.”(Vanhanen, 2003) Në shpërqendrim të pushtetit, rol të madh luajnë format e shumta decentralizuese dhe zhvillimi i sferës ekonomike e shërbyese private me shtresat plurale dhe shoqërinë civile përkatëse. Në Kosovë kjo ende nuk kishte ndodhë. Seymour Martin Lipset në veprën Political Man, kërkonte shpërndarjen e burimeve e resurseve të pushtetit në shoqëri e ekonomi. Pra, pushteti të mos i zotërojë këto burime. (1960:48) Në këtë pikëpamje, Lipset fut edhe tregues tjerë të burimeve: p.sh. burimet e dijes, ekonomisë, gjendjes së pronësisë, pronësinë agrare, informacionit, etj., në raport me pushtetin. (1959:69-105) Në Kosovë analizat dhe treguesit nga monitoruesit vendorë e ndërkombëtarë tregojnë raste të shumta të pushtetit grupor institucional mbi burimet ekonomike publike dhe informacionit. Edhe privatizimi dhe shumë shërbime e kompani publike, ishin të ndërlidhura me grupet e korruptuara në institucione.

Qendrimet për reduktim, zvogëlim, jo shtrirje dhe shpërqendrim i pushtetit ndaj ekonomisë dhe shoqërisë, nuk d.m.th. zvogëlim dhe dobësim i sundimit të ligjit, përkundrazi, kjo kërkon forcim dhe fuqizim më të madh të efektivitetit e efikasitetit të institucioneve në sferat e sundimit të rendit dhe ligjit sipas kushtetutshmërisë. Pa këtë forcim të se drejtes dhe institucioneve nuk ka as reforma e as zhvillim ekonomik. Këtë sundim të se drejtes dhe forcim demokratik efektiv të institucioneve e kërkonte edhe Bashkësia Ndërkombëtare dhe proceset integruese. Këtë e thekson edhe Fukuyama:

“Një problem jetik me të cilin përballen vendet e varfëra, që bllokun mundësitë e tyre për zhvillim ekonomik, është niveli i papërshtatshëm i zhvillimit institucional. Ato nuk kanë nevojë për shtete të zgjeruara, por kanë nevojë për shtete të forta dhe efektive brenda fushës së kufizuar të funksioneve të domosdoshme shtetërore.”(2010:175)

Me këto probleme ishte ballafaquar edhe qeverisja kosovare me institucione të brishta e joefektive. Sipas teorive demokratike, kërkohet që së paku 45% të qytetarëve të

jenë të përcaktuar për qeverisje demokratike.(Inglehart/Wellzel, 2005: 300). Ky problem i numrave qëndron edhe në qeverisjen kosovare, si rezultat i përqendrimit të pushtetit, papunësisë e varfërisë, jozhvillimit të sferes private, vlerave e kulturës politike, medie, etj.,Ngase, votuesit vrapojnë pas liderëve e partive duke shpresuar në ndonjë përvetësim nga sektori publik, e jo për qeverisje të mirëfilltë demokratike. Ndërsa, gjysma e qytetarëve nuk merrnin pjesë në votime, ngase nuk e kishin besimin se mund t'i ndryshojnë praktikën egzistuese.

Vendet postkomuniste me shpërndarje më të madhe të pushtetit politik dhe ndarje më të madhe të pushtetëve, kanë arritur të krijojnë më shpejt një sistem të stabilizuar dhe efektiv, sesa vendet në të cilat pushteti politik ishte më i përqendruar. (Hellman, 1996) Në rastin e Kosovës kjo perspektivë është pakëz më e sigurtë si rezultat i shpërndarjes më të madhe të pushtetit në shumë aktor politik: vendor dhe ndërkombëtar, rregullimit kushtetues, sistemit zgjedhor proporcional, vetëqeverisjes komunale, garancave për pakicat, etj. Këtë shpërqendrim e bëjnë më efektiv edhe procesi i integrujes në BE. Pra, këta aktor dhe faktor shpërqendruar të pushtetit në Kosovë, sadoqë krijojnë vështirësi në vendimmarrje dhe në efikasitet, kanë krijuar parakushte për një sistem të stabilizuar demokratik.

Tradita dhe religjioni

Teoritë kulturaliste flasin edhe për traditën kulturore të përkatësive fetare të popullsisë, të ndërlidhura me formën dhe efektet në qeverisje. (Merkel, 2003; Anderson, 2004; Hunter & Malik, 2005) Në Kosovë kemi kulturë me një shkallë të lartë laike dhe kjo po ndikon që qeverisja demokratike të funksionojë më efektshëm se sa në vendet tjera me ngarkesa fetare fundamentaliste. Në Kosovë kemi ndarje të shtetit dhe jetës publike nga feja; nuk kemi ndikim të fundamentalizmit fetar në

politikë dhe në shtet. Në dispozitat e përgjithshme të Kushtetutës përkufizohet se Kosova është shtet laik me qëndrim neutral ndaj besimeve fetare, por siguron dhe mbrosh trashëgimnin kulturorë e fetare dhe siguron të drejtën dhe lirinë fetare (neni 8 dhe 9). Kundërshtarët e Pavarësisë, të lirisë e të demokracisë, përpiqeshin për ta instrumentalizuar religjionin në Kosovë, jo për ndonjë problematikë fetare, ngase ajo nuk ekziston, por për qëllime krejt tjera. Rol të tillë negativ dhe instrumentalizim, luajti Kisha ortodokse serbe, e cila u instrumentalizua në tërësi në funksion të politikës ekspansioniste serbe në Kosovë. Teritorin kosovar e konsideronte tokë të shenjtë serbe dhe shqiptaret si ardhacak. Këtë e bënte për ta indoktrinuor popullin serb dhe arsyetuar politikën gjenocidale e pastrimin etnik. Ngjashëm kishte vepruar edhe gjatë largimit të pushtuesit turk, kinse po e pastronte rajonin nga mbeturinat turke, duke bërë gjenocid dhe pastrim etnik të popullatës shqiptare nga trojet e tyre. Me këtë “arsyetohej” para opinionit të vendeve me ndikim. Ngjashëm përpiquej edhe gjatë rezistencës së viteve 90-ta dhe gjatë luftës 1998-99!

Identiteti kombëtar shqiptar të popullata shqiptare në Kosovë ishte i fuqishëm gjatë tërë shekullit të kaluar, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore e cila, fuqishëm kërkonte vetëvendosjen dhe afirmimin kombëtar shqiptar. Identiteti fetar të shqiptaret e Kosovës ishte i dorës së tretë. Ngritja e vetëdijes kombëtare te qytetarët dhe arsimimi mbi ecuritë historike dhe lidhja me perëndimin e informacionin, kurrsesi nuk lejonte, dhe nuk do të lejojë predikim me elemente fundamentale të fesë islame. Edhe qëndrimet e sistemit socialist-largimit të fesë nga institucionet shtetërore e publike e kishin efektin e vet. Popullata shqiptare e besimit islam në Kosovë, nuk posedon pikëpamje fetare të interpretimit ekstrem fundamentalist dhe as vlera e sjellje kulturorë

sikurse në disa vende islamike. Përkundrazi, ka një kuptim tradicional liberal, racional dhe jo emocional, ka kuptim të arsyeshëm për qëllimet burimore të fesë islame. Arsyet janë të shumta, por edhe përkatësia e mëparshme krishtere për një kohë të gjatë, ka ndikuar në kuptimin dhe interpretimin më të drejtë të fesë islame, duke mos lejuar krijimin e paragjykimëve për besimin krishterë. Në kuptimin burimor, feja islame nuk ishte kundër feve moniste para saj, përkundrazi.

Rinia kosovare dhe popullata për një kohë të gjatë është rritur në një ambient sekular, ku feja ishte pjesë marginale e identitetit të saj. (Forumi 2015, tetor 2011:7) Serbia dëshironte dhe dëshiron të shikonte ‘rolin’ e fesë në konflikte, me qëllimin e instrumentalizimit të përkatësinë fetare për t’i arsyetuar e mistifikuar pretendimet ekspansioniste territoriale. Ajo mbante shpresë se bota e krishtere perëndimore do të merrte qëndrime negative ndaj përkatësisë islame shqiptare dhe çështjes së Kosovës, dhe do t’i toleronte qëllimet ekspansioniste të pastrimit etnik të shqiptarëve, me arsyetim të përkatësisë islame.¹⁰⁰ (KCSF- CIVICUS, mars2011:20) Përpiquej të kompromitonte qëllimet e qarta kosovare për liri, demokraci e shtet të pavarur. Inteligjenca dhe popullata kosovare ishte dhe është e vetëdijshme për këtë. Në këtë kontekst, Ukshin Hoti shkruante:

Lufta e kombit shqiptar për liri nuk ka pse të instrumentalizohet si një luftë me terma fetarë midis kristianizmit ortodoks serb dhe myslimanizmit fundamentalist shqiptar. Kjo gjë është një absurditet. Te shqiptarët, ku ekziston një pluralitet fesh, nuk ka ekzistuar ndonjëherë një fetarizëm i lidhur me qenien etnike. Fundamentalizmi fetar për shqiptarët është një shpikje idiote dhe e kotë. (Kadare – Hoti, 2014)

Duke u nisur nga tradita dhe proceset specifike fetare dhe etnike në trojet shqiptare, pra edhe në Kosovë, gjatë shekujve të fundit në Lëvizjen kombëtare shqiptare u arrit

suksesshëm ideja e kombit mbi fetë si njohje dhe përcaktim i vetës si një komb modern. Oliver Jens Schmitt, këtë sukses ia vesh edhe faktorit të etno-politikës greke dhe serbe, e cila ngjalli frikën ekzistenciale të shqiptaret e të gjitha feve. Të gjitha se bashku kanë krijuar një identitet dhe vetëdije specifike kombëtare edhe për fenë dhe sjelljet përkatëse. (Schmitt, 2012:135,111-135) Sado që, në botën moderne, ndikimi i religjionit në politikë po rritet në kontekst të instrumentalizimit negativ të saj, në Kosovë instrumentalizimi i saj ishte i pa mundur, si rezultat i procesit të vetëvendosjes kombëtare, arsimimit dhe proceseve integruese. Në një hulumtim të Forumit 2015 konstatohet se rinia kosovare ka krijuar orientime properëndimore dhe me vetëdije kombëtare etnike e kulturore të theksuar dhe me vlera e sjellje demokratike perëndimore. (Forumi 2015, tetor/2011) Popullata e përkatësisë fetare islame në Kosovë ka orientim dhe synim integrimin europian. (UNDP, 2010) Në vetëdijen politike të qytetarët kosovar, dominojnë njohuri kognitive për problemet reale kosovare dhe për vlerat qeverisëse, ekonomike e kulturore perëndimore. (Forumi 2015, tetor 2011) Shumica e familjeve kosovare apo gjysma e tyre tani jetojnë, punojnë, veprojnë, arsimohen dhe edukohen në vendet perëndimore dhe janë të ndërlidhura fuqishëm me Kosovën. Informimi dhe proceset globale të rinia kosovare, kanë hapur perspektiva të njohjeve të shumanshme që tejkalojnë mentalitetin feudal mbi fenë dhe interpretimin e proceseve në frymën dhe praktikën feudale. Në një hulumtim të opinionit mbi përceptimin e problemeve që ballafaqohet aktualisht Kosova, në kontekst të ekstremizmit fetar, të bërë nga Forumi 2015, konstaton se „ekstremizmi fetar nuk figuron si problem madhor, vetëm 1.% të të anketuarve e konsiderojnë atë si problem serioz” (Forumi 2015, tetor/2011:7)

Në Kosovë nuk kishte konflikte ndëretnike dhe ndërfetare, madje as me komunitetin pakicë serbe në Kosovë. Politika e Serbisë e keqpërdorte dhe e instrumentalizonte pakicën serbe në Kosovë, së bashku me aparatën ushtarakë dhe policor kundër popullatës shqiptare. Kjo tolerancë ndëretnike në mes të përkatsisë shqiptare dhe asaj serbe në Kosovë shihet edhe nga pranimi i subjekteve politike kosovare dhe nga ana e qytetarëve, që t'u garantohet e respektohet një pozitë tejte e avancuar komunitetit serb dhe komuniteteve tjera pakicë në shtetin e Kosovës. Në Kosovë nuk kishte konflikt etnik e as ndërfetar, por Serbia kishte qëllim përvetësimet territoriale të Kosovës duke e keqpërdorur pakicën serbe dhe fenë. Ngjashëm kishte ndodhur edhe në të kaluarën duke e larguar përkatsinë shqiptare nga trojet e tyre.

Charlotte Keenan, shefe ekzekutive e Fondacionit dhe projektit universitar "Faith and Globalisation Initiative," të Tony Blair, projekt universitar që tani operon në 20 universitete ndërkombëtare, me qëllimin për të gjetur "vakumin e njohurive" për rolin e fesë dhe përdorimin e fesë në politikë, thotë se dëshiron të mbështet përpjekjet për të parandaluar një konflikt fetar në Kosovë. Gerantina Kraja, studiues e kësaj problematike në këtë institucion, thekson se:

Ne besojmë se, nëse dëshironi që të kuptoni botën moderne atëherë duhet ta kuptoni ndikimin e religjionit në të...ambicet e një konflikti fetar në Kosovë mund të duken modeste, por janë ambicie. Kosova është një kazan i jashtëzakonshëm i kontradiktave. Është një shembull i jetës së identiteteve të ndryshme. Nëse "ballkanizimi" do të thotë fragmentim i shteteve në pjesë të papërputhshme, atëherë Kosova është e Ballkanizuar në standarde të Ballkanit. Shumica e popullsisë janë shqiptarë etnik, shumica mysliman, edhe pse emërimi i sheshit kryesor më emrin Nëna Terezë reflekton se aty ka edhe të krishterë. Kemi edhe minoritetin e vogël serb në rajon që kanë një lidhje të fort historike me serbët, për këtë Serbia nuk e njeh shtetin dhe legjitimitetin e Kosovës. Dëshironte të shikonte rolin e fesë në konflikte, më qëndrimin se kjo mund të bëhet një pikë diplomatike e verbër. Përderisa ishte e zakonshme të analizohen konfliktet në terma të ideologjisë, ekonomisë dhe tensioneve etnike, roli i fesë ishte lënë në njërin anë, si një fantazmë në mekanizmin e paqebërjes...Besimi nuk e shkaktojë luftën, sepse ajo kishte të bënte me territore.... (Kraja : BBC- 3 July 2013)

Të gjitha faktet tregojnë se ambicet e instrumentalizimit të feve në Kosovë janë modeste. Sado që ka "identitete të shumta" në Kosovë, ato nuk janë kontradikta që

burojnë nga jo toleranca fetare. Dallimet identitare fetare nuk janë fare kontradiktore. Pas largimit të pushtuesit serb dhe shpalljes së Pavarësisë, Kosova është një shembull i mirë i jetesës së identiteteve të ndryshme. I vetmi problem serioz ka qenë integrimi i pakicës serbe, ngase ishte e dirigjuar nga politika destruktive e Serbisë. Problemi mund të ndodhë vetëm nëse lejohet e përkrahet ndërhyrja e politikës ekspansioniste e Serbisë kundër sovranitetit, kundër lirisë dhe qeverisjes e institucionalizimit kosovar. Pra, kjo nuk ka të bëjë fare me religjionin. Shoqëria kosovare është e preokupuar për zhvillim dhe integrim me botën perëndimore e globale, pra nuk është e “preokupuar” me paragjykime e dallime fetare. Dallimet fetare të feve moniste nuk janë fare kontradiktore nëse interpretohen drejtë, por ato dallime formale keqpërdoren për qëllime e interesa tjera, që nuk kanë të bëjnë fare me besimin. Shoqëria kosovare i ka të qarta këto tendenca e qëllime negative që vijnë nga jashtë. Tradita, kultura, arsimimi, informacioni dhe synimet zhvillimore kosovare, janë me orientim të qartë properëndimor.

Kosovarët kishin dhe kanë nevojë, jo për identitet fetar, por për identitet të lirë kombëtar dhe shtetëror që siguron shoqëri të lirë, të zhvilluar e demokratike. Këtë identitet të synuar e kishte penguar Serbia për përvetësime të territoreve. Këto i kishte dhe i ka të qarta popullata kosovare. Shkatërrimi i xhamive gjatë luftës nuk u bënte përshtypje kosovarëve të besimit islam, ngase ata i dinin qëllimet e vërteta të Serbisë. Ndjenjat fetare islame të shumica kosovare janë më shumë besime të bazuara në meditime mbi botën, e jo emocione ekstreme afektive. Shqiptarët e Kosovës nuk kanë paragjykime ndaj religjioneve tjera moniste. Andaj, ndikimet negative të religjioneve në institucionet dhe qeverisjen kosovare janë me mundësi të vogla, sa do që do të ketë përpjekje dhe qëllime negative, ndaj të cilave duhet vepruar më transparencë e debat intelektual të sinqertë.

Pikëpamjet e Huntington-it, se konfliktet politike në botë do të përplasen në mes të qytetërimeve, si dhe paralajmërimi se vendet lindore të cilat janë më të lidhura me perëndimin në fushën e historisë dhe të fesë do të kenë më shumë sukses në vendosjen dhe zhvillimin e regjimeve demokratike, (Huntington, 2011:325) në rastin e Kosovës si rezultat i të gjithë faktorëve e rrethanave të lartë theksuara në këtë punim, sukseset në vendosjen dhe zhvillimin e qeverisjes e kultures demokratike nuk do të mungojnë. Gjatë viteve të 90-ta, u arrit lidhja e drejtëpersedrejtë e Kosovës me perëndimin, e cila do të sjell suksese në zhvillimin e demokracisë qeverisëse, se sa vendet tjera në rajon. Kjo po kushtëzohet nga nevojat dhe përpjekjet e rinisë kosovare për zhvillim e mirëqenje. Por, pengimi i instrumentalizimit negativ të religjioneve për të manipuluar qeverisjen dhe institucionet është gjithëherë i domosdoshëm. Kjo vlenë edhe për Republikën e Kosovës.

Rrethanat ndërkombëtare e rajonale

Vendet që shtrihen në mesin e vendeve të zhvilluara e demokratike, e kanë më lehtë qeverisjen demokratike. Por, Kosova nuk e kishte këtë privilegj, veçmas sa i përket vendeve fqinje dhe konfrontimeve të sferave të interes të vendeve më ndikim. Faktor tjetër me rëndësi për qeverisje demokratike kosovare janë rrethanat ndërkombëtare pro demokratike, proceset integruese të rajonit në BE, pozita ndaj tregjeve e proceseve globale në rajon, etj. Ndryshimet e pas viteve 90-ta, proceset integruese evropiane, proceset globale ndaj rajonit, pozita gjeografike, pozita ekspozuese të tregut global, investimet regjionale etj., janë forcë ndikuese dhe rrethana për proceset pozitive konkrete në Kosovë, kuptohet krahas angazhimit të faktorit kosovar. Ndikimet negative nga Serbia dhe rivalitetet e vendeve me ndikim ndaj rajonit dhe ndaj Kosovës, ndikuan drejtpërdrejt edhe në efektet qeverisëse si dhe në institucionalizimin në Kosovë. Të gjitha këto krijuan

pengesa e vonesa në qeverisje, në reforma, në integrim dhe rrjedhimisht në pengesa serioze në zhvillim dhe në konsolidimin demokratik në Kosovë. Por, proceset globale integruese dhe veprimtaria e organizatave ndërkombëtare, vendet me ndikim pozitiv dhe nevojat vendore, po ndikojnë në detyrimin e çdo vendi, veçmas në Kosovë, të përfillë dhe të inkorporojë konventa e praktika qeverisëse mjaft demokratike e të dobishme për qytetarin dhe për shoqërinë kosovare në raport me institucionet dhe qeverisjen. P.sh. Aspekti kushtetues dhe kërkesat e tyre për respektimin e të drejtave të njeriut, të pakicave, kërkesat për sundimin e rendit dhe ligjit; kërkesat për reforma institucionale politike, ekonomike, juridike, informative, investuese e kulturore, janë duke dhënë rezultate, por qendrimet e Serbisë dhe toleranca e Bashkësisë së ndërkombëtare ndaj qendrimeve e sjelljeve të saj, ishin të patolerushme.

Shoqëria civile dhe mediet e pavarura

Demokracia, mund të funksionojë vetëm nëse janë të fuqishme ndikimet dhe kontrolli i qeverisjes edhe nga shoqëria civile. (Mati & Silva, Anderson, 2010, 2008-2010) Janus Bugajski, ndër të tjera thekson se, konsolidimi i qeverisjes kosovare duhet të :

përfshijë edhe zgjedhje të rregullta me pjesëmarrjen e përgjithshme të qytetarëve dhe përfshirjen e shumë partive, kandidatëve dhe votuesve, të zgjedhjeve të paanshme dhe të pavarura nga ndikimi i qeverisë apo kontrolli i ndonjë partie politike, transparencën e qeverisë para parlamentit për zbatimin e politikave, llogaridhënien ligjore të gjykatave për të siguruar që zyrtarët të veprojnë sipas ligjit, llogaridhënien financiare gjykatave në përputhje me ligjin në fuqi, garantimin e të drejtave politike dhe civile, përfshirë të drejtën e shprehjes të hapur të pakënaqësisë, janë absolutisht kyçe. Përveç kësaj, kjo përfshin edhe ekzistimin e një shoqërie civile të zëshme, të përbërë nga një rrjet i tërë organizatash përmes të cilave njerëzit mund të zgjidhin problemet e tyre, një shoqëri civile e cila i vë kufizime pushtetit të qeverisë dhe që kanalizon vendimet qeveritare në veprime praktike.¹⁰¹ (Bugajski, 2008)

Të gjitha këto përpjekje pozitive ishin prezente në Kosovë, por ende janë në hapat e pare të konsolidimit dhe efektivitetit. Teoritë e demokracisë perëndimore e theksojnë

pozitivitetin e aktivizimit politik të qytetarit përmes shoqërisë civile aktive. Pa shoqërinë civile, pa forcat shoqërore që vijnë nga poshtë, elitat partiake nuk mund të bëjnë shumë. Nëse mungon cilësia qytetare aktive e kritike dhe e përgjegjshme, elita partiake në rrethanat e krijuara lehtë deformohen. Roli dhe ndikimi i shoqërisë civile dhe i qytetarëve kosovarë me aktivitet të qartë, e pasuruan procesin qeverisës në Republikën e Kosovës. Kërkohej që shteti t'i shërbejë shoqërisë, e jo shoqëria t'u shërbejë interesave të ngushta grupore. Procesi i demokratizimit dhe tranzicionit në Kosovë kërkon ndryshim të raportit në mes të shtetit dhe shoqërisë. Pra, tejkalimin e raportit të vjetër, kur shteti nuk i shërbente shoqërisë, por e sundonte atë. Edhe Raporti i Progresit thekson se „ambienti në të cilën OJQ-të operojnë, duhet të përmirësohet me të madhe.” (KE: Raporti i Progresit, 2010:17) Roli dhe funksionet e shoqërisë civile dhe medieve për realizim të qeverisjes demokratike, janë të kërkuara e të garantuara me kushtetutë e ligje. Komisioni i pavarur i medieve, si institucion i pavarur ka kompetencat e veta për të ndikuar në implementimin e pavarësisë së medieve. Ato kanë filluar të luajnë rol pozitiv në pasqyrimin dhe aktivitetin kritik ndaj dukurive negative në procesin qeverisës, në transparencën dhe efektet e saj. (KPM, 2012) Dhe anasjelltas, instrumentalizimi negativ i tyre po ndikonte në krijimin e njëanshëm të opinionit. Grupet e interesit publik, si: sindikatat, shoqatat, mediet e pavarura, OJQ-të, institutet, etj. jashtë ndikimit të partive dhe grupeve në pushtet luanin rolë dhe ndikim pozitiv në procesin qeverisës. Edhe qeverisja e institucionet e krijojnë vullnetin politik përmes medieve. Forcimi i shoqërisë civile përmes OJQ-ve, e pasuronte spektrin e grupeve të interesit publik. Por, mungonin grupet e mirëfillta të interesit me karakter ekonomik, si rezultat i jo zhvillimit dhe organizimit të pamjaftueshëm. OJQ-të e shumta po krijojnë opinione dhe transparencë, por atyre u mungonin shtresat përkrahëse

të grupeve të interesave të caktuara. Ato po financohen nga donatorët e jashtëm dhe u mungonte mbështetja e shoqërisë civile. (UNDP: Raporti i zhvillimit Njerëzor 2008)

Sa i përket rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve për ndikim në qeverisje dhe institucione, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me CIVIKOS kanë hartuar strategjinë qeveritare për bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë për periudhën 2013-2017, e cila ka për qëllim ta përmirësojë procesin e konsultimeve dhe të bashkëpunimit lidhur me mënyrën e hartimit të legjislacionit në bashkërendim me organizatat e shoqërisë civile dhe për konsultime publike. Qeveria, për ta përmirësuar këtë kontekst, ka vendosë që Ministria për Integritet Evropian dhe një përfaqësues i shoqërisë civile si bashkë-udhëheqës i procesit ta angazhohet që, Qeveria e Kosovës të përkushtohet ndaj një qeverisjeje më transparente dhe të përgjegjshme, për të përmirësuar integritetin publik dhe për të rritur besimin tek qytetarët. Nga raportet e qeverisë dhe hulumtimeve të Forum 2015 - projekt operacional i KFOS-it, konstatonte se:

Qeveria e Kosovës ka marrë veprime relevante. Sipas urdhëresës administrative nr. 7/2008 të Ministrisë së Administratës Publike, të gjitha institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës janë të obliguara t'i krijojnë faqet e tyre të internetit ose t'i përmirësojnë ato ekzistueset si mjet për rritjen e transparencës....Krijimi i zyrës qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile mund ta forcojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike dhe qytetarëve dhe ta rrisë pjesë- marrjen publike. Publikimi i të dhënave në e-portalin e Qeverisë së Kosovës dhe në faqet e internetit të institucioneve përkatëse janë mjetet kryesore teknologjike që shfrytëzohen për t'ua ofruar qytetarëve të dhënat më afër dhe për ta rritur transparencën. (KFOS, 2013)

Shoqëria civile dhe grupet e interesit lokal kanë filluar të fokusohen në çështjet specifike dhe në shqetësimet për arritjen e rezultateve konkrete, si shtrimi i rrugëve, furnizimi me ujë, kanalizimi, ambienti, shërbimet konkrete publike komunale, shërbimet e administratës lokale, etj. Ky aktivitet ka filluar t'i bëjë autoritetet lokale më të përgjegjshme duke arritur rezultate konkrete. Veprimtaria e tyre në këtë drejtim kishte filluar dhe është në konsolidim e sipër. Ato po bëjnë presion ndaj qeverisjes dhe institucioneve për më shumë llogaridhënie. (KCSF, 2010, 36-40)

5.4. Të drejtat e njeriut dhe të pakicave

Të drejtat e njeriut

Fuqia e qeverisjes dhe e kulturës demokratike të çdo vendi matet përmes nivelit të implementimit përmbajtësor të lirive dhe të drejtave të njeriut. Liritë dhe të drejtat e njeriut janë gurë matës i demokracisë qeverisëse kosovare. Të drejtat politike dhe sociale të njeriut, shprehen përmes realizimit të politikës pjesëmarrëse të qytetareve në vullnetin politik, në vendimmarrje dhe në proceset shoqërore. Liritë pozitive përfshijnë: liritë themelore të shprehjes, lëvizjes, mbledhjes, organizimit, pjesëmarrjen e qytetarëve për të maksimalizuar rolin llogaridhënës të qeverisë, përfshirë të drejtën për të garuar për poste publike dhe për të votuar, kode adekuate administrative, përfshirë llogaridhënien qeveritare dhe informimin e publikut, të drejtat adekuate sociale dhe shëndetësore, të sigurisë dhe arsimimit, të drejtën e votës së lirë, e cila shpreh sovranin në raport me qeveritarët. Të gjitha të drejtat dhe liritë e tilla kosovare në aspektin juridik formal-kushtetues e ligjor, u garantohen të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh etninë, vullnetin e shumicës ose të pakicës. Ato mbrohen me Kushtetutë dhe me ligj. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës këtë sferë e rregullon Kapitulli II me nenet 23-56. Pas shpalljes së pavarësisë në Kosovë ka filluar zbatimi dhe respektimi praktik i tyre.

Përfaqësuesja e lartë për Politikë të Jashtme e Siguri e BE-së, Catherine Ashton, në emër të Bashkimit Evropian për Ditën e të Drejtave të Njeriut, më 10 dhjetor 2012 në Bruksel, në kontekst të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, të cilat janë paraqitur përmes institucionit të Avokatit të Popullit, deklararon:

Sot, më 10 dhjetor, ne e festojmë Ditën e të Drejtave të Njeriut. Ngritja e zërit për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit është fije ndriçimi e cila i drejton marrëdhëniet e jashtme të BE-së. Këtë vit e kujtojmë si vit produktiv për BE-në në të drejtat e njeriut. BE-ja e miratoi Strategjinë për të Drejtat e Njeriut për të shtuar efikasitetin dhe konsistencën e politikave të BE-së për të drejtat e njeriut me një shtrirje të plotë të aktiviteteve të saj...Shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, të

cilat janë paraqitur tek institucioni i Avokatit të Popullit, kanë shënuar rritje për rreth 12 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Mbi 40 për qind e ankesave janë të drejtuar kundër ekzekutivit, rreth 36 për qind janë kundër gjykatave, ndërsa të tjerat adresohen te ndërmarrjet publike. Diskriminimi dhe shkelja e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me ligje, reflekton nivelin e ulët të shtetit ligjor. Qeveria, e cila duhet të zbatojë ligjet, ndërsa gjykatat që duhet të ndajnë drejtësinë, po e mbyllin edhe një vit problematik me sfida të patejkaluara. Të drejtat e njeriut ...fillojnë të shkelen që nga fëmijët, të cilët bëjnë punë të ndaluara me konventat ndërkombëtare, e deri te pensionistët, të cilëve u mohohet e drejta në pension, bazuar në kontributet shumëvjeçare. Për shumë kategori, mospërfillja institucionale do të vazhdojë. Dhuna në familje, sidomos ndaj gruas, mbetet shqetësuese, kërcënimet ndaj gazetarëve vazhdojnë...Ky mozaik shkeljesh e abuzimesh me të drejtat e njeriut, e bën Kosovën të duket krejt ndryshe nga ajo që parashihet në legjislacionin tonë, ku jepen garanci të shumta. Mungesa e shtetit të së drejtës është duke e nxitur edhe vetëgjyqësinë...Mosbesimi në gjykata po e shton pasigurinë e qytetarëve, të cilët kërkojnë rrugë alternative, por joligjore për të vënë drejtësinë në vend. Institucionet duhet t'i marrin shumë më seriozisht shembujt e abuzimit me të drejtat e njeriut, për të ndikuar që vitin e ardhshëm të kemi sa më pak raste të tilla. (Ashton,PJS e BE,10/12/2012 paraqitur nga institucioni i Avokatit të Popullit)

Kjo deklaratë e përshkruan gjendjen e nivelit të respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë. Kur kësaj i shtojmë edhe gjendjen e varfërisë, papunësisë, politikës sociale dhe nivelin e shërbimeve bazë publike, atëherë gjendja nuk mund të vlerësohet e mirë. Edhe pozita e qytetarit në raport me disa nga institucionet nuk ishte e kënaqshme. (Raportet e Shtetit, 2012) Në aspektin normativ kushtetues, ligjor e procedural kemi përcaktime juridike pozitive, por implementimi dhe zbatimi i tyre real dhe i plotë mungonte. Neni 21 i Kapitullit II të Kushtetutës thekson: „Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. (Neni 21, K-II)

Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, janë garantuar me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të cilat përfshihen në Kapitullin II të Kushtetutës, që duhet të zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe të cilat kanë prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave, ligjeve dhe veprimeve të institucioneve publike në Kosovë. Këto akte janë:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor

- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
 - (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
 - (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.
- (Nenin 22)

Megjithatë, për shkak të vonesës në integrim dhe pamundësisë së gjertanishme që të jetë anëtare e Këshillit të Evropës, Kosova dhe qytetarët e saj gjenden në një situatë të pavolitshme, në raport me sistemin evropian të të Drejtave të Njeriut, që është i ndërtuar kryesisht rreth Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qytetarët e Kosovës nuk kishin qasje në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si instanca e fundit legale që garanton respektimin dhe interpretimin e të drejtave të përcaktuara në këtë Konventë. Kushtetuta e Kosovës, edhe pse Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka pjesë të sistemit të vet juridik, qytetarët e saj si bartës të të drejtave, nuk mund të përfitojnë nga ky sistem. Kosova ende nuk është pjesë e Këshillit të Evropës dhe rrjedhimisht, qytetarët e saj nuk mund të aplikojnë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat nga institucionet publike. Qytetarët mbeten nën mëshirën e gjykatave dhe administratës publike vendore, ngase vendimet e tyre nuk mund të apelojnë përtej Gjykatës Kushtetuese. Kur është fjala për të drejtat e njeriut, gjyqësori dhe administrata nuk brengosen të rrisin cilësinë e performancës së tyre në fushën e vendimmarrjeve në frymën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pra, duke mos qenë pjesë e këtij sistemi dhe duke mos pasur “frikën” se aktgjykimet e tyre do të rrëzohen në Strasburg, gjykatësit tanë nuk e shohin të nevojshme të rrisin performancën e tyre në frymën e praktikës gjyqësore të Strasburgut.

Duke qenë i izoluar nga sistemi evropian i të drejtave të njeriut, sistemi gjyqësor përformon dobët. Edhe për këto arsye është i rëndësishëm integrimi i Kosovës në institucionet e BE-se, ngase lidhen instrumentet institucionale evropiane me qytetarët e

vendit dhe institucionet vendore kosovare nuk mund të jenë “sovrane” të dukurive negative, ngase kontrollohen edhe nga drejtësia e jashtme, nga mundësia dhe e drejta për t’i përdorur ato. Andaj, edhe për këtë qeverisja e shoqëria kosovare dhe Bashkësia Ndërkombëtare duhet të bëjnë hapa paraprakë drejt integritit, për t’i përmirësuar të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe qeverisjen kosovare, sipas këtyre standardeve. Zvarritja e proceseve gjyqësore nga gjykatat paraqet një ndër shkeljet më të shpeshta të të drejtave të njeriut. Këtë e pohojnë edhe raportet e Ombudspersonit kosovar dhe një mori organizatave të jashtme dhe OJQ-të vendore, si dhe opinionet e qytetarëve, e edhe vetë institucionet. (Raportet e Ombudspersonit 2011,2012; Raportet KGJK, 2012; Raporti i GjEA 2012; BGK,2013; KKK, 2012)

Nga 31 të drejta të garantuara në Kapitullin e II të Kushtetutës, vetëm katër kanë karakter ekonomik, social e kulturor, pra vetëm njëra u takon të drejtave të solidaritetit (mbrojtja e ambientit). Ndër dokumentet që mungojnë janë Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Karta Sociale Evropiane. Mungesa e këtyre të drejtave dhe sidomos, mungesa e instrumenteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat ekonomike dhe sociale nuk janë pjesë e Kushtetutës së Kosovës dhe qeverisjes, ngase ka implikime financiare. Por, këto të drejta janë esenciale për të drejtat reale të njeriut për krijimin e mundësive të barabarta për zhvillim human. Arsyetimi financiar qëndron, por Kushtetuta e Kosovës duhet të përfshijë edhe këto të drejta, të cilat do të krijojnë kushte për një mbrojtje më të mirë të të drejtave ekonomike dhe sociale të shtresave më të brishta të shoqërisë kosovare. Pra, roli i qeverisjes në shpërndarje ishte i pa konsoliduar sa duhet në këtë sferë. Edhe pse Buxheti i Kosovës ishte i pa mjaftueshëm, fillimi i praktikave të tilla me sasi të ulëta financiare do të ishte mjaft pozitiv, ngase do e rriste sigurinë dhe të

drejtat e njeriut. Në sajë të ndihmës sociale familjeve pa të ardhura dhe pensionet e pleqërisë që po praktikohen, kishin përmirësime në zbutjen e varfërisë por ato ishin të pamjaftueshme. Avokati i popullit (Ombudspersoni) ka paralajmëruar një kaos shoqëror e institucional në Kosovë, me ndikim në gjendjen e të drejtave të njeriut:

Kjo që po ndodh në Kosovë do ta dërgojë vendin drejt një kaosi, ku më i forti do ta marrë ligjin në dorë... nuk jam optimist se vendi mund të shkojë përpara, pa bërë ndonjë revolucion institucional në vend... me reforma të vogla asgjë nuk mund të ndryshohet në këtë vend... Qeveria e Kosovës ka pasur tendenca të vazhdueshme për bllokimin e punës së Ombudspersonit...Gjyqësori është shkelësi më i madh i të drejtave të njeriut... Numri më i madh i ankesave të qytetarëve në institucionin e Avokatit të Popullit është i drejtuar kundër gjyqësorit, e këtu po e përfshij edhe prokurorinë. Gjyqësori në Kosovë nuk bën shkelje të drejtpërdrejtë, por bën shkelje moderne...këta janë shkelësit në kuptimin e mosrealizimit të të drejtave...Gjyqësori bën shkelje sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë, të drejtës për gjykim në afat ligjor, vonon ekzekutimin e vendimeve, e këtu është problemi më i madh.¹⁰² (korrik,2012)

Edhe informimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mundësitë dhe të drejtat ka ndikim. Sa më shumë njohuri që qytetari do të ketë për të drejtat e tij, mundësitë, obligimet e përgjegjësitë, aq më aktiv e cilësor do të jetë ai në synimin për t'i realizuar ato. Duke qenë aktiv, ai do të bëjë presion në sistemin juridik, politik dhe administrativ që të sigurojë më mirë liritë dhe të drejtat e njeriut. Andaj, institucionet duhet t'i informojnë sa më shumë dhe qartë qytetarët për të drejtat e tyre dhe procedurat e mekanizmat e mbrojtjes së tyre. (Iniciativë e të Rinjve për të Drejtave të Njeriut, 2010) Jozeph and Welch, në proceset avancuese të marrëdhënieve ndërkombëtare, theksojnë se “shtetet kanë detyrim të mbrojnë të drejtat e njeriut e të qytetarëve të tyre, kurse veprimtaria e komunitetit ndërkombëtar e ka përgjegjësinë për të mbrojtur individët që viktimizohen nga qeveritë e tyre, kjo praktikë po merr ndikim gjithnjë më të madh.” (Jozeph & Welch, 2013:561) Konstatime për nivelin jo respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë, bëhen edhe nga *Freedom House* dhe *Organizata Amnesty International*. (shih: Raportet, 2008-2012)

Edhe në procesin e amendamentimit të Kushtetutës, ekziston procedura e sigurimit të drejtave de lirie: “Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet t’i referojë Gjykatës Kushtetuese amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.” (Neni 113) [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] Megjithatë, dihet se nuk mjaftojnë vetëm dispozitat kushtetuese e ligjore, por ato duhet të realizohen me veprime faktike në terren. Prandaj të gjitha institucionet duhet të luajnë një rol më aktiv në promovimin dhe ngritjen e vetëdijes te zyrtarët publikë dhe të zbatuesit e ligjit, mbi përgjegjësinë për implementimin e legjislacionit në fuqi që siguron liritë dhe të drejtat e njeriut.

Të drejtat e komuniteteve pakicë

Sipas propozimeve të Planit të Ahtisarit, prioriteti kryesor që duhej përmbushur institucionet dhe qeverisja kosovare, ishin respektimi i të drejtave të pakicave përmes garancive kushtetuese e ligjore dhe implementimit të tyre. Këto obligime ishin obligative dhe të dobishme për qytetarët e saj dhe obligime e rekomandime ndërkombëtare. Plani i Ahtisarit e përmban fuqishem këtë komponentë: “Kosova do të krijojë kushtet e duhura të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, mbrojnë dhe zhvillojnë identitetet e tyre.” (Neni 2) Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale ka qenë e lidhur ngushtë me garantimin e të drejtave të komuniteteve dhe përfaqësuesve të tyre me rastin e delegimit të autoritetit nga niveli qendror në atë lokal. (Council of Europe Publishing: March 2010:9) Në përputhje me këto parime, filloi reforma e pushtetit lokal në Kosovë në vitin 1999/2000, dhe pas pavarësisë me Kushtetutë e ligje. (MPL, gusht, 2013) Të gjitha obligimet për respektimin dhe garantimin e të drejtave të pakicave,

Kosova i arriti me sukses, të cilat u vlerësuan edhe në përmbylljen e mbikëqyrjes ndërkombëtare.(2010) Këto obligime janë arritur me përkushtim institucional dhe nga shoqëria civile e qytetarët, të cilët pas shpalljes së Pavarësisë morën përgjegjësinë për respektimin e të drejtave të komuniteteve pakicë.

Në Kushtetutën e Kosovës, në Kapitullin III (Nenin 57-62) [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre], përcaktohet se Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre, por edhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre: fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre; të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, të marrin arsimim në gjuhën e tyre, të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare; të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike; të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për interpretuesit ose përkthyesit, do të mbulohen nga autoritetet kompetente; të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare; të krijojnë dhe të përdorin mediet e tyre vetjake; të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor e fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare, të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe

shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, K. III, Neni 57-62)

Kushtetuta në (nenin 60) Kapitulli III, parasheh një Këshill Konsultativ për Komunitete, i cili vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve.

Mandati i këtij Këshilli Konsultativ për Komunitete parasheh:

- (1) ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;
- (2) mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse; (K-III, Neni 60.1-2)

Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë: “për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë shërbimin policor në zonat e banuara nga komuniteti përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.”(Neni 61) Implementimi i gjertanishëm i të gjitha këtyre përcaktimeve dhe obligimeve juridike, është mjaft inkurajues. Këto suksese nuk janë vetëm tek institucionet, por edhe të kultura tolerante e përkrahëse në realizimin të këtij obligimi nga shoqëria kosovare. Kjo vlerë është e thelluar të rinia kosovare e cila i ka konceptuar drejt vlerat e diversitetit dhe multietnicitetit.

Përfaqësimet e garantuara në nivel qendror dhe komunal, në të gjitha institucionet kryesore dhe në administratë u arritën me sukses. Përfaqësimin e komuniteteve etnike pakicë në institucionet qendrore e lokale të qeverisjes, është tejte e avancuar:

- 1.Në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve.
3. Zëvendëskryetari për komunitetet, do të promovojë dialog ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punët e saj

4. Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës. (Neni 62, p. 1,3,4) [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal]

Kapitulli III I Kushtetutës, përcakton Kompetencat e zgjeruara vetjake komunale ku garantohen të drejtat dhe përgjegjësitë e avancuara për komuna të caktuara në Kosovë, siç është Komuna e Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe e Shtërpçës, komuna multietnike:

a. Autoritetin për të ushtruar përgjegjësinë për çështje kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore të serbëve dhe të tjerëve brenda territorit komunal... b. Të drejta të avancuara pjesëmarrëse në zgjedhjen dhe shkarkimin e komandantëve të stacioneve policore, 4.2 Për sa u përket këtyre kompetencave të zgjeruara vetjake, Kosova do të nxjerrë legjislacionin kornizë për të ofruar qasje të barabartë ndaj shërbimeve publike; standard minimale cilësore dhe sasiore në ofrimin e shërbimeve publike; 4.3 Komunitet që zbatojnë kompetencat e zgjeruara vetjake mund të bashkëpunojnë me çdo komunë tjetër në ofrimin e shërbimeve të tilla. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, K-I, Nenin.4.1-7)

Në Nenin 6 të K-III, rregullohet shqyrtimi administrativ i aktiviteteve komunale:

Sa i përket kompetencave të deleguara komunale, autoritetet qendrore mund të shqyrtojnë përshtatshmërinë e vendimit komunal të dhënë apo të aktit tjetër, krahas pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje dhe, së këndejmi mund të pezullojnë, modifikojnë apo zëvendësojnë, sipas nevojës, ekzekutimin e vendimit komunal. (Neni 6.2)

Kjo duhet të vlejë për të gjitha Komunitetet kur tentojnë të shkelin kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Pra, edhe për ato në pjesën veriore.

Të gjitha komunitetet u integruan dhe realizuan pjesëmarrjen e paraparë në të gjitha nivelet dhe filluan t'i ushtrojnë suksesshëm kompetencat, të drejtat dhe përgjegjësitë sipas zgjidhjeve juridike, përpos në pjesën Veriore.

5.5. Institucionet dhe rritja ekonomike

Ndër objektivat kryesore të institucioneve dhe qeverisjes kosovare duhet të jetë zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i vendit. Ky ishte obligim politik, juridik e moral, ngase, qeverisja demokratike nuk mund të realizohej pa zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Martin Lipset e theksonte qartë se: “Sa më i pasur të jetë një vend, aq më të mëdha janë mundësitë për ta ruajtur demokracinë” (1959:69-105) Pra, kjo vlen edhe për

Republikën e Kosovës. Për matjen e efekteve dhe rezultateve të qeverisjes demokratike, ishte i domosdoshëm zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe shndërrimi i kësaj rritje në zhvillimin e sferave tjera kosovare. Por, pa zhvillim të sferës ekonomike private nuk ka qeverisje demokratike dhe nuk ka shpërqendrim të pushtetit, e as shoqëri civile të avancuar. Njëherit edhe pa qeverisje efektive, sundim të rendit e ligjit, sigurisë, politikave të përshtatshme ekonomike, administratë cilësore, shërbime publike cilësore, integritet, etj, të cilat duhet t'i siguroi mirëqeverisja, nuk mund të arrihej zhvillimi ekonomik e as shoqëria civile përkatëse. Pra, ekzistonte një ndërlidhje e ndërveprim reciprok e kushtëzues për tejkalimin e situatës jozhvillimore dhe efektivitetit në qeverisje. Edhe Samuel Huntington, thekson se, në vendet e varfëra demokratizimi është i pashpresë. (2011:80) Por, kjo sfidë në Kosovë mund dhe duhej menagjuar duke e shtuar legjitimitetin politik me efektivitetin institucional, duke plotësuar funksionet e sistemit qeveritar, duke mbrojtur interesat publike dhe nevojat bazë të shumicës së popullsisë gjatë reformave, duke zgjidhur konfliktet strukturore, duke i integruar shtresat e mesme dhe të varfëra, duke i kushtuar vëmendje shpërndarjes. Për t'i realizuar të gjitha këto objektiva, kërkohej krijimi i kushteve dhe politikave të qarta me projekte zhvillimore afatmesme e afatgjata. Pra, kjo varej nga shpërndarja e mundësive dhe burimeve të shumta për një kohë të gjatë: duke planifikuar e realizuar përmes politikave të qarta zhvillimore; shpërqendrim e reduktim të pushtetit ndaj ekonomisë; liberalizim dhe bashkëpunim intensiv ekonomik e konkurrencë të plotë; siguri politike e juridike dhe siguri sociale gjatë transformimit.

Qeverisja ndikon në indikatorët ekonomikë përmes politikave ekonomike të qeverive, duke krijuar mjedis të përshtatshëm biznesor, me vizion e strategji të menaxhimit të

burimeve njerëzore dhe burimeve natyrore e shërbyese, si faktor të zhvillimit.¹⁰³ (Bertelsmann, 2010) Qeverisja ndikon përmes shpërndarjes së buxhetit, përmes legjislacionit, përmes politikave investuese, instrumenteve makroekonomike, politikave sociale, shërbimeve publike cilësore, konsolidimin e hapësirave dhe infrastrukturës publike. Pra, krijimin e mundësive e parakushteve përmes politikave ekonomike.

Mungesa e traditës së ekonomisë së tregut të hapur dhe vlerat në qeverisje e institucionet kosovare, po ndikojnë në sferën ekonomike dhe anasjelltas. Tradita e kaluar dhe vlerat në qeverisje, janë të prira për jo stabilitet, buxhet të vogël, papunësi të madhe, varfëri, pasiguri, shërbime të dobëta publike, arsim jocalësor, shëndetësi të pa konsoliduar dhe dukuri negative në qeverisje e shoqëri, të cilat ndikonin drejtëpërsdrejti dhe terëthorazi në sferën ekonomike. Kjo ka ndikuar që të kemi ekonomi të brishtë, më shumë probleme zhvillimore, biznese të zhytura në kredi të pavolitshme, qytetarët pa mbrojtje të mjaftueshme sociale e shëndetësore, me pensione të ulta, etj. UNDP, thekson se të gjitha këto shprehen në pengesa të përgatitjes së kapitalit human për të sotmen dhe të ardhmen zhvillimore. (UNDP, 2009) Kemi krijimin e disa bizneseve të vogla përmes përfitimeve nga privatizimi jo i mirëfilltë, nga kontrabanda, krimi i organizuar, informaliteti, përmes tenderëve të korruptuar dhe dukurive tjera negative. Si rezultat i mungesës së investimeve dhe parakushteve biznesore, Kosovës ende i mungon shtresa e mesme dhe një diferencim social plural. Mungon qëndrimi pozitiv dhe vlerësues ndaj punës dhe fitimit të mirëfilltë sipas ligjësisve ekonomike dhe të tregut, mungon menaxhimi cilësor dhe vetë iniciativa si faktorë i suksesit dhe i zhvillimit. Edhe qëndrimet ndaj

pronës e mjedisit public ishin negative, si rezultat i se kaluarës. Të gjitha këto kanë krijuar qëndrime, emocione, sentimente, identitete, vlera, nivel njohje, e specifika tjera kulturore, që përcaktojnë sjellje ndaj sferës ekonomike, ndaj pronës publike e private.

Procesi i privatizimit nuk ishte i suksesshëm sa duhet, mjetet nga shitja e privatizimi nuk iu kthyen ekonomisë kosovare për një kohë të gjatë. Në këtë proces nuk kishte konkurrencë të mirëfilltë. Privatizimet u bënë me favore për grupet në pushtet dhe grupeve të ndërlidhura me to. Privatizimet e tilla nuk dhanë efektet pozitive ekonomike, ngase blerësit nuk kishin traditë dhe përvoja menaxhuese biznesore. Këtyre privatizimeve u mungonte strategjia dhe politikat e mirëfillta ekonomike. (Riinvest, 2005; BB, 2012; OECD- FAO, 2008; OEK, 2012)

Dukuritë negative jo vetëm që dëmtonin Buxhetin e Kosovës dhe ekonominë, por po e dëmtonin edhe krijimin e vlerave të reja ekonomike e zhvillimore në shoqëri. Pastrimi i parave dhe kriminaliteti ekonomik është prezent, si rezultat i shumë rrethanave të lartëcekura. Nuk ka shënime të kësaj dukurie, por shfaqja e pasurive dhe ‘bizneseve’ të cilave nuk ju dihen burimet, tregon mjaftueshëm se ky fenomen ishte prezent. Përpos pasojave të shumta ekonomike e financiare, kjo dukuri po krijonte thyerje të vlerave dhe humbje të besimit, mosrespektim të ligjeve dhe procesit demokratik, ngase këto grupe ndërlidheshin me përfaqësuesit në institucione. Pasojat e korrupsionit dhe dukurive tjera negative ishin polivalente: pengonin investimet e brendshme e të jashtme, deficit të lartë tregtar, keqpërdornin donacionet, dëmtim buxhetin shtetëror, cilësi të dobëta të shërbimeve dhe investimeve publike. Efektet tejet negative kishin në thyerjen e vlerave dhe humbjen e besimit, demotivim, dhe qëndrime, vlera e sjellje të qytetari e votuesi.

Pra, roli i traditës negative dhe vlerave përcjellëse në qeverisje, në institucionet politike dhe në shoqëri, ndikonin drejtpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik.

Mënyra se si menaxhoheshin burimet ekonomike e sociale në favor të zhvillimit ishte mjaftë domethënëse. Qeverisjes i takonte kërkimi i formave të reja, i vlerave dhe qasjeve të reja për t'i përballuar sfidat e zhvillimit kosovar, për të përkrahur bizneset dhe krijimin e kushteve për zhvillim e integrim të suksesshëm. Rritja e nevojave, e popullsisë, lidhjeve dhe ndërlidhjeve të ekonomive në nivel regjional e global, dinamizmi i zhvillimit, teknologjisë, informacionit, tregut financiar dhe biznesit ndërkombëtar, i obligonin institucionet politike dhe ekonomike për përgjegjshmëri e llogaridhënie në krijimin e parakushteve për rritje ekonomike.

Mungesa e besimit dhe e sigurisë luan rol në sjellje dhe në tërë aktivitetin ekonomik e zhvillimor. Qeverisja e mirëfilltë efektive, e përgjegjshme, llogaridhënëse, stabiliteti politik, shteti ligjor, gjyqësia efektive, administrata cilësore, etj. ndikojnë drejtpërsëdrejti në klimën investuese, financiare, tregtare e integruese. Kusht i domosdoshëm për zhvillim ishte ekzistimi efektiv e demokratik i qeverisjes. Në këtë drejtim, institucionet dhe qeverisja nuk e luanin rolin e duhur për zhvillimin ekonomik. Ende mungojnë rezultatet konkrete të politikave ekonomike zhvillimore. Institucionet legjislative, ekzekutive, gjyqësore, administrata publike, institucionet financiare dhe agjencitë e pavarura, duhet të ishin më me ndikim në krijimin e parakushteve të volitshme për reforma dhe liberalizim të tregut dhe ekonomisë, duke e fuqizuar sundimin e ligjit dhe rendit juridik e politik. Ngase, zhvillimi ekonomik kërkonte kushte e garanci nga institucionet, nga sistemi juridik, nga siguri i shërbimeve cilësore publike dhe infrastrukturës së të gjitha llojeve. Varej nga politikat e qarta makroekonomike kosovare dhe nga zbatimi i instrumenteve të

saja. Tregjet duhej liberalizuar dhe mundësuar e garantuar më klimë politike, legjislacion, e infrastruktur. Pra, mekanizmin e tregut duhej plotësuar me krijimin e kushteve të favorshme për investime, siguri e rend, me garanci juridike të zbatueshme.

Një analizë teorike, e cila mund të jetë me rëndësi praktike edhe për politikën ekonomike të qeverisjes kosovare e gjejmë edhe të profesor Civici, i cili e analizon rolin e sotëm të institucioneve dhe qeverisjes në raport me tregun dhe zhvillimin.

Ekspertët e ekonomisë janë në unison se rolet e reja të shtetit në këtë epokë moderne të shek. XXI, të karakterizuar nga një vokacion liberal dominues dhe efekteve të pashmangshme të fenomenit të globalizimit duhet të rikonceptohen dhe të sintetizohen në disa drejtime e koncepte themelore: në një rol stabilizues që siguron kontrollin e nevojshëm për të evituar pasojat negative të një hapjeje ekonomike e tregtare totale; një rol garant të transparencës, të qëndrueshmërisë së sistemit financiar, bankave dhe institucioneve të tjera financiare; një rol promovues dhe shpërndarës së informacionit sidomos për aktivitetet e zhvillimit dhe ndërtimin e avantazheve krahasuese dhe konkurruese; një rol aktiv në zbulimin dhe konsolidimin e burimeve efektive të rritjes dhe zhvillimit, sepse Shteti është i vetmi aktor kombëtar që mund t'i angazhojë të gjithë aktorët e tjerë në linjën e një vizioni afat-gjatë të qëndrueshëm; një rol organizues dhe garantues të solidaritetit kombëtar dhe politikave sociale... një rol menaxhues në atë që quhet “qeverisje e kujdesshme e tregjeve.”(Civici, 2013)

Sipas ekonomistëve edhe “Qeveria (shteti) gjithashtu përfaqëson një agjent ekonomik, pra një vendimmarrës në fushën ekonomike, në rolin e saj si krijuese dhe mbikëqyrëse e rregullave të lojës ekonomike...dhe në të gjitha funksionet tjera ekonomike, që i realizon përmes politikave të saj ndërhyrëse në ekonomi.” (Maqellari, 2007:22) Edhe reformat në arsim, shëndetësi, politika sociale, etj., kontribuojnë në rolet e tregut dhe në proceset e zhvillimit. Me rëndësi thelbësore në këto procese ishin institucionet si element thelbësor për procesin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Institucionet qeverisëse duhej të luajnin rol kyç në zhvillim duke krijuar stabilitet, siguri, liri dhe politikë ekonomike të suksesshme. Ngase, pa rezultatet zhvillimore ekonomike, është vështirë e realizueshme qeverisja demokratike. Institucionet duhet të kenë efekte influencuese përmes politikës makroekonomike, përmes legjislacionit, sigurisë dhe sigurimit të infrastrukturës .

Zhvillimi ekonomik sipas Fukuyam-ës (2010) kërkon ndarje të ekonomisë nga menaxhimi i drejtpërdrejt nga shteti dhe qeverisja. Ai kërkon liberalizim ekonomik afatgjatë në njërin anë, por, edhe forcim të institucioneve dhe sferave tjera të sigurisë dhe rendit, në anën tjetër. Kuptimi, qasja dhe zbatimi i këtij parimi, në disa vende në zhvillim dhe vende të tranzicionit ka munguar:

reforma e liberalizmit të ekonomisë dështoi në arritjen e objektivave të premtuar në shumë vende. Më të vertetë në disa vende, mungesa e kuadrit të duhur institucional i la ato më keq pas liberalizimit sesa do të ishin pa e zbatuar fare atë. Problemi qëndron në dështimin konceptual themelor për të ndarë dimenzionet e ndryshme të shtetit dhe për të kuptuar se si lidhen ato më zhvillimin ekonomik (2010, 142)

Fukuyam-a, sqaron se si të ndikohet në zhvillimin ekonomik përmes forcimit paraprak të institucioneve kryesore politike dhe zbatimit të ligjit, krijimit të sigurisë për investime e liberalizim ekonomik, pa të cilat nuk ka rritje ekonomike e konsolidim zhvillimor.

Një situatë e dështimit në arritjen e objektivave ekonomike zhvillimore ndodhi edhe më politikat, qeverisjen e institucionet kosovare, duke filluar nga kuadri jocosilësor institucional, mungesa e konkurrencës krahas liberalizimit ekonomik, mungesa e forcimit të institucioneve kryesore dhe mungesa e sundimit të ligjit si domosdoshmëri primare. Ky proces i reformave ekonomike në Kosovë ishte në hapat e parë dhe me pikënisje nga zeroja, por mu në hapat e parë dhe në orientimin e drejtë, varët edhe suksesi. Pra, kërkohej ndërtimi i sistemit të ekonomisë sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut rajonal, evropian dhe atij botëror, me një politikë rregullative të përshtatshme të rendit, sigurisë dhe sundimit të ligjit në të gjitha sferat, dhe kuptimi i plotë se këto funksione joekonomike të qeverisjes edhe pse duken të tërthorta, janë thelbësore për zhvillimin ekonomik, edhe pse nuk janë sfera të natyrës thjeshtë ekonomike. Pra, sistem politik e juridik funksional efikas që krijon një ambient të përshtatshëm për integrimin e ekonomisë së Kosovës në rajon e më gjerë.

Roli i institucioneve si një instrument efektiv dhe kompetent të ‘ndërhyrjes shtetërore’ për të garantuar rritje të përshpejtuara ekonomike, po konsolidohet:

“Shteti zhvillues” i modelit aziatik është tashmë i afirmuar si një instrument efektiv për të garantuar rritje të përshpejtuara ekonomike. Edhe Banka Botërore që për shumë kohë ka mbrojtur idenë se “zhvillimi është rezultat i lojës së lirë të forcave të tregut”, ka bërë një rivlerësim të rolit të shtetit dhe ndërhyrjeve të tij. Në një nga raportet e saj “Mrekullia e Azisë jug-lindore”, Banka Botërore e pranon efektivitetin e ndërhyrjes shtetërore, ndërkohë që në raportin e saj që i kushtohet problemeve të zhvillimit “Shteti në një botë në ndryshim” gjendet dhe formulimi se: “një Shtet efikas dhe kompetent është më i preferueshëm se një shtet minimal”, apo dhe konkluzionin se “një zhvillim pa prezencën aktive të shtetit është i destinuar të dështojë. (Civici, 2013)

Zhvillimi i kapitalit human në pajtim me trendët teknologjike dhe ligjeve të tregut e konkurrencës në nivelin rajonal e global, për qeverisjen kosovare, duhet të jetë prioriteti kryesor. (UNDP, 2010) Sipas ekonomistëve kërkohet menaxhim i efektshëm i burimeve humane dhe tërheqje e kapitalit në investimet strategjike për Kosovën dhe liberalizim ekonomik, të cilat do sjellin zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm. (Sadiku, 2004)

BB, FMN, UNDP, BQK, ASK, OJQ-të dhe institucionet tjera, japin shifra shqetësuese mbi varfërinë dhe papunësinë në Kosovë. Edhe pse ekonomia e Kosovës, kishte normë pozitive të rritjes ekonomike, kjo ishte e pamjaftueshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe zvogëlim të deficitit tregtar, zvogëlim të varfërisë dhe papunësisë. Sipas konstatimeve të BQK-ës: “Republika e Kosovës ka arritur ta ruajë stabilitetin makroekonomik. Rritja ekonomike vazhdon të jetë pozitive, duke e mbajtur në nivel të arsyeshëm edhe borxhin publik.” (BQK, 2012:3) Dominimi i deficitit të theksuar tregtar, importi i lartë në raport me mundësitë prodhuese vendore të atyre produkteve, eksporti tejet i ultë-exporti mbulon importin vetëm rreth 16%, janë tregues të politikave ekonomike joefektive. (BQK, 2012:129-133) Bankat komerciale ofrojnë kredidhënie të papërshtatshme. Ka investime të ulëta vendore dhe thithje e dobët e investimeve të jashtme. (BQK, 2011) Mundësitë dhe disa faktorë potencialë të zhvillimit ekzistojnë: kapitali human, burimet natyrore e

hapësinore të pashfrytëzuara, tregu, etj, të cilat me një politikë ekonomike e makroekonomike konsistente, do t'i aktivizonte këto potenciale ekonomike

Raporti i rregullt ekonomik i BB për Evropën Juglindore 2012, sugjeron vazhdimin e përmirësimit të klimës investuese dhe reformën e tregjeve të punës dhe të sektorit publik. (BB, dhjetor 2012) Qeverisja joefektive e përcjell me dukuri negative është pengesë thelbësore e zhvillimit, e sigurisë, e investimeve dhe e integriteteve. Shfrytëzimi i pa përgjegjshëm i Buxhetit, korrupsioni i lartë, krimi i organizuar, gjyqësori joefikas e i politizuar, informaliteti, administrata e pa reformuar, jo llogaridhënia papërgjegjësia e lidershipit, etj., ishin disa nga karakteristikat e realitetit kosovar. Si të tilla e pengonin rritjen ekonomike dhe investimet. Politika zhvillimore me instrumentet përkatëse makroekonomike efektive, ende po mungon. Po mungonte krijimi i ambientit të volitshëm e të sigurt biznesor. Qeverisja efikase, e përgjegjshme, e ndershme, profesionale e llogaridhënese, nuk mund të bëhej pa lidership, subjekte, përfaqësues e votues përkatës. Kjo i mungonte Kosovës, andaj pa këto nuk kishte zhvillim ekonomik. Tërheqja sa më e madhe e investimeve të huaja dhe kredidhëniesve të volitshme duhej të ishte prioritet. Përshtatja e legjislacionit për të stimuluar proceset zhvillimore ishte e ngutshme. Sadiku, kapërcimin e gjendjes jo zhvillimore e sheh në bashkërendim dhe aleancë të shumë aktorëve:

Shteti i ri si Kosova, duhet të demonstroj qëndrueshmëri ekonomike dhe sociale. Në këtë kontekst, krijimi i aleancave për promovimin e rritjes dhe zhvillimit ekonomik duke përfshirë qeverinë, asociacionet e bizneseve, investitorët, sindikatat, shoqërinë civile, dhe institucionet hulumtuese dhe akademike është i një rëndësie të veçantë. Rritja ekonomike e qëndrueshme afatgjatë është e mundur të realizohet nëse të gjithë aktorët bashkohen rreth një aleance e cila i kupton problemet aktuale dhe sfidat dhe ka vizion për të ardhmen. (2004, 3)

Institucionet legjislative, ekzekutive, gjyqësore, administrata dhe institucionet e tjera bëjnë rregullimin dhe garantimin e infrastrukturës juridike për sferën ekonomike,

rregullimin e monopoleve natyrore, zgjidhjen e kontesteve, rregullimin e kushteve për konkurrencë të brendshme dhe ndërkombëtare, edukimin dhe shëndetësinë, infrastrukturën, mbështetjen e bizneseve me politikat monetare, fiskale, subvencione, dhe në marrëdhënie me jashtë. Cilësia e funksioneve legislative, kontrolluese, mbikëqyrëse, emërtuese, ratifikuese, shkarkuese, etj., nga institucionet, luajnë rol në procesin e tërësishëm të qeverisjes dhe rrjedhimisht në zhvillimin ekonomik. Cilësia e infrastrukturës ligjore, zbatimi i saj krijon garanci për sferën ekonomike. Përmirësimi i politikave rregullatore e legislative për liberalizim dhe garantim ligjor të biznesit, tregtisë, pronës, qarkullimit të lirë të kapitalit, investimeve, etj është e domosdoshme. Përkrahja dhe kontrolli ndaj politikave ekonomike qeveritare dhe kontrolli ndaj administrates, luan rol në ecurinë ekonomike. Krijimi i organeve përkatëse parlamentare për të ndikuar në sfera të caktuara të ekonomisë dhe strategjive zhvillimore luan rol të veçantë. Debatet e mirëfillta pozitë-opozitë shmangin dhe zgjidhin krizat. Miratimi i buxhetit dhe strategjisë së shfrytëzimit të tij, paraqet njërin ndër faktorët bazë të ecurisë ekonomike. Zgjedhja e drejtuesve të institucioneve dhe të administratës, bordeve të kompanive publike, shërbimeve publike, etj., përkatësisht cilësia e tyre, ndikon në mos/zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e sferave tjera në Kosovë. Të gjitha këto ishin prezente e funksionale, por kërkohej efikasitet dhe cilësi me e lartë.

Parlamenti, sipas përcaktimeve kushtetuese e ligjore, bënte emërtimin dhe zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve financiare, agjencive të pavarura, prokurimit, doganave, gjyqësorit, udhëheqësve të administratës dhe në shërbimet publike, agjencisë së privatizimit, zgjedhjen e bordeve të kompanive publike, ratifikimin e marrëveshjeve me jashtë, etj. Pra, institucioni legjislativ përcaktonte dhe udhëheqte në vija të përgjithshme

ecuritë politike dhe ekonomike por, të gjitha këto ishin hapa pozitiv, por ende jo sa duhet efikase, shpesh jocilësore e joefektive. (KE: *Raporti i progresit*, 2012)

Programi ekonomik i qeverisë përmes politikës makroekonomike, projektbuxhetit, projektligjeve, akteve nënligjore, investimeve kapitale, krijimit të infrastrukturës publike, shërbimeve publike, tregtisë, subvencioneve për prodhim, investimeve në edukim, shëndetësi, etj. ndikonte drejtpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik. (MTI & MF, 2010, 2011, 2012) Në veçanti, politikat bashkëpunuese dhe integruese, politikat fiskale, monetare, marrëdhënieve ekonomike më jashtë, mbështetjes së eksportit e shpërndarjes.

Gjyqësori paraqiste shtyllë e faktorë ndikues të drejtpërdrejt në sigurinë e investimeve, tregtisë e biznesit vendor e ndërkombëtar, në zgjidhjen e kontesteve, etj. Sipas Varian, analizat ekonomike bëhen në raport më praktikën e së drejtës dhe rendit ligjor. Investitorët interesohen jo vetëm për mënyrën se si funksionojnë institucionet, por edhe me çështjet që lidhën me të drejtën, me analizën ekonomike të krimit, me të drejtën e detyrimit dhe çështje të veçanta të ligjit antitrust. (Varian, 2002:468) Efikasiteti dhe efektiviteti i gjyqësorit nuk ishte në nivelin e kërkuar; kjo ndikonte në sigurinë e investimeve e veprimtarisë biznesore dhe në procesin e zhvillimit. Pa gjyqësor efikas, të pavarur e të fuqishëm, të mbështetur nga institucionet tjera qeverisëse, nuk ka as zhvillim ekonomik. Një gjendje e rëndë në gjyqësor dhe institucione tjera i ngadalësonte proceset integruese ekonomike. Arsyet e rënies së investimeve të huaja ishin pasojë e mungesës së sundimit të ligjit. Kosova duhej të krijojë ambient më të mirë biznesi duke ulur nivelin e lartë të korrupsionit në institucione dhe krimin e organizuar. BQK, duke analizuar ecuritë e vitit 2012, konstatonte se dukuritë negative në institucione, po ndikojnë drejtpërsëdrejti në pasigurinë e investimeve vendore dhe të huaja. Edhe politikat e paqarta zhvillimore po

ndikojnë në mos rritje ekonomike. Të gjitha këto po kanë pasoja të drejtpërdrejta në sferën e investimeve të jashtme. (BQK, mars 2013) Duke i kërkuar Kosovës reforma në këto sfera, Drejtoresha e BB për Europen Juglindore, Armitage, thekson se: “duhet të bëhen shumë gjëra, të luftohet korrupsioni, të përmirësohet gjyqësori, të gjitha këto janë pjesë e mjedisit bisnesor. Kur bëhen llogarit dhe indikatorët e biznesit dhe afarizmit, investorët i shikojnë të gjithë këta indikatorë.” (Armitage, nëndor 2012:6)

Edhe administrata duhet të ishte më profesionale, e depolitizuar, efikase, e përgjegjshme, e kontrolluar dhe me kushte të mira hapësinore, teknologjike e kadrovike. Në një hulumtim të BB rreth vlerësimit të mjedisit biznesor, Kosovën e rendit në vendin 117-të. (BB, tetor 2011) Një pikë e këtij vlerësimi, janë edhe procedurat dhe dokumentacioni që duhet siguruar për hapjen e një biznesi. Shërbime të veçanta dhe legjislacion shtesë për investorët e jashtëm dhe të brendshëm, me procedura të thjeshta e favorite, do të përmirësonte cilësinë dhe efikasitetin; do të krijonte klimë të favorshme për tërheqjen e investorëve në ekonominë kosovare. Dukuritë negative në administratën kosovare ishin pengesë për hapjen dhe funksionimin e bizneseve. Në këtë drejtim kërkohej që të ketë koordinim ndërinstitutional, në mënyrë që investorët të trajtohen konform ligjeve ekzistuese dhe me një efikasitet të veçantë t’u lehtësohen procedurat për investime e biznes. Edhe institucionet tjera, si BQK-ja, Gjykatat, Organet policore, Doganat, Odat Ekonomike, Institutet Hulumtuese Shkencore, organizatat jo qeveritare, mediet e pavarura e kritike, etj., duhet ta kishin prioritet ekonominë.

Përkrahja e shumanshme e bashkëpunuese e Organizatave Ndërkombëtare për proceset zhvillimore e reformuese nuk mungonte. Kosova, edhe pse është anëtare e disa mekanizmave ndërkombëtarë financiarë, si FMN, BB, BERZH, etj., autoritetet kosovare

nuk i shfrytëzonin mundësitë për të përfituar maksimumin nga këto institucione të rëndësishme. Këta mekanizma financiarë ndërkombëtarë e kanë ndihmuar Kosovën në ruajtjen e stabilitetit fiskal dhe financiar. Por, kërkohej një mobilizim më i theksuar për shfrytëzimin më të madh të mbështetjes dhe të shfrytëzimit të kësaj mbështetjeje me projektet konkret në Kosovë dhe rajon. Në draft strategjinë e BERZH-it për përkrahjen e ekonomisë së Kosovës thuhet se:

Aftësia sovrane hua marrëse e Kosovës ka shumë mundësi që të jetë e kufizuar brenda kufijve të vendosur nga marrëveshjet me Fondin Monetar Ndërkombëtar...institucionet vendëse ende janë të papjekura për të pasur qasje në huat e kësaj banke...aftësia e institucioneve për këtë çështje duhet të vihet në provë edhe për një kohë të caktuar (BERZH,mars.2013)

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) kërkon nga Qeveria që në vitin e ardhshëm 2013, t'i kushtojë kujdes më të madh ekonomisë, përmes inkurajimit sistemor për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Ajo konsideron se gjatë vitit 2012, në agjendën shtetërore kanë dominuar çështje politike, ndërkaq ekonomia ka mbetur nën hijen e tyre:

Indikatorët kryesor tregojnë se kemi rënie në eksport, në investime të huaja, rritje të borxheve të këqija dhe reflektim më i madh i krizës globale në vendin tonë. Shkalla jashtëzakonisht e madhe e papunësisë dhe shkalla madje edhe më e madhe e varfërisë, atëherë mund të konkludohet se Kosova me hapa të sigurt po rrëshqet drejt një krize të thellë ekonomike, nëse nuk merren hapa urgjente dhe konkrete në trajtimin e çështjeve kryesore zhvillimore. Ajo që Kosovës i duhet shumë shpejt është politikë inkurajuese ekonomike për ndërmarrje të vogla dhe të mesme që nuk kërkojnë investime të mëdha, ndërkaq absorbojnë fuqinë e madhe punëtore. Na duhet edhe përkrahja më e madhe për bujqësinë. Bujqësia është njëra nga shanset tona më pak të shfrytëzuara. Oda Ekonomike e Kosovës pret që ky vit të jetë vit i ndryshimit radikal në trajtimin e ekonomisë së vendit dhe bizneseve. (OEK, dhjetor 2012)

Oda Ekonomike Gjermane dhe ajo e Tregtisë dhe Industrisë në Evropën Qendrore dhe Lindore, në një anketim, konstatuan se Kosova është një nga vendet me shkallë të lartë të korrupsionit, me pasiguri ligjore, me politika jo të mira ekonomike, si dhe me cilësi të dobët të arsimit profesional. Kosovën e vlerësuan me nota shumë negative nga të dhënat e anketimit mbi klimën e biznesit në Kosovë–2012. Thuhet se Qeveria e vendit po e neglizhon prodhuesin vendor, dhe se në 5 vitet e fundit investimet e huaja në Kosovë kanë rënë për 200 milionë Euro. (OEGJ, qershor 2013) Në raportin e BQK-ës mbi indikatorët

ekonomikë të Kosovës thuhet se “Investimet e huaja direkte deri në shtator të 2012-s arritën vlerën prej 167 milionë eurove, kanë shënuar rënie substanciale prej 41.3 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2011.” BQK-ja vlerëson se “rënia e këtyre investimeve, përveç përkeqësimit të ambientit të përgjithshëm ekonomik në Evropë, në masën më të madhe i adresohet ngadalësimit të procesit të privatizimit gjatë vitit 2012.” (BQK, mars 2013)

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), pas Shpalljes së Pavarësisë, menaxhohet nga Agjencia Kosovare e Pronave (AKP) dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (Ligji Nr. 04/L-034) si kompani publike, përmes bordeve të zgjedhura nga institucionet. Kosova njihet, mbron dhe fuqizon ushtrimin e të drejtave të personave mbi pronat e tyre private të luajtshme dhe të paluajtshme, në pajtim me norma dhe standarde të njohura ndërkombëtare. Megjithatë procesi i privatizimit të pronave e bizneseve nuk ka dhënë rezultatet e duhura. Bizneset dhe mekanizmi i vjetruar si dhe gjendja e ndërmarrjeve të plaçkitura, nuk mund të prodhonin e menaxhoheshin më efikencë. Hapja e tregut u pamundësonte përballimin e konkurrencës. Menaxhimi i ndërmarrjeve publike në realitetin kosovar nuk ishte efikente, por edhe privatizimi jo i mirëfilltë i tyre nuk dha rezultatet e pritura. (BQK, qershor 2012) Privatizimi i Korporatave të mëdha mundëson menaxhim më cilësor, por ato duhet të përcillen me konkurrencë. Në kushte të monopolit dhe marrëveshjeve me konkurruesin e vetëm, nuk sjellin produkte e shërbime cilësore.

Disa ndërmarrje publike janë në menaxhimin e qeverisë përmes bordeve drejtuese, të cilat bëjnë strategjinë zhvillimore e afariste të këtyre ndërmarrjeve. Si rezultat i ndikimit të tepruar në qeverisje të grupeve klanore partiake, bordet po zgjidhen jo sipas kriterëve e aftësive profesionale, por nga përkatësia dhe interesat partiake e grupeve. Këto borde nuk

janë sa duhet të pavarura e profesionale. Punësimi në këto korporata bëhej gjithashtu nga këto baza e kritere, përcillej me mbi punësim, nuk kontrolloheshin shpenzimet. Të gjitha këto veprimtari përcilleheshin me menaxhim të dobët dhe keqpërdorime, papërgjegjësi, korrupsion, produktivitet të ultë dhe jo efikasitet. Si rezultat i kësaj kemi shërbime jocilësore dhe shpesh edhe ngarkesë për buxhetin e Kosovës, p.sh. Këto fonde në Kosovë ndaheshin për KEK-un. Aeroportin, etj por, cilësia e shërbimeve nuk përmirësohej! Këto korporata mund të ekzistonin në treg edhe me këto dukuri negative, ngase, nuk kishin konkurrencë dhe zhvillonin biznesin sipas kushteve monopoliste.

Partneriteti Publiko-Privat (PPP) është i rregulluar me Kushtetutë e ligj përkatës (Ligji 03/L-090) dhe kishte filluar të implementohet. Përparësitë dhe dobitë e PPP në realitetin kosovar janë mjaft specifike. Angazhimi i kapitalit privat përmes PPP sjell fleksibilitet, inovacion, cilësi në shërbime, angazhim të resurseve private dhe zvoglim të alokimit të fondeve nga buxheti i Kosovës. Por, edhe në këtë sferë kishte dukuri negative të lartëpërmendura.

Kreu VI: Proceset integruese dhe Republika e Kosovës

6.1. Fillesat e Integritimit në BE: aspekti juridik e politik

Vendet me ndikim dhe proceset globale e rajonale influencuan dhe po influencojnë drejtpërdrejt në praktikën qeverisëse kosovare si nevojë e tejkalimit të gjendjes së rëndë në shumicën e sferave dhe në ruajtjen e sigurisë rajonale. Edhe Kosova me procese e reforma të vonuara përpikëj t'i imitojë vendet e zhvilluara demokratike në procesin e qeverisjes dhe në proceset integruese. Orientimi i Kosovës për integrim në BE përkufizohet edhe në Kushtetutën (2008) me "synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike" (preambula). Qytetarët dhe Institucionet e Kosovës kanë përceptime pozitive për rolin e Bashkësisë ndërkombëtare dhe për SHBA-në, dhe Bashkësinë ndërkombëtare me forumet e saja, duke i konsideruar mekanizma që ndihmuan Kosovën në aspektin e ndërmjetësimit, intervenimit ushtarak, politik, juridik e ekonomik. Partneriteti i institucioneve kosovare me institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, ishte i qëndrueshëm. Proceset kosovare qeverisëse: konsolidimi kushtetues e ligjor e organizativ institucional, u avancu nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe BE-ja. Por, ky ndikim dhe prezencë ndërkombëtare nuk ishte sa duhej efikas e efektiv në përgatitjen dhe përkrahjen e Kosovës drejtë pavarësisë, demokracisë e integritimit, si shkak i pengesave të disa vendeve me ndikim negativ dhe rivalitetet e tyre.

Ndikimi i proceseve globale dhe i vendeve me ndikim global në Kosovë, ka qenë i drejtpërdrejtë dhe tejet i theksuar gjatë vitit 1999-2012. Ky ndikim ishte realizuar përmes Organizatave Ndërkombëtare, akteve juridike ndërkombëtare dhe vendeve me ndikim. Bashkësia Ndërkombëtare këtë ndikim e bënte edhe përmes angazhimit të BE-së duke ndikuar drejtpërsëdrejti edhe në format institucionale e qeverisëse kosovare, si dhe në

vetë procesin e integrimit. Pra, Kosova ishte dhe siq duket do të jetë për një kohë, *sui generis* i ndikimit të Bashkësisë Ndërkombëtare dhe BE-së në të gjitha sferat dhe proceset, pra edhe në sferën qeverisëse dhe në integrim.

Rasti i Kosovës ka specifikat e veta dhe është shembulli më i ri ndërkombëtar i ndikimit intenziv i Bashkësisë ndërkombëtare dhe i BE-së. Nga këto ndikime, rrethana e procese janë përcaktuar edhe fillesat e integrimit evropian të Kosovës. I tërë procesi i qeverisjes dhe sistemit politik e juridik është përcaktuar nga sygjerimet, pëlqimet, imponimet dhe vendimmarrjet ndërkombëtare, krahas angazhimit të faktorit kosovar. Në këtë proces vërehen ndikimet e faktorit të jashtëm në zgjidhjet juridike e sistemore dhe implementimi i atyre formave në sistemin qeverisës dhe institucional, sipas demokracisë së moderuar dhe konsensuale, më garancitë juridike që mbrojnë pakicat dhe të drejtat e njeriut. Mbrojtja e theksuar e komuniteteve pakicë është shembull i veçantë, jo vetëm për rajonin, por edhe më gjerë. Ky avancim i ndërhyrjes në rregullimin juridik të qeverisjes është i veçantë, i cili ka paraparë edhe balancimin e pushteteve, sistemin parlamentar dhe sistemin zgjedhor proporcional. Gjykata Kushtetuese me përfaqësuesit ndërkombëtarë, Bankën Qendrore me valutë konvertibile Euron.

Përparësia e gjithë këtij procesi të mundimshëm të protektoratit dhe vetëvendosjes përmes pavarësisë, ishte process i tej zgjatur dhe me kompromise por, si shtet i ri funksional, (2008) i njohur dhe i përkrahur nga vende me ndikim global dhe nga 25 vende të BE-së dhe anëtare e organizatave të rëndësishme globale. Fillet e mëtejme të avancimit për integrimin kosovar në BE janë edhe vetë prezenca e BE-së në Kosovë dhe në proceset kosovare së bashku me institucionet. Strukturat e kësaj prezence dhe përkrahje janë: Zyra ndërlidhëse e KE në Kosovë, Përfaqësuesi Special i BE-së, Misioni i Bashkimit

European për Sundimin e Ligjit (EULEX), PUN, MEPSM, Zyrat ose ambasadat e shteteve dhe atyre të BE-së në Prishtinë-tani 17 prej tyre i kanë përfaqësitë e tyre në Kosovë. Kjo prezencë ka për qëllim zhvillimin dhe integrimin e Kosovës në BE. (Qendra informative dhe kulturore e BE-së në Kosovë, janar 2012:18-20) Kjo prezencë dhe asistencë e Institucioneve ndërkombëtare dhe e BE-së në Kosovë, është shumë me rëndësi për të pas përceptime reale për Kosovën. Duke qenë prezent dhe pjesëmarrës i kupton problemet e sfidat e Kosovës drejt integritit Evropian dhe nuk lejon dezinformime e pengesa të motivuara nga kundërshtarët e Kosovës.

Pas shpalljes së Pavarësisë, Kosovën e njohën numer i konsiderueshëm i vendeve ekonomikisht të zhvilluara, më ndikim rajonal e global dhe anëtare të Organizatave të rëndësishme ndërkombëtare. Kosova u bë antare e FMN-së (qershor/2009). Në të njëjtën kohë u antarësu në BB me të drejta të plota. Antarësimi në këto dy institucione globale ekonomike-finansiare ishte e një rëndësie të veçantë e me ndikim në efektet qeverisëse e zhvillimore. Pengesa ishte në antarësimin e saj në OKB, si rezultat i pengesave nga Rusia. Në Kosovë ende qëndron UNMIK-u me rolin rudimentar, pasi ende nuk ka Rezolutë të re në OKB për Kosovën. Në OSBE si penges është edhe Serbia. Anëtarësimi në Këshillin e Europës ishte më i lehtë ngase 2/3 e vendeve antare e kanë njohur Republikën e Kosovës. NATO është e pranishme në Kosovë më një mision force me një mandat të pandryshuar.(PUN) Pjesëmarrja e Kosovës në iniciativat rajonale në kuadër të Ballkanit Perëndimor përmes paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe konsolidimi i marrëdhënieve rajonale me Evropën Juglindore ishte një e arritur e madhe. Përfaqësimi në këto iniciativa, ka treguar se Kosova ka gatishmërinë politike dhe institucionale për bashkëpunim me vendet e rajonit. Ky bashkëpunim dhe konsolidimi i marrëdhënjëve të

mira më vendet fqinjë është kusht për integrim në BE. Edhe BE është mjaftë prezente në Kosovë, por pengesë është mosnjohja e pesë vendeve të BE-së, por parlamenti dhe organet tjera të BE-së dhe vendet e saja më ndikim janë përkrahese të procesit të konsolidimit institucional dhe afirmimit të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto suksese dhe pengesa të pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ndikonin në veshtirësi dhe suksese konkrete qeverisese dhe në integrim. Edhe ngritja e cilësisë qeverisëse ndikonte në afirmim, anëtarësim e integrim dhe anasjelltas, niveli i ultë i cilësisë është pengesë serioze për njohje, anëtarësim e integrim.

Disa specifika qeverisëse gjysmë të imponuara nga proceset dhe aktorët e lartpërmendur, kanë përparësitë, disfavoret dhe efektet në qeverisje. Megjithatë, proceset globale ishin, janë dhe do jenë rrethanë e ambient i favorshëm për tejkalimin e vështirësive në qeverisje, veçmas në afirmimin dhe në integrimin e Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë. Integrimet rajonale në frymën dhe vlerat e BE-së, gjithashtu janë rrethana përcaktuese pozitive për qeverisje, sovranitet dhe zhvillim të shoqërisë dhe forcim institucional të Republikës së Kosovës. Faktori human kosovar është një kapacitet dhe resurs esencial për realizimin e këtyre proceseve pozitive, ndërsa politikat e BE-së dhe ato globale në rajon, janë rrethanë dhe ambient që duhej shfrytëzuar çdo moment, nga faktori qeverisës dhe shoqëria kosovare. Proceset integruese rajonale, kontinentale e globale janë rezultat i proceseve ekonomike, tregtare, politike, informative, teknologjike etj., të cilat po luajnë rol zhvillimor në shumë sfera. Ato janë mjaft ndikuese edhe në sferën qeverisëse e institucionale në Kosovë.

Ndikimet globale janë prezent në të gjitha vendet dhe krizat. Soros sugjeronte përballimin e krizave me institucione të reja globale të udhëhequra jo vetëm nga

“fundamentalizmi i tregut, që tani është naiv dhe jologjik e që duhet plotësuar me vlera e rregulla juridike e morale globale, për interesa globale dhe kolektive, për krijimin e shoqërisë së hapur dhe për përballimin e krizës së tanishme të kapitalizmit global.” (Soros, 1999:10) Edhe qeverisja dhe institucionet e mirëfillta demokratike kosovare gjithherë duhet të jenë të hapura për të gjitha format bashkëpunuese e integruese.

Proceset globale po e imponojnë ‘Qeverisjen globale’ si imperativ të kohës, pra, si domosdoshmëri. P.sh. Pierre Calame thekson se, për zgjidhjen e të gjitha problemeve kërkohet koperim në nivel lokal, rajonal e global:

që sot, pjesa më e madhe e problemeve që lidhen me edukimin, shëndetin, ushqimin, ujin, mjedisin, kohezionin social, kërkimin, paqen, etj., nuk mund të zgjidhen në një nivel të vetëm. Çdo zgjidhje efektive kërkon marrëdhënie qeverisëse në shumë plane e nivele. Mekanizmi i kooperimit ndërmjet nivelit lokal, rajonal, nacional dhe internacional është çelësi i çdo arkitekture qeverisëse në të ardhmen. (Pierre , 2008, 17)

Kjo vlen edhe për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Proceset integruese në të gjitha sferat kërkojnë zgjidhje dhe forma qeverisëse në pajtim me integrimet rajonale e globale, për krijimin e parakushteve e standardeve demokratike në qeverisjen vendore. Kosova nuk ka arsye, as mundësi të jetë përjashtim, përkundrazi, kjo ecuri globale paraqet rrethanë të volitshme zhvillimore e afirmuese , veçmas integrimi në BE.

Proceset globale kanë forcuar dhe rritur numrin dhe efektin e organizatave rajonale e globale në veprimtarinë e tyre. (Puto, 2008, 91-102) Konsolidimi i mëtejshëm juridik, organizativ dhe veprimtaria e tyre është në proces. Në proces është edhe konsolidimi i mjeteve shtrënguese edhe aspekti aplikues i tyre. (Krisofi, 2015) Këto procese janë në rritje të cilësisë dhe sasisë integruese e bashkëpunuese në të gjitha nivelet dhe fushat. Nue dhe Welch, theksojnë se Institucionet Ndërkombëtare po evoluojnë gradualisht kah një drejtim i ri. Të drejtat e njeriut dhe zgjerimi i i konceptit të sigurisë njerëzore po bëhen më të rëndësishme. Në këtë kuptim, e drejta ndërkombëtare humanitare, thekson se shtetet

kanë detyrim për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe të qytetarët e tyre, kurse komuniteti ndërkombëtar ka ''Përgjegjësinë për të Mbrojtur individët që viktimizohen nga qeveritë e tyre-po merr ndikim gjithnjë më të madh.'' (Jozeph & Welch, 2013:565) Këto procese ishin dhe janë ambient i mirë për proceset qeverisese në Republikën e Kosovës.

Bashkësia Ndërkombëtare gjithnjë po shkon drejt integritimeve rajonale e globale dhe reformave të thella, për t'iu përshtatur proceseve zhvillimore e biznesore globale në shumë sfera. Veçmas proceset integruese të BE-së dhe vendeve që synojnë integrimin në të. Këto procese ndikuan dhe do ndikojnë drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi në procesin e qeverisjes, institucioneve dhe legjislacionit në çdo vend, pra edhe në Kosovë. Këto janë kushte e standarde të domosdoshme të ekzistimit, bashkëpunimit e integritimit në shumë sektor e nivele. Kosovës i kërkohej: sundimi i rendit juridik, reforma e zhvillim ekonomik, respektim të të drejtave e lirive të njeriut dhe të pakicave, institucione efikase e të përgjegjshme, etj. Këto fakte dhe procese janë kuptuar si faktori vendimtar i rendit dhe stabilitetit jo vetëm në Kosovë, por edhe për rendin e stabilitetin ndërkombëtar në rajon.

Forma më avancuese e integritimit deri me tani është BE-ja. Andaj, të gjitha këto procese e dukuri për qeverisjen kosovare, duhet të jenë orientuese për përshtatjen këtyre proceseve, në funksion të afirmimit të pavarësisë dhe zhvillimit. Vullneti i BE-së në Kosovë është ngritja e cilësisë institucionale, "për të ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës përmes një perspektive të qartë evropiane në pajtueshmëri me perspektivën evropiane të rajonit." (Zyrja e BE-Kosovë, janar 2010:20) Integrimi i rajonit të Ballkanit në BE, është proces intensiv, që duhet shfrytëzuar, ngase krijon parakushte favorizuese në shumicën e aspiratave kosovare. Por, reformat dhe parakushtet për proceset integruese duhet t'i bëjë dhe përgatisë qeverisja me institucionet kosovare. (KE-

Drejtoria e përgjithshme për zgjerim, 2011) Këtu qëndron thelbi i sfidës institucionale dhe qeverisjes kosovare, drejtë proceseve integruese.

Faktori i brendshëm ishte aktori kryesor në realizim e këtyre objektivave përmes cilësisë qeverisëse e institucionale, e cila nuk ishte në nivelin e duhur. Nuk ka zhvillim të as një sfere, e as integrim në BE, e as më vendet dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare, pa kapacitete e cilësi qeverisëse e institucione të mirëfillta kosovare. Në rastin e Kosovës kjo është më se e domosdoshme për të gjitha proceset që kaloi e po kalon Kosova, së bashku me Bashkësinë Ndërkombëtare. Andaj, sipas Strategjisë, roli dhe ndikimi i institucioneve kosovare, së bashku me Bashkësinë Ndërkombëtare dhe me BE-në si pjesë e saj, duhet të bashkërendojnë formën dhe përmbajtjen e partneritetit, për zhvillimin e integrimin e Kosovës në BE. Këtë proces dhe strategji Kosova e ka filluar.(Strategjia GIZ, 27 mars 2012) Sukses i Kosovës ishte: Pjesëmarrja e Kosovës në Procesin e Stabilizim Asociimit (PSA). Kosova ka siguruar procesin e Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asociimit (MPSA) për tu involvuar në proceset integruese dhe për të krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e Bashkimit Evropian. Involvimi në Mekanizmin Përcjellës të Stabilizim Asociimit kërkon plotësimin e kriterëve të kërkuara nga Bashkimi Evropian të cilat, kërkojnë reforma juridike, politike, ekonomike dhe institucionale. Këto reforma dhe plotësimi i kriterëve integruese të Kosovës nuk është i lehtë. Procesi i anëtarësimit kërkon plotësimin e *Kriterëve të Kopenhagen-it*: Kriterin Politik, Ekonomik dhe Kriterin e Standardeve Evropiane – Eu Acquis. Në kriterin politik bëjnë pjesë: Demokracia dhe Sundimi i Ligjit, Mbrojtja e të Drejtave të njeriut dhe Minoriteteve, Intensifikimi i Bashkëpunimit Rajonal. Në kriteret ekonomike hyn konsolidimi i krieterëve të ekonomisë së tregut: ndërtimi i kapacitetve

konkuruese; privatizimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike; qëndrueshmëria buxhetore dhe ekonomike; zhvillimi i sektorit financiar; ngritja e kapacitetve njerëzore; dhe procesi i integritit ekonomik në BE. Në kuadër të standardeve evropiane-EU Acquis bëjnë pjesë : tregu i brendshëm; politikat Sektoriale; Liria, Siguria dhe çështjet e tjera.

Sfidat juridike e politike të integritit në BE

Procesi i anëtarësimit kërkon plotësimin e Kritereve Politike e juridike: Demokracia dhe Sundimi i Ligjit, Mbrojtja e të Drejtave të njeriut dhe Minoriteteve, Intensifikimi i Bashkëpunimit Rajonal. Ndërsa, kriteri i standardeve evropiane – Eu Acquis, paraqet fillimin e përafrimit të ligjeve me EU acquis. Angazhimi permanent i BE-së në Ballkan dhe sidomos në çështjen e Kosovës gjatë të gjitha fazave, si dhe njohja nga 25 vendet anëtare të BE-së, ishin fillesa mjaft domethënëse për integritin e Kosovës në BE. Ndërsa, pengesë politike e vendimmarrëse është mosnjohja nga 5 vendeve të BE-së. Por, politikat e zgjerimit dhe ndikimit të BE-së në Ballkan dhe në Kosovë janë të pashmangshme. “Kosova nuk duhet të lihet prapa në progresin e regjionit të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së...Edhe pse shtetet anëtare të BE-së kanë pikëpamje të ndryshme për statusin e Kosovës. Kjo nuk duhet të jetë pengesë për progresin thelbësor në marrëdhëniet në mes BE-së dhe Kosovës”(Qendra informative dhe kulturore e BE-së në Kosovë, janar 2012,18-20) Këto politika janë fillesat e integritit evropian të Kosovës të cilat janë definuar në një Komunikatë të saj: “Qasja e dallimit në njohje, por e unitetit në angazhim.” (Qendra informative dhe kulturore e BE-së në Kosovë, janar 2012,18-20)

Edhe Kushtetuta e Kosovës në dispozitat e mundësisë se bartjes së sovranitetit (neni 20) rregullon sferen e antarësimit dhe integritit. Kosova “mundë të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare” (neni 2.3) “në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara

ndërkombëtare, për qeshtje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizative ndërkombëtare” (neni20.1) dhe përmes antarësimit të Kosovës në një organizatë ndërkombëtare, këto norma të kësaj organizate kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës, (neni 20.2) janë zgjidhje kushtetuese të përshtatshme që Kosova përmes parlamentit vendos për integrim në organizatat ndërkombëtare dhe në BE.

Këshilli i BE-së, nga dhjetori 2011 ka hapur mundësinë e dialogun për viza për Kosovën me Komisionin Evropian. Mundësinë për marrëveshje tregtare me Kosovën, anëtarësimin e Kosovës në BRZh dhe mundësinë e pjesëmarrjes së Kosovës në programe të BE-së. (Këshilli i Bashkimit Evropian, 2011) Në janar 2012, Komisioni filloi dialogun për liberalizim të vizave me Kosovën. Disa muaj më vonë, filloi Dialogu i strukturuar mbi Sundimin e Ligjit, së bashku me lansimin e udhërrëfyesit të liberalizimit të vizave nga Komisioni. Me konkluzionet e Këshillit në mars 2012 me studimin e fizibilitetit për MSA ndërmjet BE-së dhe Kosovës, i publikuar në tetor 2012, është arritur hapi i parë i hyrjes në marrëdhëniet kontraktuale me BE-në. Ky studim ka ekzaminuar se sa janë përmbushur kriteret politike, ekonomike dhe ligjore për një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit. Raporti shënon se Kosova “në pjesën më të madhe është e gatshme të filloj negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit” dhe ka propozuar direktiva për përmbushje të prioritetëve në fushën e drejtësisë, administratës publike, mbrojtjes së pakicave dhe tregtisë. (KE, 2012) Por, mos-njohja e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së, paraqetë sfida gjatë negociatave për MSA-në dhe procesit të integritit. Procesi i ratifikimit të pesë shteteve anëtare të BE-s që nuk e kanë njohur Kosovën, do të jetë sfidues. Por, përmbajtjen dhe cilësinë e procesit parapergaditor integruar duhet jetësuar faktori kosovar, tani përmes institucioneve, qeverisjes efektive dhe angazhimit të

shoqërisë civile; më përkrahjen dhe mbështetjen e mirëfilltë dhe të paanshme të BE-së, veçmas në raportin Kosovë-Serbi.

Shoqëria dhe politika kosovare duhet të krijojë parakushte për proceset pozitive integruese e bashkëpunuese, duke i tejkaluar pengesat. Këto pengesa janë shumë dimensionale dhe u shprehen edhe kundër qeverisjes e institucionalizimit kosovar. Andaj, faktori kosovar, duke i fuqizuar institucionet dhe qeverisjen, i tejkalon më se miri këto pengesa, dhe se bashku me faktorët pozitivë ndërkombëtar e konsolidon qeverisjen, institucionet dhe pozitën integruese ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Qeverisja dhe institucionet kosovare janë instrument i zhvillimit dhe integritit kombëtar, rajonal, integrim në BE dhe global, njëkohësisht.

Çështja e sundimit të ligjit dhe stabilitetit institucional e qeverisës, është esenciale për integrim në BE. BE-ja po i mbështet reformat dhe transformimet në shumë sfera vitale që shkojnë në favor të krijimit të parakushteve për integrim. (Qendra informative dhe kulturore e BE-së në Kosovë, janar 2012:14) Proceset integruese janë të domosdoshme për zhvillim. Edhe Pavarësia e Kosovës kishte qëllim lirinë dhe shtetin si instrument të zhvillimit e bashkëpunimit përmes afirmimit dhe integritit. Diplomati austriak Rohan Albert, i cili ka qenë ndihmës i Ahtisarit në negociatat për status të Kosovës, për „Këndin evropian të Kohës” bashkëpunuese me Zyrën e BE-së në Kosovë, me qëllim të stimulimit të debatit rreth perspektivës së Kosovës në BE. Në pyetjen se: Çka nënkupton integrimi evropian për Kosovën dhe popullin e saj? Ai, ndër të tjera, shkruan:

Kjo do të thotë, mbi të gjitha, se Kosova si një shtet evropian ka të drejtë që të aplikojë për anëtarësim në BE kur t'i plotësojë të gjitha kriteret për anëtarësim. Sipas Traktatit të Unionit, BE-ja është e themeluar mbi vlerat e dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e minoriteteve. Këto vlera janë të përbashkëta për shtetet anëtare në një shoqëri ku pluralizmi, mos diskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave mbizotërojnë. Sigurisht, ky është një lloj i bashkësisë pjesë e së cilës duhet të jenë Kosova dhe njerëzit e saj. Për më tepër, BE-ja ofron paqe dhe siguri për anëtarët e saja. Historia e

gjysmë shekullit të kaluar tregon se konfliktet e armatosura janë bërë të papara mendueshme në pjesën e integruar të Evropës. Përveç kësaj, shumica e shteteve anëtare të BE-së i takojnë edhe NATO-s, aleancës më të fuqishme ushtarake në botë, e cila i mbrohet nga kërcënimet e mundshme nga jashtë. Brenda e jashtë Unionit, katër liritë lejojnë rrjedhën e lirë të mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe njerëzve, në të mirën e të gjithë qytetarëve. BE-ja është ekonomia më e fuqishme në mbarë botën dhe me 500 milionë banorë është një nga tregjet më të mëdha... (Rohan, 17.02.2013, 1)

Kërkohej stabilitet i institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve, aftësinë për tu përballur me konkurrencën-forcave të tregut brenda BE-së, sigurimin e një ekonomie funksionale, aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit dhe në veçanti, *''acquis communautaire''*. Të miratohen dhe implementohen në tërësi ligjet sipas standardeve të BE-së- *“Acquis Communautaire”*. (Qendra informative dhe kulturore e BE-së në Kosovë, janar 2012:17) Në Kosovë është në krijim e sipër edhe një pako legjislativë e reformuar dhe në pajtim me standardet Evropiane apo me EU *acquis*, por kërkohej që këto ligje të gjejnë zbatim në specifikat e Kosovës. Pra, kërkojnë qeverisjen dhe institucionet më cilësi e standarde implementuese demokratike. Por edhe vetë hapat parapërgaditor dhe mbështetja në procesin integrimin nga BE-ja, mundësojnë dhe krijojnë parakushte për qeverisje dhe tejkalim të dukurive negative në qeverisje, siç është p.sh. procesi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asocimit (MSA), procesi i sigurimit të kushteve për liberalizimin e vizave, etj. (KE: MSA, tetor 2012) Qeverisja kosovare duhej t'i përkushtohej më shumë përgatitjes së vendit për integrim, që d.m.th. të ngrite nivelin e cilësisë demokratike, efikase e efektive sipas përcaktimeve kushtetuese dhe kërkesave të BE-së, për të cilat është përcaktuar qeveria e Kosovës. (MSA, 2012) Pra, këto janë sfidat juridike e politike të integrimin në BE.

Theksohej se, nëse Kosova arrin progres konkret në fushat si: sundimin e ligjit, administratën publike, mbrojtjen e minoriteteve dhe çështjet e tregtisë, atëherë Këshilli i

BE-së mund të konkludojë se Kosova është e gatshme të nisë negocimin e MSA-së. As në fundvitin 2012, nuk kishte datë për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA-në) dhe as afat për liberalizimin e vizave. Qeveria po ia hedh topin BE-së, duke u ankuar se po e vonon Kosovën në procesin integruar, ndërsa Këshilli Evropian thotë se nuk janë plotësuar kriteret. Ndër prioritetet afatshkurtra nga të cilat varej edhe data e MSA-së, liberalizimi i vizave, etj., ishin përmirësimi i sundimit të ligjit dhe reformat në administratën publike. Raportet monitoruese ndërkombëtare, Përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, Avokati i Popullit, drejtues institucionesh, mediet, shoqëria civile, etj, flasin për drejtësinë e rrënuar, për skandale, shkelje të të drejtave, aferat në ekzekutiv dhe në nivele të tjera qeverisëse, në komuna, kompani publike, etj. Në konkluzat e Këshillit të Europës, Kosovës i kërkoheshin rezultate në luftën kundër korrupsionit. Brukseli kërkon mosndërhyrje në punën e gjyqtarëve, prokurorëve dhe bën thirrje për bashkëpunim më të mirë. Ndërkohë, reforma në administratë ende ishte e paqartë. Kishte një mbi punësim, nepotizëm, militantizëm partiak, mospërfillje kriteresh profesionale, mungesë gradimi sipas vlerave të nëpunësve, etj. Në kërkesat e tyre kushtuar Kosovës, përfshihej edhe liria e shprehjes. (MSA,2012) Pra, Kushtet për anëtarësim ishin përcaktuar nga Këshilli Evropian. (Komisioni Evropian-Drejtorja e përgjithshme për zgjerim, 2011) Cilësia qeverisëse e institucionale është faktori esencial, krahas politikave e gatishmërive zgjeruese të BE-së. Kosova duhet të siguroi vlera të përbashkëta të vendosura në Traktatin e Unionit dhe ato kërkohej që të kenë arritur stabilitet të institucioneve dhe qeverisje demokratike dhe ekzistim të një ekonomie konkurrense të tregut. Të miratoj dhe implementoj në tërësi ligjet sipas standardeve të BE-së- “*Acquis Communautaire*”. (Qendra informative dhe kulturore e BE-së në Kosovë, janar 2012:17) Në Kosovë ishte

përgaditur një pako legislative e reformuar dhe në pajtim me standardet Evropiane apo me EU acquis, por kërkohej që këto ligje të gjejnë zbatim.

Ky është një proces i gjatë dhe i vështirë. BE-ja do të vazhdojë me sigurimin e asistencës, por rezultatet varen nga vetë Kosova, nga lidershpi i saj dhe qytetarët. Për Kosovën është me rëndësi vitale që të jetë e integruar në BE, por për këtë kërkohej cilësi demokratike qeverisëse. Njëherit, edhe vetë procesi integruar do të garantonte cilësi qeverisëse e institucionale. Andaj, hapat duhet të jenë të përbashkët. Kosova ka përfituar shumë nga përkrahja që i është dhënë prej BE-së, SHBA-së dhe nga shtetet tjera, si dhe nga Organizatat dhe institucionet globale e rajonale të shumta. Kosova kishte përfituar asistencë të konsiderueshme të të gjitha llojeve, madje edhe financiare. Mandati i tyre ishte përkrahja në fuqizimin e institucioneve në fushën e drejtësisë dhe rendit të ligjit, veçmas pas Pavarësisë. Përfitimet e Kosovës nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) janë të mëdha. Kërkesat e këtij procesi përgatitor për integrim, ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë qeverisëse e institucionale. Mobilizojnë qeverisësit dhe qytetarët në përmirësimin e këtij procesi, dhe ishin një lloj kontrolli, përgjegjësie e transparence për ecuritë dhe pengesat. Vlerësimet e Organeve të BE-së për qeverisjen kosovare në këtë kontekst i informojnë qytetarët dhe institucionet për shumë dukuri negative në qeverisje.

Përshtatja dhe synimi drejt integritetit dhe vetë procesi i integritetit, Kosovës i sjell këto përfitime: mirëqeverisje dhe forcim të shtetit të së drejtës, konkurrencë në sektorin qeverisës dhe në ekonomi, lëvizje të lirë të njerëzve e kapitaleve, mallrave e shërbimeve, ulje e kostove tregtare, unifikim i tregut të punës, perspektivë në edukim, rritje ekonomike, siguri, pjesëmarrje të suksesshme në globalizim, mirëqenie dhe rritje të përgjithshme të standardit të jetës dhe në marrëdhëniet me vendet fqinje.

Në një intervistë gjatë publikimit të studimit të fizibilitetit të MSA-s, Komisionari për Zgjerim, Stefan Fule, duke theksuar se Zgjerimi rritë stabilitetin në Ballkan, për Kosovën sugjeroi një numër prioritetesh afatshkurta dhe afatgjata: “Sundimin e ligjit, reforma në administratën publike, integrimin e minoriteteve dhe tregtinë e zhvillimin ekonomik.” (Fule: tetor, 2012) Ndërsa, Raporti i këtij studimi i KE për studimin e fizibilitet për kushtet e hapjes së MSA për Kosovën, në mënyrë analitike e paraqet gjendjen në sektorin e demokracisë dhe Sundimin e Ligjit, në sferën e të drejtave njerëzore dhe mbrojtjen e minoriteteve, në gjendjen ekonomike dhe të stabilitetit dhe në Politikat e bashkëpunimit rajonal. (MSA për Kosovën, 2012)

Dokumenti i studimit të fizibilitetit për MSA për Kosovën-tetor 2012, vlerëson të arriturat në legjislativ, ekzekutiv, në administratën publike, reformat në sektorin e Sigurisë, në Sistemin Gjyqësor dhe luftën kundër korrupsionit, të cilat mund të përmblihen:

a) Vlerëson rezultatet e Kuvendit gjatë tri viteve të fundit në ngritjen e kapacitetëve dhe kornizën institucionale për legjislacionin dhe kontrollin e ekzekutivit, Komisionin e Kuvendit për reformë kushtetuese, vendimin e Gjykatës Kushtetuese për imunitetin funksional të deputetit, mbajtja e zgjedhjeve qendrore e lokale, duke cekur mangësitë serioze dhe teknike të zgjedhjeve më 2010 dhe 2011. Thekson dobësitë në emërtime nëpër institucionet e pavarura dhe agjencitë rregulluese, dhe buxhetimin e tyre. Thekson se nën marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit duhet forcim më i madh i parimeve demokratike të qeverisjes nga parlamenti dhe politikat e brendshme e të jashtme të subjekteve partiake. Respektimin e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe sundimin e ligjit.

b) Vlerësohet pozitivisht krijimi i institucioneve ekzekutive dhe stabiliteti i mjaftueshëm politik. Vlerësohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese për konfirmimin e mandatit të plotë të Presidentes aktuale. Përmbushja e agjendës ambicioze të reformave të BE-së. Sugjeron që koordinimi në mes Qeverisë dhe Kuvendit të forcohet. Të bëhet mbikëqyrja e komunave nga niveli qendror, veçmas ndihma dhe asistenca për komunat më shumicë serbe. Theksohen sfidat e decentralizimit në Veri, etj. Si përmbledhje rekomandohet thellim i parimeve demokratike të qeverisjes në ekzekutiv, për të siguruar një ekzekutiv më adekuat dhe më efektiv në të gjitha nivelet e administrimit.

c) Vlerësohet pozitive korniza ligjore në fushën e administrimit publik, megjithëse kërkohet të adaptohen të gjitha legjislacionet sekondare për ligjet e shërbimit civil dhe pagat e tyre. Hapësirë dhe analizë i kushtohet Institucionit të Ombudspersonit si organ i pavarur që lidhet me administratën publike. Kërkon mbështetje më serioze ndaj këtij institucioni nga qeveria dhe Kuvendi. Kërkohet decidivisht në përmbushjen e politikave dhe veprimeve në reforma të administratës publike: në strategji, planë veprimi, legjislacion relevant dhe alokim të burimeve të mjaftueshme. Të mbështesë dhe përmirësojë profesionalizmin, përgjegjësinë dhe efikasitetin e administratës publike, me qëllim të funksionimit më cilësor në të mirë të qytetarëve dhe bizneseve.

ç) Vlerësohen reformat e sektorit të sigurisë. Theksohet se Kosova ende nuk ka forcë të sigurisë me kapacitete të mbrojtjes. Rishikimi strategjik i sigurisë duhet të përmbyllet në qershor 2013. Kërkohet mbikëqyrje e këtij sektori nga Kuvendi i Kosovës. Konkludohet se duhet të forcohet më shumë kontrolli demokratik mbi sektorin e sigurisë.

d) Vlerësohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në veçanti respektimi i tyre nga të gjitha autoritetet dhe lidershipi. Kërkohet qartë përmirësimi i gjendjes së pavarësisë,

efikasitetit, përgjegjësisë dhe paañësisë së gjyqësorit. Të garantohet siguria dhe mbrojtja e gjykatësve, prokurorëve, dëshmitarëve, të pandehurve e stafit të gjykatës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial duhet të rekrutojnë më shumë gjykatës dhe prokuror nga minoritetet, siç parashihet edhe më kornizat legjislative. Kërkohet sigurimi i objekteve në të cilat mbahen seancat gjyqësore dhe objektet korrektuese. Zbatimi i vendimeve civile dhe penale konsiderohet i dobët. Edhe sistemi administrator duhet reformuar. Qasja e gjyqësorit në veri ende është e penguar. Nën Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit kërkohen përforsim i parimeve të gjyqësorit dhe institucioneve tjera për sundimin e ligjit. Kjo arrihet nëse realizohen forcime shtesë të pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimit të efikasitetit.

e) Kërkohet bashkëpunim më i ngushtë në mes EULEX-it dhe institucioneve vendore. Prokuroria speciale të rrisë numrin e arrestimeve dhe bastisjeve. Dhe mbështetje më e madhe ndaj EULEX-it për përmbushje të mandatit të tij.

ë) Kërkohet një kornizë legjislative antikorrupsion e mbështetur nga politika dhe institucionet. Vlerësohen pozitivisht ligjet për deklarimin e pasurisë, shmangien e konflikteve të interesit në funksionet publike, në prokurimin publik dhe në financimin e partive politike. Por, ka vërejtje në rezultatet e veprimit dhe zbatimit. Kërkohet që të obligohen partitë të kenë vetëm një xhirollogari të vetme bankare dhe publikimin e raporteve financiare në afate. Lufta antikorrupsion të mbështetet nga të gjitha institucionet dhe ndaj të gjithë bartësve të tyre. Konstatohet se, nuk ka mbështetje nga lidërshipi i lartë në luftimin e korrupsionit.

f) Në sferën e të drejtave të njeriut përmenden të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale. Sado që këto të drejta janë të parapara në Kushtetutë, MSA kërkon ngritjen e

nivelit të respektimit në praktikë. Përmend të drejtën e shprehjes dhe kërkon ndryshimin e Kodit Penal për mediet dhe mbrojtjen e burimeve të gazetave. Ka vërejtje në kornizat ligjore dhe në implementim rreth të drejtave pronësore, zbatimit të vendimeve gjyqësore e administrative. Vlerësohet pozitivisht përmirësimi i kushteve në qendrat e burgimit, kërkon rritjen e profesionalizmit të stafit korrektues. Nën marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, Kosova duhet të respektojë dhe përmbush të drejtat njerëzore të përcaktuara me dokumentet kryesore ndërkombëtare si *Deklarata Europiane e të Drejtave Njerëzore* dhe *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut*.

g) Në mbrojtjen e minoriteteve vlerësohet pozitivisht legjislacioni kushtetues dhe vazhdimi i garantuar në praktikë edhe pas mbikëqyrjes ndërkombëtare, garantimi i përfaqësimit dhe respektimit të të drejtave kulturore, gjuhës së minoriteteve, veçmas ndaj atij serb sa i përket të drejtave mbi Kishën Ortodokse serbe. Kërkohet të punohet në afrimin e kushteve më të mëdha për kthimin, e arsimimin e pakicave.

h) Kërkohet një bashkëpunim më i përafërt në mes të Kosovës dhe BE-së, për të diskutuar e bashkërenduar një kornizë për dialogun politik, integrim, riafirmim gradual, bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Vlerësohen ecuritë e dialogut me Serbinë me ndërmjetësimin e BE-së. Kërkohet implementim i të gjitha marrëveshjeve të arritura në mes Prishtinës dhe Beogradit.

Kapërcimi i sfidave tjera politike të Kosovës, ndërlidhen edhe me kapërcimin e dallimeve brenda vetë BE-së. Mosnjohja e Kosovës nga pesë vendet e BE-së dhe qëndrimet joparimore e tolerante ndaj sjelljeve të Serbisë në Kosovë, veçmas në pjesën Veriore dhe ndaj Kosovës në përgjithësi, paraqesin sfida për integrimin e Kosovës në BE, të cilat duhet tejkaluar bashkarishtë Kosova dhe vetë BE.

Sfidat ekonomike të integrimit në BE

Këshilli Evropian, kërkonte plotësimin e kriterëve ekonomike të deklaruar me Kriteret e Kopenhagës. Në kriteret ekonomike hyn konsolidimi i kriterëve të ekonomisë së tregut: ndërtimi i kapacitetve konkurruese; privatizimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike; qëndrueshmëria buxhetore dhe ekonomike; zhvillimi i sektorit financiar; ngritja e kapacitetve njerëzore; dhe procesi i integrimit ekonomik në Bashkimin Evropian. Pra, për ta përmirësuar gjendjen ekonomike në funksion të integrimit në BE, kërkohet që politikat ekonomike të bazohen në respektimin e plotë të parimeve të ekonomisë së tregut, veçmas liberalizimit dhe konkurrencës. BE, në kërkesat nga MSA kërkonte ekonomi funksionale të tregut, e cila është në gjendje të përballet me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut në BE. Ambienti makroekonomik të mbështetet nga një kornizë stabile institucionale dhe liberalizim gjithëpërfshirës i çmimeve e transaksioneve. Fuqizim i sektorit privat dhe demonopolizim e privatizim dhe menaxhim i mirë i sektorit financiar. Kërkonte që këto politika të jenë të rregulluara e të mbështetura në korniza stabile e transparente ligjore e procedurale. (GAP, Qershor 2009)

Dokumenti për Partneritet Evropian për Kosovës, shkurt 2008, sa i përket kriterëve ekonomike kërkonte që:

1. Të mbahen politika fiskale stabile dhe, në veçanti, të sigurohet që politikat sociale që adresojnë varfërinë dhe përjashtimin social, të jenë në harmoni me qëndrueshmërinë afatgjate të financave publike;
 2. Të caktohen synimet vjetore për inkasimin më efikas të shërbimeve publike, dhe definimi dhe zbatimi i strategjive për t'i arritur këto synime;
 3. Të avancohet në mënyrë domethënëse privatizimi i ish-ndërmarrjeve shoqërore në pajtueshmëri me afatet e përcaktuara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit;
 4. Të përmirësohet qeverisja, efikasiteti dhe qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjeve publike. Të përforcohet më tutje pavarësia operuese dhe financiare e autoriteteve rregullative me qëllim të rritjes së transparencës dhe konkurrencës në sektorët relevantë;
 5. Të zhvillohen dhe zbatohen politikat që lehtësojnë transferimin nga punësimi i paregjistruar në atë të regjistruar në mënyrë që të krijohet një treg pune funksional dhe zyrtar dhe të qartësohet efikasiteti i politikave të tregut të punës.
- (GAP, Qershor 2009, 8)

Edhe në Raportin e Progresit për Kosovën 2012, gjendja ekonomike vlerësohet e pavolitshme, veçmas papunësia e theksuar, mbi 40%; vetëm çdo e teta grua është e punësuar! Në aspektin e politikave fiskale, si problem ceket deficitin buxhetor. Kërkohej përmirësimi i ambientit biznesor, thjeshtëzimi i regjistrimit të bizneseve, reduktimi i dokumenteve për import dhe eksport. Vërejtje ka në implementimin në praktik të legjislacionit dhe kornizës rregullative në këto sfera.

Kërkohej ngritja e kapaciteteve cilësore administrative për të negociuar në fushat e ndërlidhura me tregtinë, të identifikojnë përfitimet dhe kostot e ndryshimeve në regjimet tregtare nga negociatat me BE-në. Vlerësohen hapat e riorganizimit dhe përfortimit të ministrive përkatëse, por kërkohej të jetë sa më operacionale dhe e pajisur me staf të aftë, që të mbulojë të gjitha aspektet e negociatave tregtare që garantojnë bashkëpunim të plotë në procesin e negociimit.

Konstatohet se Kosova ka një deficit të vazhdueshëm tregtar në mallrat industriale për të përfituar nga regjimi preferencial tregtar me BE-në. Tregtia me mallra bujqësore nuk po mund të realizohet pa i kryer reformat strukturore bujqësore, andaj kërkohej të behën këto ndryshime. Synimet e ardhshme janë sigurimi i qarkullimit të lirë të mallrave. Sa i përket lëvizjes së punëtorëve nga jashtë në Kosovë, kërkohej rregullim ligjor efikas dhe i përshtatshëm. Regjistrimi i Kompanive të BE-se në Kosovë të kenë trajtim të garantuar sikurse kompani lokale ose atë të shtetit më të favorizuar.

Konstatohet se shërbimet kosovare janë në proces të rritjes së GDP-së kosovare, bilancit pozitiv tregtar që ndikojnë në rritjen ekonomike. Në veçanti janë shërbimet e udhëtimit që varen nga diaspora e fuqishme kosovare. Sa i përket lëvizjes së Kapitalit dhe pagesave, Kosova ka një regjim liberal të lëvizjes, përfshirë investimet e drejtpërdrejta të

jashtme. Kosova ka lidhur një mori traktatesh bilaterale investimesh me Shqipërinë, Belgjikën dhe Luksemburgun. Raporti në fjalë, sugjeron reforma të mëtutjeshme që duhet të prezantojnë kërkesat e rrezikut Basel II dhe të krijojnë një kornizë ligjore në përputhje me standardet e BE-së për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe sistemeve të pagesave, në veçanti për investimet e drejtpërdrejta.

Departamentet për integritet evropiane ishin krijuar në të gjitha ministritë dhe ishin të koordinuara nga Ministria e Integritetit Evropian. Edhe në këtë sferë është arritur progres në përafrimin të legjislacionit me acqinë e BE-së, por në Raport kërkohet të rriten kapacitetet dhe niveli i ekspertizës në fushën e bashkërendimit legjislativ me të gjitha elementet e acqinës të BE-së. Ky Raport i kushton kujdes edhe Konkurrencës, duke konstatuar se Komisioni i Pavarur i Konkurrencës i Kosovës, themeluar më 2009, nuk është i përfshirë sa duhet në aspektet konkurruese të privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha publike. Sugjerohet që Ligji për ndihmat shtetërore të plotësohet me një legjislacion sekondar efektiv. Të amendamentohen aspekte të caktuara të Ligjit për konkurrencë, për të qenë në harmoni me rregullat e konkurrencës së BE-së: të rregullojë monopolet shtetërore të karakterit komercial për të siguruar tregtinë e lirë të mallrave e shërbimeve. Kërkohet edhe transparencë më e madhe në fushën e ndihmës shtetërore. Gjithashtu kërkohet kujdes më i shtuar sa i përket mbrojtjes së të drejtës mbi pronën intelektuale. Ligjet që rregullojnë këtë sferë konsiderohen në përputhje me ato të BE-së, por mund të plotësohen me legjislacion sekondar dhe me kapacitete të stafit.

Kërkohet që, Prokurimi Publik të rritë integritetin dhe transparencën e procesit të prokurimit, ndërsa rastet e korrupsionit e mashtrimit të adresohen e të ndëshkohen nga organet përkatëse. Edhe korrupsioni i brendshëm në fushën e prokurimit duhet identifikuar

e luftuar me efektshëm. Të përmirësohet profesionalizmi në këtë sektor. Kompanitë e BE-së të kenë qasje në procedurat e dhënies së kontratës me trajtim të barabartë me kompanitë vendore. Kërkohej që edhe legjislacioni i prokurimit publik të jetë në një vijë me atë të BE-së. Për të qenë i suksesshëm ky sektor, kërkohej efikasitet i gjyqësorit.

Pra, në Raportin e Studimit të Fizibilitetit për MSA për Kosovën, kërkohej përmirësimi i standardizimit ligjor dhe veprimet konkrete institucionale konform standardeve e praktikave të BE-së në të gjithë sektorët, për të ardhur deri të Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe për hapat tjerë integruar në BE. Pra, përshkruan të arriturat qeverisëse e institucionale në Kosovë, identifikon dukuritë negative e mungesat që duhet plotësuar dhe sugjeron mënyrat e instrumentet se si të arrihen qëllimet. Të gjitha këto vlerësime dhe sugjerime, në Studimin e Fizibilitetit të publikuar nga KE, janë definuar si kushte për Kosovën. (Raporti i Studimit të Fizibilitetit për MSA për Kosovën, 2012)

Në tetor 2012 Komisioneri i Bashkimit Evropian për zgjerim, Stefan Fyle, i dorëzoi Kosovës Dokumentin e Studimit të Fizibilitetit, duke premtuar që negociatat për marrëveshjen e stabilizim-asocimit mund të fillojnë shpejt, nëse Kosova vazhdon progresin dhe arritjen e rezultateve në një numër të prioritetëve afatshkurta, që kanë të bëjnë me kapacitetet administrative, me sundimin e ligjit, me mbrojtjen e pakicave dhe me përmirësimin e kapaciteteve tregtare. (Fule, tetor 2012:1) Kryeministri i Kosovës u zotua se do të punohet në përmbushjen e këtyre kriterëve dhe se pret që në pranverë 2013, Kosovës do t'i caktohet data e nisjes së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit. (Thaqi, Koha ditore, tetor 2012:1)

Në Raportin e Parë të cilin e ka publikuar KE, ku vlerësohet progresi i arritur nga institucionet e Kosovës në përmbushjen e kushteve të dala nga Udhërrëfytyesi për

Liberalizimin e Vizave, (2012) thuhet se Kosova vazhdon të mbetet vend i rrezikshëm për t'ia hequr regjimin e vizave dhe paraqet një listë rekomandimesh të mëdha, që Prishtina zyrtare duhet t'i marrë parasysh dhe t'i plotësojë, nëse dëshiron që qytetarët e saj të udhëtojnë pa viza në BE. Krimi i organizuar, korrupsioni, shkelja e të drejtave të njeriut, ligje që nuk përkojnë me standardet e BE-së, ligje të miratuara por që nuk zbatohen, aktivitete kriminale, si trafikim me qenie njerëzore, me drogë, me armë, me cigare e karburante, janë disa nga të gjeturat e KE-së për Kosovën. Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida të mëdha në parandalimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat po pengojnë perspektivën ekonomike dhe politike të Kosovës dhe integrimin e saj.

Në tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian botoi Studimin e Fizibilitetit për MSA në mes të BE dhe Kosovës dhe vërtetoi se Kosova është “kryesisht e përgatitur për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.”(Fule, tetor 2012:1) Por, siç u theksu më lartë, ky studim nënvizon se Kosova po përballlet me mangësi serioze përkitazi me kriteret politike, ekonomike dhe ligjore, që duhet të trajtohen për të përshpejtuar rrugën drejt BE-së. Por megjithatë, në raportin e përbashkët të Komisionit Evropian dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, në prill të vitit 2013, u paraqit një analizë për përparimin e Kosovës në lidhje me prioritetet afatshkurta të Studimit të Fizibilitetit si dhe çështjet e tjera që iu referuan përfundimeve të Këshillit në dhjetorin e vitit 2012:

Raporti i përbashkët konstatoi se Kosova ka përmbushur prioritetet afatshkurta dhe prandaj Komisioni Evropian paraqiti propozimin e tij për një vendim nga Këshilli që autorizon nisjen e negociatave për MSA në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Tani pritet që Këshilli të miratojë direktivën për negociatë që do t'ia hap rrugën Kosovës për fillimin e negociatave për MSA. (Strategjia Kombëtare për Integrim Evropian, 2013,4)

Institucionet kosovare në vitin vijues (2013) krijuan mekanizmat dhe Strategjinë Kombëtare për Integrim Evropian,"Kosova 2020":

Autoritetet qeveritare, shoqëria civile, komuniteti i medieve dhe i biznesit do të ndërmarrin përpjekje dhe strategji të përbashkëta për të përmirësuar imazhin e vendit në botë. Me qëllim të rritjes së numrit të shteteve që njohin Kosovës, me qëllim të ndryshimit të opinionit publik në Evropë dhe me qëllim të angazhimit efektiv në arenën ndërkombëtare, Kosova duhet së pari të kuptojë problemin e imazhit të saj dhe të krijojë të ashtuquajturën “markën e re kombëtare”. Përveç kësaj, Kosova do të bëjë përpjekje maksimale dhe do të bëjë përmirësime të konsiderueshme në lidhje me reformat e brendshme, të tilla si sundimi i ligjit dhe gjyqësori. Kosova do të synojë që të ulë numrin e imigrantëve të paligjshëm dhe që të sigurojë përparim të dukshëm dhe të mjaftueshëm në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. (Strategjia Kombëtare për Integrim Evropian, 2013: 66-67)

Por, edhe BE ka sfidat e veta që e vështirësojnë procesin e integrimit të vendeve të reja. Sfidat e Bashkimit Evropian që ndikojnë në Integrimin e Kosovës në BE, janë: politika e jashtme e BE-së; kapaciteti apsorbuës i BE; Tendenca për migrim nga Ballkani Përendimor në BE dhe sfida të tjera ndaj rajonit dhe raporteve ndërkombëtare.

6.2. Integrimi ndërshqiptar në suazat rajonale

Të gjitha rezultatet e hulumtimeve zhvillimore, tregojnë se rritja ekonomike në vendet e tranzicionit ka lëvizur pozitivisht kryesisht, si rezultat i bashkëpunimit në mes veti. (Balkan Monitor (ed) Raporti analitik, 2010; USAID, 2009) Parakusht për zhvillim dhe integrim në BE është bashkëpunimi në mes vendeve dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore. Republika e Kosovës është në hapat e parë të krijimit të këtij bashkëpunimi. Duke i ditur pasojat e politikave të gabuara të së kaluarës, të gjitha vendet duhet investuar me të gjitha forcat në krijimin e kulturave e mentalitetit të ri që kanë për bazë bashkëpunimin, respektin dhe kuptimin e interesit ekonomik, nacional e global. Ndryshimet dhe integrimet globale po japin rezultate konkrete në tejkalimin e mentalitetit dominues, konfrontues e jonjerëzor në politikë bërje. Andaj, edhe popujt e Ballkanit duhet shëruar nga mentaliteti jonjerëzor në politikë bërje dhe në raportet në mes vendeve e popujve. Në qeverisje duhet të vijë lidhshipi politik dhe subjektet politike me cilësi të tilla humane. Pa këtë kulturë politike të politikë bërësve, nuk ka investime të jashtme dhe bashkëpunim rajonal, nuk ka zhvillim të mirëfilltë, e as integritet cilësor.

Qeverisja dhe institucionet politike të mirëfillta janë instrumente të domosdoshme për rritjen ekonomike, për investimet dhe zhvillim e integrim. Proceset integruese evropiane në Ballkan po krijojnë klimë për zhvillim e integrim. (Kipred, 2013) Edhe lidershpi kosovar po shkon drejt këtyre orientimeve. Investimet në infrastrukturën rajonale dhe proceset kooperuese e integruese në Ballkan, po hasin në përkrahjeve konkrete të BE-së. (Mojmir dhe Tilev, 2008) Por iniciativat lokale e qendrore nuk duhet të mungojnë. Anëtarësimi i plotë i Kosovës në Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit po nxit marrëdhëniet bashkëpunuese me fqinjët. Bashkëpunimi rajonal ishte katalizator real për zhvillimin e infrastrukturës dhe energjisë, dhe bashkëpunim për sigurinë. Siguria dhe zhvillimi janë dy motive vendimtare për vendosjen e bashkëpunimit dhe integritit rajonal.

Të gjitha vendet në rajon janë të vendosura në mënyrë të qartë për zbatimin e të gjitha reformave të nevojshme në udhën drejt Bashkimit Evropian, por ky proces paraprakisht kërkon bashkëpunim, zhvillim e integrim në mes vendeve fqinje. Ky bashkëpunim cilësor dhe i gjithanshëm do të jetë katalizatori më i mirë i procesit zhvillimor e integrues cilësor. Proceset e arsyeshme e njerëzore në politik-bërje, janë shtylla e bashkëpunimit cilësor. Jo humanizmi dhe shkurtëpamësia konfrontuese e qëllimkeqe në politikë-bërje ka qenë karakteristikë e vendeve ballkanike, e cila ka qenë shkaktare e se keqes dhe jozhvillimit me të gjitha pasojat tjera. Kjo duhet tejkaluar rrënjësisht, ngase tejkalimi është i dobishëm për të gjithë.

Republika e Kosovës e ka të lehtë integrimin kombëtar shqiptar, përmes bashkëpunimit intensive rajonal në të gjitha sferat. Ky integrim bashkëpunues intensiv është i mirëseardhur dhe në dobi të kombit shqiptar dhe zhvillimit rajonal e global në këtë pjesë. Ky synim nuk është në dëm të askujt, përkundrazi. Integrimi ndërshqiptar kiste dhe

ka veshitësi, ngase janë krijuar realitete shtetërore, politike, ekonomike, etj., nga realitetet e kaluara të ndara e jo bashkëpunuese. Shqipëria dhe Kosova në këtë proces të integrimit ndërshtetëror, kanë pengesa të joshvillimit ekonomik, infrastrukturë e pengesa qeverisëse. E kaluara e tyre për një kohë të gjatë të izoluar, ka lënë pasojat e saj shumë të dëmshme. Shqipëria në integrimin përmes bashkëpunimit intensiv me Kosovën dhe trojet shqiptare në ish RSFJ, ka probleme të joshvillimit ekonomik e infrastrukturës. Edhe Kosova me trojet shqiptare në ish-RSFJ, nuk mundi të zhvillohej dhe të luante rol në integrimet ndërshtetërore. Kosova dhe shqiptarët në Maqedoni, në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi, tani për tani nuk kanë potencial të theksuar ekonomik për integrame shqiptare përmes bashkëpunimit intensiv ekonomik e tregtar. Por, kjo nuk do të thotë se nuk kanë potencial human, tregtar dhe investues në të ardhmen në shumë sektorë. Bashkëpunimi, automatikisht do të ngritë potencialet ekzistuese. Integrimet shqiptare tani janë shumë më të lehta se më parë. Proceset integruuese rajonale e globale janë domosdoshmëri e kohës. Pse të mos vlejë kjo edhe për vendet dhe pjesëtarët e kombit shqiptar në Ballkan? Kufijtë janë formalë dhe bashkëpunues. Bashkëpunimi intensiv është shumë më i lehtë në mes shqiptarëve, përkatësisht, në mes vendeve e trojeve të tyre. Ky bashkëpunim intensiv dhe zhvillim si rezultat i këtij bashkëpunimi, nuk është në dëm të askujt. Përkundrazi, shumë autor e theksojnë bashkëpunimin rajonal si faktor thelbësor në dobi të rajonit dhe zhvillimit global. (Riedeland & Eichelberg , tetor 2009) Andaj, aspekti i rregullimit juridik të këtij bashkëpunimi duhej dhe duhet të jetë i qartë, i plotë dhe efikas.

Kosovarët, në mungesë të ndërtimit të identitetit shtetëror dhe gjendjes paraprake të pabarazisë e lirisë, identitetin kombëtar shqiptar e ndjejnë shumë më të theksuar sesa vendet dhe shtetet e lira. Në rrethanat e sotme politike, në Kosovë kemi identitetin

kombëtar të shqiptarëve edhe identitetin e shtetit të Kosovës. Në një hulumtim të lirë të opinionit për këto çështje, morëm kryesisht këto përgjigje: Me bërjen e Kosovës shtet, a do të bëhet edhe një komb i ri? Shumica e përgjigjeve është: Jo, sepse kombi shqiptar tanimë është i formuar. A do ta ndryshojnë identitetin kombëtar shqiptarët e Kosovës dhe çfarë do të jenë kosovarët në një periudhë të ardhshme, komb i veçantë, apo pjesë e një kombi të ndarë në shtete të ndryshme? Përgjigja është kategorike: Pjesë e kombit shqiptar jo i ndarë, por i bashkuar përmes bashkëpunimit e integritit intensiv. Pra, dominon pikëpamja se shqiptarët janë një komb dhe se procesi i formimit të kombit shqiptar ka përfunduar shumë kohë më përpara dhe se bërja e Kosovës shtet, nuk ndikon në proces të ndarjes dhe largimit, përkundrazi. Pikëpamjet se Kosova me bërjen shtet do të kalojë në procesin e bërjes së një kombi të ri, janë të papërfillshme. Pikëpamjet e tilla rrjedhin nga identifikimi i kombit me shtetin, sikurse në vendet e zhvilluara. Por, kosovaret tani kanë identitetin kombëtar të qartë dhe identitetin shtetëror në proces të konsolidimit sipas vlerave e standardeve demokratike qeverisëse e integruese.

Shqiptarët e Kosovës dhe shqiptaret në përgjithësi janë me vetëdije kombëtare të qartë, të krijuar në proces të përpjekjeve për vetëvendosje dhe mbrojtje nga politikat dominuese, pushtuese e asimiluese. Vetëdija kombëtare dhe identiteti kombëtar shqiptar është i theksuar në Kosovë dhe në trojet shqiptare në ish-RSFJ. Nga ana tjetër, gjendja ideale një shtet-një komb, për shkak të shumë rrethanave, nuk arriti të realizohet. Gjatë shpërbërjes së RSFJ-së, nuk u lejua vetëvendosja etnike. Kjo ndarje e shqiptarëve, tani u zbutë me Pavarësinë e Kosovës dhe mbrojtjen e respektimit të komuniteteve etnike.

Nevojat vendore të rinisë së Kosovës dhe Shqipërisë, të shoqëruara me reformat e proceset evropiane e globale integruese, do t'i detyrojë qeveritë të ndryshojnë agjendat

dhe të fokusohen në bashkëpunim për zhvillimin ekonomik dhe në luftimin e dukurive negative në qeverisje. Ndryshimi cilësor në qeverisje dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe i sferave tjera, do të reflektohet fuqishëm në bashkëpunim intensiv. Qeveritë dhe partitë politike ende nuk kanë vizion të qartë se si të gjenerojnë këtë zhvillim kaq të kërkuar dhe esencial për shqiptarët e të dyja vendeve. Korrupsioni dhe krimi i organizuar dhe joangazhimi në luftimin e tij, mospërkrahja e bizneseve, po hendikepojnë zhvillimin dhe integrimin dhe bashkëpunimin intensiv në mes të të dyja vendeve.

Pengesë e integritetit në BE janë dukuritë negative në institucione dhe qeverisje, të cilat janë përafërsisht të njëjta në të dyja vendet. Në këtë kontekst, Oliver J. Schmitt e përshkruan gjendjen me optimizëm:

Ngurtësimit të shumë strukturave të elitës dhe të pushtetit e debateve agresive mbi politikën dhe identitetin, u rri përballë gjallëria mbresëlënëse e shoqërive të reja shqiptare. Megjithëse në Kosovë ato janë të kufizuara në lëvizjet e tyre nga politika e vizave e BE-së, ato i janë afruar Evropës më tepër se elitat e moshuara. Në diasporë është rritur një brez i ri i arsimuar mirë, që e ka vështirë të sjellë në shoqërinë shqiptare diturinë dhe socializimin e vet demokratik-pluralist, për shkak të qëndresës së paepur të elitave rajonale...ngritja e një shoqërie të vërtetë civile me përgjegjësi për shoqërinë dhe bashkëjetesën, për një demokraci funksionale, për një drejtësi të pavarur e të besueshme do tua hapin rrugën drejt Evropës shoqërive shqiptare. Ata njerëz që angazhohen për këtë gjë, meritojnë përkrahjen e plotë të Europës. (Schmitt, 2012)

Intensifikimi i marrëdhënieve në të gjithë sektorët duhet të jetë prioritet i qeverisjes së të dyja vendeve. Nuk duhet pritur integrimet evropiane, siç propagandojnë disa. Çështjet që duhej të gëzonin prioritet për institucionet e të dyja vendeve janë definimi i marrëdhënieve të avancuara ekonomike, politike e kulturore në mes të Shqipërisë dhe Kosovës: definimi i tregut të përbashkët dhe krijimi i kornizës ligjore përkatëse që lehtësojnë, mundësojnë e garantojnë bashkëpunim cilësor. Rregullimi i sistemit të qarkullimit të mallrave në mes të dy vendeve tona dhe heqja përfundimtare e barrierave, nxitja e investimeve reciproke dhe të përbashkëta, rregullimi i qarkullimit të kapitalit, krijimi i bursës së përbashkët Kosovë–Shqipëri, harmonizimi i standardeve teknike dhe

legjislacionit, harmonizimi i sistemit të edukimit, krijimi i qendrave të përbashkëta për shërbime të biznesit, integrimi i turizmit, implementimi i hapave për tregun e përbashkët, bashkëpunim më intensiv kulturor, etj. Pra, institucionet dhe qeverisja e të dyja vendeve, veçmas shoqëria civile dhe bartësit e biznesit, duhet të punojnë, planifikojnë e realizojnë këmbëngultësisht dhe në mënyrë permanente, këtë proces të integrititit përmes bashkëpunimit intensiv. Kjo sjell nacionalizëm të shëndosh dhe identitet kombëtar e human të të gjithë shqiptarëve. Kjo do të reflektohet edhe në raportin dhe respektin reciprok në mes kombeve e vendeve të Ballkanit dhe më gjerë. Këtë proces të integrititit ndërshqiptar përmes bashkëpunimit intensiv rajonal duhet ta nxisë dhe përkrah qeverisja dhe institucionet e të dyja vendeve.

6.3. Integrimi i veriut

Mitrovica veriore dhe komunat veriore të pa integruara në qeverisjen kosovare është realitet i krijuar qëllimisht dhe artificialisht, qysh nga ndërhyrja e Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë, (1999) i arsyetuar më sigurinë e pakicës serbe pas lufte. Në Konferencën Ndërkombëtare “Germia Hill” në Prishtinë, nëntor 2012, ish Administratori i parë i Kosovës, Bernard Kushner, pranon se:

gabimi më i madh ishte ndalesa të lumi Ibër. Territori i Kosovës ishte mbi malet e jo mbi lumin. Kjo ndoshta nuk ishte zgjidhje e drejtë, por kjo është jeta...ka hapësirë që të negociohet për një autonomi substanciale për këtë pjesë, siç është bërë që nga fillimi i krizës dhe ashtu siç është definuar edhe nga komuniteti ndërkombëtar përmes planit të Ahtisarit...kjo autonomi e qeverisjes lokale nuk nënkupton autonomi substanciale politike që do ta dëmtonte sovranitetin dhe integritetin e shtetit të Kosovës.(Kushner, nëntor 2012)

Politika e Serbisë me ndikimet negative të disa vendeve me ndikim, gjithëherë ka manipuluar, edhe sot po manipulon me ndarje mbi baza etnike të komunitetit serb në këtë rajon. Qëllimet e saj ishin pengimi i funksionalitetit shtetëror të Kosovës. Pas shpalljes së Pavarësisë, kishte pretendime edhe të ndarjes, nëse lejon Bashkësia Ndërkombëtare.

(Kipred, 2012) Por, tani në proces të Bisedimeve me Serbinë me ndërmjetësimin e Bashkësisë Ndërkombëtare, zgjidhjet juridike të Planit të Ahtisarit të cilat u përfshinë në tërësi në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, integritet të suksesshëm të pakicës serbe në pjesët tjera të Kosovës, paraqesin argumente të fuqishme, për integrimin e veriut. Edhe qëndrimet ndërkombëtare janë të qarta se nuk ka ndryshim kufijsh në baza etnike. (Clinton & Ashton, dhjetor 2012:3) Andaj, përpjekjet për ndarje dhe vazhdimin e rolit destruktiv të Serbisë përmes pengimit të institucionalizimit në qeverisjen kosovare të pakicës serbe të veriut, tani duket se janë të pamundura. Edhe konsolidimi i pushtetit lokal/komunal është i rregulluar e funksional në Republikën e Kosovës, i pranuar dhe i mbikëqyrur edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare.

Të gjitha zgjidhjet rekomanduese të Planit të Ahtisarit për garantimin e të drejtave të komunitetit serb, janë përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, janë realizuar, përpos në pjesën Veriore, të mbikëqyrura e pranuar edhe nga faktori ndërkombëtar. Diplomati A. Rohan, zëvendës i Ahtisarit në bisedimet e Vjenës për caktimin e statusit të Kosovës, me hapjen e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, në kontekst të Veriut theksonte se “Plani i Ahtisarit përmban autonominë substanciale për serbët e veriut të Kosovës...çdo largim nga ky Plan, krijon komplikime në sistemin politik e juridik të Republikës së Kosovës.”(Rohan, tetor2012:2) Këtë e kanë kuptuar të gjitha palët. Edhe Republika e Serbisë, e detyruar nga nevojat integruese në BE, ka filluar të ndryshoj qasjen ndaj Kosovës dhe veriut të saj.

Plani i Ahtisarit mbetet qasja e mirë në arritjen e këtyre qëllimeve, por tani është Kushtetuta e Kosovës, si i vetmi akt juridik qeverisës që i përmbanë dispozitat e këtij plani dhe rregullon qeverisjen e institucionalizimin e Republikës së Kosovës. Marrëveshja mbi

implementimin e tij do të shmangte edhe përpjekjet për të zgjidhur “problemin e Veriut” përmes përdorimit të forcës apo formave tjera. theksonte Galluci, (2011) Plani i Ahtisarit, Kushtetuta e Kosovës në pajtim me te, integrimi i pakicës serbe në tërë Republikën e Kosovës, i garantonin të drejta tejet të avancuara komunitetit serb në pushtetin lokal dhe qendror, me standarde më të theksuara demokratike dhe shumë më të avancuara se në vendet e rajonit. Këto janë argumente të fuqishme për integrimin e sukseshëm të këtyre komunave. Këto garanci janë të rregulluara më Kushtetutë dhe ligje e zbatim në praktik jo vetëm në pushtetin lokal, por edhe në përfaqësim e vendimmarrje përmbajtësore në pushtetin qendror. Sigurojnë një kornizë për një demokraci funksionale multietnike. Qëllimi i këtyre dispozitave kushtetuese e ligjore për komunitetin e pakicës serbe kishte synim dhe qëllim sigurimin e të drejtave të komunitetit serb në Kosovë dhe deinstrumentalizimin e kësaj pakica nga politika destruktive e Serbisë. Andaj, as ndërmjetësuesit ndërkombëtar në dialogun me Serbinë në këto bisedime, nuk kanë argumente për kërkesa tjera plus. Ky plan ofron elemente kryesore për të drejtat minoritare, për një formë të fortë të qeverisjes lokale të decentralizuar.

Fuqizimi i institucioneve dhe qeverisja efikase e efektive demokratike kosovare në të gjitha nivelet, veçmas në nivelin qendror, do të ndikonte në integrimin cilësor të këtij komuniteti. Mungesa e shtrirjes së pushtetit në këtë pjesë ka mundësuar informalitet dhe futje të mallrave pa doganë nga Serbia dhe ka krijuar e forcuar grupe të krimit të organizuar e kontrabandës, duke e dëmtuar buxhetin e Kosovës dhe duke shkaktuar edhe shumë pasoja tjera. Në këtë pjesë ishin koncentruar grupe të cilat kishin marrë pjesë në kryerjen e krimeve para, gjatë luftës dhe pas saj. Edhe Bashkësia Ndërkombëtare në Kosovë në këtë pjesë nuk e kreu misionin për sundimin e rendit dhe ligjit. Realiteti në

teren ishte krijuar nga politika e Serbisë, me tolerimin e disa faktorëve të jashtëm. Qëllim ishte pengimi i funksionalitetit shtetëror të Kosovës edhe pas shpalljes së Pavarësisë. Por, tani pas rezultateve të arritura dhe pamundësisë së copëtimit të Kosovës, dhe nevojave integruese të Serbisë në BE, ka filluar të zbutet roli destruktiv i saj, duke lejuar pjesërisht institucionalizimin e kësaj pakice në qeverisjen kosovare. Edhe Serbia po përcepton qartë, se rajoni i Ballkanit nuk ka tjetër alternativë, përpos integritit evropian.

Në pesëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës, bashkëhartuesi i Planit të Ahtisarit, Albert Rohan, në intervistën për Radion Evropa e Lirë, thekson se shteti i ri i Kosovës ka bërë përparime pozitive. Megjithatë, ai tërheq vërejtjen se në kuadër të negociatave të tashme, të mos bëhen lëshime për veriun, duke thënë se duhet përjashtuar plotësisht, si ndarja, ashtu edhe autonomia rajonale e komunave serbe. Rohan porositi kosovarët të qëndrojnë unikë në çuarjen e shtetit përpara:

Po që se të dy palët pajtohen, ato mund të pajtohen për çdo gjë, kjo është në rregull, por nuk mendoj se këtu kemi të bëjmë me një çështje të tillë. Mendoj se dy pyetjet, nëse duhet këtë ndarje - kjo përjashtohet plotësisht, askush nuk do ta pranojë këtë. Dhe mundësia e dytë është autonomia rajonale, që sipas mendimit tim duhet të refuzohet, sepse është e panevojshme, sepse nuk është e duhur që të ketë dy lloj grupe serbe në Kosovë, një në veri me autonomi rajonale dhe tjetra në jug, me autonomi komunale. Mendoj se autonomia komunale, që ofrohet me Planin Ahtisari i ofron komunitetit serb vetëqeverisje në masë të madhe dhe kjo është ajo që duhet në të vërtetë. (Rohan, tetor.2012, 2)

Njëri nga kushtet e BE-së për Serbinë, është Kosova. Autoritetet evropiane u kanë vënë kusht autoriteteve serbe normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, nëse duan të avancojnë në procesin e integritit. E gjithë kjo do të ndikojë në shtrirjen e pushtetit në veri dhe në integrimin e pakicës serbe në qeverisjen dhe institucionet kosovare. Bisedimet Kosovë - Serbi me ndërmjetësimin e BE-së, ishin të iniciuara nga faktori ndërkombëtar dhe nevojat e brendshme të Serbisë dhe gjendjes në pjesën Veriore të Republikës së Kosovës. Bisedimet u përcollën me Rezolutën e Kuvendit dhe formimin e grupit përkatës. Këto bisedime dhanë rezultatet e para rreth tabelave, pikave kufitare, njohjes se disa

dokumenteve, kthimin e dokumentacionit kadastral, etj. Por, pati ngecje në implementim të këtyre marrëveshjeve nga ana e Serbisë.

Gjendja e krijuar dhe e toleruar për një kohë të gjatë në veri, krijoi çështje dhe komplikime për implementin e ligjshmërinë në këtë pjesë. (KIPRED, Analizë, 2012:2) Komplikimet dhe çështjet kryesore ishin: Doganat, Telekom, Energjia, Trepça, etj. Implementimi e Planit të Ahtisarit dhe i Kushtetutën se Kosovës e penguan shumica e serbëve të veriut, të shtyrë nga politika destruktive e Serbisë dhe mu për këtë integrimi i kësaj pakice u vështirësua. Por, duke qenë se Bashkësia Ndërkombëtare është kategorike në moslejimin e ndarjes së Kosovës, problemet e brendshme ekonomike të Serbisë, e veçmas procesi dhe nevojat e saj për integrimin në BE, e detyruan Serbinë të futet në bisedime me Republikën e Kosovës. Edhe Kosova, në pamundësi për të shtrirë pushtetin e plotë në këtë pjesë përmes proceseve politike normale dhe nevoja për përkrahje të shumanshme nga Bashkësia Ndërkombëtare për shkak të nevojës për integrim e afirmim ndërkombëtar, plotësimin e kushtit për bashkëpunim rajonal, etj., u detyrua të futet në dialog me Serbinë pa kushte, por, përmes ndërmjetësimit të BE-së-shefes së diplomacisë evropiane, Catherine Ashton. Në fillim të bisedimeve u arritën rezultate të caktuara, të cilat nuk dalin esencialisht nga Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës. Arritja më e madhe në dialog deri tani, ishte Marrëveshja e Dhjetorit 2011, mbi “menaxhimin e integruar të pikave të kalimit” (MIK) dhe fillimin e zbatimit të saj në dhjetor 2012 në dy pika kalimi, përfshirë njërën në Veriun e Kosovës. Përgjatë periudhës 2011-2012, bisedimet u fokusuan në çështje të lidhura me kufirin, doganat, lirinë e lëvizjes dhe menaxhimin e pikave kufitare. Falë dialogut, kanë filluar të përmirësohen elementë të tjerë

të marrëdhënieve dypalëshe: kosovarët kanë filluar për të udhëtuar përmes Serbisë për në vende të treta, regjistrat civilë po kopjohen dhe disa diploma kosovare janë njohur.

Kufiri është jashtëzakonisht i rëndësishëm për Prishtinën për të shënuar integritetin territorial dhe sovranitetin e vet, për të rritur të ardhurat përmes doganave dhe për të kontrolluar trafikimin dhe kontrabandën. (Crisisgroup-Raport N°223, shkurt 2013:15) Por, politika destruktive dhe pengesat e Serbisë ende nuk kanë ndryshuar plotësisht. Ajo po përpiqet të ndikojë negativisht në implementim dhe interpretim të marrëveshjeve, për ta penguar qeverisjen dhe institucionalizimin normal të kësaj pjese dhe të minoritetit serb në Kosovë. Por, BE dhe Bashkësia Ndërkombëtare kërkon përmirësimin e marrëdhënieve si kusht dhe mënyrë që Serbia të vazhdoj rrugën e integriteteve evropiane. Ka premtime se këto procese dialoguese e bashkëpunuese nuk do ta dëmtojnë Sovranitetin kosovar, por kërkohet qeverisje e vendimmarrje cilësore e institucioneve kosovare. Këtë e thotë qartë edhe kryeministri Thaçi në Kuvendin e Kosovës: “Unë jam i bindur se normalizimi i raporteve shtetërore me Serbinë është i domosdoshëm për evropianizimin e rajonit. Por ky normalizim me asnjë kusht nuk do të kalojë në kurriz të shtetësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës sonë të re.” (Kryeministri Thaçi, shtator/2012) Dy kryeministrat Thaçi dhe Daçiq, ranë dakord që ta jetësojnë marrëveshjen për menaxhimin e integruar të kufirit, e njohur si IBM, në dy pika kufitare, në Jarinjë dhe Merdare. Më 10 dhjetor 2012, marrëveshja e IBM-së filloi të zbatohet. K.K.Johana Demiel, zëvendës drejtoresh e Asociacionit Gjerman për Europën Juglindore, thekson se „Konsultimet e Serbisë dhe Kosovës duhet të jenë transparente dhe të kryhen në qeveritë dhe parlamentet e të dyja vendeve... Kosova është barrë e brendshme e Serbisë, nga e cila duhet të shkarkohet,” (Demiel gusht 2012:4) thotë ajo. Se, Serbia ka kushte nga Bashkësia

Ndërkombëtare, kryesisht nga BE, e cek edhe Komisionari për Zgjerim i BE-së, “normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën, është krye kusht për Serbinë;” (Fule, gusht 2012:3) Në vizitën e fundit në Kosovë 31.10.2012, Clinton dhe Ashton theksuan se s’ka ndarje dhe lëvizje kufijsh, por dialogu për Veriun duhet të rezultojë dhe garantojë që „qytetaret e veriut të jetojnë jetën e tyre duke u ndier pjesë e kësaj shoqërie” (Clinton & Ashton, nëndor 2012). Andaj, edhe institucionet duhet të jenë transparente dhe aktive në këtë proces, pa manipulime të opinioneve për interesa pushtetore partiake e grupe.

Ekspertja e Qendrës për Politikë Evropiane në Bruksel, Rosa Balfour, ka vlerësuar se Gjermania do ta mbështesë BE-në, që në qershor të përcaktojë datën e fillimit të negociatave për pranimin e Serbisë, vetëm në rast se hiqen institucionet paralele në Veri dhe kërkon që, Serbia të heqë dorë nga ndarja e Kosovës. Institucionet evropiane kanë qenë të qarta që veriu i Kosovës patjetër duhet të jetë pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe se nuk ka opion të ndarjes së Kosovës dhe se nuk ekzistojnë opionet për mbetjen e institucioneve paralele. (Balfour, gusht 2012) Pra, politika e Serbisë është e detyruar të dialogojë, bisedojë dhe normalizojë marrëdhëniet me Kosovën, për shkak të nevojave e interesave të saj integruese në BE. Këto janë interesat dhe qëllimet kryesore të saj. Por, në raport me Kosovën, politika e Serbisë ende nuk ka ndryshuar plotësisht. Ajo gjithnjë do përpiqet për ta keqpërdorur edhe këtë proces të bisedimeve e dialogimit, jo për t’i normalizuar marrëdhëniet, por për t’u përzier akoma më shumë në mënyrë që ta destabilizojë dhe ta pengojë qeverisjen e brendshme dhe afirmimin e Kosovës. Për këtë, pala kosovare duhet të jetë e vetëdijshme. Sikur të kishte qëllime të mirëfillta normalizuese, do të ndryshonte politikën e saj ndaj Kosovës në shumë aspekte.

Vetëqeverisja lokale komunale dhe decentralizimi në Kosovë njësi bazë ka komunat, të cilat gëzojnë një shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në jetën qeverisëse, sipas kompetencave dhe të drejtave për vetëfinancim dhe financim nga autoritetet qendrore. Kushtetuta e Kosovës përcakton: “Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.” (Kap. X, Neni 123.4) Komunat kanë të drejtë për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar në fushat e kompetencave të tyre vetjake dhe të zgjeruara:

3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin. (Kap. X, neni 124. 3-7)

Qeverisja komunale paraqet avancim të qeverisjes demokratike sipas standardeve e praktikave evropiane të qeverisjes lokale. Kapitulli i X i Kushtetutës së Kosovës thekson:

Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues. (Kap.-X, neni 123.1)

Kjo është kërkesë nga të gjithë qytetarët dhe komunitetet etnike të Republikës së Kosovës, për zhvillim e prosperitet për të gjithë. Kjo zgjidhje juridike po realizohet më sukses, sepse:

Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në afrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Nenin 123.4, Kap.-X)

Për të realizuar të gjitha këto të drejta dhe qëllime për interesin lokal, janë rregulluar e funksionalizuar edhe Kompetencat komunale të parapara me Kushtetutë. P.sh., në Kapitullin X parasheh këto kompetenca të komunave:

a. Zhvillimi lokal ekonomik; b. Planifikimi urban dhe rural; c. Përdorimi dhe zhvillimi i tokës; d. Implementimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve të kontrollit të ndërtimit; e. Mbrojtja lokale e mjedisit; f. Afrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale; (Kap. X, Neni 3.1)

Autoritetet qendrore në Kosovë delegojnë përgjegjësi të shumta te komunat si Kompetenca të deleguara komunale. Aktivitetet komunale në fushat e kompetencave të tyre vetjake përkufizohen në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjin në fuqi. Kjo bëhet nga ana e shqyrtimit administrativ të akteve komunale:

Autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kërkojë nga komuna që të rishqyrtojë vendimet apo aktet tjera ligjore që konsiderohen se janë në mospërputhje me Kushtetutën apo ligjet e miratuara në pajtim me këtë zgjidhje...autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kundërshtojë vendimin apo aktin tjetër ligjor në gjykatën e qarkut kompetente për territorin e komunës. Gjykata e qarkut, si masë të përkohshme, mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të vendimit të kontestuar apo aktit tjetër ligjor...autoritetet qendrore mund të shqyrtojnë përshtatshmërinë e vendimit komunal të dhënë apo të aktit tjetër, krahas pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje dhe, së këndejmi, mund të pezullojnë, modifikojnë apo zëvendësojnë, sipas nevojës, ekzekutimin e vendimit komunal. (Kap. X, neni 6)

Pra, edhe Komunitet me shumicë serbe në veri të Kosovës, nuk kanë asnjë arsye që të mos funksionojnë sikurse komunitet tjera. Komunitet e veriut të Kosovës do të funksionojnë sipas qeverisjes lokale dhe kompetencave të nivelit qendror. Dhe kur kësaj i shtojmë garancitë e pjesëmarrjes mjaft përmbajtjesore të minoritetit serb në pushtetin qendror, atëherë çështja është si të integrohet sa më shpejt dhe suksesshëm. Të qeveriset e institucionalizohet sipas Kushtetutës dhe ligjeve kosovare: qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes lokale komunale mjaft të avancuar, dhe sipas Kartës Europiane të Qeverisjes Lokale. Këto zgjidhje juridike e zbatime faktike, janë më të avancuara në rajon. Andaj, nuk ka asnjë arsye për asnjë formë destruktive e enklavizuese, që do t'i dëmtonte përcaktimet demokratike të qeverisjes dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Rezultatet konkrete të dialogut shihen gjatë vijimit të dialogut, pas vitit 2012.¹⁰⁴

Përfundimi

Qeverisja dhe institucionet kosovare në RSFJ, karakterizoheshin me qeverisjen socialiste dhe me jo barazinë kombëtare të popullsisë shqiptare. Gjatë viteve 70-ta kishte të arritura pozitive, të përcaktuara me Kushtetutën Federative (1974) dhe me Kushtetutën e Kosovës (1974). Qeverisja socialiste në RSFJ ishte më liberale, se sa në vendet tjera të Bllokut Socialist. Politika serbe gjatë viteve 80-ta dhe 90-ta, për të dominuar në Federatë dhe për të penguar përpjekjet kosovare për liri e barazi, shkeli Kushtetutën dhe rendin federativ; rrënoi autonominë e Kosovës dhe e okupoi që nga marsi 1989 deri në qershor 1999. Kosova, gjatë këtij okupimi u ballafaqua me dhunë shtetërore më forma gjenocidiale. Njëherit, gjatë viteve 1990-1999 filloi edhe shpërbërja e RSFJ-së dhe formimi i shtetëve të pavarura. Në Kosovë, në kushte të okupimit, u shfaqen procese rezistuese politike, akte juridike dhe përpjekje për vetëqeverisje e institucionalizim demokratik të pavarur. Popullata shqiptare e Kosovës, që përbënte rreth 93% të popullsisë, e bllokoi politikisht juridikisht dhe institucionalisht pushtuesin përmes aprovimit të akteve kushtetuese kosovare e organizimit multipartiak dhe institucioneve qeverisëse të pavarura, përkundër kushteve në rrethana okupimi dhe reprezaljeve. Gjatë viteve 1998-99, u shfaqen format e rezistencës ushtarake e civile. Rezistenca politike dhe ushtarake 1989-1999 ishte këmbëngulëse, gjithë popullore dhe me shumë sakrifica. Pasojat e kësaj periudhe ishin: shkatërrimi ekonomik, mungesën e reformave dhe mungesa e krijimit të traditës për qeverisje e institucione demokratike.

Ngjarjet në BRSS dhe ndryshimet e sistemit socialist në vendet e Lindjes, rezultuan edhe me përfundimin e Luftës së Ftohtë. Këto procese krijuan raporte të reja globale e

rajonale formë të re qeverisëse e institucionale dhe vetëvendosje të njësive federative në RSFJ. Këto rrethana krijuan parakushte të reja edhe për çështjen e Kosovës, e cila u gjend e okupuar, me statusin e autonomis si element konstituiv i RSFJ-së; ishte autonomi tejet e avancuar, por nuk ishte republikë siç ishin njësitë tjera federative. Rrethanat ndërkombëtare në rajon kishin efektet e tyre, por, faktori vendor kosovar ishte faktori esencial zbërthyes në ndryshimin e gjendjes ekzistuese në bashkëveprim me proceset e veprimet e faktorëve të jashtëm. Ndërthurja pozitive e synimeve të faktorit vendor me rrethanat e jashtme rajonale e ndërkombëtare nuk ishte fare e lehtë, megjithatë ishte më e favorshme se sa më parë, dhe kërkonte angazhim e sakrificë të madhe për institucionalizim dhe qeverisje të pavarur. Por, populli dhe institucionet ishin përcaktuar për liri, pavarësi e zhvillim.

Ndërhyrja ndërkombëtare në rajon ishte e vazhdueshme gjatë tërë viteve të 90-ta, me një mori vendimesh, rezolutave dhe presioneve. Ndërhyrja më e drejtpërdrejtë në Kosovë ndodhi gjatë vitit 1999, përmes një mori akteve e veprimeve konkrete ndërkombëtare, kryesisht me Konferencën e Rambujesë (1999), ndërhyrjen ushtarake të NATO-s (1999) dhe Rezolutën 1244 e KS të OKB-së (1999), të cilat krijuan rrethana dhe akte të reja përcaktuese për qeverisjen dhe institucionet në Kosovë.

Gjatë Administrimit Ndërkombëtar (1999-2008), qeverisja dhe institucionalizimi në Kosovë bazohej kryesisht në përcaktimet e Rezolutës 1244 të OKB-së. Kjo Rezolutë ishte kundërthënëse dhe pengonte vetëqeverisjen e Kosovës, deri në gjetjen e ndonjë zgjidhje politike. Në realitetin kosovar kjo rezultoj si pengesë në qeverisjen dhe institucionalizimin e mirëfilltë demokratik e të pavarur. Kjo situatë vendore, rajonale e globale dhe përcaktimet e Rezolutës krijuan karakteristika specifike juridike, institucionale e

vendimmarrëse në qeverisjen kosovare (1999-2008). Faktori qeverisës vendor ishte i penguar në kompetenca dhe si i tillë, nuk kishte efektivitetin e duhur institucional e qeverisës në asnjë sferë. Zvarritja e një gjendje të tillë e *status quos* statusore dhe qeverisëse, ishte faktori kryesor që ndikoi në mungesën e efektivitetit dhe në jo cilësinë demokratike qeverisëse me pasoja të dëmshme gjatë kësaj periudhe dhe për të ardhmen.

Kompetenca tejet të reduktuara të faktorit vendor në qeverisje u sanksionuan edhe me Kornizën Kushtetuese (2001), e cila nuk i lejonte faktorit politik vendor mundësi të vendimmarrjeve të rëndësishme në procesin qeverisës. Kuvendi i Kosovës nuk e kishte funksionin e vërtetë ligjvënës e kontrollues; gjyqësori nuk ishte i pavarur, dhe ekzekutivi me institucionet tjera gjithashtu! Procesi i qeverisjes (1999-2008), ishte i subordinuar nga faktori ndërkombëtar. Si i tillë sillte gjendje kaotike, anarkike, papërgjegjshmëri dhe ishte i papërcaktuar në shumë aspekte. Kjo rezultonte në pengimin e qeverisjes dhe institucionalizimin e mirëfilltë demokratik kosovar. Kjo periudhë zgjati mbi tetë vite mbajtje peng dhe vonesë në shumë procese e reforma të tranzicionit dhe të vullnetit politik për pavarësi. Rrethanat e tilla ndikuan në funksionet dhe efektet institucionale e qeverisëse në Kosovë. Pra, kjo periudhë karakterizohej me:

- Institucioet Ndërkombëtare (1999-2008) joefektive, për shkak të statusit të papërcaktuar të Kosovës.
- Institucionet kosovare me subjektet politike gjatë bashkëqeverisjes me faktorin e jashtëm (1999-2008), ishin të penguar, të varura dhe u mungonin kompetencat. Si të tilla ishin joefektive, joefikase, e jodemokratike në procesin qeverisës.
- Pengesat e lartëpërmendura dhe vonesat në reforma e integrim, kanë ndikuar negativisht në shumë sfera e procese, pasojat e të cilave do jenë afatëgjata.

Sekretari I Përgjithshëm i OKB-së e ngarkoi Marti Ahtisarin (Nëntor, 2005) për të filluar bisedimet për përcaktimin e statusit të Kosovës. Ky ndërmjetësim me karakter ndërkombëtar duhej të realizohej me miratimin dhe përcaktimin e Grupit të Kontaktit ndaj çështjes së Kosovës. Në mars 2007 u prezantuan rezultatet e bisedimeve dhe propozimet e Planit të Ahtisarit për Kosovën, i cili propozonte pavarësi me një mbikëqyrje ndërkombëtare, në funksion të zbatimit të përcaktimeve të këtij Plani. Ky Plan i përcaktonte qeverisjen dhe institucionet kosovare dhe garantonte mekanizma kushtetues, ligjorë e institucionalë për t'u qeverisur sipas standardeve demokratike dhe të promovoj bashkëjetesën dhe prosperitetin e të gjitha komuniteteve e qytetarëve. Plani parashihte një shoqëri shumetnike, ku duhet të qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Në respektimin e nivelit më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht, në veçanti promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha nivelet dhe proceset. Kosova obligohej që këto parime t'i përfshinte në Kushtetutën e saj dhe faktori ndërkombëtar të mbikëqyrte realizimin e tyre. Faktori politik kosovar besonte se këto zgjidhje për pakicat do të stabilizohen dhe nuk do të jenë pengesë në forcimin e funksionimit institucional të shtetit demokratik, me decentralizimin e theksuar komunal, si dhe me proceset integruese në të ardhmen. Pra, besonte se përmes të drejtave të avancuara daj pakicës serbe të Kosovës, do të amortizohej dhe e pengohej politika ndërhyrëse e Serbisë dhe e aleatëve të saj në Kosovë. Kuvendi e miratoi këtë Propozim përmes një Deklarate (prill 2007).

Më 17 shkurt 2008, në pajtim me Planin e Ahtisarit, Kuvendi i Kosovës shpalli Pavarësisë së Kosovës. (Deklaratën) Pasi njohja ndërkombëtare e një numri të

konsiderueshëm të vendeve me ndikim global. Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008 përcaktoi karakterin, funksionet, kompetencat dhe organizimin e institucioneve. U konsoliduan shumica e institucioneve dhe vazhduan funksionimin e tyre sipas përcaktimeve kushtetuese dhe ligjeve e akteve nënligjore përkatëse, me përjashtim të shtrirjes së pushtetit në veriun e Kosovës. Aspekti kushtetues e ligjor përcaktoi organizimin dhe veprimtarinë institucionale, duke respektuar parimet qeverisëse demokratike, multietnike, jo religjioze, me gjuhën shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare. Me Kushtetutë e ligje i përcaktoj dhe konsolidoj të drejtat e komuniteteve minoritare me përfaqësim përmbajtjesor e vendimmarrës në të gjitha institucionet e nivelit qendror të qeverisjes dhe në nivelin komunal, për mbrojtjen e identitetit nacional-etnik, kulturor, gjuhësor, fetar të të gjitha komunitetëve dhe anëtarëve të saj. Por, këto zgjidhje i tejkaluan përcaktimet nga koncepti i multietnicitetit që afirmohej me të madhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, duke kaluar në Komuna ‘serbe’ e jo komuna multietnike, ashtu siç ishin. Kjo ndarje në baza etnike nuk ishte parimore dhe nuk shprehte strukturën reale të popullsisë kosovare. Ndarja e tillë në baza etnike, më tepër krijonte parakushte enklavizimi se sa bashkëjetesë multietnike. U formuan Komunat me shumicë serbe dhe u integruan në institucione e qeverisje qendrore, përpos komunave veriore, të cilat vazhduan të jenë instrument i politikës destruktive të Serbisë, e cila u shndërrua në penguese të institucionalizimit dhe qeverisjes kosovare në këtë pjesë.

Të gjitha kompetecat, funksionet dhe përgjegjësitë e institucioneve u përcaktuan në Kushtetutën e Kosovës dhe u konsoliduan të gjitha institucionet e legjisllacioni përkatës. Të gjitha këto suksese, patën rezultat afirmimin e Kosovës dhe përmbylljen e mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe vlerësimet pozitive të saj, si dhe qetësinë rajonale që solli pavarësia.

Vazhdoi njohja ndërkombëtare e vendeve më ndikim global dhe i 25 vendeve të BE-së. Kosova, u anëtarësua në një mori organizatave rajonale e globale të rëndësishme.

Forma qeverisëse ishte Republikë parlamentare, e ngjashme më vendet në tranzicion dhe më demokracitë perëndimore. Shtet unik, më qeverisje lokale në nivelin komunal më kompetenca të theksuara vetëqeverisëse. Me balancim të pushtetëve, sistem zgjedhor proporcional, me garanci të theksuara sistimore e kushtetuese për komunitetet pakicë, në veçanti për komunitetin serb. Pra, shtet i ri, i vonuar në reformat e tranzicionit dhe më traditë fillestare në procesin qeverisës e institucional të pavarur e demokratik. Por, më një shoqëri që ka sakrifikuar shumë për këtë pavarësi dhe që ka përcaktim e nevojë për liri, demokraci dhe zhvillim të të gjitha sferave. Sipas rendit juridik, Kosova ka një sistem kushtetues e institucional të konsoliduar. Kosova si shtet unik, republikë parlamentare, me sistem zgjedhor proporcional, pluralitet partiak, balancim të pushteteve, Gjykatë Kushtetuese, me qeverisje të avancuar lokale në nivelin komunal, etj., konsiderohet sistem qeverisës i përshtatshëm demokratik për shoqërinë dhe proceset aktuale më specifikat kosovare momentale dhe për të ardhmen e afërt. Zbatimi i tyre kërkon legjislacion sekondar dhe përkushtim institucional e politik demokratik më efektiv sipas kushteve e rrethanave specifike në proceset dhe sferat konkrete.

Sistemi parlamentar dhe rendi kushtetues e ligjor në Kosovë, nuk ishte pengesë e cilësisë qeverisëse. Edhe pushteti komunal dhe decentralizimi në nivel komunal nuk është pengesë, por pengesë është moszbatimi i tij dhe keqpërdorimi i pakicës serbe në Kosovë nga politika destruktive e Beogradit. Andaj, kishte nevoj të pengohej kjo ndërhyrje destruktive. Kishte nevoj të krijohen mekanizma plotësues për zbatim dhe implementim të Kushtetutës, në funksion të zbatimit e konsolidimit sa më efikas dhe efektiv. Veçmas, ndaj

dukurive negative në institucione e qeverisje, përkatësisht në fuqizimin e sundimit të ligjit. Më shpalljen e Pavarësisë 2008, e deri në fund të vitit 2012, qeverisja kosovare realizoi një varg suksesesh në konsolidim juridik-kushtetues e ligjor dhe në konsolidimin institucional organizativ, por megjithatë, efektiviteti dhe funksionet qeverisëse nuk ishin në pajtim me kërkesat e kohës dhe qëllimet e standardet demokratike të qeverisjes. U krijuan parakushtet juridike për qeverisje e organizim institucional, me përcaktime kushtetuese e ligjore sipas standardeve demokratike dhe sipas standardeve të së drejtës ndërkombëtare, por, implementimi efektiv e qëllimor nuk ishte i kënaqshëm. Kërkohej fuqizim i sundimit të ligjit dhe implementim më efikas, më cilësor e më përmbajtjesor i rendit juridik e politik, për të mos lejuar tjetërsimin e qëllimeve e përcaktimeve kushtetuese në procesin qeverisës. Ky proces ishte i vështirë, për shkak të mungesës se kushteve bazë për qeverisje demokratike: nivelit të ultë të zhvillimit ekonomik, mungesë e traditës demokratike, pengesave të jashtme, kulturës politike etj.

Qeverisja dhe veprimtaria institucionale gjatë periudhes 2008-2012, u karakterizua me këto dukuri dhe rezultate efektive në qeverisje:

- Qeverisja funksiononte përmes institucioneve sipas përcaktimeve juridike. Por, nuk ishte cilësia e duhur e lidërshipt partiak dhe e zyrtarëve në institucionet përfaqësuese, ekzekutive, në administratë, gjyqësor, në shërbimet publike dhe as në institucionet tjera. Vërejtje të theksuara ka në sistemin e drejtësisë, i cili nuk ishte efektiv kundër dukurive negative në institucione. Njëherit, nuk kishte as përkrahje serioze nga institucionet kryesore politike për luftimin e dukurive negative.
- Nuk kishte politika të qarta ekonomiko-zhvillimore. Mungonin reformat dhe politikat e qarta ekonomike e makroekonomike. Politikat e gjertanishme ekonomike

nuk ishin konkrete e specifike; nuk ishin projekte e strategji afatmesme dhe afatgjata për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Dukuritë negative në institucione krijojnë pasiguri, dhe si të tilla pengojnë investimet e mirëfillta dhe zhvillimin ekonomik.

➤ Autoriteti dhe legjitimiteti qeverisës e institucional, tek qytetarët përceptohej negativisht si rezultat i dukurive negative në udhëheqjet partiake dhe në institucione, dhe dukurive negative në procesin zgjedhor. Kishte shkelje të rënda të parimeve demokratike në procesin zgjedhor, të cilat ndikonin në uljen e nivelit të legjitimitetit, autoritetit dhe efektivitetit qeverisës e institucional.

➤ Konkurrenca ndërpartiake ishte jo parimore: e përcjellë me akuza, shpifje e ofendime dhe jo bashkërenduese në krijimin e institucioneve, në krijimin e vullneteve politike, në vendimmarrje e reforma , për shkak të dukurive negative në institucione.

➤ Mungonin forca opozitare të mirëfillta. Si rezultat i kësaj kishte pjesëmarrje të ultë në votime e proces politik.

➤ Mosndëshkim nga gjyqësori i bartësve të dukurive negative në qeverisje dhe përzierja e politikës në gjyqësor.

➤ Mosndëshkim me votë nga qytetarët, si rezultat i votuesve emocionalë e me vetëdije politike të ngarkuar nga e kaluara dhe nga përqendrimi i lartë i pushtetit mbi burimet publike dhe jo zhvillimi i sektorit privat.

➤ Me sistemin zgjedhor proporcional u influencua paksa bashkërenditja, kooperimi dhe toleranca ndërpartiake si dhe ulja e tensioneve në mes tyre në procesin politik e qeverisës. Si rezultat i kësaj nuk kishim dy taborre e dy tirani të shumicave, por disa parti të mesme të detyruara për aleanca e konsensus të domosdoshëm për të krijuar

pozitën. Ngjashëm ishin të shpërndara edhe forcat opozitare, të cilat janë të detyruara të bashkëpunojnë e bashkërendojnë për veprime opozitare të efektshme.

➤ Kishte ndërhyrje të theksuara ndërmjetësuese nga faktori i jashtëm, në zgjidhjen e krizave institucionale dhe në proceset vendimmarrëse.

➤ Përpjekjet në eliminimin e kundërshtarëve partiakë përmes metodave jodemokratike, gjithnjë relativizoheshin.

➤ Guximi qytetar dhe aktiviteti racional politik ka filluar të rritet. Shoqëria civile, përmes OJQ-ve gjithnjë po konsolidohet. Edhe mediet kanë ngritur nivelin e pavarësisë, të analizës dhe kritikës së bazuar.

➤ Shtresëzimi dhe struktura plurale e shoqërisë kosovare po mungon, si rezultat i jo zhvillimit të sferes private. Raporti shtet-shoqëri dhe vetëdija ende nuk është sipas parimit demokratik, që shteti duhet t'i shërbejë shoqërisë e jo ta sundojë atë.

➤ Mbrojtja nga sulmet e jashtme bëhet nga forcat ushtarake ndërkombëtare dhe politikat përcjellëse të Bashkësisë Ndërkombëtare. Ruajtja dhe mbikëqyrja e kufirit dhe siguria e brendshme po bëhet nga Policia e Kosovës. Kosovës, ende i mungonte forca ushtarake me rolet dhe funksionet e saj.

➤ Zbatimi i ligjit nuk ishte në nivelin e duhur, por të gjithë po vetëdijesheshin për gjendjen dhe pasojat. Megjithatë, nuk mungonin kërkesat, presionet e përkrahja nga jashtë që të përmirësohet kjo sferë esenciale për qeverisje demokratike, pa të cilën nuk ka zhvillim ekonomik të qendrueshëm.

➤ Vetëmbrojtja e brendshme po bëhet nga institucionet e sigurisë, të mbikëqyrura e të kontrolluara nga forcat civile institucionale dhe nga sistemi juridik.

➤ Mbështetja kulturore dhe konsolidimi i vlerave demokratike ishte në rritje.

- Ndarja e pushtetit ekzekutiv ishte koalicion partiak dhe me vende të garantuara të komuniteteve pakicë. Pra, nuk është përqendrimi i pushtetit ekzekutiv në duart e vetëm një partie të shumicës që qeverisë e vetme. Ngjashëm ishte në Parlamenti, ku asnjë parti e vetme nuk e ka shumicën; shumica krijohet me koalicion paszgjedhor.
- Balancimi juridik i pushtetit midis ekzekutivit dhe legjislativit ekziston. Por, si rezultat i specifikave brenda partiake dhe dukurive negative, kishte dominim të ekzekutivit ndaj legjislativit.
- Nuk ishte në nivel kontrolli parlamentar i qeverisë e administratës. Deputetët e pozitës, nuk kërkonin përgjegjësi e llogaridhënie nga Qeveria edhe kur qeveria nuk jep efekte, apo kur meritonte shkarkim.
- Shtet unitar, por me kompetenca të decentralizuara përmes qeverisjes lokale komunale mjaft të avancuar, veçmas për komunat serbe në veri.
- Sistem përfaqësues me një dhomë me vende dhe kompetenca të garantuara të përfaqësimit të rezervuar e të garantuar të komuniteteve pakicë në vendimmarrje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë.
- Kushtetutë e shkruar dhe e detajuar, që mund të ndryshohet vetëm me 2/3 dhe që kërkon miratimin e shumicës së grupeve të komuniteteve pakicë.
- Kushtetuta nuk mund të ndryshohet me anën e shumicës së thjeshtë dhe amendamentet duhet vlerësuar paraprakisht nga Gjykata Kushtetuese.
- Interpretimi, kontrolli i kushtetutshmërisë, legjislacionit dhe veprimtarive institucionale, bëhet nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka përbërës të jashtëm dhe përfaqësues të komuniteteve pakicë.

- Sistem korporativ i raporteve shtet-shoqata. Një numër i madh i OJQ-ve dhe medie ve vlerësojnë dhe e monitorojnë procesin qeverisës dhe prezantimin e interesave plurale përmes transparencës e formave demokratike.
- Monitorime e sugjerime të shumta nga Bashkësia Ndërkombëtare.
- Bankë Qendrore autonome, me valutën Euro dhe jo të varur vetëm nga ekzekutivi.
- Ekonomi e hapur e tregut me synime integruese.
- Kulturë politike demokratike, në hapat e parë të konsolidimit.
- Shtet laik, tolerancë e lartë ndërfetare dhe ndëretnike, etj.

Pra, Kosovës nuk i munguan sukseset konkrete në konsolidimin juridik e institucional dhe në efektivitetët, por nuk kishte rezultate në nivelet e duhura, të kërkuara, të mundshme e të premtuara në: sundimin e ligjit, në menjanimin e dukurive negative, në cilësinë e procesit zgjedhor, në krijimin e sigurisë dhe kushteve për investime e rritje ekonomike, në cilësinë e punëve e veprimtarisë administrative, në cilësinë e shërbimeve publike, në krijimin e vlerave të reja, në politikën e jashtme dhe në proceset integruese.

Andaj, për të gjitha këto sfera, në vazhdimësi kërkohen: analiza, rekomandime, vendimmarrje e veprime konkrete për përmirësime. Për të ngritur nivelin e efektivitetit të institucioneve dhe cilësinë demokratike të qeverisjes gjatë periudhes 2008-2012 kërkohet:

- a) Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit në të gjitha institucionet e nivelet sipas përcaktimeve kushtetuese e ligjore, fuqizimin e sundimit të ligjit, zbatimin e politikave, menjanimin e dukurive negative në institucione, respektimin e parimeve demokratike të procesit zgjedhor dhe ndryshimin e tij, reformat në administratë, plotësimin e legjislacionit, transparencën e fondeve publike,

informimin e shpejtë dhe të drejtë të publikut, në politikat ekonomike dhe në bashkëpunim cilësor me Bashkësinë Ndërkombëtare.

- b) Veprimtaria e Parlamentit duhej të ishte më efektive në të gjitha funksionet: legjislativ, kontrollues e zgjedhor, dhe në rolet e përgjegjësit tjera. Të respektohej ndarja e pushteteve dhe kontrolli reciprok, në veçanti, kontrolli parlamentar ndaj qeverisë dhe organeve e pushtetëve tjera, në monitorim të zbatimit të ligjeve dhe ngritjen e efektshmërisë së sistemit ligjor, dhe në efektet e parlamentit përmes avancimit të politikave të brendshme e të jashtme të subjekteve partiake.
- c) Të koordinohet më mirë Qeveria dhe Kuvendi. Të rritej mbikëqyrja e komunave nga niveli qendror, veçmas asistencë në komunat multietnike. Të ballafaqohet me sfidat e decentralizimit në veri. Thellim i parimeve demokratike të qeverisjes në ekzekutiv, për të siguruar një ekzekutiv më adekuat dhe më efektiv në të gjitha nivelet e administrimit.
- d) Sistemi i Drejtësisë duhej të ishte më imun dhe me i pavarur nga politika, nga grupet e interesit dhe nga grupet e presionit. Konsolidimi i Gjyqësorit me kuadro të guximshme dhe fillimi serioz i hetimeve dhe denimi i bartësve të korrupsionit e krimit të organizuar brenda institucioneve, pra politikanëve dhe zyrtarëve të korruptuar. Prokuroria speciale të rriste numrin e arrestimeve dhe bastisjeve ndaj tyre. Konsolidimi i një kornizë legjislative antikorruption të mbështetur nga politika dhe institucionet. Shmangien e konflikteve të interesit në funksionet publike, në prokurimin publik dhe në financimin e partive politike. Të obligoheshin partitë që të kenë vetëm një xhirollogari të vetme bankare dhe publikimin e raporteve financiare në afate. Të garantohej siguria dhe mbrojtja e

gjykatësve, prokurorëve, dëshmitarëve, të pandehurve e stafit të gjykatës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial duhej të rekrutnin më shumë gjykatës dhe prokuror. Zbatimi i vendimeve civile dhe penale të përmirësohej, sistemi administrator të reformohej, dhe të përforcoheshin parimet e gjyqësorit dhe institucioneve për sundimin e ligjit.

- e) Kërkohej reformimi dhe konsolidimi më cilësor i administratës duke i adaptuar legjislacionet sekondare dhe pagat. Kërkohej mbështetje nga qeveria e Kuvendi ndaj Institucionit të Ombudspersonit si organ i pavarur. Reformat e administratës publike ishin të nevojshme: në strategji, planë veprimi, legjislacion relevant dhe alokim të burimeve të mjaftueshme, që të përmirësonin profesionalizmin, përgjegjësinë dhe efikasitetin e administratës publike, në të mirë të qytetarëve dhe bizneseve.
- f) Ndëshkimi i lidershit dhe subjekteve politike të papërgjegjshme e joefektive nga votuesit dhe respektimi e konsolidimi i parimeve demokratike të procesit zgjedhor. Forcat politike partiake që nuk e kishin prioritet mirëqeverisjen, por qëllim primar kishin përvetësime e përfitime personale e grupore përmes dukurive të shumta negative, duhej demaskuar e luftuar me të gjitha mënyrat institucionale, juridike dhe me manifestime publike protestuese demokratike, nga qendrimet kritike të qytetarëve, medieve dhe nga shoqëria civile, në veçanti përmes votes dhe konkurrencës së mirëfilltë.
- g) Bashkësia Ndërkombëtare kishte filluar presionet ndaj Serbisë për ta detyruar të ndryshojë sjelljet ndaj Kosovës dhe veriut të saj, por qendrimet dhe presionet duhej të ishin më të qarta e të prera të Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj politikës

destruktive të Serbisë. Duhej kërkuar e vepruar më më ngulmë në konsolidimin institucional në komunat veriore, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, të cilat janë në pajtim dhe më të avancuara se standardet e kërkuara demokratike të vetëqeverisjes lokale të BE-së. Institucionet kosovare duhej të ishin më të qarta e më active në këtë drejtim.

- h) Institucionet dhe qeverisja kosovare pas shpalljes së Pavarësisë (2008) dhe përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare,(2010) ka pavarësi vendimmarrëse, megjithatë, influenza e jashtme ende është e madhe. Kjo gjendje dhe raporti i varësisë, duhej ndryshuar. Aftësia institucionale për vendimmarrje aktive të pavarur, duhej të ishte më prezente.
- i) Pa një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nuk kishte qeverisje demokratike i cili, nuk mund të vinte pa sundim të ligjit të siguar nga qeverisja dhe institucionet kosovare. Institucionet dhe lidhshipi politik duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë rol specifik e të vështirë, në këtë periudhë të procesit qeverisës. Pra, qeverisjes dhe institucioneve u takonte krijimi i kushteve për qeverisje demokratike në favor të zhvillimit ekonomik përmes krijimit të sigurisë dhe parakushteve juridike, politike, integruese dhe objektivave e instrumenteve të politikës makroekonomike.
- j) Ndryshimet e sistemit zgjedhor duhej të bëheshin në favor të një sistemi të kombinuar proporcional-mazhoritar, që të absorbonte të gjitha anët pozitive të të dyja sistemeve zgjedhore dhe të relativizonte refleksionet negative të të dyja sistemeve. Edhe zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit nga qytetarët, do të sjellte president më unifikues dhe më të përshtatshëm për ushtrimin e funksioneve e përgjegjëse.

- k) Krahas konkurrencës në mes subjekteve politike, kishte nevojë të thellohej e të dominojë edhe konsensusi, respekti e debati kritik konstruktiv, veçmas në vendimmarrjet për interesa të vendit, e jo të dominojë destruktiviteti naiv në mes subjekteve partiake, i motivuar për interesa të ngushta keqpërdoruese.
- l) Krijimi i vlerave, i njohurive dhe i qëndrimeve të reja etek votuesit. Konsolidimi i subjekteve opozitare me liderë dhe kuadro me integritet. Konsolidimi e veprimtaria më aktive e shoqërisë civile dhe mediave për mbikëqyrjen qytetare dhe gritjen e transparences.
- m) Në frymën e bashkëpunimit intensiv rajonal duhej thelluar edhe bashkëpunimi mbarëshqiptar në të gjitha sferat, veçmas në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, si katalizator i proceseve zhvillimore dhe integruese. Të krijonin parakushte infrastrukturore për procese bashkëpunuese intensive, në pajtim me proceset e kërkuara të bashkëpunimit rajonal, cili është tejet i dobishëm, dhe nuk do jetë në dëm të askujt, përkundrazi.
- n) Të avancoheshin parakushtet juridike e institucionale më efikase e më garantuese për liberalizim dhe konkurrencë të plotë rajonale e globale në harmoni me ligjësitë e tregut të hapur, konkurrent e integruar. Të reduktohej shtrirja e pushtetit partiak e grupor keqpërdorues në sferën ekonomike dhe në privatizimin kompanive publike. Duhej konsoliduar konkurrencën dhe liberalizimin e plotë në të gjithë sektoret. Të forcoheshin institucionet në sferën zbatuese të së drejtës për garantimin dhe sigurinë e aktivitetit ekonomik e biznesor të mirëfilltë sipas ligjësisë të tregut të hapur, përkatësisht, krijimit të parakushteve juridike, politike dhe ekonomike për zhvillim. Pra, fuqizimi i sektorit privat dhe demonopolizim-konkurencë e

privatizim, dhe menaxhim i mirë i sektorit financiar, përmes politikave të qarta afatmesme e afatgjata ekonomike.

- o) Institucionet dhe qeverisja kosovare duhej të ishte më efikase dhe më kompetente për politika ekonomike të shoqëruara më sundimin e ligjit, rendit dhe sistemit juridik, efikasitetin e gjyqësorit dhe administراتes, për arritjen e një ndjenje të sigurisë ligjore. Kërkohej përmirësimi i ambientit biznesor, thjeshtësim i regjistrimit të bizneseve, reduktimi i dokumenteve për import dhe eksport- implementimin në praktik të legjislacionit dhe kornizës rregullative në këto sfera. Kërkohej ngritja e kapaciteteve cilësore administrative për të negociuar në fushat e ndërlidhura me tregtinë dhe identifikimin e përfitimeve e kostove të ndryshimeve në regjimet tregtare. Riorganizim dhe përforcimi i ministrive që të jetë sa më operacionale dhe të pajisur më staf të aftë, që të mbulojë të gjitha aspektet e negociatave tregtare që garantojnë bashkëpunim të plotë në procesin e negociimit. Sigurimi i qarkullimit të lirë të mallrave, lëvizjes së punëtorëve nga jashtë në Kosovë. Regjistrimi i Kompanive të BE-se dhe të vendeve tjera në Kosovë të kenë trajtim të garantuar e të favorizuar. Të krijoj një kornizë ligjore në përputhje me standardet e BE-së për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe sistemeve të pagesave, në veçanti për investimet e drejtpërdrejta.
- p) Të zbulonin dhe promovonin burime të mundshme të rritjes dhe zhvillimit. T'i angazhonin të gjithë aktorët dhe faktorët në linjën e një vizioni për zhvillim të qëndrueshëm. Politika sociale, shpërndarje dhe zbutje të pasojave të krijimit të diferencave në mirëqenien elementare të grupeve të caktuara sociale. Pra, të kishin

një rol më të avancuar të menaxhimit të kujdesshëm të zbatimit të ligjit dhe kushtetutshmërisë, të proceseve ekonomike e politike njëkohësisht.

- q) Kosova ende nuk ka forcë të sigurisë me kapacitete të mbrojtjes, andaj kërkohej formësimi i saj. Duhej të forcohet më shumë kontrolli demokratik mbi sektorin e sigurisë, veçmas nga Kuvendi.
- r) Kërkohej ngritje e nivelit të respektimit më të lartë të të drejtave civile, politike, ekonomike e sociale. Konsolidim i kornizës ligjore për implementim rreth të drejtave pronësore, zbatimit të vendimeve gjyqësore e administrative. Kosova duhet të respektojë dhe përmbush më shumë të drejtat njerëzore të përcaktuara me dokumentet kryesore ndërkombëtare si: Deklarata Europiane e të Drejtave Njerëzore dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
- s) Kërkohej një bashkëpunim më i përafërt në mes të Kosovës dhe BE-së, për të diskutuar e bashkërenduar një kornizë për dialogun politik, integrim, riafirmim gradual, bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Kërkohej implementim i të gjitha marrëveshjeve të arritura në mes Prishtinës dhe Beogradit.
- t) Kërkohej avancim i konsolidimit të kriterëve të ekonomisë së tregut: ndërtimi i kapaciteteve konkurruese, privatizimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike, qëndrueshmëria buxhetore dhe ekonomike, zhvillimi i sektorit financiar, ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe avancim në procesin e integritimit në BE.
- u) Kërkohej harmonizim i legjislacionit, sipas praktikave të BE-së. Të rritëj kapaciteti dhe niveli i ekspertizës në fushën e bashkërendimit legjislativ me të gjitha elementet e acqui-sit të BE-së. Ti kushtohet kujdes Konkurrencës në proceset konkurruese të privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha publike. Ligji për

ndihmat shtetërore të plotësohej me një legjislacion sekondar efektiv. Të amendamentohen aspekte të caktuara të Ligjit për konkurrencë, për të qenë në harmoni me rregullat e konkurrencës së BE-s, të rregullojë monopolet shtetërore të karakterit komercial për të siguruar tregtinë e lirë të mallrave e shërbimeve. Transparencë më e madhe në fushën e ndihmës shtetërore. Gjithashtu kujdes më i shtuar sa i përket mbrojtjes së të drejtës mbi pronën intelektuale.

- v) Kërkohej që, Prokurimi Publik të rritë integritetin dhe transparencën e procesit të prokurimit, ndërsa rastet e korrupsionit të adresohen e të ndëshkohen nga organet përkatëse. Korrupsioni i brendshëm në fushën e prokurimit duhej identifikuar e luftuar me efektshëm përmes efikasitetit të gjyqësorit. Të përmirësohej profesionalizmi në këtë sektor dhe legjislacioni i prokurimit publik të jetë në një vijë me atë të BE-së.

Pra, kërkohej përmirësim në sundimin e ligjit dhe veprime efikase e efektive institucionale konform standardeve demokratike, sipas përcaktimeve kushtetuese e ligjore në të gjithë sektorët. Shumica e këtyre rekomandimeve vlejnë edhe për periudhën pas vitit 2012 dhe për qeverisjen e veprimtarinë institucionale aktuale, ngase disa nga dukurit, problemet, shkaqet dhe efektet, janë ende të ngjajshme.

Shenime plotësuese për burimet dhe literaturën

1. Fukuyama, F.(1989): *The end of history, The National Interest*” N.Y. p.325. Autori, analizon përparësitë e demokracive qeverisëse tek vendet e zhvilluara në proces të zhvillimit, integritet dhe stabilitet ndërkombëtar. Një rol i tillë i qeverisjes demokratike është i domosdoshëm edhe për vendet e tranzicionit, i cili e dërgon vendin dhe shoqërinë në zhvillim, integritet dhe stabilitet ndërkombëtar. Për këto vende kërkon qeverisje efektive, efektive dhe sundim të ligjit në funksion të zhvillimit. Më gjerësisht, Fukuyama, F.2010: *Ndërtimi i shtetit, Qeverisja dhe rendi botëror në shek.21*, AIIS, Tiranë, f.142-177 (përkth. E.Shehi) Sqarohet roli dhe ndikimi i institucioneve të qeverisjes vendore në rendin, qetësinë dhe zhvillimin vendor e global. Sipas tij shkaktojnë krizave në vendet e tranzicionit ishte mungesa e qeverisjes demokratike për një kohë të gjatë, duke përfshirë rastin RFSJ-së dhe rastin e Kosovës. Në këtë punim, në proces dhe kontekst konkret të përmirësimit të legjitimitetit demokratik dhe forcimit të institucioneve, Fukuyama-a e ka fjalën edhe për Kosovën. Ngase shumë nga problemet dhe dukurit të cilat i shtjellon, janë prezente edhe në Kosovë, në kushtet dhe rrethanat e saj, të cilat duhet menaxhuar.
2. Bzhezinski, Z. (1996): *Jashtë kontrollit*, Tiranë, Qabej, f 83. Trajton ndryshimet e rendit ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, në kontekst të përfundimit të kontrollit dhe ndikimit që kishin dy superfuqitë dhe mundësitë e destabilitetit të rendit ndërkombëtar në të ardhmen. Ky ndryshim në nivelin ndërkombëtar ndikoj në destabilitetin ndërkombëtar në rajone të caktuara, por ishte pozitiv për sa i përket ndryshimit të sistemit qeverisës. Por, stabiliteti ndërkombëtar do ketë probleme tjera, të cilat do të kenë ndikime negative në të ardhmen, dhe nuk do të jetë lehtë të menaxhohen, thekson autorin.

Kreu I

3. Kryesisht, janë përdorur sygjerimet metodike të: Weber, M. (2010): *Kuptimi i "çlirimit nga të vlerësuarit"* në shkencat sociologjike dhe ekonomike. F. Noli. Tiranë; Mathes, B. & Ross, S. (2010): *Metodat e hulumtimit në shkencat shoqërore e humanitare*, përkth. Tiranë: ÇDE; Samic, M.(1988): *Kako nastaje naučno djelo*, Sfetlost, Sarajevo; Zogaj, A. 2006: *Stili i shkrimit akademik dhe mendimi kritik*, Universiteti i Prishtinës, (leksione) Prishtinë; Barnett, S., Bellanca, P. & Stubs, M., 2000: *A short Guide to college writing*, (përkth. Stavri Pone-bot. ISP, DITA, Tiranë; APA format- E disponueshme: Google Search, APA format- 2013-2014. Të gjitha këto trajtojnë dhe preferojnë aspekte dhe procedura efektive metodologjike.
4. Andrew Heywood, (2002) *Politics*, 2nd edition, Përkthim dhe botim në shqip, Tiranë: Dudaj-Instituti për studimet publike dhe ligjore, 2008-përkth. Sonila Danaj & Enzo Shijaku. Autori bënë një analizë gjithëpërfshirëse të qartë mbi institucionet, proceset dhe qeverisjen bashkëkohore.
5. Shih: Schmidt M. G. (2010) : *Demokratiethorien*, Weisbaden, shqip. *Teoritë e Demokracisë*, botart, Tiranë, përkth. Sokol Mici) Paraqitja, analiza dhe krahasimi i teorive dhe praktikave qeverisëse demokratike gjatë historisë deri në ditët e sotme. Në veçanti, problemet e sotme-anet e forta dhe (anet e dobëta) të metat e sfidat e shumta të qeverisjes demokratike.
- 6.. Një shpjegim i plotë i faktorëve ekonomik, objektivave të dukurive të instrumenteve, makroekonomike, teoritë dhe praktikat për rritjen; reforma dhe rritja ekonomike në Europën lindore, masat që duhet ndërmarrë institucionet, i gjejmë të Tekstit universitar: Dornbusch, R. & Fischer S. (2000): *Makroekonomia*, Tekst universitar përkthim në Dituria, Tiranë. Janë të qartësuara politikat, dukuritë dhe faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike dhe produktiviteti-teoritë dhe politikat për rritjen. Të gjitha këto njohuri janë të vlefshme edhe për kuptimin e politikave ekonomike të makroekonomike të qeverisë në Republikën e Kosovës.
7. Masat që duhet ndërmarrë për reformat dhe tejkalimin e gjendjes së veshtirë të vendeve në tranzicion pas ndryshimit të sistemit socialist, u përmbledhën edhe në : “*Journal of Economic Perspectives*” Fall 1991; *Symposium on Economic Transition in the Soviet Union and Eastern Europe*. Mendoj se këto masa dhe sygjerime janë të vlefshme edhe për Kosovën.
8. Një analizë koncize, të qartë dhe gjithëpërfshirëse të karakteristikave të përgjithshme të procesit qeverisës demokratik dhe të institucioneve kryesore në krijimin e politikave, vendimmarrjes dhe performancat në stabilitet, sferën materiale, dhe demokracisë në qeverisje, e gjejmë të Andrew Heywood, (2002) *Politics*, 2nd edition, Përkthim në shqip, Tiranë: Dudaj-Instituti për studimet publike dhe ligjore, 2008 (përkth. Sonila Danaj & Enzo Shijaku) Pjesa 4: *Makinia e Qeverisë*. f.313-417, dhe Pjesa 5: *Procesi i politikave dhe performanca e sistemit*. f.423-441
9. Wilson, G. (1990), *Interest Groups*, Oxford: Blackwell. Një shpjegim i rolit të grupeve të interesit në demokracinë liberale.
10. Shih: Andrew Heywood, (2002) *Politics*, 2nd edition, Përkthim dhe botim në shqip, Tiranë: Dudaj-Instituti për studimet publike dhe ligjore, 2008-përkth. Sonila Danaj & Enzo Shijaku) Pjesa 4, f. 315-323. *Klasifikimi*,

qellimet dhe rëndësia e Kushtetutave. Ai thekson se aktet juridike dhe kushtetuta si akti më i lartë, kanë dalë nga përfaqësuesit e votuesve ose nga demokracia e drejtpërdrejtë-referendumi, për interesa e qëllime momentale dhe në perspektivë. Zbatimi i tyre kërkon edhe kulturë, traditë e përkushtim nga shumica e qytetarëve dhe lidhshipi, kërkon mekanizëm juridik e institucional detyrues efikas, si dhe vullnet e proces të qartë politik. Kërkon zgjedhje sipas parimeve demokratike. Si e tillë është mjet dhe qellim bazë e qeverisjes.

11. Amartya, Sen (1999) : *Development as freedom*, Cambridge. shqip: dudaj,Tiranë, përkth.Petra Pojani. Amartya thekson se, qeverisja dhe institucionet duhet të sigurojnë lirinë, mireqenjen dhe zhvillimin e të gjithë individeve të shoqërisë. Ky duhet të jetë qellim dhe instrument-mjet i zhvillimit real, duhet të perfillet nga institucionet dhe i cili vlen për zhvillimin real të çdo vendi dhe zhvillimin global. Kjo objektivi qeverisese duhet të realizohet edhe në Kosovë, si qellim dhe instrument i zhvillimit real i Kosovës

12. Shih: Soros, G. (1999),: *Kriza e kapitalizmit global*, Toena, Tiranë, f.10 (përkth.Xhevat Lloshi) Autori,Paraqet arsyet dhe nevojat e domosdoshme për qeverisje globale.

13. Mills,W. C.(1956): *The pover elite*, (shqip.Buzuku, Prishtinë,2004, f.267-268 dhe 145-178) Shqyrton grupet e interesit në udhëheqjet e dy partive kryesore dhe interesat e tyre grupeve gjatë qeverisjes në vendimmarrjet institucionale. Ai përshkruan edhe lidhshmërinë e veprimin e këtyre grupeve me udhëheqësit dhe qeverisësit e dy partive kryesore. Edhe procesin zgjedhor e konsideron vetëm „rrotacion i tyre” dhe ndikimin grupor e shëh të dyja partitë e mëdha.

14. Dojç, K.(1997): *Analiza e marrëdhënieve ndërkombëtare*, Aferdita, Tiranë, f.26; shih: Richardson, J.(1993), *Pressure Groups*, Oksford and New York: Oksfor University Press, Një grup artikujsh që analizojnë grupet e presionit nga një këndvështrim krahasues; Wilson, G. *Interest Groups* (1990) Oksford: Blackwel. Një diskutim konciz i rolit dhe ndikimit të grupeve të interesit në demokracitë liberale.

15. Shih: Leibhols G. ,1958 :*Der Strukturëandel der modernen Demokratie*, Karlsruhe, 78-141;Hennis (1998) dhe Gabriel/Shtoess (2001) Hennis, W. 1998 : *Auf dem Weg in den Parteienstaat*,Studgart ; Gabriel O./ Stoess, R. ,2001 :*Parteindemokratie in Deutschland*,Berlin

16. Shih: KCSF- CIVICUS: *Qeverisje më e mirë për një ndikim më të madh*, Raporti analitik për Kosovën (mars,2011) *Shoqëria civile në Kosovë*: Koncepti i shoqërisë civile, Analizohet roli dhe ndikimi i shoqërisë civile kosovare në procese të shumta. Pra, edhe ndikimi i saj në demokratizimin e qeverisjes dhe në vendimmarrjet institucionale.

17. Shala, A. (2001): *Roli dhe ndikimi grupeve të interesit dhe grupeve për presion në institucione e procese politike*, Prishtinë:Libri shkollor, Kapitulli III. *Ndikimi grupeve të vendeve më ndikim ndërkombëtar, ndaj proceseve politike në Kosovë f. 156-172*.Ky ndikim vazhdoi dhe ende po vazhdon, ashtu siq parashihej në këtë hulumtim Një analizë e këtyre dukurive në Kosovë 1981-2001. Në vendet e tranzicionit, veçmas në Kosovë, institucionet politike e shtetërore janë të brishta e jo funksionale sa dhe si duhet sipas përcaktimeve kushtetuese. Moszbatimi i vendimeve, jo efikasiteti dhe jo efektshmëria e gjyqësorit, ndikimi i paqartë nga jashtë, etj., e bën specifik rolin dhe ndikimin e grupeve të interesit dhe grupeve të presionit në institucionet dhe në procesin qeverisës dhe në proceset politike kosovare pas vitit 1999 e edhe pas pavarësisë së saj.

18. Mendime, vlerësime e krahasime për demokracinë qeverisëse, kemi që nga mendimet e Antikës, Hobbes-it, Lockes-it, Montesquieus-it, Rousseaus-it, Aleksis de Tocquevill-it, John Stuart Mill-it, Marksit, e shumë e shumë të tjerë.

19. Një analizë gjithëpërfshirëse mbi teoritë dhe përvojat e demokracisë qeverisëse e gjejmë te Schmidt M.G.(2010): *Demokratiethorien*,Weisbaden, perkth.Teoritë e Demokracisë,botart,Tiranë. Si të tilla, mund të na ndihmojnë në kuptimin e thellimin e njohurive dhe referencave matëse, vlerësuese e krahasuese; në kuptimin e shkaqeve, synimeve dhe standarteve demokratike të qeverisjes dhe institucioneve kosovare; Një permbledhje të qartë e gjejmë edhe të: Andrew Hejwood,(2002) *Politics*, 2nd edition,Perkthim dhe botim në shqip, Tiranë: dudaj-Instituti për studimet publike dhe ligjore,2008-perkth. Sonila Danaj &Enzo Shijaku; Ndërsa për problemet konkrete të shtetëndërtimit funksional të vendeve në zhvillim dh në Kosovë e analizon edhe : Fukuyama,F.2010: *Ndërtimi i shtetit, Qeverisja dhe rendi botëror në shek.21*, AIIS, Tiranë, f.142-177 (perkth. E.Shehi); Llambro,F.(2012): *Sistemet politike bashkëkohore*, ideart, Tiranë, etj.

20. Më gjerësisht : Weber, M. (2006), *Politika si profesion, Shkenca si profesion, Tre tipat e pastër të sundimit legjitim*, Fan Noli, Tiranë.; Weber, M.(2010): *Kuptimi i”çlirimit nga të vlerësuarit”në shkencat sociologjike dhe ekonomike*. F. Noli. Tiranë.Më gjerësisht shih: Weber M.(1976): *Wirtschaft und Gesellschaft*,Tubingen. Weber, pranon dobinë shoqërore të nxjerrjes së udhëheqjes dhe rregullave të lojës përmes legjislacionit. Por, ai njëkohësisht thekson se kjo është dytësore në raport me interesat e ngushta, ngjashëm siç është “profiti në raport me produktin” Qeveritë nuk synojnë mirëqenien e përgjithshme, ata

kanë synime egoiste dhe interesa për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit. Mendonte së zgjedhësit nuk janë të informuar dhe të aftë për zgjedhje të arsyeshme, në veçanti në kuptimin e interesave afatgjata.

21. Schumpeter, J.(1950), Po aty,f.411. Ai thekson se, elitat konkurruese fitojnë fuqinë për të vendosur për çështje me rëndësi për tërë shoqërinë. Parlamenti nuk është vend i rrahjes së mendimeve. Aktorët e zgjuar politikë kthehen në bosë, të cilët i drejtojnë partitë e tyre si makineri fushatash zgjedhore, theksonte ai.

22. Downs, A. (1957):*An Economic Theory of Democracy*, New York. Downs, e ndërlidhë teorinë ekonomike me ato politike të qeverisjes dhe interesave. Ka disa pikëpamje të ngjashme me Schumpeter-in, rreth sjelljes së votuesve. Por, për dallim nga Schumpeteri, Downs, sjelljen e tyre e konsideron si sjellje e arsyeshme, në bazë të llogaritjes së kostove dhe përfitimeve, si në ekonomi. Kjo ndodh edhe të sjellja e kandidatëve dhe partitë, të orientuara nga kostot dhe përfitimet e pushtetit, nga oferta, përkatësisht, nga votat.

23. Bentley A.F.(1908):*The Process of Government*, Chicago Qeveritarët që dalin nga pluralizmi partiak dhe ndikimet e grupeve të shumta të interesit, frenohen edhe nga aspekti juridik dhe kontrollet institucionale në mes të pushteteve.

24. Dahl, R.A.(1998): *On Democracy*, New Haven-London. Dahl (1971) theksonte se, shteti duhet t'i shërbejë shoqërisë-sovranit, e jo e kundërta. Për këto kërkon procedura dhe institucione përkatëse. Pra, shoqëria me sferat dhe strukturën organizative plurale aktive, të jetë primare në krijimin e vullneteve politike, në raport me shtetin-institucionet dhe qeverisjen. Ai thekson se për qeverisje demokratike duhen: premiset social-ekonomike dhe faktorët kulturo-politikë dhe shoqëria e strukturuar në mënyrë pluraliste, ku qytetarët kanë qëndrime dhe kulturë demokratike. Gjithashtu ai kërkonte kontroll të ushtrisë e policisë nga zyrtarë të zgjedhur nga populli. Globalizmin dhe evropianizimin e konsideron të pafavorshëm për cilësitë demokratike qeverisëse. Por, i vlerëson pozitivisht kërkesat e BE-së, që shtetet anëtare të BE-së të kenë qeverisje vendore sipas standardeve demokratike dhe e vlerëson efektivitetin e këtyre organizimeve të BE-së. Dahl, R.A.(1971):*Polyarchy Participation and Opposition*, New Haven-London

25. Fraenkel, E.(1991): *Struktur analyse der modernen Demokratie*, Frankfurt, d. 326. Fraenkel, thekson se, organizimi plural partiak në shoqata e grupe të interesit, janë pozitive, ngase shprehin interesa të veçanta, pa marr në tërësi edhe interesat e përbashkëta gjithë shoqërore. Këto interesa duhet t'i përfaqësojnë institucionet dhe qeverisja, përmes përfaqësimit në institucione në politik-bërjen dhe vendimmarrjen demokratike në institucione të shumta dhe në nivele të ndryshme.

26. Karakteristikat e kësaj teorie i gjejmë të Meyer, Th. (2005): *Theorie der Sozialen Demokratie*, Wiwsbaden. Përfaqësuesit e kësaj teorie nuk janë të kënaqur vetëm me të drejtat dhe liritë politike. Ata duan më shumë së të drejtat politike e qytetare të shtetit liberal të së drejtës dhe të shtetit konstitucional. Ata kërkojnë demokraci sociale dhe ekonomike, kërkojnë shtet social për shërbime bazë sociale, për plotësimin e tyre me efektivitet, për të zbutur pabarazinë shoqërore e individuale, siguri të ekzistencës ekonomike për çdo individ. Kjo teori dhe politikë ka kundërshtarët e vet të shumtë. Por, nuk mund të ketë qeverisje demokratike pa zhvillim individual të të gjithë anëtarëve të shoqërisë, veçmas pa i dhënë mundësi të barabarta anëtarëve të rinj të shoqërisë dhe çdo individ, pa marr parasysh gjendjen ekonomiko-ekzistenciale paraardhëse. Në vendet e zhvilluara kuota të mëdha të buxhetit po destinohen për politika sociale.

27. Giddens A. (2007): *Sociologia*, Çabej, Tiranë, f.298-334(perkth.Teuta Starova dhe Kastriot Miftiu) Kjo teori kërkon qytetarë të kualifikuar dhe që transformohen duke marrë pjesë aktive në këto forma e mjete demokratike. Përfaqësues të këtyre pikëpamjeve janë: Habermas (1969), Benjamin Barber (1988), Giddens (1997) dhe përfaqësues tjerë. Më gjerësisht shih: Habermas, J. (1999):*Die Einbeziehung des Anderen*, Frankfurt; Barber, B.R.(1988): *The Conquest of Politics, Liberal Philosophy in Democratic Times*, Princeton, NY.

28. Riker, W.(1982): *Liberalsm against Populism*, San Francisco. Kjo teori kritikon parimin dhe rregullin e shumicës në të cilin thirret demokracia, ngase sipas kësaj teorie ajo nuk ekziston. Qoftë në zgjedhjet me shumicë, proporcionale apo të përziera, në asnjë sistem elektoral dhe ndarje të mandateve, nuk nxirret shumica në pushtet. Gjithherë, një shumicë tjetër voton për alternativa të tjera. Pra, pakica qeveris me shumicën.

29. Lijphart, A.(1994) :*Electoral Systems and Party systems*, Oksford u.a. Sipas kësaj teorie shumë grupeve u mohohet artikulli real i vullnetit politik dhe i interesave në procesin vendimmarrës në institucione dhe qeverisje. Kalojnë dhe mbrohen vetëm interesat e nevojat që janë krijuar nga filtrat e qëllimshëm, në proces të krijimit të vullnetit politik dhe procesit vendimmarrës. Institucionet orientohen dhe reagojnë vetëm në temat që paraqesin rrezik për qëndrueshmërinë politike dhe interesat e vet institucioneve.

30. Schmidt M.G.(2010) :*Demokratiethorien*,Weisbaden, perkth.*Teoritë e Demokracisë*,botart,Tiranë. F. 254-272, Schmidt M.G, kritiken e tyre e përmbledhë në pesë teza kryesore: 1) Shumica është e gabueshme dhe e korruptueshme ngase sundohet nga elitat; 2) Deformohet nga situata ku vendimmarrja është e detyrueshme; 3) Të gjitha votat barazohen, pa marr parasysh vlerën e ekspertizës, angazhimit e përgjegjësisë; 4) Vepron sipas momentit, ndërsa pasojat afatgjata janë të pariparueshme; dhe 5) Krijon konflikte në raport me pakicën..
31. Lijphart, A. (1994): *Democracies:Forms,Performance,and Constitutional Engineering*, EJPR. Përfaqësues të pikëpamjeve kritike mbi demokracinë janë të shumtë: Claus Offes, Guggenberger, Arrow, William Riker, Arend Lijphart, Dieter Nohlen, Bernholz, e shumë të tjerë.
- 32 Paraqitjen dhe analizë të sukseshme të kësaj teorie e gjejmë edhe te: Schmidt M.G.(2010): *Demokratiethorien*, Weisbaden, përkth.*Teoritë e Demokracisë*,botart,Tiranë,f.265; më gjerësishtë Kapitulli 15. *Teoria kritike e demokracisë*, f.254-272
33. Scharpf, F.W.(1970) *Demokratiethori swischen Utopie und Demokratiedefizit*, Konstanz; Kjo teori kërkon një aftësi më të madhe të institucioneve në vendimmarrje, me vlera politike aktive dhe reaguese, më elastike në zgjidhjen e problemeve e të konflikteve në frymën afatgjate, Weber,kerkonte parashikimin dhe parandalimin e tyre, e jo politikë reaktive që reagon vetëm pas proceseve e ngjarjeve.
34. Kjo teori kërkon jo vetëm treguesit, por edhe rezultatet e qeverisjes, qëllimet dhe matjen e tyre. Pra, përfaqësuesit e Teorisë se qeverisjes demokratike komplekse, kërkojnë: pjesëmarrje autentike, qartësi në krijimin e vullnetit, vështirimin e vlerave, aftësi vendimmarrëse, vullnet e aftësi për reforma dhe përcaktime e kriteret të sakta se çka përfitohet nga ndryshimi dhe reforma. Scharpf, F.W.(1970) *Demokratiethori swischen Utopie und Demokratiedefizit*,Konstanz Kjo teori merret edhe me dukurinë e „shkombëtarizimit” të qeverisjes demokratike, si pasojë e integriteteve rajonale e globale që ka përfshirë shoqëritë, ekonominë dhe politikën që po udhëhiqen nga organizatat ndërkombëtare. Ai flet edhe për efektivitetin dhe legjitimitetin demokratik në BE, në efektivitetin e saj në zgjidhjen e problemeve dhe rritjen e mirëqenies.
